

M. FETHULLAH GYLEN

STATUJA E SHPIRTRAVE TANË

Rimëkëmbje e mendimit dhe veprimit islam

Rreth autorit

I lindur në Erzurum të Turqisë Lindore në vitin 1941, M Fethullah Gylen është një dijetar dhe mendimtar islam si dhe një shkrimtar e poet mjaft produktiv. Ai mori mësim në shkenca fetare nga një numër dijetarësh të shquar muslimanë dhe udhëheqës të ndryshëm shpirtorë. Gylen gjithashtu studioi parimet dhe teoritë e shkencave moderne shoqërore dhe natyrore. Duke u mbështetur në aftësitë e tij të jashtëzakonshme për të nxënë dhe për tu përqëndruar në studim, ai shumë shpejt i tejkaloi bashkëmoshatarët e tij. Në 1959, menjëherë pasi u diplomua me rezultate të shkëlqyera, atij iu dha një leje e ushtrimit të profesionit të predikuesit (në Edirne) dhe më pas u ngrit në detyrë duke shkuar në Izmir, qyteti i tretë për nga madhësia i Turqisë në vitin 1966. Atje Gylen nisi të kristalizojë pikëpamjet e tij dhe të rrisë audiencën në mënyrë të dukshme. Në predikimet dhe ligjëratat që mbante, ai e vinte theksin mbi çështjet më të mprehta sociale të kohës: objektivi kryesor i tij ishte nxitja e brezit të ri për të harmonizuar ndriçimin intelektual me botën e pasur shpirtërore dhe aktivizmin në çështje që kanë të bëjnë me humanizmin.

Gylen nuk u kufizua vetëm me predikimet nëpër qytete. Ai udhëtoi kudo në çdo provincë të Anadollit duke predikuar jo vetëm nëpër xhami por gjithashtu edhe në takime të ndryshme në qyteza apo nëpër kafene periferike. Kjo e bëri atë më depërtues në popull dhe tërhoqi vëmendjen e komunitetit akademik, veçanërisht të bashkësisë së studentëve. Temat bazë të ligjëratave të tij, qoftë formale apo informale, nuk kufizoheshin ekskluzivisht në çështjet

fetare; Ai fliste gjithashtu edhe në lidhje me edukimin, shkencën, Darwinizmin, rreth ekonomisë si dhe drejtësisë shoqërore. Falë thellësisë dhe cilësisë së diskutimeve të tij në një gamë mjaft të gjërë çështjesh, shumica e komunitetit akademik mbeti i mahnitur duke bërë që ai të fitonte vëmendjen dhe respektin e tyre.

Gylen u tërhoq nga detyra formale e predikuesit në 1981 pasi ishte bërë një objekt frymëzimi për një brez të tërë studentësh të rinj. Përpjekjet e tij që datojnë që nga vitet 60 veçanërisht në fushën e reformave edukative, e kanë shndërruar në një prej figurave më të mirënjohura dhe të respektuara të Turqisë. Nga 1988 deri në 1991 ai bëri një sërë predikimesh si i ftuar në disa prej xhamive më të famshme në qendrat më të mëdha të banuara, duke vijuar njëkohësisht përhapjen e mesazheve të tij edhe në trajtën e konferencave popullore, jo vetëm në Turqi por edhe në Europën Perëndimore.

Idetë kryesore

Në predikimet dhe shkrimet e tij, Gylen parashikon një shekull të njëzetënjëtë në të cilin ne do të mund të bëhemi dëshmitarë të lindjes së dinamizmit shpirtëror i cili do të rigjallërojë vlerat morale të rëna në letargji; Parashikon një epokë tolerance, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar që do të na udhëheqë drejt dialogut ndërkulturor dhe vlerave të përbashkëta duke sjellë për pasojë lindjen e një qytetërimi të vetëm dhe gjithpërfshirës. Në fushën e edukimit, ai është bërë promotor i themelimit të shumë organizatave bamirëse që punojnë për mirëqenien e shoqërisë, si brenda ashtu dhe jashtë Turqisë. Ai ka nxitur që në fillim përdorimin e massmedias, televizioneve të shquar për të informuar publikun rreth çështjeve më akute që kanë të bëjnë me ta si nga pikëpamja individuale ashtu dhe nga ajo kolektive.

Gylen beson se rruga që të çon tek drejtësia e përgjithshme është e lidhur ngushtë me format e përshtatshme dhe të studjuara mirë të edukimit. Vetëm kur të arrihet kjo do të ketë mirëkuptim dhe tolerancë të mjaftueshme për të garantuar respektimin e të drejtave të të tjerëve. Për këtë qëllim, ai përgjatë viteve, ka nxitur vazhdimisht elitën shoqërore dhe liderët e komuniteteve, industrialistët e fuqishëm por edhe biznesmenët e vegjël për të mbështetur

edukimin cilësor. Falë donacioneve nga të tilla burime, institucione të shumta edukative janë hapur si në turqi ashtu dhe jashtë saj.

Gylen në mënyrë të përsëritur ka shprehur mendimin se në botën moderne e vetmja rrugë për t'i bërë të tjerët të pranojnë idetë tuaja është metoda e bindjes. Ai i përshkruan ata të cilët flasin me gjuhën e forcës si njerëz të degraduar intelektualisht; Njerëzit duhet të kenë gjithmonë lirinë e zgjedhjes për mënyrën sesi ata i kryejnë punët e tyre. Ashtu siç duhet të jenë të lirë të shprehin vlerat e tyre shpirtërore dhe fetare. Demokracia, argumenton Gyleni, pavarësisht mangësive të saj të shumta, është sot për sot i vetmi sistem politik i praktikueshëm, ndaj njerëzit duhet të përpiqen të modernizojnë dhe konsolidojnë institucionet demokratike, në mënyrë që të ndërtojnë një shoqëri ku të drejtat dhe liritë individuale të jenë të mbojtura dhe të respektuara, ku mundësitë e barabarta për të gjithë të mos përbëjnë më vetëm një ëndërr.

Veprimtaritë ndërfetare dhe ndërkulturore

Që nga momenti i daljes në pension, Gylen i ka përqëndruar përpjekjet e tij në vendosjen e një dialogu të vazhdueshëm ndërmjet grupeve që përfaqësojnë ideologji, kultura, fe dhe popuj të ndryshëm. Në 1999 broshura e tij me titull “Nevoja për dialog ndërfetar” u prezantua në Parlamentin e Fëve Botërore të mbajtur në Cape **Toën** në datat 1-8 Dhjetor. Ai i mëshon idesë se “dialogu përbën një domosdoshmëri” dhe se njerëzit pavarësisht kombësisë apo kufinjëve politikë, kanë shumë më tepër gjera të përbashkëta sesa mendojnë.

Duke u nisur nga ky fakt, Gyleni i konsideron këto përpjekje të nevojshme dhe të domosdoshme për vendosjen e një dialogu të sigurtë në mënyrë që të rritet mirëkuptimi reciprok. Për këtë qëllim ai ka dhënë ndihmesën e tij në themelimin e Fondacionit të Shkrimtarëve dhe Gazetarëve në 1994, aktiviteti i të cilit në promovimin e dialogut dhe tolerancës në të gjitha sferat e shoqërisë ka qenë mjaft i mirëpritur nga njerëz të të gjitha fushave. Madje Gylen ka shkuar edhe më tej duke kryer dhe pritur vizita të shumë liderve jo vetëm të Turqisë por të mbarë botës. Ai ka vizituar Papa Gjon Palin II në Vatikan, e më vonë John O Connor arqipeshkvin e **Neë York**, Leon Levy

ish presidentin e Ligës Kundër Shpifjeve dhe mjaft të tjerë përfaqësues të njohur të botës fetare me të cilët Gylen ka shtruar për diskutim çështje që kanë të bëjnë me dialogun duke ndërmarrë edhe iniciativa në këtë drejtim. Në Turqi, Ambasadori i Vatikanit, Patriarku i Kishës Ortodokse Turke, Patriarku i Kishës së Komunitetit Armen në Turqi, Kryerabini i Komunitetit Turko-Hebre si dhe mjaft figura udhëheqëse të tjera janë takuar vazhdimisht me të duke dhënë një shembull kuptimplotë në lidhje me mënyrën se si mund të vendoset një dialog i singertë ndërmjet njerëzve me besime të ndryshme.

Në takimin me Papa Gjon Palin II në Vatikan në 1998, Gylen paraqiti një propozim për ndërmarrjen e hapave të vendosur për të ndaluar konfliktin në Lindjen e Mesme nëpërmjet punës së përbashkët në këtë drejtim në vendin e origjinës së tri feve të mëdha monoteiste. Në propozimin e tij, ai nënvizoi faktin se shkenca dhe feja përbëjnë dy aspekte të ndryshme që burojnë nga e njëjta e vërtetë: “Njerëzimi herë pas here ka mohuar fenë në emër të shkencës dhe ka mohuar shkencën në emër të fesë, duke argumentuar se ato paraqesin pikëpamje që bien në kundërshtim me njëra tjetrën. E gjithë dija i përket Zotit dhe feja buron nga Zoti. E si është e mundur atëherë që këto dy aspekte të përbëjnë konflikt? Prandaj përpjekjet tona të përbashkëta duhet të orientohen drejt dialogut ndërfeetar nëpërmjet të cilit mund të arrihen rezultate të mëdha në shtimin e mirëkutimit dhe tolerancës ndërmjet njerëzve.”

Gylen bëri një deklaratë për shtyp ku dënonte sulmet terroriste të 11 Shtatorit në SHBA të cilat ai i konsideron si një dëm i madh ndaj procesit të paqes botërore duke njollosur padrejtësisht besimtarët e vërtetë: “...terrori nuk mund të përdoret asnjëherë në emër të islamit apo për arritjen e ndonjë objektivi që ka të bëjë me të. Një terrorist nuk mund të jetë kurrë musliman dhe një musliman nuk mund të jetë kurrë një terrorist. Muslimani mund të jetë vetëm përfaqësues dhe simbol paqes, mirëqënies dhe prosperitetit.”

Përpjekjet e Gylenit për paqen botërore kanë pasur jehonë të gjërë në konferenca dhe simpoziume. “Simpoziumi i Heronjëve të Paqes” i mbajtur më 11-13 Prill 2003 në Universitetin e Teksasit Austin, shpalli një listë me mbi 5 mijë njerëz të paqes të gjithë historisë së njerëzimit. Gyleni përmendet në këtë listë mes heronjëve të tillë të paqes si Jezusi, Buddha, Mohandas Gandhi, Martin Lutherking dhe NënëTereza.

Në Mars 2004, Fondacioni Shpirtëror i Kirgizstanit e vlerësoi Gylenin me çmimin e “Përpyjekjeve dhe Kontributit Ndërkombëtor për Paqe” për kontributin e tij në fushën e paqes ndërkombëtare nëpërmjet ideve dhe aktiviteteve të tij në fushën e edukimit.

Gylen ka dhënë kontribut në një numër gazetash dhe revistash. Ai shkruan editorialet e disa revistave. Ai shkruan gjithashtu artikuj kryesorë për The Fountain, Yeni Umit, Sizinti dhe Yagmur, revista këto mjaft të njohura të mendimit shpirtëror në Turqi. Ai ka shkruar më shumë se dyzet libra, qindra artikuj dhe ka të regjistruar me mijëra audio dhe video kaseta. Ai ka dhënë mendimet e tij në shumë çështje në lidhje me shoqërinë dhe fenë. Disa nga librat e tij shumica e të cilëve kanë qenë best-seller në Turqi, gjenden edhe të përkthyer në anglisht si psh “I Dërguari i Zotit : Muhammedi – Një Analizë e Jetës së Profetit,” “Pyetje dhe Përgjigje Rreth Besimit,” “Perlat e Mençurisë,” “Profeti Muhammed si Komandant,” “Të Metat e Besimit Islam,” “Drejt Parajsës së Humbur,” “Koncepte Bazë në Praktikën e Sufizmit” etjerë. Disa prej librave janë përkthyer në gjuhët gjermane, ruse, shqipe, japoneze, indoneziane dhe spanjolle.

Përgjegjësit e fushës së edukimit të frymëzuar nga Gyleni kanë themeluar organizata vullnetare jofitimprurëse të panumërta, fondacione dhe shoqata të ndryshme në Turqi dhe jashtë saj të cilat ndihmojnë një numër të madh nxënësish.

Falë figurës së tij të mirënjohur në publik Gylen ka arritur të shmangë gjithmonë përfshirjen në politikën formale. Admiruesit e tij përfshijnë njerëz të shquar të gazetarisë, akademikë, personalitete të televizionit, politikanë të ndryshëm si dhe autoritete shtetërore nga Turqia dhe jashtë saj. Ata e shohin Gylenin si një novator të vërtetë si dhe një reformator unik shoqëror i cili e vë në praktikë atë që predikon. Ata e konsiderojnë gjithashtu edhe si një aktivist paqeje, intelektual, dijetar fetar, mendimtar, autor dhe poet si dhe një udhëheqës shpirtëror i cili ia ka kushtuar jetën përpyjekjeve për shërimin e sëmundjeve shoqërore dhe plotësimin e nevojave shpirtërore. Ata e shikojnë lëvizjen që ai e ndihmoi të rritet si një lëvizje që i kushtohet tërësisht edukimit të zemrës dhe shpirtit po aq sa edhe atë të mendjes, duke u bazuar në rigjallërimin dhe fuqizimin të gjithë qënies për të arritur nivelin e mjaftueshëm

që bën të mundur garantimin e të mirave dhe shërbimete nevojshme ndaj të tjerëve.

Parathënie

Ata të cilët vërejnë me hollësi botën e ideve të Gylenit do të shohin se ajo që ai ka shkruar apo predikuar para 15 apo 20 vitesh dhe idetë që ai hedh në ditët e sotme nuk kanë kurrfarë ndryshimi dhe nuk përbëjnë në asnjë rast kontradiksion; Përkundrazi të gjitha veprat dhe diskutimet e tij shpjegojnë njëra-tjetrën dhe gradualisht të shpien drejt një ideje kryesore. Ai ka shkruar një bibliotekë të tërë me vepra përgjatë viteve dhe të gjitha këto janë fokusuar në çështje si tronditjet dhe kolapsi në të cilin bota muslimane e në veçanti kombi turk ka rënë, në dështimin në përfaqësimin siç duhet të islamit dhe në arsyet që çuan në këtë, në të kuptuarit e nevojës për rilindje në botën muslimane, në përfaqësimin e islamit edhe njëherë tjetër si një nivel universal si dhe në dinamikat bazë dhe karakteristikat e brezit që do ta kryejë këtë detyrë. E parë nga ky këndvështrim, vepra e Gylenit përmban të njëjtin mesazh që formon një simfoni të madhe kur bëhet e gjitha bashkë. Statuja e Shpitrave Tanë është një prezantim sistematik dhe i hollësishëm i ideve që autori ka sugjeruar për rigjallërimin dhe përpjekjet që duhen bërë në këtë aspekt. Ai është i orientuar drejt rigjallërimit në mendim dhe veprim duke paraqitur konturet udhërrëfyese për ato që quhen sipas tij “Trashëgimtarët e Tokës”

Libri në fillim na jep një pamje të përgjithme në lidhje me kushtet aktuale të botës muslimane duke na mundësuar të shohim pozicionin aktual të muslimanëve i cili përbën një paradoks. Nga njëra anë depresioni, plogështia, dobësia, fakti që njerëzit janë duke prekur fundin për shkak të injorancës dhe supersticionit; Nga ana tjetër njerëzit me përgjegjësi janë më të prirur se më përpara për tu kthyer drejt Zotit duke bërë përpjekje të shumta pothuajse kudo në botën Islame për Rilindje... Ju mund të vëreni njerëz të etur për paqe dhe siguri të cilat premtohen nga islami. Depresioni të cilin autori e përkufizon si “periudha e tatëpjetës”, ka qenë vazhdimisht një plagë që ka pikuar gjak në botën muslimane gjatë shekujve të fundit.

Muslimanët të cilët njëherë e njëkohë i dhanë botës “Një Dimension Parajse”, e sakrifikuan fenë, burimin e tyre të vërtetë të fuqisë, për hir të kësaj bote duke humbur kështu balancën e përkryer që ata vetë kishin vendosur ndërmjet universit, njerëzimit dhe jetës. Në këtë mënyrë ata e shkatërruan trashëgiminë njëmijëvjeçare dhe u përpoqën ta zevëndësojnë atë me tulla dobëta të papërshtatshme me natyrën bazë të njerëzimit. Megjithatë është fakt që pavarësisht gjithë këtyre traumave, stuhish dhe depresioni të kësaj epoke tatëpjete, ideja e rigjallërimit ka qenë gjithmonë prezente në qoshtet e ndërgjegjes njerëzore duke pritur ditën e triumfit.

Me fjalë të tjera e gjithë bota muslimane ka nevojë të ecë drejt një “Ringjalljeje” në mënyrë që të riparohet logjika e lëkundër e muslimanëve, të rregullohen rregullimet dhe të ecet drejt një jete të re dhe të shëndetshme. Ky gjallërim duhet të jetë i tillë që të mund të mbrojë origjinën e fesë brenda gjërësisë dhe universalitetit të premtuar nga parimet fleksibël të islamit, rigjallërim i cili të mund të plotësojë nevojat e të gjitha shtresave të njerëzve dhe të përqafojë çdo aspekt të jetës në çdo kohë dhe në çdo vend.

Është theksuar vazhdimisht se njerëzimi, jeta dhe universi duhet të përballohen duke u nisur nga këndvështrimi islam, ndaj është një detyrë e jona që shoqëritë muslimane të cilat i kanë flakur tutje logjikën, idetë dhe konceptet islame, të nxiten drejt një rilindje të plotë në të gjitha aspektet.

Ata të cilët do ta ndërmarrin këtë përgjegjësi të rëndë dhe që do të ndihmojnë në të kuptuarit e ndryshimit universal, duhet të jenë një lloj i ri njerëzish. Autori i quan ata “Trashëgimtarët e Tokës” dhe i përshkruan si njerëz të cilët pasqyrojnë shpirtin e Profetit dhe moralit Kur’anor.

Në njëfarë mënyre, “Statuja e Shpirtrave Tanë”, përshkruan dhe analizon këtë rilindje e cila tashmë ka filluar. Kjo rilindje është një proces që mund të realizohet vetëm atëherë kur një komb i tërë i rikthehet rrënjëve të tij shpirtërore. Kombi ynë i cili ka përjetuar një rilindje kohë më parë mund të shmangë sëmundje të tilla si “pasioni, përtacia, etja për famë, egoizmi, dashuria për këtë botë, mendjengushtësia, përdorimi i forcës” dhe duke i zevëndësuar me vlera të tilla si të kënaqurit me pak, kurajoja, modestia, altruizmi, dijet dhe virtytet si dhe aftësia e të menduarit universal”; Vetëm

atëherë mund të themi se është arritur një rikthim drejt natyrës bazë duke u mbështetur dhe orientuar tek Kur'ani.

Kjo ringjallje apo rilindje e madhe duhet të bëhet nga pjestarët e kombit i cili në tërësi duhet të ketë të njëjtin shpirt rigjallërimi. Në këtë mënyrë kombi ynë do të fitojë besimin e humbur për një kohë të gjatë dhe do të synojë ta kthejë botën në parajsë. “Statuja e Shpirtrave Tanë” idealizon dhe bëhet zëdhënës i horizontit të mendimit por edhe analizon pengesat shoqërore dhe historike që ngrihen përpara rindërtimit të botës muslimane. Megjithatë Gyleni nuk e humbet kurrë besimin në kombin i cili mbart përbrenda zjarrin e thellësisë së rilindjes duke e ndjerë veten të lidhur me të nepërmjet shpresës së përjetshme.

Në fakt mund të vërehet se tema qendrore e kësaj përmbledhjeje shkrimesh të Gylenit është nxitja e vetëpërmirësimit të orientuar të pasuesve të tij dhe të gjithë muslimanëve në përgjithësi. Muslimanët duhet të përpiqen të bëhen të denjë dhe të mbajnë premtimet e dhëna. Ai aludon vazhdimisht për premtimin që Zoti u ka bërë besimtarëve:

“Ne kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Levhi Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të mirë.” (Enbija 21:105).

Gylen i bën jehonë mësuesit të madh Rumiut kur thotë të mos injorojmë doktrinën e shkaqeve e as të mos rrimë më kot pa bërë asgjë duke pritur ndihmën nga Zoti, por përkundrazi të përpiqemi pa fund në mënyrë që ta transformojmë këtë botë të prishur në botën e paqes dhe drejtësisë në përputhje me vullnetin e Zotit. Ashtu si Rumi, Gylen thekson se liria e vërtetë gjendet vetëm në nënshtrimin me dëshirë ndaj vullnetit të Zotit, prandaj paradoksalisht, është ky nënshtrim dhe vetëm ky i cili mund të na të na çlirojë nga skllavëria e së kotës, rebelizmi shkatërrues, tekat, marrëzia dhe tundimi për të bërë gjëra të ndaluara. Ai na tregon shtegun që të çon tek liria dhe jeta e pasosur, herë duke na dhënë udhëzime të thjeshta dhe të drejtpërdrejta që mund të zbatohen në aspektin e jetës së përditshme ku ne gjendemi e herë me anë të përshkrimeve të bukura të dritës shpirtërore të gjendur gjatë këtij shtegu e deri në destinacionin ku duam të mbërrijmë, prandaj ai na porosit vazhdimisht që të ndjekim me vullnetin tonë të lirë këtë rrugë të drejtë.

Vepra e Gylenit përbën një nxitje konstante për përpjekje, dije, vetëkontroll dhe disiplinë më të madhe. Ai na sjell ndërmend se këto përbëjnë cilësitë për të cilat Zoti do të na shpërblejë. Ai na rikujton vlerën e durimit dhe se sa herë nepër faqet e Kur'anit ne porositemi të jemi të durueshëm dhe të matur. Ai nuk e bën dhe madje nuk e ka bërë kurrë më parë avokatinë e përdorimit të dhunës për qëllime politike. “Ditët e përfitimit me anë të përdorimit të forcës kanë marrë fund,” na thotë. “Në botën e sotme të ndriçuar, rruga e vetme për ti bërë të tjerët të pranojnë idetë tuaja është me anë të bindjes dhe argumentave të pakundërshtueshëm. Ata të cilët përdorin forcën për të arritur qëllimet e tyre janë të degraduar intelektualisht.” Ai nuk është një “eksternalist” domethënë një njeri që mendon se islami mund tu imponohet të tjerëve me anë të zbatimit me forcë të Sheriatit. Ai dëshiron që rinovimi i shoqërisë të nisë nga brenda zemrës. E ndërsa e pohon rëndësinë e ligjit dhe rregullit në shoqëri, ai nuk beson se virtyti mund të injektohet me forcë dhe se shoqëria e virtytshme mund të ndërtohet me anë të dhunës. Përkundrazi, ai proteston sa herë që liria kufizohet pa nevojë. Gyleni mbështet porosinë kur'anore sipas së cilës fiset dhe kombet e ndryshëm që e kanë prejardhjen të gjithë nga Zoti duhet të mësojnë nga njëri tjetri, kështu që nuk duhen hedhur poshtë aspektet teknologjike, politike dhe kulturore të modernizmit perëndimor siç janë demokracia, parlamentarizmi dhe edukimi shkencor. Përkundrazi ai këshillon që këtyre institucioneve t'u jepet një dimension islam duke shmangur në këtë mënyrë si efektet negative të një ideologjie tërësisht laike, ashtu edhe stanjacionin dhe fosilizimin e një shoqërie fetare që nuk i përshtatet mjedisit të vet.

Në sytë dhe në jetën e Gylenit, islami nuk është ajo relike muzeale e brishtë dhe e fosilizuar që laikët modernë do të dëshironin të ishte. Për të dhe për shumë të tjerë që bien dakord me mendimet e tij, islami nuk është vetëm i gjallë dhe vital por është e vetmja rrugë e jona, lidhja jonë e vërtetë me të Vërtetin, Realin, me Burimin e jetës sonë. Prandaj porositë e Zotit në Kur'an, sunnet dhe kozmos, duhet të riezaminohen, rindërtohen dhe t'i përshtaten çdo epoke nën dritën e përparimit të dijes dhe ndryshimit të situatave. Xhihadi i Tij nuk është dëshpërimi i errët dhe mëkatar apo beteja e pashpresë e ekstremizmit i cili e sheh vetveten të rrethuar nga shumë armiq imagjinarë,

por përkundrazi një përpjekje të mbështetur tek besimi dhe optimizmi i njeriut që mendon se Zoti ka vendosur në zemrat e njerëzve dëshirën për mirësi dhe plotësim, duke e paisur me mirëkuptim, prandaj ai beson se detyra e muslimanit është të nxjerrë në pah me butësi këto virtyte dhe t'i ndihmojë ato të lulëzojnë.

Një koncept madhor që trajtohet si temë e veçantë përgjatë këtij libri, është kuptimi i Gylenit për “kombin.” Megjithëse ky koncept i referohet në mënyrë të veçantë botës muslimane dhe popullit turk në kontekstin e rolit të tyre në modelimin e historisë njerëzore si përfaqësuesit dhe lojtarët më të mëdhenj të paqes globale, këtu sigurisht është fjala për shumë më tepër sesa thjesht koncepti i një kombi të veçantë, sidomos kur hedhim sytë nga vizioni dhe idealet e Gylenit për dialog dhe tolerancë. Në këtë libër, Gyleni jep këshilla për zgjidhje të vlefshme për sa i përket lirisë dhe pozicionit të nderuar që çdo popull duhet të synojë të arrijë. Etika motivuese e karrierës së Gylenit siç del në pah mjaft qartë në aktivitete të shumta dialogu dhe iniciativa edukative është ajo e një paqeje botërore tek e cila mund të arrijmë me pjesëmarrjen e të gjithë popujve. Përkufizimi i Gylenit për kombin nuk përfshin një racë të vetme; Anadulli gjithmonë, përgjatë gjithë historisë ka qënë një vend i grupeve të ndryshme etnike të cilat sot formojnë një komb të bashkuar. Larg çdo tipari shovinist, ai i referohet mozaikut shumëngjyrësh të Anadollit i cili i ngjan një kryqëzimi ku takohen njerëz nga Azia Qendrore, Ballkani dhe Mesopotamia.

Në fund, si një nga mendimtarët dhe aktivistët më të shquar të Turqisë e madje të mbarë botës së sotme islame, Gyleni është përqëndruar në veprat e shkruara përgjatë jetës së tij në gjetjen e zgjidhjeve për ndjesi të tilla shpirtërore si ndjenja e përjashtimit, indiferentizmi, dobësia, fataliteti dhe mungesa e integritetit prezente në botën muslimane që nga rënia e Shtetit Otoman në fillim të shekullit të njëzetë. Megjithatë, në kundërshtim nga shumë udhëheqës të tjerë muslimanë, ai as nuk e mohon realitetin duke i kthyer shpinën modernizmit, e as nuk bie në kthetrat e kryeneçësisë, moskuptimit dhe inatit, por përkundrazi, ai u bën thirrje muslimanëve të shkollohen, të kontrollojnë vetveten si dhe të përdorin burimet dhe aftësitë e tyre për të rifituar dhe rikthyer kulturën identitetin dhe vëmendjen ndaj fesë së tyre.

Mesazhi i tij në thelb përbën një mesazh paqeje dhe shprese, mesazh i cili është i dhënë më së miri në librin “Statuja e Shpirtrave Tanë.”

Ne dëshirojmë të falenderojmë Hakan Jeshilovan për mbikqyrjen e gjithë procesit të botimit gjatë publikimit të këtij libri; Kurkut Altay për kritikizmin e paçmuar dhe veçanërisht për bashkëpunimin në kontrollin e përkthimit nga origjinali si dhe Jane Louise Kandur për ndihmesën e dhënë në pikëpamjen stilistike.

Ruth **Ëoodhall**
Muhammed Çetin

BOTA NË EMBRION

Në të shkuarën jo të largët, bota islamike si tërësi ka përjetuar periudhat më të trazuara të saj nga pikëpamja e besimit, moralit, mënyrës së të menduarit, edukimit, industrisë, zakoneve, traditave apo praktikës.

Ndërsa dikur muslimanët dalloheshin shumë më tepër se sot për mëshirën, devotshmërinë, korrektesën dhe nderin; ata ishin më të pregatitur të mbizotëronin në fusha të ndryshme në gjithë botën falë horizontit të tyre shoqëror dhe politik si dhe mënyrës së tyre të të menduarit që ishte më përparimtare dhe e sofistikuar. Ata e praktikonin fenë e tyre pa gabime apo dështime, duke përsosur moralin, duke kuptuar vendin dhe vlerën e shkencës dhe dijes, gjithmonë të aftë për të qënë në ballë të përparimit në dije për standartet e epokës në të cilën jetonin, duke vlerësuar në të njëjtën kohë siç duhet dhe duke balancuar lidhjen dhe ndërthurjen ndërmjet frymëzimit, arsyes dhe përvojës.

Ja përse ata qenë në gjendje të qeverisin territore kaq të gjëra që nga Pirenée deri në Oqeanin Indian, që nga Kazani deri në Somali, që nga Poitiers e deri tek Muri i Madh Kinez, me anë të sistemit më të mirë administrativ dhe

qeverisës të njohur deri në atë kohë duke bërë që idealet e tyre të bëheshin shkas për lindjen e admirimit nga të gjithë. E ndërsa popujt e tjerë po përjetonin periudhat më të errëta të historisë së tyre, muslimanët, në territoret që gjendeshin nën juridiksionin e tyre gëzonin dhe përhapnin tek popujt e tjerë sisteme qeverisjeje të cilat ishin idealizuar si një utopi apo si parajsë tokësore.

Sa keq që kjo pjesë e botës shmangu dhe distancoi vetveten nga dinamikat historike dhe vlerat islame të cilat i kishin mbajtur lart përgjatë epokave dhe u shndërruan në skllavër të injorancës, imoralitetit, supersticionit dhe kënaqësive trupore. Kjo ishte koha kur qytetërimi islam filloi tatëpjetën e tij drejt kthetrave të errësirës dhe mosmarrëveshjeve të mëdha; kur ai filloi të kridhej nga një krizë në tjetrën; kur ai filloi të venitej kudo ashtu si kokrrat e tespihëve kur këputet peri; kjo ishte koha kur islami u la pas dore si fletët e grisura të një libri; kur ai u trondit thellë nga rivalitete të pafrytshme të rënduara dyfish nën peshën e mijëra debateve, i egërsuar dhe i nxitur nga këngët e lirisë sikur të kishte përjetuar skllavërimin, poshtërimin dhe turpërimin më të madh të mundshëm; Kur ai filloi të ndjente mungesën e një ndjenje të fortë identiteti pavarësisht se ekzistonte e fortë ndjenja e egoizmit; kur ai filloi të devijonte udhëzimet e Zotit dhe kur porositë e profetit u dukeshin njerëzve tabu e për më tepër kur muslimanët ishin të mbërthyer nga kthetrat e shumë të tjerëve; kur islami nisi të bëhej “më i mjeri nga të gjithë”.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta të armiqve dashakeqinj nga brenda dhe jashtë, periudha e errët e kohëve të fundit në fakt nuk zgjati shumë. Muslimanët e sotëm të cilët llogariten në rreth 1/5 e popullsisë së botës, janë duke bërë përpjekje për një epokë të re rilindjeje pothuajse kudo në botën islame dhe janë duke u munduar të shpëtojnë vetveten nga kjo periudhë e mallkuar e skllavërimit. Veçanërisht në vitet e fundit, nga fakti që atyre iu desh të ballafaqoheshin me fatkeqësi të reja çdo ditë, është bërë e mundur rritja e ndërgjegjësimit shpirtëror të muslimanëve të cilët mendojnë se ka ardhur momenti i rikthimit drejt Zotit duke e rritur kështu vendosmërinë e tyre.

Ne ishim të sigurtë si për përputhjen ndërmjet shpirtit të islamit dhe natyrës njerëzore, me mbështetjen e tij për përparimet materiale dhe shpirtërore të njerëzve, ashtu edhe për cilësinë e veçantë të tij për të balancuar këtë botë dhe botën e pasosur, prandaj mbijetuam duke pëshpëritur “e vërteta

do të jetë gjithmonë fitimtare; E vërteta kurrë nuk mund të mundet”¹; ndaj natë e ditë ishim në pritje të “fundit të lumtur që është për të devotshmit”², pa e humbur shpresën kurrë. Sot ne jemi në gjendje të dëshmojmë në të gjitha fushat e jetës me tendencë rritjeje të shpejtë të islamit; jemi në gjendje të vërejmë se islami është duke dalë në ballë dhe duke fituar terren në zona mjaft të gjëra që nga Shtetet e Bashkuara deri në Stepat Aziatike, nga Skandinavia deri në Australi.

Megjithëse shumë aktivitete misionare të feve të tjera bëhen sistematikisht nga grupet e ndryshme, ata nuk kanë arritur të ngjallin as një të dhjetën e interesit apo ngrohtësisë së islamit në fetë e tyre respektive. Sot në çdo kontinent mijëra njerëz në vit zgjedhin të përqafojnë islamin, duke gjetur strehë tek drita e Kur’anit edhe pse e dinë se mund t’i nënshtrohen formave të ndryshme të diskriminimit.

Për sa kohë që ne të dështojmë në ruajtjen e bindjes ndaj Zotit, sihariqet e Mesazhit Hyjnor do të përjetojnë përsëri: “Kur erdhi ndihma e Allahut dhe ngadhënjimi, Dhe ti i pe njerëzit të hynin turma-turma në fenë e Allahut, Atëherë falenderojë Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; Sigurisht që Ai është Mëkatfalësi.” (Naser 110 1-3)

Nga Amerika në Europë, nga Ballkani në Murin e Madh Kinez dhe në zemër të Afrikës, kudo e në çdo vend, besimi, shpresa, siguria e për rrjedhojë paqja do të përjetojnë edhe njëherë nën ombrellën e islamit; i gjithë njerëzimi do të bëhet dëshmitar i një rendi të ri botëror i cili do të jetë larg çdo imagjinate; çdokush do të përfitojë sipas natyrës, gadishmërisë dhe mentalitetit të tij.

TRASHËGIMTARËT E TOKËS

Bota është duke ecur përpara si të rrotullohej në orbitën e saj reale... por a janë “trashëgimtarët e drejtë të tokës” të gatshëm të rimarrin dhe të rikthejnë trashëgiminë që u është rrëmbyer nga duart? Të drejtat themelore ishin të garantuara si dhuratë dhe si të tilla janë mjaft të ndryshme nga të drejtat e fituara me anë të përpjekjeve dhe aksionit. Të drejta që nuk jepen për llogari

të meritokracisë, edhe nëse fillimisht i jepen një grupi, kuadri apo populli të veçantë, mund të shkelen në çdo moment; ata mund të vazhdojnë të ndërrojnë duar mes atyre vlera e të cilëve është më e madhe sesa e të tjerëve deri atëherë kur të dalin në pah ata të cilët janë me të vërtetë të vlefshëm.

“Ne kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Levhi Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të mirë.” (Enbija 21:105).

Padyshim që ky premtim i garantuar në këtë verset me anë të një betimi, do të përmbushet një ditë. Madje nuk ka dyshim që nuk bëhet fjalë vetëm për të trashëguar tokën sepse sepse të trashëguarit e tokës gjithashtu nënkupton qeverisjen dhe menaxhimin e burimeve të qiellit dhe hapsirës. Ky duhet të jetë një dominim universal meqënëse ky dominim do ti delegohet një kujdestari apo të ngarkuari nga ana e Zotit, është tepër e rëndësishme madje thelbësore që cilësitë që duhet të kenë trashëgimtarët e tokës dhe qiejve të jenë në përputhje me porositë e Zotit. Vetëm kur plotësimi i njerëzve me këto cilësi të bëhet realitet dhe të vihet në praktikë, ëndrra e mësipërme mund të realizohet.

Qysh nga epokat e trazuara të historisë ata të cilët pretendonin se ishin trashëgimtarët por që dështuan në kryerjen e detyrave që buronin prej kësaj trashëgimie hyjnore përjetuan heqjen e kësaj forme mbizotërimi nga ana e Pronarit të Gjithçkaje; e vetmja rrugë për të shpëtuar nga një privim i tillë është rikthimi dhe kërkimi i strehës nga Ai.

Zoti nuk ia ka premtuar këtë trashëgimi një klani, fisi, kombi apo race të veçantë. Trashëgimia është për ata shërbëtorë të Tij të cilët janë të drejtë në mendim dhe fe; për ata të cilët zotërojnë një shpirt muhammedi dhe moral kur'anor; për ata të cilët mbjellin dhe përhapin idenë e unitetit, mirëkuptimit, bashkimit dhe solidaritetit; të cilët janë të vetdijshtëm për epokën në të cilën jetojnë; të cilët janë të paisur mirë me njohuri dhe dije shkencore; të cilët e mbajnë dhe kujdesen vazhdimisht për balancën ndërmjet kësaj bote dhe tjetrës; Shkurt, për heronjtë e shpirtit, realiteti dhe vizioni shpirtëror i të cilëve pretendohet të jetë në të njëjtën orbitë me Sahabet e të Dërguarit të Allahut, yjet zbukurues të qiellit të profecisë. Prandaj kjo trashëgimi qëndron brenda kontureve të sunnetullahut, rrugës së Zotit, mënyrës së Tij të trajtimit të çështjeve.

Sipas ajetit “Ju nuk do të gjeni asnjë shmangie në rrugën e Zotit dhe nuk do të gjeni asnjë ndryshim në ligjin e Zotit” (Fatir 35:43), ky përbën një ligj të natyrës që është ligji i krijimit siç është urdhëruar nga Alahu ndaj ai është i pandryshueshëm.

Kjo është arsyeja përse të qënit trashëgimtar të tokës kushtëzohet para së gjithash nga përpjekja e vazhdueshme për ta jetuar fenë në përputhje me kur'anin dhe sunnetin. Së dyti do të thotë të përpiqesh për ta bërë fenë themelin e jetës. Së treti është e domosdoshme të drejtuarit e shqisave nga shkenca dhe dijet e epokës përkatëse. Një pikë e cila nuk duhet harruar kurrë është se ndëshkimi bie në mënyrë të paevitueshme mbi ata të cilët nuk i binden ligjeve natyrore prezentë ne univers (shfaqja e Vullnetit dhe Fuqisë së Allahut në univers) si dhe ligjeve Hyjnore (të manifestuara në shkrimet e shenjta të cilat rrjedhin nga cilësia e Zotit e quajtur kelem - të folurit njerëzve) në shkrimet e shpallura. Ky ndëshkim bie gjithashtu mbi ata të cilët kanë përjetuar një ndryshim negativ në jetën e tyre shpirtërore edhe nëse në atë moment mund të jenë duke gëzuar pozita dominuese mbi të tjerët. Historia, varreza e popujve që kanë rënë dhe janë shuar për këtë arsye, është dëshmitare e këtij fakti. Zoti kurrë nuk ia heq avantazhet dhe të mirat që i ka garantuar një shoqërie apo kombi dhe nuk ia ndryshon kurrë gjendjen për sa kohë që populli vetë bën ndryshime në mënyrën e të jetuarit, botën e brendshme, derisa ta deformojë veten, shpirtin dhe thelbin e tyre. Verseti i cituar më sipër dhe ky që po citojmë “Vërtet, Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli derisa ndryshimi të vijë nga brenda tyre” (Rrad 13:11) i cili ka lidhje me qeverisjen dhe të qeverisurit, nderin dhe poshtërimin, na sjell ndërmend një parim të përgjithshëm mjaft domethënës dhe gjithashtu hedh dritë mbi dështimin në mënyrë të veçantë të muslimanëve të ditëve tona.

Ne mund ta përmbledhim këtë dështim me fjalët deformim i pësuar si në strukturën e brendshme (në zemër dhe në shpirt) ashtu edhe në atë të jashtme (ngelja prapa në dijet bashkohore). Nuk ka shumë rëndësi nëse kjo ka ardhur si rezultat i pengesave të vendosura nga të tjerët për mbi dyqin vjet me radhë, apo për shkak të injorancës, plogështisë, paaftësisë dhe mangësisë. Një gjë është e sigurtë se komuniteti islam është duke derdhur gjak të kotë për shkak të indiferencës së tij dhe duhet që sa më shpejt, për të mirën e vet të bëhet

burim i fuqisë e cila e ka mbajtur në këmbë për shekuj me radhë dhe që do ta kthejë muslimanin në “trashëgmtarin e merituar të tokës.”

A mund të themi që ata të cilët pretendojnë se e përfaqësojnë islamin në një periudhë të tillë kaq fatkeqe kanë zemrën aq të madh dhe shpirtin aq të pastër sa muslimanët e parë? A mund të themi që muslimanët duhet të lënë menjëanë dhe të harrojnë dëshirën e tyre për të jetuar dhe të pajisen më dëshirën që buron nga bota e madhe shpirtërore për ti bërë të tjerët të jetojnë? Sa njerëz mund të jenë ata të cilët jetojnë të ndërgjegjshëm se ajo që po bëjnë do të shpjerë drejt së mirës, së bukurës, së vlefshmes dhe së dobishmes dhe jo drejt shkatërrimit? Sa njerëz të singertë mund të përmendim të cilët kanë preferuar më mirë të vdesin me nder sesa të jetojnë të përbuzur? Sa shpirtra të ndritur mund të tregojmë të cilët nuk i janë nënshtruar shtypjes apo pengesave të armiqve dhe të cilët kanë vijuar të jetojnë pa e ndryshuar kursin dhe drejtimin e jetës së tyre?

Gjatë një periudhe të tillë të errët, plogështia e administratës dhe administratorëve është pikëlluese. Megjithëse Kur’ani i ndalon muslimanët të jetojnë nën sundimin e tiranëve, fatkeqësisht kemi qenë të paaftë ta shpëtojmë vetveten nga kjo e keqe. Prandaj ne nuk mund të mohojmë se kemi vuajtur varfërinë dhe poshtërimin e madh nën thundrën e atyre të cilët na kanë mbajtur të shtypur për vite nën sundimin e tyre.

E vërteta është se ne kemi bërë një prej gabimeve më të pafalshme në histori: për ta bërë botën tonë materiale të përparuar, kemi sakrifikuar fenë dhe kemi adoptuar një sistem mendimi që ka e ka bërë botën më të preferuar se fenë; për rrjedhojë ne jemi ndeshur vazhdimisht me një “rrjetë pamundësish dhe absurditetesh.” Për pasojë, jo vetëm e kemi humbur fenë por gjithashtu kemi dështuar edhe të përfitojmë nga kjo botë. Ky komb i lavdishëm por i pafat vuajti një periudhë zbrazëtie: një histori e bekuar dhe një mijë vjet trashëgimi u flakën tutje; prejardhje të shpikura së fundmi iu imponuan njerëzve; një shtet i madh u rindërtua me anë të “tullave” të papërshtatshme të parimeve të cilat nuk kanë jetëgjatësi vlerash; historia, lidhjet e bashkësisë dhe kulturës, prejardhja dhe kultura dhe trashëgimia kombëtare u shpërfillën, fyen dhe përqeshën; ne gjetëm strehë tek ata të cilët për njëmijë vjet me radhë i patëm kundërshtarë të sistemit tonë të mendimit dhe që kishin ide krejt të

ndryshme nga tonat të cilat u importuan tek ne bashkë me idetë më profane dhe shprehjet më të tmerrshme të mundshme. Atyre të cilët i bënë jehonë me sukses gjërave të tilla në prozë dhe poezi iu dhanë çmime dhe shpërblime; në një botë të tërë shtrembërimi, padrejtësie, dënimesh dhe shtypjesh ata pretendonin që me sisteme të tilla si komunizmi të arrinin prosperitet në ndjenja, mendime dhe moral.

Unë akoma sjell ndërmend faktin se kur ideologji të tilla si socializmi dhe komunizmi ishin në ditët e tyre më të mira, ekzistonte një grup prej afro dymbëdhjetë të paaftësh, të lodhur nga mosbesimi, të cilët dyshonin edhe në veten e tyre dhe të cilët gjithmonë ndjenin nevojën e fshehjes pas figurave publike, dogmave dhe ideologjive në mënyrë që ta sulmonin fenë, që sulmonin çdo gjë të shenjtë në një mënyrë mizore dhe vulgare. Në ditët e sotme ne po përjetojmë fushatën më të turpshme dhe të tmerrshme të këtij lloji për shkak të të njëjtëve individë, të njëjtës bandë. Akoma duke u mbështetur në të njëjtat ideologji të paligjshme, ata vjellin gjithë urrejtjen keqdashëse dhe mllëfin e tyre dhe deklarojnë luftë për tu mbyllur gojën njerëzve të devotshëm e fetarë dhe gjithë fesë në përgjithësi. Poeti i njohur kombëtar turk Mehmet Akif Ersoy (1873 – 1936) i cili është autori i himnit kombëtar turk i ka theksuar këto çështje tek libri “Safahat” (Fazat) me zemër të thyer dhe me ankth mendor kur ka ilustruar fuqishëm periudhën e errët gjatë së cilës muslimanët dhe islami ishin vënë në vëzhgim, goditje, ndjekje dhe persekutime dhe kur dashuria, entuziazmi dhe lidhja me fenë urrehej, përçmohej dhe përbuzej.

Megjithatë unë dua të theksoj faktin që ky komb i ndritur i cili ka pasur fatin e keq të vuajë shtypjen arbitrare dhe blasfemuese për vite me radhë nuk është nënshtruar kurrë plotësisht dhe aspiratat drejt jetës së pasosur kanë qënë gjithmonë prezente në jetën e tij. Këto aspirata përbëjnë në të njëjtën kohë një thëngjill të kuq e të nxehtë, një shkëndijë që kërcet dhe ndizet më tepër kur trazohet, dhe një burim drite që është në gjendje të ndriçojë botërat; ato janë bashkuar me forcën qendërsynuese të kujdesit, maturisë, largpamjes dhe vetpërmbajtjes. Gjë që ka sjellë reduktimin në përmasat e një embrioni të tyre me qëllim aftësimin për të mbijetuar në ditët më të tmerrshme të shekullit por duke parë në horizont përmbushjen e tyre dhe gadishmërinë për të ndërtuar plotësisht botën kur koha e tyre të vijë.

Ne duhet ta marrim parasysh periudhën e gjatë të mjerimit në të njëjtën masë sa edhe vështirësitë e kaluara dhe përpjekjet për të dalë nga kjo situatë. Duke kuptuar islamin i cili është një burim i mjaftueshëm fuqie për rigjallërimin tonë shpirtëror dhe material, në përputhje me thelbin e tij dhe duke iu bashkangjitur shërbëtorëve të tij të drejtë, emocionet, mendimet, perceptimet, ndërgjegjia dhe vullneti i të cilëve janë kumbuese dhe të fuqishme, të cilët qëndrojnë të palëkundër në idenë e të jetuarit dhe komunikuarit të Fjalës së Zotit,⁴ të cilët janë sistematikë në përfitimin e dijeve, besnikë në punën dhe sjelljet e tyre, me karakter të fortë, të cilët nuk rendin pas dëshirave trupore dhe të cilët kanë arritur të harmonizojnë zemrën dhe mendjen e tyre, le të provojmë edhe njëherë se ne jemi trashëgimtarët e tokës. Nëse Zoti na jep udhëzim dhe sukses, ne do të vazhdonim të ecnim në udhëtimin tonë sipas drejtimit të kësaj linje të humbur.

SI TA GJEJMË RRUGËN TONË?

Që nga dita kur ne u privuam nga trashëgimia e tokës bota islame është ndodhur në një gjendje të mjerueshme mes dobësisë së muslimanëve dhe sulmeve të pareshtura të armiqve. Fajet, drejtësia dhe shtypja mund të përbëjnë veti të agresorëve, por dobësia e muslimanëve është e papranueshme. Kur i dërguari i Zotit tha “O Zoti im unë kërkoj mbrojtje tek Ti nga guximi i mekatarëve dhe nga dobësia e atyre që të kanë frikë” ndoshta i referohej këtij fakti.

Fakti që mendja dhe arsyeja e muslimanëve u godit dhe u dëmtua domethënë stanjacioni dhe kalbëzimi ndaj të cilit muslimanët ishin keqorientuar, i shmangu ata nga rruga e drejtë e cila ecën përgjatë Kur’anit dhe sillet rreth Profetit. Ky degradim e veniti universalitetin e islamit dhe e pengoi këtë fe të përbotshme të përmbushë funksionin e saj. Është e qartë se një devijim i tillë i cili është shndërruar në kronik në radhët e muslimanëve të shekullit të fundit dhe veçanërisht në radhët e udhëheqësve muslimanë nuk mund të ç’rrënjohet me ngritjen e disa shkollave, komisioneve apo mbajtjen e disa konferencave, e as nuk mund të kuptohet tërësisht me anë të ca fjalimeve në ajër, leksioneve apo propozimeve.

Për të ç'rrënjosur këtë lloj devijimi të gjatë në kohë, rrënjët e të cilit shkojnë disa shekuj më parë, të ushqyera nga përdorimi i gabuar i shkencës dhe teknologjisë së sotme, lypset që ne ta rizbulojmë vetveten, të gjejmë dhe të njohim kush jemi dhe ta paisim veten me ndërgjegje dhe stilin e të menduarit dhe të arsyetuarit islam; nevojiten përpjekje për një kohë të gjatë, zell i vazhdueshëm, kohë e mjaftueshme, durim i pareshtur, shpresë e madhe, vullnet i palëkundër dhe vetpërmbajtje konstante. Megjithëatë në qoftë se ne nuk mund të gjejmë stilin tonë dhe vazhdojmë të kërkojmë në një rrugë tjetër nga rruga e vërtetë për të dalë nga gropa ku kemi rënë, do të gënjëjmë vetveten dhe do të biem në kundërshtim me brezin tonë edhe njëherë tjetër.

Nga kjo pikëpamje, është një detyrë për ne të kuptojmë siç duhet konceptet në mënyrë që ti shohim krijimin dhe ngjarjet nga këndvështrimi islam dhe të studjojmë hollësisht gjithçka me anë të arsyes islame. Për të arritur këtë, dija jonë rreth njerëzimit, jetës dhe universit duhet së pari të jetë në akord me thelbin dhe realitetin e çështjes, në të njëjtën rrugë dhe orbitë me origjinën dhe objektivat e saj: të gjitha pjesët duhet të mbështesin njëra-tjetrën dhe të bashkëpunojnë; tërësia dhe pjesët e veçanta duhet të lidhen dhe ndërveprojnë si zëra të ndryshëm që shprehin të njëjtën temë, si një kompozim me të njëjtin ritëm dhe me të njëjtin sistem matjeje, si një motiv imët i rrethuar nga një skicë e përsëritur. Çdo fenomen apo çështje duhet të përceptohet dhe njihet si i ndërlidhur në një mënyrë apo në një tjetër thelbësisht dhe në mënyrë domethënëse me çdo gjë tjetër që e rrethon. Së dyti, meqënëse se çdo gjë, qenie dhe fenomen në univers është e përbërë prej plot botërash të ndryshme, kuptimi, përmbajtjeje, dhe mençurie që i ngjajnë një libri të hapur për çdo qenie dhe ngjarje, një vepre të bukur arti me shumë faqe të mbushur me bukuri dhe që pasqyron dhe paraqet vepra të panumërta hyjnore, arsyeja dhe logjika duhet të përdoren për të kuptuar gjithë këto gjëra dhe ngjarje, për të njohur lidhjen ndërmjet pjesëve të vogla pa u ngatërruar në çikërrima. Përkundrazi, duke qenë të ndërgjegjshëm për të përgjithshmen dhe universalen që shtrihet pas dhe për të veçantën kur futet me guxim brenda të përgjithshmes dhe universale në mënyrë që të përfshijë zonat më të largëta të detajeve dhe veçantive, ne mund të jemi në gjendje të sigurohemi se disa pjesë të punës dhe studimeve tona, vërtetimet dhe konfirmimet tona ashtu edhe ndryshimet e

periudhave dhe kohërave, nuk bien në kundërshtim, mohojnë apo përplasen me njëra tjetrën.

Kjo nuk duhet të sjellë përshtypjen e gabuar se specializimi apo fragmentizimi duhet të injorohen. Sigurisht secili nga ne duhet të specializohet në fushën e vet, të përpiqet të shkëlqejë në atë karrierë dhe të arrijë objektiva e dëshiruara në fushën e vet të veprimit. Megjithatë duke vepruar kështu nuk duhen neglizhuar kuptimi përmbajtja statusi dhe veçanërisht qëllimi dhe objektivi i tërësisë. Kjo duhet të realizohet në mënyrat e duhura, qoftë nëpërmjet ndërgjegjës kolektive, qoftë me anë të përpjekjeve vetjake për të arritur tek dija apo nëpërmjet koordinimit të mirëfilltë dhe gjenialitetit. Nuk ka dyshim se ne kemi nevojë për një këndvështrim të tillë universal (të shenjtë) dhe mirëkuptues (gjithpërfshirës), ashtu siç kemi nevojë edhe për një vlerësim të përgjithshëm dhe objektiv.

Sot ne kemi nevojë të madhe para së gjithash për një mendje objektive e cila të mund ta shohë të djeshmen dhe të sotmen sëbashku, e cila të mund ta përfshijë njerëzimin jetën dhe universin brenda këndvështrimit të vet të gjithin dhe përnjëherësh, e cila të mund të arrijë të bëjë krahasime, e cila të jetë e mprehtë në përceptimin e dimensioneve të shkaqeve dhe të arsyes së ekzistencës, e cila të ketë njohuri në lidhje me skenaret e ngritjes, vazhdimësisë dhe rënies së kombeve dhe bashkësive, e cila të mund të gjykojë gabimet, fajet dhe meritat e sociologjisë dhe psikologjisë, e cila të jetë e paralajmëruar për lindjen, rënien dhe vdekjen e stadeve të qytetërimeve, e cila të ketë aftësi, ndërgjegje kumbuese dhe pavarësi për të dalluar metodat dhe përfundimet, e cila të respektojë objektivat dhe të ketë familiaritet me parimet dhe mençurinë e Ligjit Hyjnor dhe me qëllimet e përcjellësit të ligjeve (Profetit), e cila të jetë koshiente për shtyllat e pranuar si baza të fesë dhe e cila të jetë e hapur për mendimet dhe frymëzimet që rrjedhin nga Zoti.

Gjatë kohës që ne jemi duke pastruar dhe liruar kanalet e bllokuara të mendjes sonë dhe duke rindriçuar sistemin tonë të arsytimit i cili ka qënë i kthyer me shpinë nga sublimja duke u bërë kështu bajat, në mënyrë që ai të udhëtojë nëpër orbitën e duhur rreth Kur'anit, ne nuk duhet të neglizhojmë sekretet e njerëzimit, jetës dhe universit. Duke vepruar pa reshtur nën urdhërat fetarë duke bërë ata pjesë të jetës sonë, një veprim ky i cili përbën një nga

bazat më domethënëse për një vazhdimësi të gjatë dhe të pandërprerë, ne duhet t'ia lehtësojmë rrugën vetes ashtu siç bëri i Dërguari i Allahut me anë të së bukurës dhe fisnikes, tolerancës dhe faljes, duke u treguar të tjerëve se kjo është një mënyrë inkurajimi e cila të fton me anë të sihariçeve dhe jo një rrugë e cila i dekurajon dhe zbraps njerëzit duke i mbushur ata me shije të keqe dhe neveri.

Ne duhet të vendosim fuqinë e dijes dhe meditimit në thelb të islamit dhe interpretimit islam duke sjellë përfundimisht fundin e epokës së shterpësisë dhe joproduktivitetit të përjetuar në shekujt e fundit. Ne duhet të vendosim kudo, në shtëpi dhe rrugë, në shkolla dhe vende adhurimi vëzhgues me anë të të cilëve të mund të vërehet e vërteta që qëndron pas njerëzimit, jetës dhe universit.

Ne duhet të rihapim rrugët e të përjetshmes të cilat kanë qënë të bllokuara për disa shekuj me radhë. Ne duhet ta ngremë islamin në vendin e parë dhe më të rëndësishëm të axhendës duke e injektuar në çdo element të jetës.

Ne duhet të bëhemi të ndjeshëm ndaj çështjes së shkaqeve dhe pasojave duke vepruar në mënyrë racionale dhe të llogaritur mirë, në përputhje me parimet e lidhjes dhe proporcionit të shkaqeve. Një cilësi e tillë e kuptimit, perceptimit, njohjes dhe maturisë do ta lehtësonte rigjallërimin dhe reformimin tonë dhe do të na siguronte gurët e themeleve të jetës së pasosur.

Disa mund të mendojnë se dhënia e një rëndësie kaq të madhe shkaqeve është jo korrekte. Deri në njëfarë mase unë jam dakord. Megjithëatë njerëzimi duhet të bëjë atë që është i detyruar ta bëjë dhe nuk duhet të ndërhyjë në çështjet hyjnore. Një detyrë e tillë është përgjegjësi e jona ndaj vënias në përdorim e shkaqeve në përmbushjen e kësaj detyre përbën një formë lutjeje apo kërkesë të paraqitur në dyert e mëshirës së Zotit e barazvlefshme me një lutje të bërë me qëllim arritjen e një objektivi të dëshiruar. Të pranuarit për të vepruar në këtë mënyrë përbën një parakusht për njohjen e faktit që ne jemi të krijuar dhe Ai është Krijuesi dhe i njohjes së Cilësive të Tij Hyjnore.

Megjithëatë ekziston edhe ana tjetër e medalies. Zoti na ka dhënë ne vullnet të lirë (ekzistenca e të cilës konsiderohet si e mirëqenë) dhe e pranon atë si një ftesë drejt Vullnetit të Tij, duke na premtuar të vendosë projektet më thelbësore nën sundimin e këtij vullneti, një plan ky të cilin Ai e ka vënë në

zbatim dhe do të vazhdojë ta vërë në të ardhmen. Zoti e krijoi vullnetin tonë për shkak të mekatit dhe si bazë për shpërblim dhe ndëshkim, ndaj Ai e pranon atë si një element për përshkrimin e së mirës dhe së keqes.

Duke pasur parasysh rrjedhojat në lidhje me të, Zoti i jep vullnetit tonë i cili në vetvete nuk ka ndonjë vlerë, një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera të tillë që në rast se Ai nuk do të kishte vepruar në këtë mënyrë jeta nuk do të kishte pushuar së ekzistuari, qëniet njerëzore do të ishin katandisur në sende të pashpirtë, shtrirja e obligimeve të shërbëtorëve të Zotit do të ishte bërë e papërcaktuar dhe çdo gjë do të ishte kthyer në të padobishme dhe absurde. Kjo është arsyeja përse Zoti i ka dhënë rëndësi të madhe vullnetit tonë të lirë si dhe dëshirave dhe ëndrrave të njerëzimit; Ai e pranon atë si një kusht për ndërtimin dhe përparimin si të kësaj bote ashtu dhe të botës së pasosur duke e bërë këtë vullnet një shkak të konsiderueshëm, që i ngjan një çelësi magjik të një mekanizmi elektrik të fuqishëm që është në gjendje të ndriçojë botërat. Në të njëjtën mënyrë, Ai mund të krijojë dhe t'i japë ekzistencë një oqeani vetëm nga një pikë ujë, një dielli nga një atom dhe botërave të tëra nga asgjëja duke manifestuar kështu një nga dimensionet misterioze të fuqisë së Tij.

As shkaqet e as një ligj, qeveri, apo fuqi nuk mund të influencojë tek Zoti, Krijuesi i Plotfuqishëm. Asgjë nuk e pengon Vullnetin dhe Fuqinë e Tij Hyjnore. Çdo gjë është e vendosur dhe Zoti është Ligjvënësi i vetëm dhe absolut. Por edhe vëzhgimi i shkaqeve duke u dhënë ndikim atyre dhe duke vlerësuar arsyet për këtë ndikim si një pjesë e vogël e të vepruarit, përbën gjithashtu një urdhër të Zotit. Prandaj kur njerëzit nuk i zbatojnë parimet e ligjeve të natyrës të krijuara nga Zoti e të quajtura “sunnetullah” (rruga e të vepruarit të Zotit / rruga e Zotit, mënyra e trajtimit të Tij të çështjeve), ne besojmë se ata do të dështojnë keqas si në këtë botë ashtu edhe në botën e përtejme.

Sa kuptimplote ishte sjellja e kalifit Omer kur duke dashur të evitonte një zonë të infektuar nga kolera ai u tha atyre të cilët ishin të paaftë të ndanin këtë vendim të tij nga ideja e dorëzimit ndaj fatit dhe nënshtrimit ndaj vullnetit të Zotit: “Po iki nga caktimi i Zotit tek caktimi i Zotit.”

Në aktivitetin, punën dhe përpjekjet e një njeriu i cili në mënyrë jo të studjuar orientohet vetëm e vetëm drejt rezultateve duke i bërë ata objektivin

e vetëm të dëshirave të tij dhe duke sjellë pa nevojë një mbingarkesë në vuajtje dhe poshtërim, ky njeri larg qoftë është duke bërë pazarllek me Zotin. Nga ana tjetër mosmarrja në konsideratë e vullnetit njerëzor dhe zgjedhjes së lirë duke pritur që rezultatet të vinë nëpërmjet ndonjë mrekullie, në ndonjë mënyrë jo të zakonshme drejt për drejtë nga Zoti, përbën një iluzion të rremë dhe një arsye për mjerim. Kur’ani thotë shpeshherë në shumë vende “si një shpërblim për atë çfarë ata bënë,” “si një shpërblim për atë çfarë ata fituan,” “apo si kompensim për atë që ata punuan.”

Kur’ani i lajmëron njerëzit se ajo që ata kanë përjetuar si dhe ajo që ato do të gëzojnë apo vuajnë, prej së mirës apo së keqes është thjesht rezultat i sjelljeve veprimeve dhe punëve të tyre. Kur i dërguari i Zotit, shembulli i përkryer i balancës së zemrës, mendjes dhe ndërgjegjes tha “Në ditën e Gjykimit, pa mundur të lëvizë as edhe një hap çdo njeri do të pyetet se ku e ka kaluar jetën, si e ka përdorur dijen, si e ka fituar pasurinë dhe ku e ka shpenzuar atë si edhe ku e ka lodhur trupin,” ai do të nxirrte në pah fuqinë dhe lidhjen misterioze ndërmjet shkaqeve dhe pasojave, përpjekjeve dhe përfitimeve.

E ndërsa islami nëpërmjet kur’anit dhe sunnetit bëhet rregullator i besimit, veprave, lutjeve, moralit dhe jetës së besimtarëve në këtë botë dhe në tjetrën, ai pëshpërit në të njëjtën kohë nëpërmjet rreshtave, brenda botës sonë mendore, zemrës, shpirtit, emocioneve, ndërgjegjes dhe arsyes nga një botë dimensionesh të tjera, botë e së padukshmes, gjëra të tilla kaq të ndryshme të cilat ngohin jashtëzakonisht, prodhohen në thellësi të personalitetit tone dhe ndjenjave të ngjyrosura me kolorit hyjnor. Në këtë mënyrë, në çdo moment islami rigjallëron njerëzimin edhe një herë në një dimension të ndryshëm.

Kështu, ne e shohim veten në pozicionin e mëkëmbësit të Zotit, në një pozicion që na lejon të ndërhyjmë në fenomenet natyrore dhe të kuptojmë dhe vëzhgojmë misteret e ligjeve të natyrës. Pastaj ne bëhemi në gjendje të perceptojmë librin e universit që buron nga Vullneti dhe Fuqia Hyjnore dhe nga fjalët që burojnë nga cilësia e Tij Hyjnore e Kelem (Ligjëruesi) nëpërmjet shpalljes, si dy anë të së njëjtës medalje, ndaj kështu ne jemi në gjendje të përmirësojmë mendimet dhe konceptet tona, veprimet dhe sjelljet,

konsideratën për këtë botë dhe tjetrën, në përputhje me balancën e vendosur ndërmjet qiejve dhe tokës.

Islami e thur pëlhurën e tij nëpërmjet mendjes, trupit, shpirtit dhe ndërgjegjes së njerëzimit duke ndërthurur dimensionet e kësaj bote me botën e pasosur brenda një dantelle të bukur dhe shumëngjyrëshe. Herë pas here fijet e mendjes, trupit, shpirtit apo ndërgjegjes dalin në pah dhe hipin sipër njëri - tjetrit, por asnjëri prej tyre i vetëm nuk është në gjëndje ta pasqyrojë dhe përfaqësojë islamin, e as ta paraqesë atë në kuptimin dhe plotësinë e tij të vërtetë.

Islami dhurata më e madhe dhe universale e Krijuesit të Plotfuqishëm, mund të zbatohet në jetën reale nga njerëzimi, indeksi shpirtëror i gjithë krijimit dhurata e parë dhe më e rëndësishme e Zotit. Islami vihet në jetë vetëm prej atyre të cilët janë të pajisur me intelekt, ndërgjegje, botë shpirtërore, trup dhe cilësi të larta të brendshme të shpirtit. Ne do ta shtjellojmë më tepër këtë ide në kapitujt në vijim.

DREJT SË NESËRMES

Për shekuj me radhë bota islame endur nëpër rrethin vicioz të gabimeve duke qënë e paaftë ti drejtohet për ndihmë në ndonjë rast shpirtit dhe thelbit të vet. Sa herë që ajo ka arritur ta thyejë këtë mur dhe të ecë dy hapa përpara, menjëherë është kthyer disa hapa pas duke humbur në qerthullin e këtij rrethi vicioz. Kjo endje tekanjoze apo shmangie e pafre, në të cilën ka më tepër dëm sesa dobi dhe në të cilën e dëmshmtja e dëbon tutje të dobishmen, përpjekjet e shoqërisë për të kërkuar dhe gjetur të vërtetën pengohen së tepërmi po ashtu siç pengohet edhe puna e bërë nga njerëzit për të dalë nga kjo situatë. Ne kemi parë në këtë botë të gjërë të prishet çdo gjë pas riparimit dhe “tytat” e shteteve dhe kombeve të kthehen përsëri kundër vetvetes.

Megjithatë ne besojmë në nevojën për ta hetuar botën islame sëbashku me kuptimin e saj të besimit, pranimin dhe interpretimin e saj të islamit, vetëdijen për hyjnoren, zellin dhe dëshirën, arsyen, logjikën, mënyrën dhe sistemin e saj të të menduarit, stilin e të shprehurit dhe të komunikuarit të vetvetes si dhe institucionet e saj të cilat do ta bëjnë njerëzimin të fitojë këto

cilësi dhe aftësi. Në këtë mënyrë ne mund ta orientojmë botën tonë drejt një rilindjeje të vërtetë në të gjitha aspektet dhe elementet e saj.

Themelet e jetës sonë shpirtërore janë mendimi dhe imagjinata fetare. Ne jo vetëm e kemi mbështetur jetën tonë në to por kemi ndërmarrë gjithashtu veprime duke u bazuar atje. Nëse ne do të niseshim prej tyre ne do ta gjenim vetveten njëmijë vjet pas. Feja nuk është vetëm një përmbledhje ritualesh dhe adhurimi; qëllimi i saj përfshin të dhënit kuptim njerëzimit dhe universit, hapja ndaj natyrës njerëzore në thelbin dhe shpirtin e vet, realizimin e dëshirave të cilat shkojnë përtej kësaj bote si dhe përgjigjia ndaj shpalljes së të përjetshmes në ndërgjegjen njerëzore. Feja e përqafton tërësinë e jetës individuale dhe kolektive; ajo ndërhyr në gjithçka që ne kemi në mendje, zemër dhe shpirt; ajo i jep nuancën e vet çdo veprimi që bëjmë në përputhje me qëllimet tona si dhe ngjyros gjithçka me ngjyrën e saj.

Boshti i çdo vepre të një besimtari është adhurimi, çdo përpjekje përmban një dimension beteje kundër dëshirave trupore /xhihadi i madh/ dhe çdo përpjekje është e orientuar drejt botës së përtejme dhe kërkimit të kënaqësisë së Zotit. Nuk ekziston ndonjë ndarje midis kësaj bote dhe tjetrës në jetën e besimtarit: nuk ekzistojnë pengesat ndërmjet mendjes dhe zemrës; ndjenjat e besimtarit janë gjithmonë të bashkuara me arsyen e tij dhe frymëzimi nuk shpërfillet nga gjykimi. Kështu, në botën e tij mendore eksperiencia i ngjan një shkalle prej drite që ngrihet sipër drejt mendjes; dija përbën një bastion të lartë të përforcuar me kuptim, mençuri dhe intuitë. Besimtari është si një shqiponjë që fluturon vazhdimisht drejt pafundësisë me anë të krahëve viganë të dashurisë; ai është relievi që ravijëzon gjithë ekzistencën me anë të çekiçit dhe vulës së inteligjencës së këtij bastioni. Nuk mund të gjendet asnjë e metë në ndonjë vend nga kjo pikëpamje, pra nuk ekziston asnjë lloj shpërfilljeje ndaj njerëzimit qoftë nga pikëpamja intelektuale ashtu dhe ajo kolektive.

Ata të cilët e përceptojnë fenë si kundërshtare të shkencës dhe arsyes janë të sëmurë: ata janë të pavëmendshëm ndaj shpirtit të fesë dhe arsyes. Për më tepër është absolutisht një mashtrim bërja përgjegjëse e fesë për përplasjen ndërmjet sektorëve të ndryshëm të shoqërisë. Konfliktet ndërmjet njerëzve të veçantë dhe grupeve të njerëzve burojnë nga injoranca, nga ambicia për favore dhe përfitime personale apo nga intertesat mesquine të grupeve, partive apo

klasave të veçanta. Feja as nuk i miraton e as nuk i fal të tilla cilësi dhe ambicie. Në fakt ekzistojnë konflikte dhe përplasje ndërmjet disa individëve me orientim fetar, por kjo ndodh për arsye se megjithëse ata kanë të njëjtin shpirt, nuk kanë të njëjtën shkallë besimi, nuk arrijnë të ruajnë sinqeritetin; nganjëherë nuk mund të kapërcejnë mbi ndjenjat e tyre dhe munden nga ato. Nga ana tjetër njeriu i virtytshëm i mbushur me besim nuk mund ti miratojë e as të rendë drejt këtyre mizorive. Prandaj e vetmja rrugë për të evituar rënien në këto situata të pafavorshme është vendosja e fesë me të gjitha institucionet e saj brenda jetës sonë të përgjithshme. Në mënyrë që shoqëria të lulëzojë si një e tërë.

Bashkësia islame ka nevojë për një rigjallërim; ka nevojë për një reformë serioze nga pikëpamja mendore, shpirtërore dhe intelektuale. Në qoftë se përdorim një shprehje më pozitive mund të themi se shoqëria ka nevojë për rigjallërim, për kryerjen e përpjekjeve serioze me qëllim ruajtjen e parimeve origjinale të fesë, me shtrirjen dhe universalitetin më të madh të lejuar nga fleksibiliteti i shpalljeve hyjnore në mënyrë që ajo ti plotësojë nevojat e njerëzve në çdo fushë të jetës, në çdo vend dhe kohë. Duke përqafuar kështu tërësinë e ekzistencës.

Që nga ardhja e islamit – Zoti mos e dhëntë kurrë të privohemi nga mbrojtja e tij – ky sistem i bekuar i ka hapur dyert reformave shumë herë dhe ka përjetuar shumë momente rilindjeje. Shkollat e doktrinae (mellhebet) në përgjithësi, sigurisht shumica e tyre, përfaqësojnë zhvillime të reja në fushat e jurisprudencës dhe ligjit; urdhërat fetarë sufi punuan në drejtim të zemrës dhe shpirtit duke i kthyer ato në autostrada të gjëra; shkollat dhe kolegjet gjatë kohës që funksionuan siç duhet, merreshin kryesisht me shpjegimin e kuptimit të universit dhe qënieve të tij. Për sa i përket rilindjes dhe rigjallërimit të dëshiruar për kohën e sotme, ai duhet të jetë një kombinim i të gjitha atyre sa thamë më sipër; kjo do të bëhet e mundur vetë duke i bashkuar ato, duke lënë menjëanë dallimet e vogla të secilit model sepse e rëndësishme është rikthimi në besim, sinqeriteti në veprime dhe vetëdija për Zotin në mendime dhe ndjenja.

Sasia e akteve të adhurimit duhet të jetë e plotë dhe cilësia duhet të jetë qëllim në vetvete; fjalët duhet të jenë mjetet e lutjes dhe shpirti dhe sinqeriteti

janë thelbësore për këtë; Sunneti duhet të jetë një udhërrëfyes dhe për këtë nevojitet ndërgjegje e pastër në të gjitha këto Zoti duhet të jetë objektivi kryesor. Namazet ditore nuk janë një bashkësi ushtrimesh fizike uljeje dhe përkuljeje; dhënia e sadakasë nuk është thjesht pagesa e një takse të vogël në të holla apo mallra për të ndihmuar fatkeqët e panjohur në vendë të panjohura apo për qëllime të panjohura; agjërimi nuk është thjesht një dietë apo heqje dorë nga ushqimet dhe pija dhe pelegrinazhi (haxhi) nuk është thjesht udhëtim nga njëri qytet në tjetrin me qëllim shpenzimin e kursimeve në valutë të huaj dhe në një vend të huaj. Në qoftë se të gjitha këto veprime nuk kryhen brenda kornizës së tyre shpirtërore, si mund të quhen të ndryshme prej aktiviteteve mondane të ngjashme? Përqëndrimi në sasinë e akteve të adhurimit mund të përbëjë vetëm një lojë feminare; Thirrjet çjerrjet pashpirt gjatë duave mund ti shërbejnë vetëm atyre të cilët kanë nevojë të ushtrojnë kordat e tyre zanore; vajtja në haxh pa qënë të ndërgjegjësuar për thelbin e tij përbën vetëm një përpjekje për rehati personale me anë të përdorimit të titullit të haxhiut dhe anekdotave të udhëtimit. E si mund të quhen akte të mirëfillta adhurimi ato që kryhen në këtë mënyrë.

Mënyra e vetme për të mos humbur në rrjetën e këtyre negativizmave është mobilizimi në pregaditjen e “shkencëtarëve të shpirtit dhe realitetit thelbësor” me anë të të cilëve mund të mbushet boshllëku brenda nesh, mund të ç’rrënjaset dobësia jonë, mund të shkëputemi nga të qëniti skllëvër të trupit dhe dëshirave tona trupore dhe mund të shkojmë drejt niveleve më të larta të zemrës dhe shpirtit. Ne kemi nevojë për shkencëtarët shpirtit dhe realitetit zemrat e të cilëve janë të hapur për çdo fushë të dijes: si mendjemprehtësia, kultura, dija shpirtërore, frymëzimi dhe bekimi hyjnor, bolleku dhe përparimi, ndriçimi; Nga fizika tek metafizika, nga matematika tek etika, nga kimia tek spiritualiteti, nga astronomia tek subjektivizmi, nga artet e bukura tek sufizmi, nga ligji tek juisprudenca, nga politika tek trajnimi i veçantë në urdhërat e veçantë sufi. Ne nuk kemi nevojë për këtë apo atë cilësi apo aftësi të veçantë, por përkundrazi, për mendje të plota gjithpërfshirëse. Ashtu siç ka truri lidhjet dhe ndërlidhjet e tij me të gjitha pjesët dhe qelizat e trupit që nga më e afërta e deri tek më e largëta, nga e vogla deri tek më e madhja me anë të fibrave nervorë, po kështu duhet të lidhet një kuadër i tillë mendjesh, i cili të mund të

komunikojë dhe të ndërveprojë me anë të atomeve, molekulave dhe pjesëzave të trupit të kombit. Kështu ai do të arrijë deri tek njësitë dhe organet që përbëjnë shoqërinë. Vetëm kështu duart e tij mund të prekin dhe të kontrollojnë të gjitha institucionet jetësore. Vetëm kështu ai do të arrijë të përcjellë me butësi tek çdo njeri në çdo fushë të jetës aspekte të caktuara të shpirtit dhe realitetit të cilat vijnë nga e kaluara dhe fitojnë më tepër gjërësi në të sotmen dhe shtrihen drejt së ardhmes.

Një kuadër i tillë shkencëtarësh të shpirtit do ti përqafojë të gjithë që nga fëmijët e vëmendshëm dhe të sjellshëm të shkollave deri tek ata të cilët sillen rrugëve dhe me anë të mesazhit të shpallur në shpirtrat e të gjithë atyre, duke i ngritur ata në nivelin e njerëzve të cilët zotërojnë dije, aftësi dhe gjenialitet për të ardhmen, ata do ti prezantojnë denjësisht këta fëmijë për të mirën e përgjithshme dhe dobinë e shoqërisë. Në të gjitha shtëpitë, konviktet, shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë po ashtu edhe në vendet e pushimit, adhurimit dhe ndriçimit shpirtëror këta njerëz do të pastrojnë këdo nga të gjithë shtresat dhe nivelet e shoqërisë prej marrëzirave të moshës duke i kanalizuar ata drejt përsosmërisë njerëzore.

Për më tepër ky kuadër njerëzish të kualifikuar do të shtie në dorë armën e fuqishme të medias të përbërë nga revistat, gazetatat, radiot dhe televizionet, duke i kthyer ato në zërin dhe frymën e jetës kombëtare dhe fetare dhe nëpërmjet këtyre mediave ata do tu mësojnë pronarëve të ndjenjave mendimeve dhe zërave më të errët rrugët e duhura për tu bërë njerëz të vërtetë.

Ky kuadër njerëzish do ti shpëtojë institucionet tona të edukimit dhe shkollimit të cilat tani kanë ndryshuar formën dhe drejtimin për shkak të devijimeve të brendëshme dhe presionit nga jashtë, të cilat kthehen nga të fryjë era nën komandën dhe kontrollin e të tjerëve, duke i bërë ato të hapura dhe të përgjithshme, të afta për të përmbushur kërkesat e të sotmes, duke i rirregulluar dhe riorganizuar në përputhje me këndvështrimet historike, duke i ngritur ata si nga stili ashtu dhe nga metodologjia në një standart mjaft të lartë dhe duke i kthyer në vende me qëllime dhe cilësi superiore.

Për ta përmbledhur këtë sa thamë më lart, ne do të ngrihemi nga vuajtjet e formalizmit të vrazhdë dhe të zbrazët drejt kuptimit të vërtetë shkencor; Nga veprat e pavlera të dobëta dhe jodinjitoze që njihen rëndom me fjalën “art”

drejt artit dhe estetikës së vërtetë; nga zakonet, huqet dhe obsesionet me prejardhje të panjohur drejt vetdijes për një moral të mbështetur në histori dhe fe; nga grackat e mendimeve të ndryshme torturuese që mendojnë shpirtrat tanë tek kuptimi i vlerës së vërtetë të nënshtrimit, shërbimit, përkushtimit, dorëzimit dhe mbështetjes tek Zoti.

Bota po përjeton këtë valë reformash megjithatë ne nuk besojmë se ndonjë gjë e re do të burojë nga rrënojat e kapitalizmit, nga fantazia e komunizmit nga gjërmadhat e socializmit, nga hibridet e socialdemokracisë apo nga liberalizmi i venitur. E vërteta është se në qoftë se ka një botë të hapur drejt një rendi të ri, kjo është bota jonë. Brezat e ardhshëm, duke kthyer kokën pas ndoshta do ta konsiderojnë këtë si “Rilindje.”

Kjo rilindje do ti bëjë ndjenjat tona dhe horizontet e mendimit dhe të kuptimit të artit e të së bukurës të arrijnë gjërësi të reja dhe ndryshimin më të madh që kanë pasur deri tani. Në këtë mënyrë ne do të gjejmë kënaqësitë tona estetike, do krijojmë muzikën tonë dhe do zbulojmë romanticizmin tonë. Duke vendosur popullin tonë në themele të fuqishme në çdo fushë, nga shkenca tek arti, nga mendimi tek morali, ne do tu garantojmë atyre të ardhmen.

Në këtë drejtim përpjekjet dhe dinamizmi duhet të përbëjnë flamurin tonë dhe ndërgjegjia e besimit dhe të vërtetës duhet të jetë burimi ynë i fuqisë. Ata të cilët na kanë bërë ne të endemi nga dera në derë dhe të cilët kanë pritur zgjidhjen e problemeve nga ana e jobesimtarëve dhe imoralëve e kanë pasur përherë gabim. Ne kemi qenë gjithmonë të nderuar për sa kohë ia kemi dorëzuar zemrat tona plotësisht Zotit dhe për sa kohë që ne kemi preferuar kombin, njerëzit dhe tokën tonë, në krahët e së cilës ne jemi përkundër, duke mos e ndërruar me asgjë tjetër në botë. Unë mendoj se nuk është e nevojshme të shpjegojmë alternativat...

BOTA PËR TË CILËN SHPRESOJMË

Në epoka të ndryshme, në pjesë të ndryshme të botës shumë njerëz kanë dalë me tezën e reformimit dhe rindërtimit nën emra dhe tituj të ndryshëm. Pretendime të tilla kanë qenë gjithmonë kontradiktore me një përjashtim i cili

përqafon gjithë krijimin, realitetin e fshehur që gjendet pas tij, njerëzimin dhe jetën. Kjo është padyshim bota jonë veçanërisht kur shihet nën dritën historike.

Pas shumë periudhash të gjata krize dhe depresioni, pavarësisht gjithë periudhave të izolimit, ky popull është akoma në gjendje të përjetojë një rigjenerim; ai e ka akoma potencialin për të realizuar një rilindje të re dhe ka grumbulluar dije të mjaftueshme për të udhëhequr të gjitha formacionet e reja rreth tij. Për më tepër ai zotëron avantazhin e pranimit të pavullnetshëm nga njerëzit me të cilët ka ndarë historinë, një pozitë udhëheqëse e cila mund të përdoret përsëri në të ardhmen. Ai është i plotësuar dhe i mjaftueshëm me përfaqësues nga të gjitha fushat për sa kohë që ai mund të përdorë në kohën dhe vendin e duhur edhe një herë tjetër forcën udhëheqëse e cila përbënte shpirtin dhe jetën e një të shkuare kaq të gjatë e të lavdishme.

Dikur, në pothuajse çdo shkencë si natyrore ashtu dhe fetare kombi ynë qëndronte në ballë të epokës. Këto shkenca shtriheshin që nga sufizmi (tesavufi) tek logjika, nga planifikimi urban tek estetika duke qënë të mbushura me gjeni të mëdhenj të cilët studionin natë e ditë fenomene natyrore dhe shoqërore si **Khëarizmi**, Biruni, Ibn Sina (Avicenna), dhe **Zahraëi**; çështjet e ligjit dhe jurisprudencës islame si Abu Hanifa, Imam Muhammed, Sarakhsi, dhe Marginani; në talentet të cilët i tejkaluan normat njerëzore dhe e mundën logjikën me logjikë dhe zemër duke jetuar jetët e tyre me ndërgjegje të pastër si Imam Ghazali, Razi, Mavlana Jalal al- Din Rumi, Shaykh-Naqshband; me heronjtë e arsyes dhe inteligjencës si Imam Maturidi, Taftazani, Sayyid Sharif dhe **Daëëani** dhe me gjeni të tillë si arkitektët Hayreddin dhe Sinan, Itri dhe Dede Efendi. Sot duke mobilizuar gjithë mendjet dhe shpirtrat e tij të ndritur, kombi ynë mund ta realizojë në një kohë të shkurtër një rilindje të dytë apo të tretë. Kjo mund të arrihet duke nisur me njohjen e shpirtit dhe thelbit të islamit, duke shkuar drejt riinterpretimit të gjithë ekzistencës, duke rendur nga klima e pakufijshme hyjnore e rrugës kufi drejt metafizikës universale, me anë të vetëllogarisë dhe vetëkontrollit islam dhe vigjilencës, kujdesit dhe vetëpërmbajtjes, cilësi të cilat e bëjnë njeriun të arrijë vlera të larta; nga qytetet dhe zonat urbane në të cilat bota jonë e brendshme gjen prehje dhe ku mund të marrim frymë lirisht duke vazhduar me estetikën dhe të bukurën të cilat duhet të jenë pronë e të gjithëve; me artin

i cili e zbukuron thelbin dhe realitetin kudo duke kërkuar përjetësi tek kënaqësia që të jep. Duke u bërë gjithmonë e më i kapshëm, gjithmonë e më i bukur dhe i integruar, duke u bërë gjithmonë e më tepër i afërt me të padukshmen dhe duke shfrytëzuar të gjitha potencialet në fushat e lartpërmendura, ky komb mund të hapë një kapitull të ri. Megjithatë një detyrë e tillë madhore nuk është e lehtë të përmbushet...

Për shumë vite jeta jonë shpirtërore ka qënë venitur në një shkallë të gjërë; bota jonë fetare ka qënë shndërruar në jofunksionale; gjuha e zemrës tonë ka qënë e lidhur duke i bërë njerëzit ta harrojnë gjallërinë, dashurinë (ashkun) dhe euforinë (vaxhdin); ne i kemi shndërruar në perverse të gjitha mendjet të cilat zhyteshin në të lexuarit dhe të menduarit sipas pozitivizmit të egër; fanatizmi zuri vend duke zëvendësuar forcën e karakterit, fuqinë e fesë dhe ruajtjen e së vërtetës; edhe duke kërkuar jetën e pasosur dhe parajsën, lutësit me mentalitet të ç'rregulluar kanë në mend modele të lumturisë së zakonshme të kësaj bote. Prandaj është e pamundur të hapet një kapitull i ri pa ç'rrënjosur më parë mendime të tilla të pabaza dhe ide të tilla të shtrembëra jashtë vetes sonë.

Kjo nuk do të thotë që marrëzia që ka pushtuar shpirtrat tanë për shekuj me radhë nuk mund të ç'rrënjohet. Megjithëatë pa e larguar veten nga kthetrat e veseve të cilat përbëjnë arsyen e vërtetë të dështimit dhe shpërbërjes së një populli si lakmia, dembelizmi, ambicia për famë, lakmima për pozitë, egoizmi dhe mendjelehtësia, pa i vendosur në vendin që u takon virtyte të tilla si fryma e përmbajtjes, kurajon, modestinë, kryeultësinë, altruizmin, spiritualitetin, mëshirën dhe mirësinë, të cilat janë të gjitha pjesë e thelbit dhe së vërtetës së islamit; pa drejtuar popullin drejt së vërtetës, pa pastruar dhe reformuar atë me ndjenjën e saj dhe pa bërë të mundur shkaqet e kuptimit të dobisë së ruajtjes së këtyre vlerave në shoqëri, do të jetë krejtësisht e pamundur të shkohet drejt rrugës së drejtë dhe ditëve të qeta.

Megjithëatë ky objektiv nuk është krejtësisht i pamundur. Në qoftë se ne do të kemi heronj mes nesh të cilët janë luajal ndaj realitetit thelbësor të islamit dhe do të kenë vullnetin e hekurt për ta përqaftuar epokën në të cilën jetojmë duke përmbushur edhe kërkesat e saj, kjo rilindje dhe ky ndryshim sigurisht do të ndodhë. Në fakt ekzistojnë mjaft heronj të tillë mes nesh ndaj mendoj se

do të jetë i mundur transformimi sipas modelit të kur'anit dhe temperimi sipas ligjeve natyrore. Kjo do të ndodhë në mënyrë të tillë që edhe ata të cilët u qëndrojnë afër këtyre idealeve por dhe masat e njerëzve të cilët ngulin këmbë të bëhen pjesë e këtij mekanizmi nuk do të jenë në gjendje ta shmangin atë. Të gjitha periudhat e rilindjes në botë kanë ardhur si rezultat i përpjekejs dhe punës së një grupi të vogël individësh gjenialë të konsideruar si arkitektët e tyre; ato nuk kanë ardhur si pasojë e përpjekjeve dhe lëvizjes së masave. Ashtu si në vitet e para që pasuan ardhjen e islamit, disa momente rilindjeje dhe ndryshime, erdhën si rezultat i jo më shumë se një duzine shpirtërash të jashtëzakonshëm dhe inteligjencës dhe ideve të tyre; shpirtëra të cilët ishin rritur gjatë periudhës së umejatëve dhe abasitëve. Kështu ka ndodhur edhe në periudhat e mëvonëshme. Po kaq të gjëra ishin mendjet dhe shpirtërat e njerëzve të ndritur që qëndronin pas lëvizjeve centrifugale dhe rilindjeve të përjetuara gjatë periudhës së Ilkhanidëve, Karakhanidëve, Silxhukëve dhe Otomanëve. Rrugët e hapura nga shpirtëra të tillë udhërrëfyes të cilët buruan brenda kuadrit të një vetëdijeje të plotë shpirtërore në pothuajse çdo epokë, duke u shndërruar me kalimin e kohën në shkolla mendimi të cilët injektuan shpirtin e rindërtimit dhe reformimit tek masat e njerëzve. Gjithashtu ata të cilët i pasuan këta njerëz i ndoqën gjithashtu udhëzimet dhe idetë e tyre duke u bërë pjesë e kësaj klime ndriçimi. Udhëheqës të tillë të mëdhenj u bënë frymëzimi dhe shpirti i popullit dhe jetuan me ta në dimension shpirtëror. Megjithëatë gjatë periudhave kur mendje të tilla të ndritura nuk ishin më dhe kur njerëzit me cilësi të mira nuk ishin ngritur të zinin vendin e tyre, e tërë shoqëria u shndërrua në kufomë, idetë u bënë mbetje të kalbura dhe ëndrrat për rilindje u shndërruan në pamundësi.

Tashmë kur ditët po u rikthehen lulëzimit dhe pengesat po bien një e nga një, ne po mbushemi gjithmonë e më tepër me shpresë duke iu lutur Zotit me fjalët “Na jep vullnet të mbështetur tek vullneti Yt, i cili të mund të ngrejë statujën e shpirtit tonë, ti bëjë zemrat tona të gjelbërta si shpatet e parajsës dhe bëji shpirtrat tanë të arrijnë sekretet e pjesëve më të brendshme të Shenjtërisë Tënde. Tregoji popullit tonë shtigjet për të rijetuar sipas rrugës së Muhammedit.”

Kërkimi dhe shpresa për këtë përbën një të drejtë dhe detyrë tonën por edhe një rrjedhojë natyrale të besimit tonë. Megjithëatë duke ushtruar këtë të drejtë dhe duke e përmbushur këtë detyrë, ne duhet ti referohemi vazhdimisht të kaluarës sonë të lavdishme dhe të pajisemi me vlerat të cilat ndihmuan në bërjen e kësaj të shkuare të shkëlqyer realitet. Kjo është mënyra me anë të së cilës qytetërimet e tjera kanë ringjallur vetveten. Kur Europa Perëndimore përjetoi Rilindjen e vet e cila u bë premisë për ekzistencën e qytetërimit aktual, ajo gjeti mbështetje tek kristianizmi, mori për model grekët e lashtë dhe shpalosi vlerat e romës antike. Duke ndjekur të njëjtën rrugë bëhet i mundur zhvillimi për çdo qytetërim. Prandaj, ne gjithashtu duhet të kthehemi drejt së kaluarës sonë ku gjenden rrënjët tona të ekzistencës, duke marrë shembuj nga gjërësia e Hyjnores të cilën koha nuk mund ta errësojë kurrë. Që nga mendimi filozofik deri tek e vërteta e sufizmit, që nga pikëpamjet bazë të fesë deri tek dimensionimi i saj real ne duhet të nxjerrim në pah modelet tona për të bërë të mundur ardhjen e epokës më të ndritur për të cilën ne jemi gjithmonë krenarë. Epoka të cilën ne duhet të marrim si model konsiderohet si epoka e artë e historisë tek e cila ne duhet të endim tapetin e të ardhmes sonë, fije pas fije mbi pëlhurën e kohës. Në këtë tapet Mevlana Xhalal al-Din Rumi, do të vijë sëbashku me Taftazanin, Junus Emre do të ulet në të njëjtin rresht me Mahdumgulin, Fuzuli do të përqafojë Mehmet Akifin, Ulug Bej do të përshëndesë Ebu Hanifen, Hoxha Dehhani do të ulet gju më gju me Imam Gazaliun, Muhy al-Din ibn Arabi do të hedhë trëndafila drejt Ibn Sina, Imam Rabbani do të rrënoqethet prej sihariqeve të Bediuzzaman Said Nursiut. Nga një e kaluar e tillë e lavdishme me panoramën e saj të gjërë, njerëzit me peshë do të vijnë sëbashku dhe do të na pëshpërisin bukurinë e shpëtimit dhe rilindjes.

Për sa kohë që ne mund të riparojmë mendimet, ndjenjat, metodat dhe filozofinë tonë, kjo do të jetë e mjaftueshme për ti bërë ata bashkë në mënyrë që të gjejmë atë mënyrë jetese hyjnore dhe të pavdekshme që kërkojmë. Kjo është arsyeja sipas meje përse ne duhet sëpari të riekzaminojmë të gjitha hapat që kemi ndërmend të ndërmarrim, duke i riparuar dhe përforcuar ato përsëri. Gjëja më thelbësore për rilindjen tonë janë frymëzimi dhe efikasiteti i zellit fetar, atmosfera shpresdhënëse, vendosmëria matura dhe mençuria në

arsyetim dhe logjikë; stabiliteti dhe humanizmi që do të na garantojë ne lirinë për të qënë vetvetja; thellësia filozofike dukuria dhe soditja e abstraksionit në artet dhe filozofinë tonë; të gjitha këto duhet të zotërojnë cilësinë e të qënit logjike në thelb dhe të frymëzuara nga Shpallja Hyjnore.

Në këtë rilindje kënaqësia e Zotit përbën qëllimin final. Shpirti ndodhet i pozicionuar mbi trupin. Egoja (nepsi) përbën një dinamikë thelbësore e cila do të ndezë ndjenjën e detyrës nën udhëheqjen e zemrës. Dashuria për njerëzimin dhe atdheun përbën një pasion të domosdoshëm. Morali i cili nuk mund të braktiset kurrë, përbën një parshikim jetësor për udhëtimin. Njerëzimi, jeta dhe universi përbëjnë një libër të mistershëm me kapituj të ndryshëm, fletët e të cilit ne i studjomë vazhdimisht nëpërmjet lenteve të kur'anit. Njerëzimi përbën një burim domethënës fuqie me karakterin dhe vlerat e tij të vërteta. Qëllimi dhe objektivat duhet të jenë të ndershme, të drejta dhe të shenjta dhe rrugët që të shpien në realizimin e këtyre qëllimeve dhe objektivave duhet të ecin nga kur'ani dhe sunneti sepse këto përbëjnë një barrierë të pazëvendësueshme kundër gabimeve.

Ajo të cilën ne mund ta quajmë një recetë për shpëtimin tonë konsiston në këto pika të veçanta: përqëndrimi i përpjekeve për të ardhmen e njerëzve dhe vendit tonë, shpenzimi i energjive në ndryshimin e fatit tonë të pafavorshëm të shekullit të fundit, ndërtimin e shpirtit që do të modelojë dhe formojë shoqërinë tonë duke e bërë atë pjesë të jetës dhe trupit tonë, duke kthyer kështu një faqe të historisë së popullit tonë. Këto përbëjnë vetëm disa prej elementeve thelbësorë të ëndrrës tonë për qytetërim dhe rilindje, e cila dallohet së tepërmi nga utopia.

STATUJA E SHIRTËRAVE TANË

Më sipër unë nënvizova shkurtimisht cilësitë e trashëgimtarëve të tokës. Tani unë do ti sqaroj më me hollësi këto cilësi.

Cilësia e parë e trashëgimtarëve të tokës është besimi i përkryer. Kur'ani thekson se qëllimi i krijimit të qënieve njerëzore është besimi tek Zoti duke qënë të pajisur me horizontin e dijes, shpirtin e dashurisë, dimensionin e dashurisë së fuqishme dhe zellit të gëzueshëm si dhe ngjyrimin e kënaqësive

shpirtërore. Qeniet njerëzore janë përgjegjëse për ndërtimin e botës së tyre të besimit dhe mendimit ose me anë të hapjes së shtigjeve që të çojnë nga thelbi i tyre i brendshëm tek thellësitë e ekzistencës, ose duke ecur sipas udhëve të ndryshme që të shpien nga ekzistenca drejt depërtimit brenda këtij thelbi. Kjo gjithashtu sjell për pasojë të vërtetën e brishtë njerëzore brenda shpirtit të tyre. Vetëm me anë të dritës së besimit ne mund të kuptojmë thelbin tonë, thellësinë e tij dhe qëllimet dhe objektivat e ekzistencës; mund të bëhemi të vetëdijshëm për aspektet e brendëshme të universit dhe ngjarjeve si dhe të arsyeve që qëndrojnë pas tyre. Vetëm atëherë ne mund ta kuptojmë siç duhet ekzistencën me të gjitha përmasat e saj. Mosbesimi është një sistem errësues, bllokues dhe pengues. Në sytë e një jobesimtari, ekzistenca nisi nga kaosi, duke u zhvilluar nëpërmjet papërcaktueshmërive të frikshme të rastësisë duke shkuar me shpejtësi drejt një fundi të tmerrshëm. Brënda kësaj rrëmuje tronditëse nuk ka vend për mëshirën e Zotit në mënyrë që shpirti të lehtësohet apo të gëzohet sadopak; nuk ekziston asnjë vend sado i vogël për aspiratat tona njerëzore në mënyrë që ne të ngushëllojmë sadopak vetveten, e madje nuk ekziston asnjë rrugicë sado e ngushtë në të cilën ne mund të ecim.

Në të kundërt, një person me besim i cili e njeh prejardhjen dhe destinacionin e vet e gjithashtu njeh siç duhet edhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij e shikon gjithçka të ndritur dhe të shkëlqyeshme; hapat që hedh nuk kanë as shenjë më të vogël të ankthit, duke e çuar drejt destinacionit përfundimtar pa frikë, me siguri dhe besim. Në udhëtimin e tyre, njerëzit me besim e studjojnë ekzistencën dhe atë që ndodhet pas saj me mijëra herë; ata i filtrojnë gjërat dhe ngjarjet pa pushim, ata përpiqen të hapin çdo derë dhe orvaten të vendosin marrëdhënie me çdo objekt; aty ku dija përvoja dhe zbulimet e tyre kanë rezultat, ata kënaqen më faktin se kanë justifikuar besimin e vetvetes dhe të tjerëve, duke vazhduar më tej udhëtimin e ndërmarrë.

Me anë të këtyre kriterëve, mund të vërehet se një udhëtar i besimit ka zbuluar një burim mjaft domethënës fuqie. Armatimi dhe thesari i tij i shprehur me frazën “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut” shprehje e cila i përket së përtëjmes, përbën një burim mjaft domethënës fuqie dhe drite, pas përfitimit të së cilës besimtari nuk ka nevojë për asgjë tjetër. Ky person më pas gjithmonë e shikon dhe e njeh Atë; ai rend për t’iu bashkuar shoqërisë së Tij duke e

orientuar jetën sipas urdhërave të Tij; ky besimtar mund të ndeshet me të gjitha fuqitë e kësaj bote në përpjestim me dijet e veta duke besuar tek Zoti me shpresën që ai mund të tejkalojë çdo pengesë edhe në rastet kur rrethanat janë krejtësisht të pafavorshme duke jetuar i mbushur me kënaqësi dhe pa rënë kurrë në pesimizëm. Meqënëse kjo pikë përbën një objekt trajtimi për shumë vepra si “Risale-i Nur” e shumë të tjera, unë u rekomandoj lexuesve tu hedhin një sy atyre duke kaluar kështu tek cilësia e dytë.

Cilësia e dytë e trashëgimtarëve të tokës është “dashuria” e cila konsiderohet si ilaçi më i rëndësishëm i rilindjes. Përsoni i cili e mbush dhe e përmirëson zemrën me besim tek Zoti dhe me pranimin e Tij, ndjen një dashuri të thellë dhe një afeksion të madh në përpjestim me besimin dhe dijet e veta për të gjitha qëniet njerëzore dhe për gjithë krijimin në përgjithësi duke jetuar me këtë mënyrë gjith jetën e vet nën tërheqjen dhe nxitjen e një dashurie gjithpërfshirëse, duke qenë gjithmonë në një gjendje euforie, ndjenjash të fuqishme, tërheqjeje ndaj Zotit dhe kënaqësive shpirtërore. Si në çdo epokë, edhe tani është e nevojshme që zemrat të mbushen me dashuri dhe të lulëzojnë prej entuziazmit, duke fituar kështu dimensione të reja ndërgjegjësimi në mënyrë që të bëhen të afta të realizojnë një rilindje të tillë të madhe. Pa dashuri nuk është e mundur të konkretizohen përpjekjet apo aktivitetet me kohëzgjatje dhe efektivitet të madh prandaj për të arritur këtë qëllim duhet të fokusohemi drejt Botës së Përtejme. Ne mund ta kuptojmë dashurinë hyjnore si qenie të ndodhura nën vëzhgimin e Zotit, nën dritën e përcaktimit të vendit tonë brenda konturit të lidhjeve që japin ekzistencë me qëllim ndijimin e jënaqësisë së të qënurit të krijuar prej Tij, duke e konsideruar veten si gjurma e dritës së Tij, duke pranuar faktin që kënaqësia e Tij përbën qëllimin kryesor të krijimit dhe arsien e këtij krijimi, duke na bërë kështu të qëndrojmë gjithmonë nën gjurmët e dashurisë dhe kënaqësisë së Tij. Një dashuri e tillë për Zotin përbën një burim të pafund dhe misterioz fuqie, prandaj trashëgimtarët e tokës nuk duhet ta neglizhojnë këtë burim, por ta përjetojnë atë plotësisht.

Perëndimi e mbushi vetveten me dashuri thjesht nga pikëpamja materiale, duke ndjekur idetë e filozofëve të ndryshëm në një klimë të mjegullt filozofie të cilën munda ta shijojë vetëm ai, por kjo bëri që të përjetohej dyshime, hezitime dhe pasiguri kudo. Ne do të shikojmë ekzistencën dhe burimin e saj

nepërmjet dritës së kur'anit dhe sunnetit. Duke ju referuar dhe duke ju drejtuar parimeve balancuese të këtyre dy burimeve dhe duke shfrytëzuar hapësirën e tyre të gjërë të hapur për metafizikën, ne do ta kuptojmë dashurinë – dridhjen e dashurisë që neve na injektohet në zemrat tona – për Krijuesin dhe lidhjen që ndiejmë me Të për arsye se falë tij është bërë e mundur krejt ekzistenca. Pa këto dy burime (kur'anin dhe sunnetin), origjina e njeriut, vendi i tij në univers, qëllimi i ekzistencës së tij, rruga që ai ndjek dhe fundi i tij, janë aq të përbashkëta me mënyrën e tij të menduarit, ndjenjat, ndërgjegjen dhe aspiratat, saqë është e pamundur të mos mrekullohesh dhe ta admirosh këtë fenomen pasi hyn në rrugën e lartpërmendur.

Për njerëzit me zemër të madhe, këto dy burime të shndritshme përbëjnë një lulëzim pranveror të zellit dhe një burim tërheqës. Ata të cilët kthehen drejt tyre me pastërti dhe sinqeritet ndjenjash duke e ndjerë veten nevojtarë për to, nuk do të kthehen kurrë duarbosh, ndërsa ata të cilët kërkojnë strehë në këto dy burime nuk do të përjetojnë kurrë vdekje. Është e mjaftueshme që ky kërkim strehe dhe ky sinqeritet të jetë në nivelin e atyre të Imam Gazaliut, Imam Rabbaniut, Sheh Veliut apo Bediuzzaman Said Nursiut, meqënëse këta i përjetuan këto situata me entuziazmin dhe frymëzimin e Xhalal al-Din Rumi, Sheik Galipit apo Mehmed Akifit; për sa kohë që ata e kthyen fytyrën drejt këtyre burimeve me anë të besimit dhe veprave të Khalid ibn Velidit, Ukbe bin Nafit, Salah al-Din Ejubit, Sulltan Mehmet Ngadhënjyesit apo Sulltan Selimit të dytë. Me anë të ndërthurjes së zellit të tyre i cili lulëzon dhe përqafton çdo kohë dhe çdo vend dhe duke përdorur mjetet mënyrat dhe stilet e epokës sonë për të arritur shpirtin e kur'anit i cili nuk ka moshë dhe është i vlefshëm për çdo epokë, duke bërë kështu të mundur arritjen e një niveli universal metafizik, do të bëhej i mundur hedhja e hapit tonë të dytë.

Cilësia e tretë e trashëgimtarëve të tokës është “kthimi drejt shkencës nepërmjet trios arsye, logjikë dhe vetdije.” Në një epokë në të cilën mendja e njeriut po paralizohet me anë të fantazive të errëta, një rikthim i tillë drejt këtyre vlerave do të ishte gjithashtu një përgjigje drejt tendencave të përgjithshme të qënieve njerëzore dhe do të përbënte një hap domethënës për shpëtimin e krejt species njerëzore. Siç ka theksuar Bediuzzamani, në epokën e fundit, njerëzimi do të rikthehet dijes dhe shkencës me të gjitha format; do të

drejtojë krejt fuqitë e tij drejt të mësuarit dhe ndoshta do të kalojë edhe njëherë në duart e shkencës, pastërtisë së të folurit (fasahatit), elokuencës (balaghatit) si dhe shprehjeve apo retorikës superiore e cila do të përbëjë një subjekt ku do të drejtohen interesat e të gjithëve; ndaj ne do të përjetojmë përsëri një epokë dijesh dhe pasurimi gjuhësor. Prandaj nëse duam të pastrojmë atmosferën e mjegullt të konjunkturave rreth nesh dhe të arrijmë të vërtetën dhe të Vërtetën e të vërtetave, kjo është rruga e vetme. Kapërcimi i vështirësive të shekujve të fundit, arritja e përsosmërisë në etikë dhe informacion si dhe sprovimi i vetvetes edhe njëherë me anë të riparimit të subkoshienës së dëmtuar për shkak të gjendjes së rëndë që kemi përjetuar vit pas viti, varet krejtësisht prej përfaqësimit dhe shpalosjes së shkencës e cila të jetë e tillë që të kalojë nepërmjet prizmit të të menduarit islam. Në të shkuarën tonë të afërt, meqënëse drejtimi dhe objektivi i shkencës nuk ishte i përcaktuar dhe dija nganjëherë ishte e përzier me shkencat pozitive dhe me filozofinë materialiste, ne përjetuam një kaos të madh në drejtim të të menduarit shkencor duke bërë që shkencëtarët të përjetonin një humbje të pariparueshme të vlerësimit. Ky vakum u përdor nga të huajt. Ata hapën shkolla dhe institucione industriale në çdo cep të vendit tonë duke injektuar tek njerëzit tanë ndjenjën e dashurisë për të huajën me anë të këtyre institucioneve edukative. Disa pjestarë të bashkësisë sonë i vendosën fëmijët e tyre inteligjentë dhe të talentuar në këto institucione duke poshtëruar vetveten dhe duke e forcuar më tej këto ndjenjë dashurie për të huajt. Pas pak kohësh nuk mbeti asgjë; as fe e as besim tek këta breza të rinj pa përvojë dhe të tradhëtuar. Feja dhe besimi u rrënuan dhe u flakën tutje. Mbarë kombi u bë subjekt i shpërdorimit, duke u shndërruar në vendin e egoizmit në mendime, ndjenja, koncepte dhe art. Arsyeja përse ndodhi kjo është shumë e qartë. Brënda këtyre shkollave dhe institucioneve pa përjashtim, shkollave të cilave ne u besuam mendjet e të rinjve tanë pa u menduar dy herë, zuri vend kultura amerikane, morali francez, zakonet e traditat angleze e kështu me radhë duke u zënë vendin shkencës dhe ideve shkencore. Prandaj rinia jonë në vend që të përqafojë epokën në të cilën jetonte nepërmjet shkencës, metodologjisë dhe teknologjisë, u grupua në kampe dhe fraksione të ndryshme dhe filloi të luante kojën e Marksizmit, Durkheimizmit, Leninizmit dhe Maoizmit. Disa e ngushëlluan veten me ëndrrat e komunizmit

dhe diktaturën e proletarriatit, disa të tjerëvajtën e zhyten në komplekset frojdiane, të tjerë e humbën mendjen pas ekzistencializmit dhe u ngatërruan me Sartrin, disa të rinj pështynë mbi gjërat e shenjta duke cituar Markusin ndërsa shumë të tjerë nisën të humbnin jetën për shkak të delirit të Kamysë... Të gjitha këto u përjetuan në vendin tonë prandaj të ashtëquajturat shtëpi të shkencës qenë përgjegjëse për kujdesjen dhe ushqimin e këtyre ideve dhe eksperiencave. Gjatë kësaj periudhe krize disa zëra dhe gjuhë shpirtrash të errët, hodhën baltë dhe shpifën vazhdimisht mbi fenë dhe besimtarët, por njëkohësisht nxorrën në pah marrëzitë dhe sëmundjet që e kishin origjinën nga Perëndimi. Sigurisht është e pamundur për ne ti harrojmë ato kohë dhe pengjet që na kanë mbeture prej tyre. Ata të cilët i pregatitën këto rrethana të dëmtimit të njerëzve dhe vendit tonë, do të mbahen mend gjithmonë si fajtorë, të dënuar prej ndërgjegjes kolektive.

Tani duke lënë pas krahëve këto periudha të errëta si dhe ideatorët e tyre të cilët me anë të veprimeve djallëzore dhe fjalëve të tyre, ende na e përziën stomakun dhe shkaktojnë dhimbje në zemrat tona, ne do të donim të flisnim rreth punëtorëve të mendjes të cilët do të ndërtojnë të ardhmen tonë.

Me anë të të menduarit dhe të kuptuarit shkencor ashtu siç kemi bërë shumë kohë përpara madje shumë përpara se perëndimi, ne duhet të zhysim dhe të kredhim brezat tonë të rinj brenda botës së shkencës dhe ideve duke realizuar kështu rilindjen dhe rimëkëmbjen tonë. Sëmundjet dhe dhimbjet e fatit të keq të së shkuarës kanë mbetur të gjalla në ndërgjegjën kolektive; dëshpërimi dhe ethet që sollën përgjatë viteve fuqitë e huaja dhe pasojat e neglizhencës dhe shfrytëzimit të kohëve të fundit të shkaktuara mbi popullin tonë, akoma sjellin lot si ato të Profetit Adem, rënkime si ato të Profetit Jonah si dhe vuajtje dhe ofshama si ato të Profetit Job. Pas pshërëtimave dhe vajtimeve të tilla si dhe të udhëhequr nga përvoja historike dhe nga rezultatet e përpjekjeve dhe ngjarjeve që ajo na tregon, ne ndiejmë se koha dhe distanca ka filluar të tkurret dhe ditët e pritura nuk janë aq larg, përkundrazi, janë disa hapa më tej.

Cilësia e katërt e trashëgimtarëve të tokës është “veprimi i të rishikuarit të pikëpamjeve në lidhje me njeriun, jetën dhe universin, si dhe përcaktimi dhe

kriticizmi i të drejtave dhe gabimeve të tyre.” Këtë aspekt do ta shohim në tre këndvështrime:

a) Universi është një libër i shfaqur nga Zoti përpara syve të njerëzve me qëllim referimin e pareshtur ndaj tij. Njeriu është një lente e hapur që vëzhgon thellësitë e ekzistencës dhe një indeks transparent i të gjitha botërave, jeta është një manifestim, një përvetësim formave të kuptimeve të cilat janë filtruar nga ky libër dhe ky indeks, prandaj ajo përbën reflektimin e asaj çfarë pasqyrohet nga këndvështimi hyjnor. Në qoftë se njeriu, jeta dhe universi konsiderohen si të ndryshme për sa i përket formës së jashtme dhe ngjyrave, ato përbëjnë faqe të ndryshme të së njëjtës së vërtetë, prandaj ndarja e tyre nga njëri tjetri, prish harmoninë e së vërtetës gjë që do të përbënte një gabim, një përgjegjësi dhe mungesë respekti në drejtim të njeriut dhe ekzistencës.

Ashtu siç është detytë të lexuarit, të kuptuarit, bindja dhe nënshtrimi ndaj Fjalës së Zotit, e cila buron prej cilësisë së Tij hyjnore të Ligjëruesit, po kështu është thelbësisht e domosdoshme të njëjhet dhe koptohet Zoti në tërësinë e gjërave dhe ngjarjeve të cilat Ai i ka paracaktuar me anë të dijes së Tij dhe krijuar me anë të Vullnetit dhe Fuqisë së Tij Hyjnore, dhe rrjedhimisht përbën një domosdoshmëri kërkimi dhe vërtetimi i përputhjes dhe pajtimit me këtë vullnet të çdo sendi dhe ndodhie. Kur’ani erdhi gjithashtu nga cilësia e tij e Ligjëruesit; ai është shpirti i gjithë ekzistencës dhe burimi i vetëm i lumturisë. Libri i universit është libri i kësaj të vërtete dhe përbën një dinamikë mjaft të rëndësishme të kësaj bote në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të botës tjetër në mënyrë të tërthortë me anë të referimit të tij ndaj fushave të ndryshme të shkencës të cilat ai i përfshin dhe përfaqëson. Kjo është arsueja përse të kuptuarit dhe vënia e këtyre dy librave në praktikë si dhe organizmimi i krejt jetës në përputhje me to meriton shpërblim, ndërsa neglizhimi, injorimi madje edhe të qenit i paaftë për ti interpretuar dhe zbaruar ato në jetë meriton ndëshkim.

b) Thellësia e vërtetë e njerëzve duhet të shihet në sensin, mendimet dhe karakterin e një personi. Po kështu, në të njëjtin prizëm duhet të shihen edhe kredibiliteti, stima dhe vlerat e tij në sytë e njerëzve të tjerë dhe Zotit. Cilësitë e njeriut superior, thellësia e sensit dhe mendimit si dhe vendosmëria e karakterit të tij përbëjnë një fletë nderi apo biletë me anë të së cilës ai pranohet

kudo. Një njeri i cili e ndot besimin dhe mendjen e tij me anë të ideve dhe veseve si ato të jobesimtarëve të cilat shkaktojnë ankth dhe frikë rreth tij për shkak të karakterit të tij të dobë, nuk mund të përbëjnë një bazë të shëndoshë për të mundësuar ndihmën dhe favoret e së Vërtetës e as për ruajtjen e paprekur të kredibilitetit, stimës dhe besimit të tij në sytë e njerëzve, për arsye se Zoti i plotfuqishëm i gjykon njerëzit duke u bazuar në virtytet e tyre njerëzore dhe karakterin superior dhe i shpërblen në përputhje me to. Ja përse ata të cilët janë të varfër në virtyte dhe të dobët në karakter e kanë shumë të vështirë të bëjnë gjëra të mëdha dhe të ruajnë arritjet e tyre, megjithëse në aparençë ngjajnë me besimtarë të mirë. Nga ana tjetër ata të cilët janë disa hapa përpara në vendosmërinë e karakterit dhe në cilësinë e njerëzve superiorë e kanë shumë të vështirë të dështojnë të gjithë sëbashku, edhe nëse ndoshta nuk duken si muslimanë të mirë. Meqënëse shpërblimi dhe vlerëzimi i Zotit janë në përputhje me cilësitë e njerëzve, mirëseardhja apo pranimi miqësor i qënieve njerëzore në njëfarë mënyre varet prej kësaj.

c) Mjetet për të arritur një objektiv të drejtë dhe të ligjshëm duhet të jenë gjithashtu të drejta dhe të ligjshme. Për ata të cilët ndjekin rrugën e islamit, objekti i përpjekjeve të cilëve në çdo sipërmarrje duhet të jetë i ligjshëm dhe i drejtë, ligjshmëria e mjeteve për arritjen e qëllimieve të tyre përbën një detyrim. Meqënëse kënaqësia e Zotit dhe bashkimi me të Vërtetën nuk mund të arrihen pa sinqeritet dhe pa vepruar për hir të Zotit, edhe shërbimi ndaj islamit dhe fokusimi i muslimanëve drejt qëllimeve apo objektivave të drejtë nuk duhet të arrihet nepërmjet mjeteve dhe rrugëve të këqija. Të jep përshtypjen sikur e vërteta është krejt e kundërta; ata të cilët kanë kumbur ndihmën e Zotit dhe respektin e njerëzve ndaj tyre për shka të vlerave të konsumuara, kredibilitetit dhe stimës boshe, paaftësisë dhe rrugëve të shtrembërta nuk mund të pretendohet të jenë të suksesshëm për një kohë të gjatë.

Cilësia e pestë e trashëgimtarëve të tokës është të qenit të aftë për të meduar lirisht dhe respekti për lirinë e mendimit. Të qenit i lirë dhe gëzimi i lirisë përbëjnë një aspekt domethënës të vullnetit njerëzor dhe një portë misterioze nepërmjet së cilës njeriu mund të depërtojë në sekretet e vetvetes. Një person i paftë për të depërtuar drejt kësaj thellësie dhe për të kaluar

nepërmjet kësaj porte, është e vështirë të quhet njeri. Për një kohë të gjatë ne jemi përpëlitur nën prangat e tmershme të skllavërisë të cilat i kemi përjetuar me anë të mendjeve dhe ndjenjave tona, për shak të shtrembërimeve të ndryshme që kanë ardhur si nga brenda ashtu dhe jashtë vendit. Në rrethanë në të cilat kufizime të mëdha na janë imponuar në lexim, mendim, ndjenja dhe jetë, është e pamundur të mbahen të pacënuara cilësitë njerëzore, le më pastaj të arrihet rilindja apo progresi. Në një situatë të tillë është mjaft e vështirë të ruhet madje edhe niveli i njeriut të rëndomtë, le më pastaj të dalin në pah personalitete të mëdhenj të cilët të ngrihen mbi të tjerët duke qenë të pajisur me shpirtin e rinovimit dhe reformimit, sytë e të cilëve të shohin drejt pafundësisë. Në të tilla kushte ekzistojnë vetëm karaktere të dobëta të cilët përjetojnë devijime në personalitetin e tyre si dhe njerëz me shpirta përtacë dhe ndjenja të paralizuara. Në të shkuarën tonë të afërt, pikëpamje të shtrembëra dhe të devijuara si dhe kriterë defektoze dhe jo tingëlluese u injektuan brenda shpirtit tanë nepërmjet shtëpive, rrugëve, institucioneve edukative dhe qarqeve artistike duke sjellë për pasojë dëmtimin e gjithçkaje, që nga materialja tek jomaterialja, që nga fizika deri tek metafizika. Gjatë këtyre viteve ne do të shprehim obsesionet tona duke pretenduar se po shprehim mendime; do të planifikojmë çdo gjë në mënyrë egocentrike duke mos llogaritur asnjëherë se mund të ekzistojnë edhe pikëpamje, besime dhe mendime të tjera përveç tonave; sapo gjenim rast, ne i drejtohem forcës dhe me anë të saj ndërmerrim masa ndëshkuese kundër njerëzve të drejtë dhe me vullnet të lirë; gjithmonë persekutojmë dhe nepërkëmbim dikë. Është një mekat i madh që edhe tani është e pamundur të themi se këto gjëra nuk ndodhin dhe nuk do të ndodhin më në të ardhmen. Megjithatë ndërsa ne ecim drejt rimëkëmbjes, është e domosdoshme që të rishikojmë dinamikën historike të njëqind viteve të fundit dhe të studjojmë arsyet e ndryshimeve dhe transformimeve të njëqind e pesëdhjetë vjetëve të fundit të historisë sonë. Kjo përbën një domosdoshmëri për faktin se gjykimet dhe vendimet edhe sot merren në përputhje me disa tabu të caktuara të pavëna në diskutim. Pikëpamjet e caktuara të cilat i udhëheqin këto vendime, i bëjnë ato të paafta dhe defektoze duke mos qenë produktive dhe duke mos mundur kurrë të bëhen shkas për përgatitjen dhe shpresat për të ardhmen e ndritur. Nëse kjo e ardhme

do të përgatitej brenda kornizës së pikëpamjeve aktuale do të kishim për pasojë përplasje ndërmjet grupeve të ndryshme të futur në rrjetën vdekjeprurëse të ambicieve, do të përjetonim konflikte ndërmjet partive politike, luftë midis popujve dhe përplasje ndërmjet fuqive të ndryshme. Kjo është arsyeja përse sot një sektor i caktuar të shoqërisë përplasët me një tjetër, përse diferencat shndërrohen në luftra; kjo është arsyeja e terrorit shkatërrues, brutalitetit dhe gjakderdhjes në botë. Nëse nuk do të kishte ekzistuar egoizmi, lakmia, ambicia dhe ashpërsia e njerëzve, bota sot do të ishte e ndryshme nga ajo ekzistuese.

Ja përse ndërsa ne përpiqemi të ecim drejt botërave të ndryshme duke marrë në konsideratë sjelljen tonë ndaj të tjerëve dhe ambiciet tona personale, ne duhet të jemi më të lirë në mendim dhe në veprim. Ne kemi nevojë për ato zemra të gjëra të cilat janë në gjndje të përqafojnë mendimin e lirë të paanshëm, të cilat janë të hapura ndaj dijes, shkencës dhe kërkimit shkencor dhe të cilat janë në gjendje të kuptojnë përputhjen ndërmjet kur'anit dhe sunnetullahut me spektrin e gjërë të universit të jetës. Në të shkuarën njerëz gjenialë i ndërmorrën dhe i kryen këto detyra të mëdha. Megjithatë so ato mund të kryhen vetëm me anë të një bashkësie njerëzish e cial ta marrë përsipër përmbushjen e misionit të këtyre njerëzve gjenialë. Në një kohë kur gjithçka është bërë kaq e detajuar, e ndarë në pjesë të veçanta, e specifikuar dhe e numëruar, këto detyra janë bërë të tilla sa që edhe individët unikë dhe të dalluar prej të tjerëve nuk mund ti kryejnë ato vetëm. Kjo është arsyeja përse vendin e gjenive tani e kanë zënë ndërgjegjet kolektive të pajisura me vendimarrje konsultative dhe kolektive dhe me ndërgjegje shoqërore, gjë e cila përbën me apk fjalë cilësinë e gjashtë të trashëgimtarëve të tokës.

Është fakt që në të shkuarën e afërt, bashkësia islame nuk i ka zotëruar këto ide. Në fakt nuk ka qenë e mundur të arrihet ndërgjegjia kolektive, vendimarrja kolektive e mbështetur tek konsultimi, mendja dhe ndërgjegjia kolektive kur shkollat merreshin vetëm me shqiptimin e dogmave të tyre të veçanta; kolegjet merreshin vetëm me ca aspekte sipërfaqësore të jetës; strehët e dervishëve ishin totalisht të ngulitura në metafizikë dhe kazermat ushtarake ulërinin dhe pozicionoheshin nga ana e forcës. Gjatë kësaj periudhe, shkollat ngelën nën influencën e skolasticizmit të errët duke marrë dhe njerrë frymë nga ajri i kësaj rryme; kolegjet ishin të mbyllura ndaj shkencës dhe mendimit,

të privuara nga aftësia e tyre për tu zhvilluar duke jetuar si të paralizuar; vendstrehimet e dervishëve ngushëlloheshin me anë të anekdotave të së shkuarës në vend që të bëheshin çerdhe zelli; ata të cilët përfaqësonin pushtetin ranë në falsitet saqë u harruan duke vuajtur vazhdimisht nevojën për tu kujtuar nga të tjerët dhe për të provuar forcën e tyre. Në këtë mënyrë çdo gjë u kthye përmbys dhe pema e kombit u lëkund dhe pothuajse u shkul nga toka. Fatkeqësisht duket se ne mund të përjetojmë përsëri lëkundje të tilla edhe në ditët tona, derisa të vijë një ditë kur ata njerëz me fat dhe të shumëpritur të bëhen pjesë e dinamikave të duhura në vendin dhe kohën e duhur duke hequr barrierat ndërmjet mendjes dhe zemrës dhe duke vendosur korridoret e mendimit dhe frymëzimit në dimensionin e fshehtë të njerëzimit.

Cilësia e shtatë e trashëgimtarëve të tokës është “të menduarit matematik.” Në të shkuarën popuj të Azisë Qendrore dhe më vonë të Perëndimit e përjetuan rilindjen e tyre me anë të ligjeve të të menduarit matematik. Njeriu zbuloi dhe solli në dritë shumë gjëra të paqarta dhe të panjohura prej botës misterioze të numrave. Pa kaluar në ekstremet e hurufive,⁵ ajo që ne themi është se pa matematikën është e pamundur të kuptohen lidhjet ndërmjet njerëzimit dhe fenomeneve natyrore. Ajo është një fushë e cila ndiçon rrugën tonë si një fanar në vijën që shtrihet nga universi drejt jetës; ajo na tregon çfarë ka përtej horizontit njerëzor, madje edhe thellësitë e botës së të papriturave për të cilën është mjaft e vështirë të mendohet, prandaj kjo shkencë na bën të takohemi me idealet tona.

Nga ana tjetër të qenit matematicien nuk nënkupton njohjen e gjithçkaje që ka lidhje me matematikën por do të thotë të mendojmë në mënyrë matematike, të mendojmë brenda ligjeve matematike dhe të jemi të vetdijsëm se ajo lejon gjithçka që nga mendja njerëzore e deri tek thellësitë e ekzistencës, nga fizika deri tek metafizika, nga lënda deri tek energjia, nga trupi deri tek shpirti, nga ligji deri tek sufizmi. Nëse duam ta kuptojmë ekzistencën krejtësisht, neve na duhet të pranojmë një metodë të dyfishtë të të menduarit sufist dhe të të menduarit shkencor. Perëndimit esencialisht i mungon thelbi dhe është përpjekur ta kompesojë këtë mungesë sa të mundet duke kërkuar stre tek misticizmi. Në botën tonë e cila ka qenë e lidhur ngushtë gjithmonë me shpirtin e islamit, nuk është e nevojshme të hidhen sytë drejt asgjëje të huaj

dhe as të kërkohet strehë tjetërkund. Ne e kemi të gjithë burimin tonë të fuqisë nrënda sistemit të mendimit dhe besimit islam. Kjo është e mjaftueshme për sa kohë që ne e kuptojmë këtë burim dhe shpirt me pasurinë e vet origjinale. Atëherë ne do të shohim disa prej lidhjeve misterioze në ekzistencë sesa harmonike janë dhe do të arrijmë një shkallë të ndryshme aftësie holumtuese duke arritur të gjejmë kënaqësi në gjithçka.

Kjo është vetëm një përmbledhje e shkurtër apo hyrje në të menduarit matematik. Edhe nëse sot kjo mund të duket një gjë e paqërtë dhe humbje kohe, unë mendoj se kjo ide do të ketë jehonë të madhe në të ardhmen. Cilësia e tetë është kuptimi ynë për artin. Megjithatë për shkak të konsideratave të caktuara të së tashmës unë do të thojë që disa qarqe nuk janë ende të gatshme për të depërtuar brënda këtij kriterit tonë duke ia lënë shtjellimin e këtij koncepti të ardhmes.

KONSULTIMI

Për trashëgimtarët e sotëm, konsultimi (shura) përbën një cilësi jetësore dhe një rregull thelbësor siç ishte edhe për trashëgimtarët e parë. Sipas kur'anit konsultimi është shenja më e qartë e një komuniteti besimtarësh dhe karakteristika më e rëndësishme e një kongregacioni i cili ja ka dorëzuar zemrën islamit. Rëndësia e konsultimit është sipas kur'anit e së njëjtës gradë me namazin (lutjet ditore) dhe infakun (rënia në luftë për mbrojtjen e fesë dhe njerëzve për hir të Zotit): "...Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japin ata e shpërndajnë." (Shura 42:38)

Në këtë ajet neva na bëhet e ditur se konsultimi përbën një lloj veprimi i cili është i të njëjtit nivel me namazin; na bëhet i ditur domethënia e konsultimit me anë të faktit se përgjigja dhe pranimi i fjalës apo ftesës së Zotit dhe rrjedhojat e saj si namazet, konsultimet dhe dhënie e lëmoshës përmenden në të njëjtin urdhër hyjnor.

Kjo është arsyeja përse një shoqëri e cila nuk e konsideron konsultimin të rëndësishëm vështirë se mund të quhet një shoqëri plotësisht besimtare dhe një komunitet i cili nuk e zbaton metodën e konsultimit nuk konsiderohet si

musliman në kuptimin më të plotë të fjalës. Në islam konsultimi është absolutisht thelbësor; këtij rreguli duhet ti binden si ligjvënësit ashtu edhe njerëzit e thjeshtë. Ligjvënësi është përgjegjës për kryerjen e konsultimit në çështje që i takojnë sferave politike, qeverisëse dhe legjislative; populli është përgjegjës për shprehjen e pikëpamjeve dhe mendimeve të tij ligjvënësve.

Disa gjëra të rëndësishme që vlejné për tu theksuar këtu janë: konsultimi është kushti i parë për sukses për një vendim të marrë në ndonjë çështje. Ne të gjithë e kemi parë se si të gjitha vendimet e marra pa u diskutuar hollësisht dhe gjerësisht më parë, pa e marrë në konsideratë pikëpamjet dhe kriticiamit e të tjerëve, qoftë kur kanë pasur të bëjnë me individë të veçantë, qoftë kur kanë pasur të bëjnë me fatet e shoqërisë kanë rezultuar fiasko, të dështuara dhe të papërkrahura. Edhe nëse një person ka natyrë superiore dhe intelekt të shquar, nëse ai është i kënaqur me opinionin e tij dhe njëkohësisht nuk pranon dhe nuk respekton opinionin e të tjerëve, është i prirur të bëjë më shumë gabime se njerëzit normalë. Njeriu më inteligjent është ai i cili vlerëson dhe respekton konsultimin e ndërsjelltë dhe shqyrtimin e çështjeve (mashvaratin) dhe i cili përfiton më së shumti nga idetë e të tjerëve. Ata të cilët janë të kënaqur me idetë e tyre në planet dhe punët që kryejnë apo ata që insistojnë me forcë që të tjerët të pranojnë këto ide, jo vetëm që humbasin një dinamikë mjaft të rëndësishme por gjithashtu përballen me mospajtime, përbuzje dhe urrejtje nga njerëzit me të cilët ata shoqërohen. Ashtu siç ishte konsultimi kushti i parë për të arritur rezultatet më të mira në çdo detyrë të ndërmarrë, po kështu kjo cilësi është padyshim një prej mjeteve që e bën njeriun të gjejë një burim domethënës fuqie shumë më të fuqishëm se forcat e veta.

Përpara çdo aventure një person duhet të mos kursejë asnjë përpjekje në kryerjen e hetimit, shqyrtimit dhe konsultimit parapreak të nevojshëm me qëllim shmangien e kritikave ndaj fatit të keq dhe qortimit të të tjerëve sëbashku me lënien e autorësisë së punës shkaqeve, duke bërë të mundur kështu qëndrimin brënda kornizave të kujdesit, duke sjellë në këtë mënyrë frenimin e ecjes zhytjes në veprime të dëmshme dhe pasojave që shpien drejt rrënimit dhe fatkeqësisë. Mospajtimi dhe ankesat janë të paevitueshme në qoftë se rezultati i përpjekjeve dhe rrjedhojat e tyre nuk kanë qenë të menduara mirë dhe në qoftë se njerëzit të cilët kanë qenë protagonistë të këtyre ngjarjeve

janë hedhur drejt aventurës pa u konsultuar më parë. Aventurat dhe sipërmarrjet e ndërmarra pa konsultim paraprak nuk kanë sukses dhe u shkaktojnë protagonistëve të tyre humbjen e kredibilitetit, duke i bërë ata të pashpirt, të shkurajuar dhe të papranuar prej njerëzve.

Konsultimi përbën një nga dinamikat kryesore e cila e mban ligjin islamik në këmbë si sistem. Konsultimi është pjesë e misionit dhe detyrës më të rëndësishme e zgjidhjes së çështjeve si nga pikëpamja individuale ashtu dhe ajo kolektive, mes njerëzve dhe shtetit, shkencës dhe dijes, ekonomisë dhe sociologjisë përderisa të mos ekzistojë një nass (urdhër hyjnor; një ajet i kur'anit apo urdhër i profetit vendimtar në ndonjë pikë të ligjit islam) me një domethënie të qartë në lidhje me këtë çështje.

Në islam, këshilli konsultativ i shtetit është një institucion me një pozitë udhëheqëse; ai merr pjesë paraprakisht në vendimet ekzekutive. Sot në shumë vende ekziston një gjykatë e lartë po funksioni i saj është mjaft i kufizuar, kopetencat e saj janë mjaft të ngushta duke e bërë atë një institucion shumë më të kufizuar në krahasim me konsultimin islam.

Edhe nëse krerët e shteteve apo udhëheqësit konfirmohen nga Zoti dhe ushqehen me anë të shpalljes dhe frymëzimit, ata janë të detyruar ti kryejnë punët me anë të konsultimit. Ka pasur disa prej tyre të cilët e kanë anashkaluar këtë veprim por në përgjithësi numri i vendeve apo bashkësive të cilat e kanë ngritur një institucion të tillë nën emra dhe tituj të ndryshëm, në epoka të ndryshme, është i konsiderueshëm. Në fakt çdo shoqëri e cila e ka injoruar dhe nuk e ka marrë parasysh këtë institucion nuk ka përparuar por përkundrazi është shuar. Prandaj i Dërguari i Zotit e shikonte shpëtimin dhe progresin e bashkësisë së tij tek konsultimi reciprok: “Ata të cilët konsultohen nuk do të jenë kurrë të humbur.”⁶

Konsultimi në kur'an theksohet qartë në dy ajete por ka shumë ajete të tjerë që i referohen atij. Ajeti i parë në të cilin përmendet konsultimi është cituar më lart ndërsa i dyti i cili nuk ka nevojë fare për interpretim është ky:

“Konsultohu me ta në çështje të ndryshme (Ali Imran 3:159).”

Duhet gjithashtu të kihet parasysh se konsultimi është fjala kyq e kësaj sureje dhe se sa kuptimplotë është ai saqë sureja është quajtur shura

(konsultimi), duke nënvizuar kështu një nga parimet bazë të cilat karakterizojnë bashkësinë e besimtarëve të vërtetë.

Në këtë kapitull, konsultimi trajtohet si një cilësi e veçantë e sahabeve. Ekziston një hadith në të cilin thuhet: “E përse u dashka që ata (sahabet) veprat e të cilëve kryhen gjithmonë duke u bazuar tek konsultimi, të mos lavdërohen?” Nga fakti që sahabet ishin veçanërisht të lavdëruar për shak të konsultimit në krahasim me shumë cilësi të tjera, kjo përbën një tregues mjaft të rëndësishëm të domethënies së tij.

Meqënëse konsultimi theksohet si një rregull i rëndësishëm në kur'an ne gjithashtu dëshmojmë se atij i është dhënë një rëndësi e konsiderueshme edhe në shembullin profetik (sunneti) dhe se rëndësia e tij është theksuar në mënyrë të vazhdueshme. I Dërguari i Zotit gjithmonë është konsultuar me të tjerët qofshin burra apo gra, të rinj apo pleq në çështje për të cilat nuk ka pasur Shpallje hyjnore. Megjithëse tani ne mund të jemi mjaft të avancuar në shumë fusha të ndryshme, ne nuk mund të pretendojmë që e kemi arritur nivelin e konsultimit që ka ekzistuar në atë periudhë.

Duke u konsultuar me sahabet e tij në çdo çështje, i Dërguari i Zotit i merrte në konsideratë opinionet dhe pikëpamjet e tyre prandaj çdo veprim që planifikonte ai ua paraqiste dhe ia parashtronte ndërgjegjes kolektive; ai mori parasysh çdo ndjenjë, emocion dhe tendencë që buronte nga ndërgjegjia kolektive, duke bërë që vepra e tij të ketë forcë dhe kohëzgjatje më të madhe. Prandaj me anë të bashkimit dhe përfshirjes së çdo njeriu mendërisht dhe shpirtërisht në punën që duhej kryer, ai e përmbushi projektin e tij në mënyrën më të fuqishme dhe kumbuese të mundshme.

Tani ne do të paraqesim disa incidente nga jeta e profetit për ta ilustruar këtë.

Përpara dhe pasi muslimanët arritën në Uhud, i Dërguari i Zotit u këshillua me sahabet dhe i udhëzoi ata të ndjekin strategji të caktuara gjatë betejës. Ndërmjet strategjive që ai shpalosi pa pasur asnjë vërejtje direkte apo indirekte prej sahabeve ishte: vendosja e disa luftëtarëve në një pozicion të caktuar mbi kodër; luftëtarët nuk duhet të ndesheshin me armiqtë dhe të merrnin pjesë në betejë dhe as nuk duhej të ndryshonin apo lëshonin pozicionet e tyre, pavarësisht asaj që do të ndodhte; edhe në qoftë se ushtarët

e tjerë do të thyenin armikun dhe do të rendnin pas plaçkave të luftës pas një fitorjeje të qartë, luftëtarët nuk duhej të lëshon pozicionet dhe duhet të vazhdonin të ndiqnin urdhërat e dhëna dhe të shkonin pas luftëtarëve të tjerë...

Megjithëatë edhe pse e kuptonin mençurinë e të bindurit ndaj urdhërave, disa prej sahabeve ranë në gabimin e interpretimit apo të gjykimit nga mendja e tyre në lidhje me kohën në të cilën urdhri i dhënë nuk ishte më i vlefshëm, duke vepruar kështu në mënyrë të tërthortë në kundërshtim me urdhrin e dhënë nga i Dërguari i Zotit gjatë konsultimit paraprak.⁷ Nëse ndonjë tjetër do të ishte përballur me një kundërshtim të tillë dhe nëse do të kishte përjetuar humbjet dhe dëmin që ai vuajti në atë kohë, ky person me siguri do ti kishte qortuar këta njerëz dhe idetë e tyre duke u thënë : “Ikni dhe Zoti ju ndëshkoftë sepse ju dezertuat.” Por i Dërguari i Zotit nuk e bëri këtë. Megjithëse ai ishte plagosur dhe njëra faqe i ishte mbuluar nga gjaku si pasojë e sulmit të befasishëm të armiqve në momentin kur për shkak të veprimit të sahabeve ai kishte mbetur i ekspozuar; pavarësisht të qnurit i rrethuar prej kufomave të shumë prej sahabeve dhe të afërmëve të tij, në një moment kur disa prej shokëve ishin frikësuar dhe kishin marrë arratinë drejt Medinës për të shpëtuar jetën, i Dërguari i Zotit ua recitoi ajetin “Kryeni punët me anë të konsultimit” atyre që kishte përreth qofshin fajtorë apo jo sikur të mos kishje ndodhur asgjë dhe u ul e u konsultua me ta përsëri rreth lëvizjes së ardhshme që do të bënte. Ai jo vetëm që mori këshilla prej tyre, por në të njëjtën kohë i njoftoi gjithashtu se do të faleshin duke u recituar ajetin e sapo zbritur që e urdhëronte atë për tu lutur për faljen e tyre.

“Ti ishe ishe i butë ndaj tyre, sepse Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërdridheshin prej teje, prandaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që i mbështeten.” (Ali Imran 3:159)

Kur zbriti ky ajet pas betejës së Uhudit, i Dërguari i Zotit raportohet të ketë thënë: “As Zoti e as i Dërguari i Tij nuk kanë nevojë për konsultim. Megjithëatë Zoti e bëri atë një mënyrë për të fituar Mëshirën e Tij. Cilido që konsultohet nuk shmanget nga rruga e drejtë dhe cilido që e lë konsultimin devijon.” Mund të kuptohet qartë nga ky hadith se Zoti ia ngarkoi detyrën e

konsultimit të Dërguarit të Tij, i cili nga ana e vet nuk kishte nevojë për të, në mënyrë që të vepronin kështu edhe administratorët apo udhëheqësit e tjerë. Udhëheqësve u kujtohet se ata nuk duhet të ushtrojnë dijtat dhe se ata duhet të përfitojnë nga idetë e qytetarëve të tyre; kjo përbën mënyrën me anë të së cilës qytetarët mund të sigurojnë asistencë në qeverisjen e vendit.

Disa prej shprehjeve të profetit në lidhje me konsultimin ndërmjet shumë të tjerave jepen në vijim:

Një person që konsultohet nuk do të ketë shkak për keqardhje.⁸

Një njeri që konsultohet nuk do të dëmtohet.⁹

Ai që konsultohet është i sigurtë.¹⁰

Nuk ka pasur asnjë bashkësi e cila është konsultuar dhe nuk ka arritur rezultatet e duhura.¹¹

Duke pasur parasysh gjithë këto ekziston një konsensus ndërmjet dijetarëve islamë rreth faktit se konsultimi përbën një prej parimeve bazë të islamit dhe se është një prej rregullave të nevojshme që duhen zbatuar në jetë. Kjo gjë është kuptuar dhe zbatuar gjithmonë në këtë mënyrë, megjithëse disa diferenca në zbatimin e kësaj pike mund të vërehen përgjatë epokave, kushteve dhe rrethanave specifike në botën islame.

* * *

Është e qartë se konsultimi nuk ka më tepër prioritet se Urdhërat Hyjnorë si burim legjislacioni. Ai në vetvete e merr fuqinë prej këtyre urdhërave hyjnorë dhe megjithëse mund të jetë bazë për disa ligje dhe parime, konsultimi është një fushë e kufizuar meqënëse varet prej burimeve të vërteta legjislative. Në ato çështje në të cilat ekziston një dekret i qartë hyjnor, nuk ka vend për ndërhyrjen e qënieve njerëzore, prandaj njerëzit në këtë rast duhet ta përdorin konsultimin vetëm për të arritur kuptimin e plotë të tyre. Ndërsa çështjet për të cilat nuk ekziston ndonjë dekret hyjnor, ngelen të hapura krejtësisht për konsultim dhe konsiderohen brënda kufijve të konsultimit. Në këtë çështje është detyrë respektimi i rezultateve dhe i vendimeve të marra me anë të konsultimeve, prandaj askush nuk duhet të veprojë në kundërshtim me vendimin e marrë dhe të vazhdojë të përhapë apo të mbrojë ide apo opinione të ndryshme. Nëse është bërë një gabim në vendimin e marrë edhe nëse ky

është marrë nga shumica, kjo shumicë duhet ta korrigjojë dhe të bëjë amendimet e duhura përsëri me anë të konsultimit.

Megjithëse urdhërat hyjnorë në lidhje me konsultimin janë në njëfarë mënyre të përgjithshme, ato kufizohen me anë të urdhërave në çështje të veçanta dhe gjithashtu prej veprimeve të të Dërguarit të Allahut. Në fakt urdhërat në islam, me disa përjashtime të vogla (ata të cilat dhprehin parime universale dhe rregulla të përgjithshme), nuk ndalen shumë në detajet e çështjeve të cilat mund të gjykohen me anë të ligjeve të dorës së dytë. Çështjet për të cilat nuk ekziston asnjë urdhëresë hyjnore janë tërësisht brënda kufijve të konsultimit, duke qënë çështje të hapura për diskutim.

Pasi pranojmë faktin që çdo çështje për të cilën islami përmban në mënyrë të qartë një urdhëresë është jashtë kufijve të konsultimit dhe se çështjet për të cialt islami nuk ka nxjerrë ndonjë urdhër të qartë mbeten brënda kufijve të konsultimit, mund të themi se konsultimi është i kufizuar prej rregullave të cilave ai u përmbahet dhe që janë brënda kufijve të islamit në çdo rrethanë dhe situatë, prandaj për të realizuar objektivat e përkthura dhe përcaktuara nga Fjala e Zotit në Kur'an, kjo çështje duhet të rregullohet duke iu referuar kur'anit dhe sunnetit. Disa prej parimeve themelore tek të cilat mbështet islami janë: vendosja e barazisë ndërmjet njerëzve; lufta kundër injorancës dhe për përhapjen e dijes; ndërthurja dhe mpleksja e çdo çështjeje dhe pune rreth identitetit islam në mënyrë që muslimanët të mos lejohen të bien në kontradiktë me thelbin e tyre; orientimi i popullit të një vendi në brojtjen e atdheut dhe ruajtja e barazpeshës ndërmjet shteteve; arritja e barazpeshës së duhur të drejtësisë shoqërore të individëve dhe shoqërisë; zhvillimi dhe përparimi i çdo individi dhe i mbarë vendit në fushën e ndjenjave të tilla si dashuria, respekti, altruizmi, sakrifikimi për të tjerët, sakrifikimi i të mirave materiale dhe shpirtërore dhe dëshira për mmirëqënien e të tjerëve; mbajtja dhe ruajtja e barazpeshës ndërmjet kësaj bote dhe tjetrës; rregullimi dhe organizimi i pilitikës vendase dhe ndërkombëtare; ndjekja me hollësi e çështjeve dhe përgatitaj nëse është e nevojshme të të gjitha rezervave për ti bërë ballë gjithë botës duke përfshirë përgatitjen dhe modernizimin e ekipeve të veçanta me qëllim ndeshjen në beteja psikologjike. Të gjitha këto përbëjnë aspekte njerëzore në të cilat udhëheqës, administratorë, opinionistë dhe

filozofë të mëdhenj e kanë vënë theksin gjithmonë. Nën udhëheqjen e ligjit dhe përfaqësimit, profeti i islamit i përpoq gjithmonë për këto qëllime duke bashkuar jetët, kulturat, veprimet, punët dhe marrëdhëniet e njerëzve me njëra tjetrën rreth këtyre parimeve; në këtë mënyrë ai që i aftë ti bashkopnte ndjenjat, idetë, mendjet, logjikën, përceptimet dhe zemrat e tyre.

* * *

Konsultimi, brënda kufijve të vet të tolerancës, sjell disa efekte dhe gjithashtu ndjek disa rregulla të cilat shpien në rezultate pozitive. Në këtë kuptim ne mund të përmendim një rritje të nivelit të mendimit dhe ndërhyrjes në shoqëri; risjelljen ndërmend të rëndësisë së tij nëpërmjet marrjes në konsideratë të pikëpamjeve në të gjitha ngjarjet e reja; duke çuar në këtë mënyrë në prodhimin e ideve alternative; mbajten e konsultimit si një parim aktiv për sa i përket çështjes të së ardhmes së islamit; marrjen në çdo rast të **Saëaad** al-A'zam (shumicës së individëve më të lartë dhe më të aftë në këshillin e komunitetit musliman) për t'iu bashkuar administratës në një nivel të caktuar; sigurimi i kontrollit publik të administratës në mënyrë që njerëzit të jenë të ndërgjegjshëm për nevojën e pyetjes dhe marrjes në llogari të administratorëve kurdoherë që situata e kërkon si dhe parandalimi i veprimeve të papërgjegjshme të udhëheqësve nëpërmjet kufizimit të pushtetit të tyre ekzekutiv.

Siç e theksuam më lart, falë kësaj rëndësie jetësore të konsultimit, Zoti iu drejtohet sahabeve të Profetit Muhammed si njerëzit “të cilët i kryejnë punët e tyre me anë të konsultimit” (Shura 42:38). Për më tepër fakti në të cilin aty nga fundi i luftës së Uhudit, në momentin më të dhimbshëm, Zoti edhe njëherë e urdhëron profetin të “konsultohet, të marrë këshilla prej tyre” (Ali Imran 3: 159) me sahanet, të cilët kishin sjellë pasoja kaq dramatike dhe momente kaq të dhimbshme, është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Të dy ajetet e shpallura të cilat kanë të bëjnë me parimin e konsultimit janë jashtëzakonisht fleksibël dhe të ndjeshme ndaj nevojave të çdo epoke; ato kanë një gjërësi që tejkalon çdo epokë, prandaj nuk ka rëndësi nëse bota ndryshon dhe koha eccën; edhe nëse njerëzit do të jenë në gjendje të ndërtojnë qytete në qiell, ata nuk do ta ndjejnë nevojën për ti shtuar ndonjë gjë të re

këtyre urdhërave (dy ajeteve të lartpërmendura). Në fakt, të gjitha rregullat dhe parimet e tjera të islamit janë të hapura ndaj këtij lloj fleksibiliteti dhe universaliteti dhe kanë ruajtur gjithmonë dhe do të vazhdojnë të ruajnë edhe në të ardhmen freskinë, rëndësinë dhe vlefshmërinë e tyre pavarësisht kohës që kalon.

Do të ishte e nevojshme të bënim një përmbledhje të pikave që formojnë bazat e konsultimit.

1. Konsultimi është një e drejtë si e qeverisësve ashtu dhe e të qeverisurve; dhe në ushtrimin e kësaj të drejte askush nuk ka preferencë, përparësi apo superioritet mbi të tjerët. Nëë ajetin “Ata të cilët i bëjnë punët me anë të konsultimit” (Shura 42:38), kur’ani e bën të qartë se të dy palët, si qeverisësit ashtu dhe të qeverisurit, gëzojnë të njëjtin status: në të gjitha situata që kanë lidhje me muslimanët si për sa i përket anës individuale ashtu dhe asaj kolektive, të drejtat e qeverisësve dhe të qeverisurve pranohen si të barabarta. Megjithatë, e drejta e konsultimit mund të ndryshojë sipas vendit, kohës dhe kushteve duke bërë që edhe mënyra e kryerjes së këtij konsultimi të ndryshojë.

2. Si rrjedhojë e ajetit “Konsultohu me ta në të gjitha çështjet” (Ali Imran 3:159), është e detyrueshme që qeveritari apo administratori ta sjellë çështjen e cila ka nevojë për konsultim në vëmendjen e njerëzve me gjykim të shëndoshë, përndryshe ai do të mbajë përgjegjësi. Të qeverisurit janë përgjegjës për shprehjen e pikëpamjeve të tyre dhe atyre duhet tu kërkohet ta bëjnë këtë. Megjithatë, në qoftë se të qeverisurit nuk i shprehin pikëpamjet e tyre kur u kërkohet atëherë ata konsiderohen njëllë përgjegjës. Kjo vjen për faktin se ata konsiderohen si njerëz të cilën nuk e kanë përmbushur detyrën e qytetarit për arsye se nuk kanë dashur të dëgjohen kur kanë shprehur pikëpamjet e tyre dhe akoma më tej kur ata neglizhojnë ti shprehin pikëpamjet dhe opinionet e veta.

3. Kryerja e konsultimit për të fituar kënaqësinë e Zotit dhe për përfitimin e muslimanëve, duke mos lejuar që këshilli konsultativ të preket apo devijojë për shkak të rryshfeteve kërcënimeve apo presionit, përbën një aspekt thelbësor. I Dërguari i Zotit ka thënë : “Një njeri që konsultohet është një njeri

me besim; ai që konsultohet rreth një çështjeje, duhet ti shprehë pikëpamjet sikur të ishte duke vendosur për veten e tij.”

4. Mund të mos ketë gjithmonë unanimitet (ixhma) në konsultim. Megjithëatë në rastet kur nuk ka ndonjë konkurrencë të përgjithshme dhe kur konsensusi i opinionit dhe i mendimeve të parashtruara nga pjesëmarrësit është pak a shumë i gjërë, vendimi merret dhe njerëzit pajtohen sipas opinionit dhe bindjes së shumicës. Sipas të Dërguarit të Zotit, shumica konsiderohet se përfaqëson konsensus të plotë:

Dora e Zotit është me shumicë.¹²

Populli im nuk bashkohet rreth devijimit.¹³

Unë iu luta Zotit të mos e lërë popullin tim të bashkohet në humbje dhe Ai e pranoi lutjen time.¹⁴

Në këto hadithe neve na bëhet e qartë se pikëpamjet e shumicës janë po aq të fuqishme sa unanimiteti dhe se ne duhet të zbatojmë dhe ti bindemi vendimit të shumicës. Ne mund të përmendim shumë shembuj nga jeta e profetit prandaj shkurt mund të themi se konsultimet qoftë në fillim ashtu dhe në fund të luftës së Bedrit dhe Uhudit qenë bërë në këtë mënyrë.

5. Kur arrihet në një përfundim me unanimitet apo me anë të mendimit të shumicës, për sa kohë që konsultimi të jetë kryer sipas rregullave të lartpërmendura, në përputhje me parimet e konsultimit, nuk është e lejueshme të ketë mospërputhje apo kundërshtime të vendimeve të marra dhe të propozohen ide alternative. Të vazhdosësh të shprehësh mendime kundërshtuese ndaj vendimeve të marra me fjalë të tilla si “Por unë sugjeroja një pikëpamje të ndryshme dhe më të mprehtë” apo “Unë bëra një vërejtje apo koment që kundërshton vendimin e marrë”, është një veprim që të çon vetëm në humbje dhe nuk është asgjë më pak sesa mëkat. I Dërguari i Allahut shkoi në Uhud në pajtim të plotë me pikëpamjet e shumicës, megjithëse kjo ishte kundër gjykimit (ixhtihadit) të tij; pas beteje ai nuk foli dhe nuk bëri asnjë vërejtje në lidhje me pikëpamjet e shumicës, shkaqeve dhe pasojave që sollën ato, pavarësisht se këto pikëpamje kishin qenë të gabuara. Për më tepër kur’ani tregon se zalla (rrëshqitja) e mukarrabinëve (njerëzve të afërt), e cila ndodhi gjatë përgatitjes së luftës së Uhudit mund edhe të analizohej.¹⁵

6. Konsultimi ka të bjë me zgjidhjen e problemeve ekzistuese. Ai nuk kryhet për të marrë vendime konjunkturale që kanë lidhje me ngjarje hipotetike. Në çdo rast, jeta islame vazhdon nën dritën e urdhërave hyjnorë. Ngjarjet të cilat ndodhin përjashta kësaj kornize si dhe jashtë këtyre planeve apo projekteve të cilat duhet të realizohen plotësisht duke marrë parasysh veçantitë e tyre dhe të zgjidhen brënda vetvetes, në përputhje me mënyrën e tyre të parashtrimit.

7. Këshilli konsultativ thirret kur lind nevoja dhe vazhdon të veprojë derisa problemet të kenë marrë zgjidhje dhe planet e projektet të jenë finalizuar. Meqenëse nuk ekziston ndonjë urdhëresë hyjnore që flet për mbajtjen e kongreseve të tilla sipas intervaleve të rregullta, atëherë nuk ekziston ndonjë udhëzim se një konventë e tillë duhet të përbëhet prej individëve të punësuar apo të paguar; praktika e Profetit dhe katër Kalifëve të parë, përbën parametrin e vlerësimit në këtë aspekt; ne nuk duhet të marrim parasysh përvojën e periudhave të mëvonëshme. Është fakt që kryerja e konsultimit nëpërmjet njerëzve të paguar apo zyrtarëve mbart në vetvete shumë probleme dhe komplikacione.

* * *

Tani është e nevojshme të trajtojmë çështjen e njerëzve me të cilët duhet të konsultohemi. Meqenëse është e pamundur ti mbledhim të gjithë njerëzit në një vend të caktuar dhe ta kryejmë konsultimin në këtë mënyrë, atëherë ai duhet bërë me anë të një kuadri njerëzish të kufizuar në numër. Për më tepër, meqenëse çështjet e paraqitura për diskutim mund të kërkojnë një shkallë të lartë dijeje, përvoja dhe ekspertize, këshilli konsultativ duhet të përbëhet prej njerëzve të dalluar për këto cilësi. Ky këshill mund të jetë i përbërë vetëm prej njerëzve të rangut të lartë, të cilët janë të aftë të zgjidhin shumë probleme.¹⁶ Veçanërisht në ditët e sotme, kur jeta është bërë më e ndërlikuar dhe e koklavitur, kur bota është globalizuar dhe kur çdo problem është shndërruar në problem planetar gjithëpërfshirës, është e domosdoshme që këta njerëz kompetentë në shkencat natyrore, inxhinieri dhe teknologji të cilët në shumicën e rasteve konsiderohen nga muslimanët si të mirë dhe të përshtatshëm, duhet të marrin pjesë përkrah këtyre njerëzve të rangut të lartë

të cilët njohin thelbin, realitetin, shpirtin islam si dhe shkencat e ndryshme. Konsultimi mund të kryhet me anë të njerëzve të kualifikuar nga fusha të ndryshme të shkencës, dijes dhe sferave të tjera; për sau përket vendimeve të marra, ata mbikqyren nga autoritetet fetare për të parë pajtimin dhe përputhjen e tyre me islamin. Meqenëse konsultimi në vetvete i lihet këtij këshilli, parashtrimi i rrugëve për kryerjen e tij në përputhje me kohën, rrethanat dhe shtetin githashtu është pjesë e këtij objekti. Përgjatë gjithë historisë është e mundur të vërehen ndryshime në kryerjen dhe zbatimin e konsultimit për shkak të epokave dhe rrethanave të ndryshme në të cilat ai është kryer. Nganjëherë në qarqe apo grupe të vogla dhe nganjëherë në qarqe apo grupe të mëdha, herë mes civilëve dhe herë duke hapur rrugët e tij drejt shkencës dhe ushtrisë, koncepti i konsultimit ka pësuar ndryshime dhe diferenca të konsiderueshme. Megjithatë kjo nuk ka ndodhur për arsye se ka ndryshuar ligji por për shkak të fleksibilitetit dhe universalitetit të konsultimit dhe praktikueshmërisë së tij në çdo epokë.

Në përputhje me rrethanat dhe kohën, ndërtimi dhe udhëheqja e këshillit konsultativ mund të ndryshojë, por kualifikimi dhe cilësitë e këtyre njerëzve si njerëz të dijes drejtësisë, edukimit dhe përvojës shoqërore, mençurisë dhe urtësisë nuk duhet të ndryshojnë kurrë. Drejtësi nënkupton plotësimin e të gjitha obligimeve të detyrueshme duke evituar atë çfarë është e ndaluar dhe duke mos bërë asnjë veprim që bie në kundërshtim me vlerat njerëzore; dija përfshin ekspertizën fetare, administrative, politike dhe shkencore. Nuk është e domosdoshme që çdo individ të jetë ekspert në të gjitha fushat e shkencës. Megjithatë këshilli dhe mendja kolektive duhet të jetë e mprehtë ndaj ekspertizës së lartpërmendur. Kur sjelljet e mira, përvoja dhe edukimi shoqëror qëndrojnë në thelb të çështjes, bëhet e mundur marrja e vendimeve falë pikëpamjeve dhe këndvështrimeve të njerëzve me eksperiencë, edhe nëse ata nuk janë pjesë e komunitetit shkencor. Mençuria përfshin dijen, butësinë, në njëfarë mënyre thelbin e profecisë si dhe perceptimin e asaj çfarë qëndron prapa realitetit të fshehur të fenomeneve natyrore. Kjo është një dije e cila i lejon njerëzit të arsyetojnë nën dritën e urtësisë dhe intuitës dhe të kuptojnë atë që ka lidhje me njerëzit e zakonshëm duke shkruar për ta gjithë talentin, aftësinë dhe inteligjencën me qëllim zgjidhjen e problemeve qoftë individuale

qoftë kolektive apo shoqërore. Mençuria është një virtyt me vlera shumë të larta por që posedohet nga shumë pak njerëz.

* * *

Rëndësia që i Dërguari i Zotit i ka kushtuar konsultimit si dhe respekti i tij për opinionin e pleqve, të rinjve dhe njerëzve me pozita të ndryshme shoqërore, këkron një trajtim të plotë dhe të veçantë. Megjithatë duke mos iu larguar qëllimit të këtij libri, ne do të ndalemi në disa shembuj. Ai gjithmonë konsultohej dhe merrte parasysh pikëpamjet e të tjerëve, duke i marrë ato seriozisht dhe duke u përpjekur ti vendosë të gjitha planet dhe projektet alternative mbi baza të shëndosha. Ai e provoi me fakte sesa lart e çmonte konsultimin, herë duke ua shprehur opinionin e tij individëve me gjykim dhe arsye të shëndoshë veç e veç e herë duke i mbledhur këta njerëz të gjithë bashkë dhe duke e bazuar më pas vendimin mbi gjykimin kolektiv:

1. Në rastin e shpifjes ndaj gruas së tij Aishes (ifkit), i Dërguari i Zotit u konsultua me disa prej sahabeve të tij, përkatësisht me Aliun, Omerin, Zejneb binti Xhash dhe Bariran. Aliu shprehu mendimin se i Dërguari i Allahut duhet ti injorojë shqetësimet e tij dhe të mos i marrë në konsideratë shpifjet e pabaza; Omeri, Zejnebi, Barira dhe shumë njerëz të tjerë me vlera të larta thanë se ata besonin se Aishja ishte e pastër dhe e dliërë prej këtyre përgojimeve. Megjithëse zinxhiri i transmetuesve nuk konsiderohet i fortë, flitet për një bisedë ndërmjet Omerit dhe të Dërguarit të Allahut, ku ky i fundit kërkoi opinionin e Omerit në lidhje me ngjarjen. Omeri tha : “Një ditë kur ti ishe duke u larguar nga xhamia, ti i hoqe shapkat dhe i vendose menjëanë. Kur ne të pyetëm arsyen e këtij veprimi, ti the se diçka e papastër i kishte ndotur këto shapka dhe se kryengjelli Xhebrail erdhi dhe të informoi duke të kërkuar që ti heqësh shapkat. Tani, nëse diçka do të kishte ndodhur duke njollosur emrin e mirë të gruas tënde, a mendon se Zoti nuk do të të kishte informuar ty për këtë?” Edhe pse autenticiteti i kësaj bisede nuk konsiderohet i madh nga disa dijetarë të hadithit, leksioni i marrë në lidhje me këshillimin, është mjaft i rëndësishëm.

2. Përpara daljes në shesh për luftën e Bedrit, i Dërguari i Allahut u konsultua me muhaxhirët (emigrantët) dhe ensarët (vendasit).¹⁷ Mikdadi nga ana e muhaxhirëve dhe Saad ibn Muadhi nga ana e ensarëve shprehën pikëpamje të njëjta, të mbushura me besim, nënshtrim dhe entuziazëm, me

anë të të cilave aprovohej, konfirmohej dhe mbështej pikënamja e të Dërguarit të Allahut, duke shërbyer kështu për bindjen e fiseve dhe bashkësive të tyre që ishin prezentë atje se ata duhej ti bindeshin vendimit të marrë. Që nga ai rast e më tutje, mund të vërehet se Profeti gjithmonë ka marrë vendime të tilla jetësore të zbatuara nga krejt bashkësia në unanimitet të plotë, duke vijuar ecjen drejt objektivit i mbështetur nga i gjithë opinioni publik rreth tij.

3. Përsëri, gjatë përgatitjes së luftës së Bedrit, i Dërguari i Zotit, mori këshilla prej sahabeve si Khubab ibn Munzir në lidhje me pozicionet dhe fushën e betejës në të cilën ushtria islame duhej të vendosej dhe mori vendime si dhe përdori strategji në një linjë me këto sugjerime. Muslimanët në atë rast thyen një ushtri tri herë më të madhe se e tyrja dhe u rikthyen në Medine duke kënduar këngë fitoreje.

4. Gjatë luftës së Hendekut (Ahzabit), ai me qëllim i kushtoi vëmendje dhe mori parasysh sugjerimet e Selman al-Farisiut i cili thoshte se muslimanët duhej të gërmonin një hendek rreth e rrotull vendeve ku armiqtë po përgatiteshin dhe po përpiqeshin të depërtonin për në Medine. Ky përbën një shembull tjetër të faktit se i Dërguari i Allahut i ka kushtuar rëndësi të madhe konsultimit.

5. Gjatë negociatave të Traktatit të Paqes të Hudejdijes, i Dërguari i Allahut u konsultua përsëri me Sahabet e tij. Pasi mori opinionet e gjithë muslimanëve, ai u konsultua edhe me gruan e tij, nënën tonë Ummi Selemen, duke mos lënë pas dore apo injoruar opinionet e saj, duke ndarë kështu pikëpamjet dhe tendencat personale me sahabet, e më pas vendosi të veprojë në një mënyrë dhe strategji e cila potencialisht ktheu një disfatë dhe dështim të plotë në një fitore të pastër dhe u kthye në Medine pasi kishte shpëtuar jetën dhe shpirtrat e shumë besimtarëve.

Kur ne hulumtojmë hollësisht jetën e të Dërguarit të Allahut, ne mund të vërejmë se çdo çështje, punë apo problem për të cilin nuk ishte dërguan ndonjë shpallje hyjnore, është kryer me anë të konsultimit, është paraqitur dhe adoptuar nga ndërgjegjia kolektive dhe më pas vendimi është vënë në praktikë dhe është ekzekutuar. Prandaj kësilli i konsultimit të cilin ne e vërejmë edhe në shtete të ndryshme islamike përgjatë .istorisë, nuk është asgjë më shumë apo

më pak sesa një vazhdimësi e thjeshtë e konsultimeve të para dhe e këshillit që ekzistonte në modelin e Profetit.

VEPRIMI DHE MENDIMI

Fusha e betejës për trashëgimtarët e tokës mund të përmbliidhet si “veprim dhe mendim.” Në fakt, rruga e vërtetë e ekzistencës në jetë shkon përmes një transformimi potencial veprimesh dhe mendimesh gjë e cila mund të shpjerë në transformimi edhe të të tjerëve. Në fakt, çdo formë ekzistence e parë nga ky këndvështrim është produkt i një veprimi dhe disa disiplinave të caktuara, ndaj vazhdimësia e saj varet gjithashtu nga ky veprim dhe nga këto disiplina.

Veprimi përbën komponentin më të rëndësishëm dhe të nevojshëm të jetës sonë. Kur marrim mbi vete përgjegjësi të veçanta nepërmjet veprimeve apo mendimeve të vazhdueshme, kur ballafaqojmë dhe mbartim vëshirësi të caktuara, në njëfarë mënyre kur i ngarkojmë vetes si detyrë ti kryejmë ato edhe nëse mund të jenë në kurriz të gjërave të tjera, neve gjithmonë na duhet të veprojmë dhe të përpiqemi. Nëse ne nuk veprojmë në përputhje me atë çfarë jemi, zhytemi në valët e shkaktuara për shkak të shtypjes dhe veprimeve të të tjerëve duke hyrë në vorbullën e planeve dhe mendimeve të tyre, prandaj për rrjedhojë detyrohemi të veprojmë në emër të të tjerëve.

Qëndrimi larg prej të vepruarit, mosndërhyrja në ngjarjet që ndodhin rreth e rrotull nesh mosbërja pjesë e tyre dhe qëndrimi indiferent është njësoj sikur ta lëmë vetveten të shkrihet si akulli duke u kthyer në ujë. Një shkrirje e tillë e cila nuk e ruan modelin tonë molekular do të ishte një dorëzim dhe nënshtrim ndaj ngjarjeve dhe ndodhive të cilat janë në kundërshtim me veten dhe thelbin tonë. Ata të cilët dëshirojnë të ngelen të vërtetë në vetvete, duhet të kërkojnë realisht thelbin e tyre megjithë forcën e dëshirës, vullnetit, zemrës, ndërgjegjes, sjelljes, punëve dhe mendimeve të tyre. E tërë esenca e qënieve njerëzore duhet të jetë vigjilente nëse dëshiron të ekzistojë. Ekzistenca dhe vazhdimësia e saj kërkojnë prej nesh veprimin e krahëve, gjymtyrëve, zemrave dhe mendjeve tona. Nëse ne nuk ia përkushtojmë që tani zemrat dhe mendjet, të ardhmes së ekzistencës sonë, të tjerët mund të na e kërkojnë këtë

paturpësisht në një vend dhe në një kohë në të cilat ne nuk do të kemi asnjë dobi.

Duke i bashkuar dëshirat dhe aspiratat tona me dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve dhe pastaj duke gjetur një rrugë apo drejtim veprimi për veten tonë brënda ekzistencës si tërësi, duke e lënë vetveten të rrjellim nrenda rugës sonë, brënda rrymave të përgjithshme dhe lëvizjeve të universit, duke ruajtur linjën tonë e njëkohësisht duke qenë të integruar me gjithë ekzistencën, ne bëhemi pjesë e aspektit më të dukshëm të veprimit dhe mendimit islam. Për sa i përket botës së brëndëshme, një person i cili është i paaftë të lidhet apo të bashkëveprojë me tërësinë e ekzistencës dhe i cili nuk arrin të përceptojë një pikëlidhje të tillë me universin, është i robëruar dhe i kufizuar prej dëshirave dhe synimeve të rëndomta individuale; ata të cilët veprojnë në këtë mënyrë janë persona të cilët e ndajnë, e bëjnë të vuajë dhe e përjashtojnë vetveten nga ekzistenca si tërësi duke e ndëshkuar dhe dënuar atë drejt qelizës së vdekur të egoizmit. Të gjitha dëshirat dhe ambiciet trupore, të gjitha betejat rreth materiales dhe trupores dhe çdo ngushëllim bosh vetëzhgënjyes që mund të vërehet tek dëshirat trupore dhe materiale, burojnë padyshim prej izolimit të plotë nga ekzistenca e vërtetë e një personi dhe nga lënia e tij në vetmi. Bota e vërtetë e një personi veprues dhe mendimtar si dhe lumturia e vërtetë që ai gjen në të, janë të ngjyrosura me nuancat e universalitetit dhe të skalitura brënda kornizës së pafundësisë. Në këtë mënyrë, bota e tyre duket si një gjë botë pa fillim e pa fund; edhe nëse ajo të të kishte ndonjë fillim apo fund, kjo e kapërcen konceptin tonë të imagjinatës. Nga ky aspekt kur ne flasim për një “njeri të lumtur,” ne kemi në mend këtë lloj personi. Është e pamundur ta quash lumturinë që ka një fillim dhe fund, lumturi të vërtetë.

I parë nga një këndvështrim tjetër më i saktë, veprimi përbën aktin e të përqafuarit të plotë të ekzistencës nëpërmjet sinqeritetit më të madh dhe vendimit më të ndjerë, analizën e ekzistencës si dhe udhëtimin drejt pafundësisë nëpërmjet koridoreve të krijimit, ndaj me anë të përdorimit të gjithë fuqisë së intelektit dhe vullnetit, me anë të sekreteve dhe forcës së fituar prej të Pafundmit, përbën vendosjen e botës së brëndëshme në orbitën dhe rrugën e vërtetë, rrugë e cila i bindet krijimit, rregullave dhe kushtetutës së natyrës.

Për sa i përket mendimit, ai përbën një veprim të brendshëm. Mendimi sistematik dhe që ka një qëllim të caktuar, përbën aktin e hetimit të universit me të cilin ballafaqohemi për të nxjerrë në pah të gjitha enigmat dhe sekretet e procesit të krijimit të tij, si dhe gjetjen dhe studimin e përgjigjeve rreth kësaj. Me fjalë të tjera, mendimi përbën veprimin e kërkimit të së vërtetës me ndërgjegje të plotë duke vendosur një lidhje të ngushtë kudo, ndërmjet mbarë ekzistencës dhe njerëzimit me gjuhën tipike të çdo fenomeni.

Falë të menduarit shpirti i njeriut lidhet ngushtë, pazgjidhshmërisht mplekset dhe mbështillet prej universit, prandaj ai vazhdimisht fiton thellësi përherë e më të mëdha në vetvete; ndarja në pjesë dhe studimi i hollësishëm dhe i llogaritur, arsyetimi i imët si dhe hulumtimi i përditshëm bën që mendja e njeriut të burojë dhe të shpëtojë vetveten nga konjunkturat, zhgënjimet dhe kufinj të ngushtë të saj, duke çuar në zgjimin drejt realitetit, dhe të vërtetës absolute e cila nuk të shpie kurrë në rrugë të gabuar. Me fjalë të tjera, mendimi përbën zbrazjen e qënies së brëndëshme me qëllim përgatitjen e hapësirës së nevojshme për përjetimin e përvojave metafizike në thellësitë e botës shpirtërore. E ndërsa ky përbën hapin e parë të të menduarit, hapi i fundit është të menduarit aktiv.

Dinamika bazë e jetës, veprimit dhe mendimit tonë është bota jonë shpirtërore; është e pamundur për ne ta ndajmë jetën tonë shpirtërore nga mendimet dhe idetë tona fetare. Lufta jonë për ekzistencë është zhvilluar gjithmonë duke e lëshuar vetveten drejt shpirtit dhe thelbit islam. Ashtu siç mbi fara kur mbillet në tokë dhe ashtu siç sythet lulëzojnë kur ndriçohen nga drita e diellit, edhe ne u shndërrojmë në njerëz me botë të thellë shpirtërore dhe cilësi të larta në esencën tonë kur kthijem sytë drejt islamit dhe e përqafojmë atë. Ky kthim fëtyrë dhe kërkim për thelbin tonë bëri që të zhvillohen aftësitë dhe potencialet tona duke na garantuar ekzistencën dhe vazhdimësinë për shekuj me radhë. Madje ashtu siç pjesëmarrja jonë në nivelet e shpirtit e zemrës brënda botës shpirtërore u arrit me anë të adhurimit, përkujtimt dhe mendimit, po ashtu edhe përqaftimi i gjithë krijimit, ndjesia e Zotit në puls të tonë si dhe përceptimi i Tij me të gjitha aftësitë që posedon mendja, varen prej vetëdijes së adhurimit dhe prej përpjekjeve tona në reflektim dhe përkujtim. Çdo veprim i një besimtari të vërtetë, përbën një

veprim adhurimi; çdo mendim i tyre përbën një akt vetëdisipline, vetëkontrolli apo vetëmbikqyrjeje; çdo fjalë e tyre është një lutje dhe episod mirënjohjeje shpirtërore; çdo vëzhgim i tyre i ekzistencës përbën një studim dhe investigim të hollësishëm dhe çdo marrëdhënie e tyre me të tjerët është mëshirë hyjnore. Arritja e një shkalle të tillë spiritaliteti apo shenjtërie, varet në të qenit i hapur ndaj përceptimeve, logjikës dhe arsyes dhe prej aty ndaj mendimeve dhe frymëzimeve hyjnore. Me fjalë të tjera është mjaft e vështirë për një person që të arrijë këtë majë, të fitojë një status të tillë, përderisa përvoja të mos jetë situr me anë të filtrit të arsyes, arsyeja të mos jetë dorëzuar intelektit të madh dhe largpamësisë së jashtëzakonëshme të profetëve, logjika të jetë shndërruar plotësisht në dashuri dhe dashuria e zakonshme të mos ketë avancuar duke u shndërruar në dashuri për Zotin. Nëse arrihen të gjitha këto, shkenca si rezultat krhehet në një dimension të fesë dhe bëhet shërbëtoare e saj; intelekti kthehet në një rreze drite e cila arrin kudo me anë të frymëzimit; dija e arritur nepërmjet përvojës kthehet në një prizëm reflektues të shpirtit të ekzistencës dhe çdo gjë flet me zërin e dijës shpirtërore, dashurisë dhe gëzimit shpirtëror.

Megjithëse disa sektorë të shoqërisë sonë ndajnë të njëjtat ndjenja dhe mendime si dhe të njëjtën ose pothuajse të njëjtën gjendje shpirtërore, pra pavarësisht kaq shumë gjërave të përbashkëta, ato janë të paafta të veprojnë në mënyrë aq pozitive sa ç'mund të pritet. Në qoftë se ato nganjëherë gabojnë, devijojnë dhe bien në mënyrë të përsëritur në kundërshtim, arsyeja për një veprim të till duhet të shikohet në faktin se njerëzit që i përbëjnë ato nuk janë apo nuk kanë qënë në gjendje të bëhën besimtarë të vërtetë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Nuk ka rëndësi se në çfarë kushtesh, presionesh apo influencave negative një besimtar i vërtetë mund të kalojë apo nënshtrohet; sjellja e tij duhet të jetë gjithmonë e ngjyrosur me besim dhe veprimet e tij duhet të jenë të paramenduara dhe të mirëpërgatitura.

Prandaj, trashëgimtarët e tokës të cilët planifikojnë të ndërtojnë botën e së ardhmes, duhet të jenë të vetëdijshëm për llojin e botës që ata duan të ndërtojnë dhe për llojin e xhevahirëve që ata duhet të përdorin gjatë ndërtimit të saj, në mënyrë që më vonë të mos e ndjejnë nevojën e shkatërimit me duart e tyre të asaj çfarë kishin ndërtuar. Rrënjët tona shpirtërore dhe thelbi ynë janë të qarta dhe të dukshme. Arkitektët e dritës të së ardhmes, duke përdorur

forcën e tyre të mendimit bashkë me dinamizmin e tyre të veprimit, duke përfituar plotësisht nga fleksibiliteti gjërësia dhe universaliteti i dinamikave historike në të cilat ata do ta bazojnë fenë dhe jetën tonë kombëtare si dhe sigurisht duke ruajtur kujdesin ndaj zbatimit rigoroz të porosive të kur'anit, sunnetit dhe gjykimeve autentike të dijetarëve të hershëm islamë të mbështetur mbi këto dy burime themelore, do të përpiqen edhe njëherë të marrin sinjalin e zërit të islamit, të kapen pas lnjës së tij të mendimit, të masin pulsën e tij si dhe të dëgjojnë rrahjet e tij të zemrës, në përputhje me kuptimin, mënyrat dhe dijet e epokës duke mos harruar të përjetojnë mosveprimin e botës së ndërmjetme pas vdekjes (barzakun) në rrugën e ringjalljes. Kjo para së gjithash, varet në distancimin e vetvetes prej të gjitha tendencave dhe presioneve të dëshirave trupore, në hapjen dhe lundrimin drejt botës shpirtërore si dhe në njohjen dhe pranimin e kësaj bote si dhomën në të cilën presim për të kaluar në botën e përtejme. Me fjalë të tjera, kjo mund të arrihet me anë të rrithjes së sasisë së praktikave dhe adhurmeve fetare cilësore; duke mbushur boshllëkun që ka ardhur për shkak të kryerjes mekanike të adhurimeve, duke bërë që tani e tutje ato të kryhen me vetëdije, sinqeritet dhe thellësi shpirtërore; me anë të lutjes së kujdesshme të vetëdijshme dhe të matur drejtuar Qënies e Cila është më e afërt për ne sesa jemi ne për vetveten. Të gjitha këto duhet të kuptohen dhe të kryhen prej atyre të cilët luten dhe e përjetojnë namazin sikur të ishin duke ecur drejt Miraxhit¹⁸; prej atyre të cilët e përjetojnë agjërimin sikur të ishin veçuar në izolim për të zbuluar sekretet Hyjnore; prej atyre të cilët japin lëmoshë duke u sjellë si administratorë të lehtësuar nga kjo barrë duke thënë “Oh, unë jam lehtësuar dhe çliruar nga ngarkesa e të mbikqyrurit të parave”; dhe prej atyre të cilët e përjetojnë haxhin si pritje e një kongresi ndërkombëtar në të cilin do të diskutohen çështjet dhe problemet që kanë të bëjnë me botën islame, në një vend ku si zemra ashtu edhe shpirti mund të vërejnë ndriçimin, shkëlqimin, ndruajtjen dhe madhështinë e së përtejmes, të sferave më të larta të ekzistencës.

Hedhja e syve drejt tyre dhe përmbushja e të gjithë qëllimeve fisnike të lartpërmendura, varet tek ato qënie shpirtërore të quajtur shkencëtarë të natyrës të cilët do të mund të diagnostikojnë dhe kurojnë sëmundjet tona të brëndëshme dhe të jashtme; në këto qënie udhëheqëse të cilat janë gjithmonë

në kontëjt të vazhdueshëm me të përtejmen dhe të cilët nuk gabojnë kurrë; në këto udhërrëfyes bota e mendimit e të cilëve shtrihet nga materialja tek jomaterialja, nga fizika tek metafizika, nga filozofija tek Sufizmi. Të tillë njerëz kanë qënë gjithmonë promotorë të periudhave të përparimit gjatë të shkuarës dhe si të tillë do të përfaqësojnë gjithashtu edhe lëvizjet e ardhëshme që kanë të bëjnë me rindërtimin dhe me rimbëkëmbjen. Ky përfaqësim do të arrihet me anë të zhvillimit të doktrinae të reja gjykuese, të bazuara në kur'an dhe sunnet, nën dritën e ngjarjeve, zhvillimeve dhe ndodhive të së ardhmes; me anë të stolisjes së pikëpamjeve të tyre me perspektivat dhe këndvështrimet e çështjeve mbarëbotërore; me anë të pastrimit dhe përmirësimit të frymës dhe ndërgjegjes kombëtare nën prizmin e islamit; me anë të përhapjes së interpretimeve të freskëta në art, duke i bashkangjitur atyre sensin e abstraksionit soditës, të përshtatshëm me universalitetin e islamit si dhe me anë të rimodelimit të kulturës sonë e cila duhet të kombinojë me botën dhe fenë dhe e cila ka arritur të mbijetojë dhe të zgjasë për qindra vjet.

Një përfaqësim në këtë shkallë do ta përparojë shoqërinë tonë nepërmjet shkencës, dijes, filozofisë, artit dhe fesë, duke e vënë atë në ballë të kombeve të tjera të botës në vitet në vijim; ajo do të drejtojë të gjitha aspektet e jetës sonë dhe do ti bëjë fëmijët tanë qofshin me shkollë apo jo dhe ata të cilët janë papunë papërkrahje dhe pastrehë, të shndërrohen në njerëz të ideve mençurisë, dijes dhe mjeshtërisë. Si rezultat të gjitha rrugët do të thithin ajrin e shkollave, burgjet do të kthehen në qendra edukimi dhe ndriçimi shpirtëror dhe shtëpitë do të transformohen në qoshe parajse duke lëshuar përreth aromën e kësaj të fundit. Shkenca dhe dija do të ecin krah për krah me fenë kudo; besimi dhe arsyeja do të mbështillen në një përqafim të ngushtë duke lëshuar dhe përhapur frytet e tyre kudo; e ardhmja do të lulëzojë dhe lulëzojë në krahë të shpresës aspiratave dhe ringjalljes, më e fuqishme, më e ngjyrosur, më elegante dhe më e pasur sesa në utopi; të gjitha mediat – radioja, televizioni, revistat, gazetat do të mbulohen nga drita e bollshme duke ndriçuar gjithçka rreth e rrotull dhe çdo zemër, me përjashtim të atyre të fosilizuara, do të sillen rreth errotull duke shijuar dhe u kënaqur me kevtherin¹⁹ gjatë kësaj pranvere hyjnore.

Kjo zanafillë e re do të lindë prej vlerave tona historike, qytetërimit, kulturës dhe romanticizmit tonë. Ajo do të lulëzojë nga njëra anë për shkak të vuajtjeve, keqtrajtimit, padrejtësive dëmimit dhe shtypjes që kemi përjetuar përgjatë viteve dhe nga ana tjetër për shkak të entuziazmit në zemrat tona të cilat janë të kënaqura dhe të ngopura me besim, duke qenë gjithmonë vigjilente nga pikëpamja shpirtërore dhe të gatshme për të vënë në provë vetveten.

Përmbushja e një misioni të tillë vital varet sëpari prej forcës me anë të së cilës ne do të lëvizim shpirtrat e shthurur në këtë botë të shthurur. Leva e ngritur dhe e ulur për pesëdhjetë vitet e fundit me qëllim vënien në lëvizje të këtij procesi, duket se ka filluar ta bëjë punën e vet. Duke marrë parasysh fjalët e poetit turk Mehmet Akif Ersoy, ne mund të themi : “Godit me kazmën tënde. E shumta ka kaluar e pakta ka mbetur.” Veprimi i parë që duhet bërë është veprimi i shpirtit; ai tani i ngjan butësisë së qetësisë (sakina²⁰); ai i ngjan ngrohtësisë dhe butësisë së gjurmëve që paralajmërojnë pranverën si dhe harkut të ylberit mbi kokat tona i cili na përshëndet ngado që shkojmë. Ne besojmë se nuk është e largët dita kur ky veprim i shpirtit do ta përqafojë plotësisht tokën e të shtypurve, të keqtrajtuarve dhe të dënuarve padrejtësisht, duke përhapur mbi ta mëshirën dhembshurinë dhe bekimet e Zotit.

Sot forca në një masë të madhe pothuajse është venitur krejtësisht për shkak të së vërtetës duke u rrethuar nga të gjitha anët prej saj. Sigurisht ekziston një arsye apo justifikim për përdorimin e forcës dhe shumë çështje është e pamundur të zgjidhen pa të. Megjithatë nuk ka dyshim se forca që buron nga shmangia prej së vërtetës duke e kundërshtuar madje atë hera e herës, është e dëmshme; ne mund ta pranojmë forcën vetëm në rastin kur ajo bashkohet dhe i shërben së vërtetës si pjesë e mbizotërimit të saj. Kurajoja që lind prej bashkimit të forcës me të vërtetën nuk është e padrejtë, mizore apo tiranike por përkundrazi është shenjë e mbrojtjes së të shtypurve dhe të keqtrajtuarve duke u shndërruar kështu në gjuhën e cila artikulon të vërtetën. Ajo çfarë është e rëndësishme pas kësaj është përfaqësimi i kësaj të vërtete nepermjet njerëzve të mendimit dhe veprimit. Në kapitullin në vijim ne do të paraqesim disa prej këtyre njerëzve të veprimit.

HERONJTË E MENDIMIT DHE VEPRIMIT.

Njerëzit e mendimit dhe veprimit, lëvizin në mënyrë aktive kur janë duke bërë plane; ata janë thellësisht të përqëndruar në sjelljen e paqes në botë dhe përfaqësojnë lëvizjen e ngritjes së rritjes së statujës së shpirtit dhe kuptimit tonë, ndërkohë që ne kemi qenë të rrëzuar përtokë vazhdimisht për shekuj me rradhë; ata sjellin vlerat tona historike në epokën moderne. Ata janë të aftë të lëvizin me efikasitet midis veprimit dhe mendimit me anë të vullnetit dhe arsyes së tyre duke qenë njerëz të veprimit të cilët bëjnë të mundur për ne endjen e pëlhurës më të re të shpirtit dhe arsyes sonë në harmoni të plotë me njëra tjetrën. Ata kanë qenë gjithmonë të frymëzuar nga, “paqja” përgjatë udhëtimit të tyre që nga ndjenjat e deri tek idetë dhe prej aty në çdo fazë të jetës praktike. Objektivi i tyre i vetëm është rindërtimi dhe projektimi i të ardhmes sonë. Ata janë ushtarët shpirtërorë të së Vërtetës, të cilët në vend që të pushtojnë vende dhe të kalojnë nga fitorja në fitore me anë të përdorimit të forcës dhe fuqisë së tyre materiale, bëjnë të mundur trajnimin e “stafit të përgjithshëm” të shpirtit, arkitektëve të mendimit dhe punëtorëve të ideve të reja; ata gjithmonë i mbushin mendjet tona me ide që kanë të bëjnë me rindërtimin dhe i udhëheqin pasuesit e tyre drejt rrugës së rindërtimit të rrënojave të shoqërisë së vjetër; ata janë ushtarët shpirtërorë të pajisur me zell të jashtëzakonshëm dhe me mirënjohje të cilët kanë qenë në gjendje të bashkojnë vullnetin e tyre me Vullnetin e Pafundëm; të transformojnë varfërinë në përparim dhe dobësinë në fuqi. Për sa kohë që ata të përdorin këto burime fuqie në përputhje dhe bindje të plotë ndaj urdhërave të Pronarit, ata kurrësi nuk mund të mposhten; në rastet kur mendohet gabimisht se janë mundur, ata do të shfaqen në majë të një kështjelle tjetër si fitimtarë.

Një person i mendimit dhe veprimit mundet të marrë përsipër rrole të ndryshme në shoqëri: herë si patriot besnik, si hero i verpimeve kuptimplote, herë si pasues i devotshëm i shkencës dhe dijes, si artist apo gjeni, si burrë shteti dhe nganjëherësi me të gjitha këto veti sëbashku. Historia jonë jo e largët na sjell ndërmend një numër të konsiderueshëm njerëzish të cilët mund ti paraqesim si shembuj për të ilustruar rolet e lartpërmendura. Disa prej tyre jetuan duke përdorur në dobi të shoqërisë më tepër mendjen sesa veprat ndërsa

të tjerë i patën të dyja në të njëjtin nivel, por ka edhe njerëz të veprimit, idetë e të cilëve qenë krejtësisht të zbehta dhe të padukshme.

Ahmed Hilmiu i Plovdivit, Mustafa Sabri Bej, Ferit Kam, Muhamed Hamdi Jazir, Sulejman Efendi, Ahmed Naim, Mehmet Akif, Nexip Fazil dhe Bediuzzamani janë vetëm disa prej emrave që mund të përmendim mes figurave të shquara për karakterin e tyre. Unë nuk do të hyj në detaje biografike me qëllim qëndrimin brenda caqeve të këtij teksti të shkurtër, por vetëm sa do tu hedh paksa dritë historive të jetës së tyre.

Ahmed Hilmiu i Filibes (Plovdiv) (1865 – 1914)

I lindur në Plovdiv të Bullgarisë dhe duke qenë i biri i ambasadorit turk atje, ai e nisi shkollimin e tij në Liceun “Gallatasaraj” (Mekteb-i Sulltani), ku u njoh edhe me idetë e epokës së re; pastaj ai u zhvendos në Izmir pasi ishte dërguar më parë në Bejrut. Ndërkohë mbante kontakte me Tirqit e Rinj dhe për pasojë u internua për në Fizan; më vonë u rikthye në stamboll dhe u angazhua në themelimin e qeverisë Kushtetuese, duke u bërë flamurtar i ideve të Ittihad-i Islamit (Unionit të Islamit), me anë të botimit të një gazete me të njëjtin emër dhe duke mbajtur njëkohësisht detyrën e zëdhënësit të kësaj rryme. Më vonë, ai nisi të punonte për një tjetër të përditshme, “Hikmet”, e cila shërbeu si një platformë për ballafaqimin e tij me Itihad ve Terakki Cemiyeti (Komiteti i Bashkimit dhe Përparimit); më pas ai vajti të punonte në shumë gazeta dhe revista të tjera si dhe të shpjegonte filozofi për pak kohë në Darulfunun (Universitetin e Stambollit). Ahmed Hilmiu vdiq në një moshë mjaft të re i helmuar prej Masonëve të lirë të cilët ishin armiq të tij më të mëdhenj.

Ky njeri mjaft i shquar i mendimit dhe veprimit në jetën e të cilit ne vetëm sa hodhëm një vështrim të shpejtë; është një person i cili la pas shumë vepra në pritje të zbulimit të tyre prej fletëve të historisë.

Ferit Kam (1864-1944). Jetëshkrimi i këtij njeriu të shquar të mendimit, shijehollë dhe mjeshtër i gjuhës, i cili ishte mjaft aktiv që në moshë shumë të re në jetën kulturore të Stambollit, është si vijon: ai ishte një mësues frëngjishteje dhe kishte një interes të madh për fushën e filozofisë. Për shkak të ndjekjes së këtij interesi, për njëfarë kohe ai ra në depresion, por menjëherë

më pas për shkak të Dritës Hyjnore, gjeti strehë tek Sufizmi dhe u bë edhe njëherë i aftë për të rigjetur ekuilibrat e humbur; ai shkroi për gazetat “Sirat-i Mustekim” dhe “Sebilurreshad”; ai punoi si profesor në “Darulfunun” dhe Medresenë “Sulejmanie”; më pas iu bashkangjiti Darul - Hikmetil Islamie (Këshilli i Mençurisë Islame), duke përjetuar lëvizje dhe pushime nga puna si dhe vuajte dhe privvime të pafundme. Si rezultat i këtyre ai, si çdo hero i mendimit dhe i veprimit kaloi një jetë mjaft aktive me përkushtim ndaj Ahiretit deri në ditën kur u nis drejt Zotit.

Vëllime të tëra librash nuk do të mjaftonin të përshkruanin gjithë jetën e tij të shquar me anë të kritikave dhe komenteve të ndryshme, ky intelektual i shekullit të njëzetë duhet të gjendet patjetër në kurrikulumin e brezave të sotëm; ai përbën një burim të pasur frymëzimi.

Mustafa Sabri Bej (1869 – 1954). Ky bir i shquar i Anadollit, ishte një hero i përpjekjeve; ai punoi si profesor, si zyrtar i bibliotekës së pallatit, si deputet në parlament, si shkrimtari kryesor i Bejanul Hak; ai qe një anëtar i Hurriyet ve Itilaf Firkasi (Partia e Pavarësisë dhe Bashkimit, dhe në fund iu bashkangjiti sheikhulislamit; ai gjithmonë u shfaq si hero i veprimit dhe i përpjekjeve derisa u detyrua të largohet nga vendi pas Babiali Raid²¹; rrethanat e pafavorshme e detyruan të vazhdonte shërbimin e tij në një vend tjetër musliman, por ai u rikthye sapo vuri re se ekzistonte mundësia për ndjekjen e kauzës së tij në Turqi; pastaj u bë anëtar i Daru’l Hikmeti’l Islamije, e më vonë u caktua si Sheikhulislam, e cila ishte mundësia e tij e fundit për ti shërbyer vendit të vet. Në vitin 1922 ai u largua për në Rumani, pastaj në Greqi dhe më vonë vdiq në Egjipt në vitin 1954 pasi kishte kaluar një jetë plot me grindje dhe ankth të pareshtur, me ulje dhe ngritje por mëse të pasur për të qenë kështu një burim i rëndësishëm kërkimi për shumë studjues.

Babanzade Ahmed Naim (1872-1934)

I lindur në Baghdad, Ahmed Naim ishte djali i një pashai. Ashtu sikurse edhe shokët e tij jeta e tij edukative u ushqye në Stamboll. Ky karakter i dalluar ishte i pajisur me një botë të gjërë ndjenjash dhe mendimi; ai studjoi në Liceun “Gallatasaj”, Shkollën “Mulkije” (Shkolla e Shërbimit Civil), pastaj u bë zyrtar i Departamentit të Përkthimeve në Ministrinë e Punëve të Jashtme e më pas drejtor i Arsimit në Ministrinë e Edukimit. Më pas ai u bë anëtar i Zyrës

së Përkthimeve, pedagog në Fakultetin e Letërsisë të “Darulfununit” e në fund u bë rektor i këtij universiteti për një kohë të shkurtër.

Duke u lënë një trashëgimi të jashtëzakonëshme shkencore dhe edukative brezave të ardhshëm, Ahmed Naim përbën një burim të rëndësishmë ushqimi për shoqërinë turke të ditëve tona si nga pikëpamja filozofike ashtu dhe nga ajo shpirtërore.

Mehmet Akif Ersoj (1973-1936)

Vëllime të tëra librash janë shkruar rreth këtij patrioti të singertë; ai qëndron më lart se çdo lloj përshkrimi që mund ti bëhet. Shumë komente dhe kritika janë bërë rreth figurës së tij dhe unë besoj se shumë të tjerë do ti bëjnë jehonë besimit, dashurisë, entuziazmit, aktivizmit, kauzës dhe ideve të tij. Ai është një nga intelektualët e paktë turq të epokës së vet i cili përshkoi Anadollin, Rumelinë (Turqinë Europianë) dhe Arabinë. Në çdo qytet ku ai u ndal, foli për brengat e gjata të një kombi të pafat dhe telenti i tij poetik i bëri të tjerët të dridhen. Ai ia arriti të ruante vijushmërinë në rrugën e tij si një figurë publike e singertë dhe e përkushtuar përgjatë gjithë jetës, duke nisur karrierën si mjek veterinar, duke vijuar pastaj si inspektor zyrtar, më pas si pedagog letërsie në “Darulfunun” dhe më vonë si anëtar i Sirat-i Mustekim duke marrë pjesë në Darul-Hikmetil Islamije dhe duke mbajtur ligjërata të shumta gjatë Luftës Kombëtare Turke.²²

Ne jemi mirënjohës për studimet që janë bërë rreth jetës dhe veprës së Mehmet Akifit. Ne vijojmë të shpresojmë se në të ardhmen do ti kushtohet një vëmendje edhe më e madhe kërkimeve rreth aktivitetit dhe ideve të shumë aktivistëve të së shkuarës në fushën e mendimit, veprimit dhe artit, si ky bir i shquar i kombit turk i cili jetoi me përrallësi si Sahabet e Profetit, duke ikur nga kjo botë krejtësisht i mjerë dhe i zhveshur nga të gjitha pasuritë e kësaj bote.

Elmalili Muhammed Hamdi Jazir (1878-1942)

Ai ishte një dijetar kalibri, i respektuar gjërësisht në të gjithë botën. Pasi kreu shkollën fillore në Elmali, një qytet i vogël në Anadoll, ai lëvizi për në kryeqytet për të plotësuar shkollimin e tij. Ai mori mësimë prej dijetarëve mjaft të shquar, duke u diplomuar në teologji e më pas duke mbajtur leksione dhe seminare në Mektebi Nuvvab dhe Medresetul Vaizin. Më pas ai u bë

anëtar i parlamentit gjatë Qeverisë së Dytë Kushtetuese. Për shkak të një interpretimi jokorrekt nga ana e tij, ai nënshkroi vendimin juridik (fetvanë) për shftronëzimin e Sulltan Abdulhamidit II; pastaj ai u bë anëtar i Darul-Hikmetil Islamiye dhe më pas Ministër i Çështjeve Sociale. Pasi u përsekutua prej “gjukatave të pavarura,” i shpëtoi ekzekutimit dhe u dërgua në një internim mjaft të gjatë, gjatë të cilit shkroi një koment të mrekullueshëm të Kur’anit. Hamdi Jazir zë një vend të veçantë në historinë tonë të filozofisë dhe aktivizmit.

Nexhip Fazil Kisakurek (1905-1983)

Paraardhësit e Nexhip Fazil ishin nga Marashi, por ai vetë lindi në Stamboll dhe u rrit si fisnik Stambolli. Kolegji Amerikan dhe Shkolla Detare qenë dy vendet që luajtën një rol mjaft domethënës në rininë e tij të hershme, duke përgatitur terrenin për aftësimin e tij për të nxjerrë në pah talentin. Pasi studjoi filozofi në Darulfunun ai iku për në Sorbonë ku u ndesh për herë të parë me botën perëndimore. Pasi punoi si inspektor bankar, i hyri biznesit pa dëshirën e tij për një kohë të shkurtër. Frymëzimi i tij artistik influençoi të gjithë me apo pa talent në Konservatorin Shtetëror dhe në Akademinë e Arteve të Bukura. Ai qe projektues dhe arkititekt por edhe zotërues i përvuajtur i shkollës së mendimit të quajtur Byjyk Dogu (Lindja e Madhe), duke botuar edhe një gazetë me të njëjtin emër. Kjo gazetë u mbyll me forcë disa herë por vazhdonte të botohej përsëri, çdoherë me një program të ri të modifikuar gjatë mbylljes, duke u udhëhequr prej vullnetit të jashtëzakonshëm të themeluesit të saj. Nexhip Fazil ishte një mjeshtër i poezisë dhe prozës dhe gjithashtu një punëtor i ideve të së ardhmes. Hapësira e tij e gjërë sufiste e mendimit, zgjuarsia metafizike, respekti i përhershëm për të Vërtetën Absolute, moderimi i thellë dhe përlulja ndaj shpirtit të Profetit, Mjeshtrit të gjithë ekzistencës, përbëjnë vetëm disa prej pikave të oqeanit të gjërë të cilësive të tij të admirueshme, të cilat ai i demostroi në fusha të ndryshme. Këtij njeriu të madh është e domosdoshme ti bëhet një analizë e thellë në çdo aspekt, ndaj ai duhet ti bëhet i njohur rinisë turke e madje edhe botës mbarë me anë të themelimit të një instituti që të mbajë emrin e tij.

Sulejman Efendi (Hilmi Tunahan 1888-1959)

Bir i një familjeje fisnike në Silistre Sulejman Efendiu u rikthye dhe filloi të jepte mësim në qytetin e tij të lindjes ashtu si i ati. Pasi arriti një nivel të lartë maturie, ai u bë i aftë të ndërthurë pasurinë shpirtërore me shkollimin që kishte marrë në Stamboll. Familja e tij duke e parandjerë misionin dhe të ardhmen e tij të ndritur, ishte mjaft e lumtur për faktin se shpresat e tyre po bëheshin realitet. Duke u mbushur me gëzim kur shikonin numrin në rritje të studentëve, shokëve dhe vëllezërve që mblidheshin rreth tij me besnikëri dhe bindje të plotë.

Sulejman Efendiu ishte një hero i përpjekjeve, një prej atyre njerëzve mjaft të rrallë, të cilët kurrë nuk lodhen gjatë gjithë jetës. Ai mbrojti me vendosmëri rrugën sunni të besimit dhe zgjodhi të punonte dhe të luftonte në një kohë kur ndjenjat dhe idetë fetare ishin nën goditje të vazhdueshme. Ai thuri dantellën e shpirtrave tanë, duke përdorur idetë dhe ndërgjegjën historike si pëlhurë; ai u përpoq ti bënte themelet e ekzistencës të dëgjueshëm për të gjithë, me anë të hapjes së shkollave, konvikteve dhe azileve në çdo cep të vendit, duke mos u tërhequr kurrë nga përpjekjet për përmbushjen e misionit të tij deri në ditën e vdekjes.

Është e pamundur ta përshkruash këtë njeri të madh të veprimit në kaq pak rreshta. Për të përshkruar një hero të tillë të shpirtit dhe arsyes, do të duheshin vëllime të tërë librash. Ky hero, pavarësisht shumë pengesave, u bë furnizuesi i çdo cepi të vendit, që nga Edirneja e deri në Ardahan, me edukim dhe Shkollim, në një periudhë mjaft të shkurtër.

Ne do tia lëmë analizën e misionit, veprës, interpretimit dhe filozofisë së këtij personaliteti mjaft të rëndësishëm kërkimeve të akademikëve me cilësi shpirtërore dhe hulumtuese, duke shpresuar që kjo përpjekje e vogël mund të shndërrohet më vonë në një vepër shumë më të madhe.

* * *

Kur flasim për intelektualët e gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë, nuk ka si të mos na vijë ndërmend Nureddin Topçu, një bir i vërtetë i kombit, mendimtar krijues, hero i dashurisë dhe ngazëllimit, pavarësisht disa prej sjelljeve të tij kontraktore të cilat bien në kundërshtim me kriteret tona bazë. Gjithashtu duhet të marrim në konsideratë edhe figurën e Sezai Karakoçit,

intelektualit të shquar dhe mendimtarit të madh; poetit kolos dhe autorit të shekullit, i cili me durim thuri idetë e tij të ndritura për të ardhmen, duke ecur në rrugën e tij i mbushur me dhimbjet më të thella por në heshtje. Ne duhet gjithashtu të përmendim me respektin më të madh Esad Efendi, Sani Efendi, Arvasi Hazretleri, Ali Hajdar Efendi, Mehmed Zahit Kotku, Imam i Alvar, Seydah i Serdehl, dhe Muhammed Rashit Efendi i Menzil dhe të mendojmë në lidhje me dashurinë, entuziazmin dhe veprat e tyre përse i përket fushës së shërbimit ndaj të tjerëve.

Dhe a mund të injorohet vallë Bediuzzamani, i cili i përmbysi të gjitha planet e jobesimtarëve dhe ateistëve me anë të besimit të tij të fuqishëm, ideve të tij kumbuese dhe aktivizmit të tij marramendës?

Aq shumë është thënë dhe shkruar në mbarë botën rreth këtij autori që është njëri prej autorëve më të lexuar në mbarë botën gjatë gjithë shekullit të fundit, veprat e të cilit janë përkthyer në të gjitha gjuhët më të rëndësishme. Nuk është e nevojshme të bëhen përshkrime të gjata për ta bërë atë më të njohur, prandaj është e mjaftueshme të citojmë një fragment të shkurtër nga parathënia e shkruar për njërin nga veprat e tij.

Bediuzzaman Said Nursi (1877-1960)

Jeta e Bediuzzamanit, përbën një burim të pasur kërkimesh për dijetarët, duke bërë të mundur prezantimin e veprës dhe personalitetit të tij, mbarë njerëzimit. Ai ishte figura numër një e epokës moderne, e cila bëri të mundur paraqitjen e oqeanit të gjërë të besimit islam, vlerave morale dhe ndërgjegjes në mënyrën më efikase dhe të pastër të mundëshme. Një vlerësim i bazuar mbi ndjenjat në lidhje me Bediuzzamanin dhe idetë e tij, nuk përbën mënyrën më të mirë për ta rikujtuar atë dhe veprat e tij. Sentimentalizmi nuk përputhet mirë me seriozitetin e çështjeve të cilat ai i studjoi në mënyrë të vazhdueshme dhe u bëri jehonë me trimëri. Ai e kaloi jetën nën hijen e Librit dhe traditës profetike si dhe nën krahët e përvojës dhe logjikës; ai qe një njeri me gjykim të shëndoshë, i mbushur me dashuri dhe entuziazëm në një shkallë të pakrahasueshme.

Shumë botime dhe konferenca janë kushtuar cilësive të dallueshme të Bediuzzamanit si devotshmëria ndaj idealeve të larta, perceptimi i tij i thellë për botën e sotme, thjeshtësia, humanizmi gjithpërfshirës, besnikëria ndaj

shokëve të tij, dëlirësia, modestia, përultësia dhe të kënaqurit me pak. Është fakt që secila prej këtyre cilësive kërkon një studim të veçantë në volume të veçanta për arsye se Bediuzzamani flet zakonisht për to në veprat e tij. Për më tepër ka ende shumë prej shokëve të tij mes nesh, çdonjëri prej të cilëve përbën një dëshmi të gjallë dhe të bekuar me fatin e mirë të të qenit afër tij gjatë jetës duke u bërë kështu dëshmitarë të gjërësisë shpirtërore dhe prosperitetit intelektual të atij njeriu.

Pamja tij e jashtme ishte e rëndomtë dhe e thjeshtë, gjë e cila nuk të jepte përshtypjen se ke të bësh me një dijetar të këtij kalibri. Megjithëatë, ai gjithmonë shfaqti një karakter mjaft të fortë nëpërmjet ideve dhe jetës së tij mjaft aktive, gjë e cila është vërejtur në shumë pak personalitete të tjera historike. Ai e përqafoi mbarë njerëzimin me anë të këtyre ideve që kishin të bënin me çështje të përbashkëta rreth vuajtjeve të njerëzve në mbarë botën. Ai urrente mosbesimin, tiraninë dhe largimin nga feja, ndaj ai luftoi kundër despotizmit, duke i qeshur vdekjes në fëtyrë. Ai i qëndroi besnik kauzës së tij me aq fisnikëri sa që nuk ndjente asgjë tjetër përveç dëshirës për të plotësuar nevojat minimale për mbijetesë. Të qenit person me një gradë të lartë shpirtërore gjatë jetës dhe misionit të tij, ishte rezultat i të vepruarit në përputhje me kur'anin dhe sunnetin si dhe i tërhequr nga arësyeja dhe logjika. Sjelljet e tij modeloheshin prej dy pjesëve të veçanta të karakterit të tij të pasur: e para ishte të qenit një person heroik, një ushtar i madh i ndërgjegjes, një njeri i dashurisë dhe entuziazmit; ndërsa e dyta përbënte pjesën e karakterit të një mendimtari visionar, i cili udhëhoqi bashkëkohësit drejt planeve dhe projekteve të mëdha që kishin për bazë ekuilibrin intelektual. Ky këndvështrim në lidhje me Bediuzzamanin është mjaft domethënës, si një prej hallkave të zinxhirit të njerëzve të mëdhenj të historisë islame, e cila do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë atë çfarë ai kishte ndërmend për ne në këtë epokë.

Megjithëse disa duket se e injorojnë me qëllim, bashkëkohësit e tij e konsiderojnë Bediuzzamanin si një prej mendimtarëve dhe shkrimtarëve më seriozë të epokës së tij, si dhe zëdhënës dhe prijës i masave dhe njëkohësisht si njeri i cili arrinte të ruante të paprekur modestinë duke qënë mjaft larg prej çdo forme mburrjeje. “Fama është e njëjtë me hipokrizinë dhe është një mjalte

e helmuar që vret zemrat,” është një prej epiteteve të tij në lidhje me këtë çështje. Ai ka qënë gjithmonë një prej autorëve më të admiruar të botës islame të shekullit të njëzetë dhe sot është një prej më të admiruarve në mbaë botën. Veprat e tij janë lexuar vazhdimisht me mjaft kujdes, me ndjenja të singerta vlerësimi dhe do të vazhdojnë të jenë të një rëndësie të veçantë sa më shumë që kalon koha.

Veprat e Bediuzzamanit janë fryt i pëprjekjeve serioze për të shpjeguar çështje të veçanta; ato kanë nevojë të studiohen nga këndvështrimi i kohës në të cilën ai lindi. Lexuesi mund të lexojë vajtimet, shpresat dhe etjen e Anadollit por edhe të mbarë botës islame. Megjithëse ai lindi në një fshat të vogël në njërin nga skajet më të largëta të Anadollit lindor, ai i shprehu ndjenjat tona si një fisnik i lindur në Stamboll, duke përqafuar mbarë vendin me një mëshirë të gjërë dhe sinqeritet të pastër.

Bediuzzamani e udhëhoqi popullin tonë i cili ishte i dërrmuar prej goditjeve të njëpasnjëshme drejt lumit të Khidrit,²³ duke frymëzuar kështu rilindjen nëpërmjet veprave të tij të cilat shndërisnin prej besimit dhe shpresës, në një kohë kur materializmi e kishte përmytur jetën tonë intelektuale, kur komunizmi kishte arritur kulmin e tij dhe kur bota ishte duke përjetuar periudha fatkeqe të mbushura me kaos. Përpara çdokujt tjetër, ai u ballafaqua dhe u përpoq të ndeshej me anarkinë e cila bazohej në mosbesim dhe ateizëm, duke e përkufizuar atë si problemin më domethënës që kishte nevojë të zgjidhej urgjentisht. Përpjekjet e tij ishin të mëdha sa që arrinin përmasat e mbinjerëzores në këtë drejtim. Duke u vënë ballë për ballë me një botë të tillë kaotike, Bediuzzamani ishte plotësisht i ndërgjegjshëm në lidhje me përgjegjësinë e madhe që kishte mbi supe, ndaj ai e mbarti pa u ankuar këtë barrë të tmerrshme; ai që një person me modesti të pashoqe dhe njëkohësisht e njihte më mirë se kushdo Zotin dhe fuqinë e Tij të pafundme si dhe mirësinë e Tij të pakufishme.

Në një epokë kur gjithë njerëzimi ishte zhytur në ateizëm për shkak të abuzimit me shkecën dhe filozofinë, kur truri shpërllahej me komunizëm dhe kur ata të cilët përpiqeshin të ndalonin këto zhvillime të pafavorshme dëboheshin nga vendi, kur dëbimet më të sikletshme kryheshin pareshtur në çdo cep të vendit (dhe të gjitha këto bëheshin për hir të qytetërimit dhe

modernizimit!), dhe kur nihilizmi përbënte ligësinë më të përhapur, Bediuzzamani na rikujton ne izolimin tonë të brendshëm, llojet e ndryshme të vetëburgosjes së shpirttrave tanë, vrasjet dhe dëbimet që ne kryenim kundër vetes; ai zgjoi virtytet njerëzore në dimensionet dhe ndërgjegjen tonë shpirtërore e cila kishte qenë për një kohë të gjatë inaktive; ai shuafti etjen e zemrave tona nëpërmjet dijes sublime; ai nxori në pah kapacitetet tona të brendëshme për të arritur botën tjetër dhe derdhi mbi ne të gjithë pasurinë e shkollave dhe strehëve sufiste (Teqet, Zevijet, Mektebet dhe Medresetë).

Në një kohë të ligë, kur kombi ynë ishte në një gjëndje të vështirë për shkak të intelektualizmit shterpë, kur çdo problem shoqëror degjeneronte në kaos, kur njerëzve u duhej të përballeshin me qindra ngjarje që sillnin gjakderdhje në mbarë vendin dhe kur vlerat kombëtare dhe islamike ishin shkatërruar, Bediuzzamani analizoi shkaqet dhe propozoi zgjidhjet e duhura, tamam si një farmacist i kujdesshëm. Ai vërente brezat e pafat që zhyteshin thellë e më thellë në moçalin e mosbesimit, devijimit dhe dyshimeve ndërsa përpiqeshin të shpëtonin nga kjo situatë, ndaj ai ishte thellësisht i vetëdijshëm në lidhje me shkallën e lartë të zymtësisë së tabllës që shfaqej përpara tij. Megjithatë jeta e tij ishte e mbushur me entuziazëm; ai e manifestonte atë vazhdimisht, duke prodhuar ide alternative dhe duke ua paraqitur ato qeverive dhe shoqërisë. Ai luftoi për ti rikujtuar këtij kombi të lavdishëm por të pafat, trashëgiminë e tij të gjërë nga e kaluara.

Bediuzzamani udhëtoi nëpër shumë provinca të vendit duke nisur që nga koha kur Devlet-i Alije (otomanët) ishin akoma në pushtet, duke vizituar kështu të gjitha zonat e banuara që nga qytetet më të mëdha e deri në fshatrat më të largët; që nga zonat më të populluara e deri në zonat më të shkreta malore. Ai lemeritej kur shikonte se në çdo vend ku ndalonte mbizotëronte injoranca; masat popullore vuanin izolimin më të skajshëm dhe njerëzit tanë pengonin dhe dëmtonin njëri-tjetrin për shkak të konflikteve të ndryshme. Si një intelektual i dalluar i cili e interpretonte kohën e tij në shkallën më të lartë të të kuptuarit, ai dëshironte të frymëzonte masat e mjera dhe të dëshpëruara me shpirtin e dijes dhe të mësuarit. Ai nxori në pah shkaqet e varfërisë aktuale dhe problemeve ekonomike, duke prezantuar edhe zgjidhjet e mosmarrëveshjeve brenda shoqërisë si dhe duke bërë thirrje vazhdimisht për

unitet dhe bashkëjetesë kolektive, duke mos e braktisur kështu vendin në fatin e tij të keq edhe në periudhat më kaotike: “Nëse mbi të gjitha këto shqetësime dhe trazime nuk vihet dorë dhe nëse plagët nuk mjekohen nga duar kompetente dhe të specializuara, sëmundjet tona do të bëhen kronike dhe plagët do të gangrenizohen. Është e qartë se ne duhet ti identifikojmë problemet tona në lidhje me dijen, ekzistencën shoqërore dhe administratën; ne duhet të nisim ti zgjidhim shqetësimet tona, qofshin ato materiale apo shpirtërore. Kjo është mënyra me anë të së cilës ne mund ta mbrojmë vetveten prej rreziqeve të ardhëshme të cilat mund të brejnë ekzistencën tonë, duke lëkundur themelet tona dhe duke na hedhur në hendeqe vdekjeprurëse.”

Bediuzzamani analizoi tre faktorë madhorë të cilët ishin në thelb të problemeve të atëhershme por që mbetën të tillë edhe sot: injoranca, varfëria dhe përçarja shoqërore. Injoranca, në sensin e indiferencës ndaj Zotit dhe Profetit, mungesës së interesit në fe dhe dinamikat historike, përbën shqetësimin kryesorë prej të cilit vuajmë. Bediuzzamani iu kushtoi jetën luftës ndaj këtij virusi fatal. Në syrin e tij, shpresa e shpëtimit për kombin tonë do të ishte e kotë përderisa ideologjitë false dhe të devijuara do të mbizotëronin dhe derisa shoqëria të mos ndriçohej me dritën e të mësuarit, dijes dhe mendimit sistematik. Për shkak të kësaj injorance, kur’ani dhe universi u ndanë nga njëri-tjetri; i pari mbeti jetim në birucat e fantazisë së shpirtërave fanatikë, të cilët janë të painformuar në lidhje me sekretet, formimin dhe fenomenet e ekzistencës, ndërsa i dyti përceptohet si asgjë më shumë sesa kaos në sytë e materialistëve me një nivel të pakrasueshëm injorance, të cilët janë totalisht të verbër ndaj botës shpirtërore.

Injoranca është arsyeja kryesore që është bërë shkak për prekjen nga varfëria dhe mjerimi i kësaj pjese të bekuar të botës, edhe pse kjo tokë është e mbuluar nga fushat më pjellore dhe lumejtë më të rrjedhshëm; e megjithëatë bonorët e kësaj zone sot u ngjajnë lypësve që trokasin tek dera.

Gjithashtu duhet theksuar një kontrast mjaft interesant; megjithëse ne jemi zhytur në borxhe të mëdha, kemi pasuri mjaft të konsiderueshme të fshehura nën tokë; të mira të panumërta materiale që burojnë nga tokat tona mbushin me lopatë gjepat e të tjetëve.

Përsëri për shkak të injorancë dhe varfërisë, punëtorët dhe fermerët ropaten ditë e natë duke punuar pa ndërprerë dhe pa arritur të vjelin frytet e punës së tyre, duke fituar aq sa për të mbajtur frymën gjallë. Ata nuk kanë si të jenë të lumtur dhe kushdo mund të vërejë se gjendja e tyre keqësohet hap pas hapi dhe ditë pas dite.

Injoranca dhe përçarja shoqërore që ajo sjell e ndalon shoqërinë të ndërmarrë veprime kundër fatkeqësive, dëbimeve, shtypjes, poshtërimit, varfërisë, pengesave dhe tragjedi të ndryshme që përjetohen në viset tona, pavarësisht gjakderdhjes së pafundme, dhunimit dhe shkeljes së vazhdueshme të të drejtave të njeriut; mbarë bota është duke u lëkundur pa vetëdije nga njëri cep në tjetrin, e zënë mat në rrjetën e çbalancimit. Përballë gjithë këtyre ngjarjeve, ne kemi dështuar ta largojmë vetveten nga përçarja, të paaftë ti japim fund kësaj katastrofe dhe sëmundjeje. Ne nuk mund ti sigurojmë botës islame shërim për plagët e saja; nuk ekziston asnjë kurë parandaluese kundër gremisjes edhe njëherë tjetër e cila mund të bëhet më e tmerrshme me kalimin e ditëve. Ne nuk mund të frymëzohemi me shpirtin e unitetit në mënyrë që të ballafaqohemi me epokën në të cilën jetojmë.

Ne jemi zhytur në dhimbje për shkak të rrethanave të lartpërmendura; ndërsa disa prej nesh janë mposhtur, sytë e tyre janë verbuar, shikimi u është turbulluar dhe kokat u janë trullosur për shkak të progresit aparent material të perëndimit. Në vend që të arrijnë pasuri materialo shpirtërore nëpërmjet angazhimit të mendjes së tyre me shkencat pozitive si dhe të zemrave me të vërtetat fetare, këta njerëz të magjepsur zgjodhën të veprojnë sikur të ishin totalisht pashpirt duke u larguar nga rrënjët e tyre; ata u bënë promotorë të dinamikave tona më fatale si nga pikëpamja kombëtare ashtu dhe ajo fetare, duke i privuar masat e njerëzve prej moralit, virtyteve, vetëdijes historike, duke i izoluar ata nga karakteri kombëtar nëpërmjet imitimit të verbër. Megjithëse kjo bëhej gjoja për të shpëtuar shoqërinë, imitimi i verbër rezultoi të ishte më i dëmshëm duke sjellë plagë të pashërueshme në shpirtin e shoqërisë.

Shoqëria jonë ka vuajtur nga ky makth shokues i injorancës dhe përçarjes për vite me radhë, duke u ndarë gjithashtu edhe nga identiteti kombëtar gjë që

solli për pasojë shkatërrimin e vlerave tona si fisnikëria shpirtërore dhe aktivizmi global.

Bediuzzamani qëndroi i palëkundër duke iu nënshtruar madje edhe keqtrajttimeve të cilave u nënshtrohej shoqëria e asaj kohe. Ai i analizoi pareshtur sëmundjet tona shekullore, i diagnostikoi ato dhe i paraqiti kurat përkatëse, duke ia kushtuar tërë jetën shërimit të tyre deri ditën kur u largua prej nesh në Urfa. Ai ishte gjithmonë i sinqertë në fjalalët dhe veprat e tij dhe trim në shpalosjen e ideve të tij.

Nuk është një punë e lehtë të futësh ide dhe mendime të reja në mendjen kolektive të një shoqërie. Po kështu është mjaft e vështirë të ç'rrënjosen idetë, konceptet dhe traditat ekzistuese, qofshin ato të drejta apo të gabuara. Masat popullore kanë qënë nën influencën e këtyre mbetjeve – të dobishme apo jo – nga e kaluara; jetët individuale apo kolektive kanë qënë të modeluara në përputhje me këto tradita, duke hedhur poshtë gjithçka që nuk ishte në përputhje me to dhe që nuk ishte në një linjë me ndjenjat e përbashkëta. Këto pikëpamje apo paragjykime mund të mos jenë gjithmonë të drejta. Duke pasur parasysh faktin që paragjykimet kolektive janë në shumicën e rasteve të rrënjosura thellë për shkak të ekzistencës dhe përjetimit për një kohë të gjatë të tyre, atëherë mund të themi se shoqëria duhet medoemos të çlirohet prej tyre dhe të stoliset me ato virtyte të cilat janë të përshtatshme.

Bediuzzamani merrej gjithmonë me të tilla ide që në moshë mjaft të re. Ai e konsideronte si tradhëti ndaj vendit dhe popullit të tij fshehjen e të vërtetave qoftë ehe më të vogla në lidhje me këtë çështje; ai qëndroi në cep të rrugës duke thirrur “Kjo është një rrugë pa krye” kur pa që ligjet e mbrapshta po rrezikonin fatet e kombit. Ai e kishte për natyrë të shqetësohej ku vërente gjëra të këqija që hidhnin baltë mbi vlerat fetare. Ai ishte një njeri me një vizion të gjërë, një njeri i përpjekjeve, i ngjashëm në vendosmëri me profetët e mëdhenj. Ky hero zemërluan nuk mundi kurrë ti mbyllte sytë përballë shkatërrimit të një kombi të tërë. Duke nxjerrë në pah të gjithë faktorët që quan në rënien tonë, duke nxjerrë përfundimet më të thella dhe duke nxjerrë në pah pikat më të fshehta të kësaj çështjeje, ai e ndihmoi shoqërinë të arrinte në një nivel autokritike. Ai vazhdimisht na risjell ndërmend arsyet që çuan në rënien tonë duke dhënë njëkohësisht edhe zgjidhjet përkatëse për daljen nga kjo

situatë. Ai i theksoi me forcë të vërtetat më të dhimbshme pas asnjë dyshim; ai na udhëhoqi larg paragjykitimeve false, mendimeve të pabaza, mosbesimit dhe ateizmit. Përgjatë gjithë jetës ai u përpoq ti rezistonte pengesave që ngriheshin para të vërtetës.

Në kohët më të egra, atëherë kur askush nuk guxonte të fliste një fjalë në lidhje me të vërtetat fetare, ai e paralajmëronte shoqërinë për rrezikun e zhgënjimit. Ai i shpalli luftë injorancës, varfërisë dhe përçarjes, duke lëkundur kështu themelet e shumë vjetërsirave të shoqërisë prej të cilave ajo ishte dalldisur. Ai themeloi një front kundër ateizmit, herezisë tronditëse dhe supersticioneve duke nxjerrë në pah qorsokakun ku ata të shpienin. Një proverb arab thotë “Zjarri është mjekimi i fundit.” Inisiativa e tij e jashtëzakonshme qytetare bëri të mundur analizimin e përkryer të fenomeneve dhe për pasojë vendosjen e hekurit të nxehtë mbi plagët tona shekullore. Fjalët e tij i bënë jehonë shpirtit të të gjithëve, që nga mbretërit dhe kryetarët e fiseve në lindje e deri tek sheikët dhe stafi ushtarak. Megjithëse për natyrë ai nuk kënaqej kurrë kur e nderonin, bukuria e veprave të tij qenë “prej natyre” magjepëse për gjithë shoqërinë në çdo udhëkryq të saj.

Xhihadi i vazhdueshëm që ai bënte, konsistonte në lëkundjen e zgjedhës dhe zinxhirëve me anë të të cilëve mendjet dhe shpirtrat tanë ishin burgosur. Ai i frymëzoi brezat e rinj me sihariqet e rilindjes dhe i udhëhoqi ata drejt shtigjeve që të shpienin në idetë islamike. Ai ishte i shqetësuar për faktin se vendi mund të përçahej, por sidomos sepse mendjengushtët, shpirtrat e trazuar, imituesit e verbër dhe kopjuesit e rëndomtë të perëndimit mund të bëheshin pjesë e njerëzve që ndiqnin idetë e tija duke çuar kështu vendin në çfarëdolloj katastrofe.

Ai gjithmonë i referohej “dijes, aktivizimit të mendjes dhe punës së madhe” dhe përpiqej të punonte për lindjen e një shoqërie perfekte dhe të shëndoshë, duke u përpjekur ti shpëtojë individët nga vetmia. Për arritjen e një ideali të tillë, ai mendonte se edukimi përbënte udhërrëfyesin – edukimi kudo dhe në çdo kohë – një mobilizim edukativ ku xhamitë, shkollat, barakat, rrugët, këndet e lojrave e madje edhe burgjet duhet të merrnin pjesë. Kjo ishte e nevojshme sepse vetëm me ndihmën e edukimit ne mund të arrijmë një bashkim ku të gjitha mendjet janë të përqëndruara tek i njëjti objektiv.

Shoqëria e mendjeve që nuk janë në paqe me njëra-tjetrën, nuk mund të zgjasë për shumë kohë. Është parakusht i domosdoshëm që ndërgjegjet sëpari të bashkohen, duke bërë që edhe zemrat dhe duart ti ndjekin ato. Ky lloj bashkimi është i mundur vetëm kur jeta jonë vijon sipas rregullave fetare të cilat janë të shpallura në mënyrën më të mirë të mundëshme dhe janë plotësisht të përshtatshme për mendjet bashkëkohore, në përputhje të plotë me Librin, Sunnetin si dhe interpretimin e pastër të pasuesve të këtyre (salaf al-salihin).

Shoqëria jonë duhet ti bëhet e njohur epokës moderne dhe duhet të përputhet me kupëtimin dhe frymëzimin e saj. Ne nuk duhet në asnjë mënyrë të mbyllemi brënda guackës sonë të vogël ndërkohë që pjesa tjetër e botës përparon me hapa të shpejtë. Për ta jetuar jetën siç duhet, çdokush duhet të ketë vullnet dhe të bëjë përpjekje të mëdha drejt harmonisë e cila përbën ujëvarën e jetës. Rrezistimi i pashpresë ndaj botës aktuale të globalizuar do të përbente një shatërrim.

Nëse vetëm disa qindra intelektualë do ta kishin përqaftuar mesazhin e Bediuzzamanit kur ai u lutej atyre pareshtur përgjatë gjithë vendit, ndoshta tani do të ishim bërë një nga kombet më të qytetëruar dhe më me peshë të botës së sotme, duke qënë mjaftueshëm të fortë për të kapërcyer çdo pengesë, duke e bërë kështu realitet objektivin e ecjes drejt kësaj rruge të ndritshme që në shekullin e njëzetë, rrugë në të cilën ne mesa duket kemi filluar të hedhim hapat e parë në ditët e sotme. Nëse do të kishte ndodhur kjo, nuk do të kishim vuajtur nga problemet e vazhdueshme që kemi kaluar. Megjithatë ne akoma shpresojmë, ndaj unë do të dëshiroja ti bashkohem atyre të cilët thonë se shoqëria jonë është krejtësisht e shkëputur nga rrënjët e saj shpirtërore, duke përjetuar një periudhë plogështie dhe neglizhence. Ne nuk mund ta mohojmë se shoqëria jonë ka përjetuar dështime ashtu si edhe shumë shoqëri të tjera; megjithatë, kjo nuk do të thotë se ne nuk mund ta marrim veten. Parapëlqimi për rehati tani është duke u transformuar në vigjilencë dhe shpirtrat tanë, të tronditura dikur me mendime “haremi,” tani janë duke u rigjallëruar dhe duke u rifreskuar. Ditët e gëzueshme pranverore do të vinë me siguri pas këtyre zhvillimeve. Bediuzzamani është një shenjë e mirë për shumë heronj si Khidri të cilët do ti kthejnë malet tona në kompte të gjelbëra adhurimi dhe Eljah²⁴ i cili do të vijë dhe do të na pregatisë për lundrim në oqeanet e gjëra.

“Gjeniu nuk zgjedh.” Kjo do të thotë se gjeniu nuk bën gjykime në lidhje me atë se çfarë duhet të bëjë dhe çfarë nuk duhet të bëjë dhe nuk vendos se çfarë është e dobishme apo e dëmshme. Gjeniu është një mrekulli e krijimit e cila si një burim i fuqishëm ka grumbulluar çdolloj fuqie me qëllim plotësimin e nevojave më të ndërlikuara, të jashtme të fshehta dhe shpirtërore të shoqërisë, duke u çelënikosur me talent hyjnor, impuls shpirtëror dhe dëshirë të zjarrtë. Studjuesit e kësaj lloji jetë dhe veprë, mund të dallojnë me lehtësi të gjitha aspektet e gjeniut tek figura e Bediuzzamanit. Ai gjithmonë ruajti nivelin e tij të jashtëzakonshëm qoftë në veprat e tij të hershme të cilat tregonin shenjat e para të zgjuarsisë së tij të jashtëzakonshme dhe sigurisht, në veprat e tij të mëvonshme, të cilat qenë secila fryt i një jete të plotësuar të mbushur me çështje gjyqësore, burgosje dhe internime.

Bota e shumëpritur

Kur thellohem në ngjarjet e mëdha historike, ne mund të vërejmë se mendimi dhe veprimi jetojnë brenda njëri-tjetrit, se ata janë të lidhur ngushtë; veprimi është nga njëra anë i planifikuar dhe i ushqyer prej mendimit, ndërsa nga ana tjetër përpjekejt dhe aventurat e reja ndërtojnë themelin e mendimeve dhe projekteve të reja. Në këtë kuptim, mendimi mund të krahasohet me qiellin, shiun, atmosferën dhe ajrin për veprimin, ndërsa ky i fundit mund të konsiderohet si ena apo vazoja, dheu dhe fuqia vegjetative e rritjes për mendimin. Nuk do të ishte ndonjë gjë e gabuar marrja parasysh e këtij reciprociteti, sepse çdo aventurë përbën realizimin e disa mendimeve dhe planeve të caktuara; çdo mendim është një fillim dhe një proces i gjetjes së kornizës dhe qëllimit të tij me anë të të drejtuarit e veprimeve drejt tij. Niveli i parë i vullnetit përbën një tendencë të brendëshme, ndërsa i fundit është i përbërë prej vendosmërisë, vendimarrjes dhe përpjekjeve; në këtë proces mendimi është si fija e pëlhurës nga fillimi deri në fund, ndërsa veprimet e ndërgjegjshme janë si krejt pelhura e endur me këto fije. Veprimet e pamenduara dhe të paplanifikuara rezultojnë në shumicën e rasteve në fiasko dhe çrregullim; ndërsa mendimet pa vepra parandalojnë ndërtimin e modeleve

të konsideruara si dimensionet më të fundme të të menduarit dhe gjithashtu dëmtojnë shpirtin e vullnetit.

Duke u rikthyer në ditët tona mund të themi se rrezet e mendimit jo vetëm që janë penguar të ndriçojnë mbi të gjithë sektorët e shoqërisë por se vullneti ka qenë gjithashtu krejtësisht i paralizuar, përfaqësimi është përjashtuar nga sistemi dhe është lejuar që anarkia të vrasë veprimin. Lëvizjet fatkeqe të shekullit të fundit, i kanë çuar masat popullore nga njëri depresion në tjetrin duke i zhytur ata nga njëra rrëmujë në tjetrën. Këto masa njerëzish, të lënë në duart e shpirtrave egoistë, lakmitarë dhe ambiciozë, janë keqduhëzuar, paralizuar dhe ngatërruar duke bërë që ata të hedhin hapa të pasigurtë majtas dhe djathtas duke u shfrytëzuar pa mëshirë dhe në mënyrë të vazhdueshme nga këta njerëz. Pavarësisht gjithë këtyre shkaqeve, ne mund të vërejmë me hidhërim se njerëzit e sotëm nuk janë pjekur akoma sa duhet për të qenë të aftë ti lëvizin zemrat dhe fuqitë mendore të tyre, ndaj ne themi “edhe pak...” kur duam të largojmë vetveten nga dobësia jonë natyrore për tu pasyruar me vullnet, për të ushqyer besimin tonë dhe për ta pjekur atë si dhe për të çrrënjësuar çdolloj mungese shprese dhe skepticizmi nga shpirtrat tanë; gjithashtu sigurisht para së gjithash, edhe kur duam ta shpëtojmë vetveten nga tronditja perëndimore ne akoma themi “edhe pak.”

Që nga revolucioni industrial i së shkuarës e deri në përparimin teknologjik të ditës së sotme, pothuajse gjithçka, çdo ngjarje ka sjellë për pasojë tronditje pas tronditjeje, duke na sjellë mjaft ndërlikime; për më tepër keqinterpretimi i “ shkencës” dhe paqëndrueshmëria dhe mungesa e vijueshmërisë e modernizmit, i ka bërë mjaft konfuze mendjet tona dhe e ka errësuar vizionin tonë. Fatkeqësisht, të tilla dobësi dhe tronditje ka shumë mundësi të vazhdojnë edhe për disa kohë dhe fjalët tona delirante gjatë somnambulizmit tonë, ka mundësi që të vazhdojnë të jenë prezente; Zoti e di edhe për sa kohë na duhet të përballemi me një situatë të tillë. Neve na duhet ta përballojmë këtë situatë sepse jemi të ndërgjegjshëm për faktin se nëse duam të riparojmë një shoqëri kaq të tronditur dhe ta rikthejmë atë në gjendjen e saj fillestare duke e modeluar në përputhje me epokën në vijim, nevojiten vepra të disiplinuar dhe pozitive me një kohëzgjatje të madhe ashtu

sikurse durimi i gjallë i koraleve, një lëvizje aktive dhe e disiplinuar e cila ti ngjajë qetësisë dhe konstantshmërisë së inkubacionit.

Pas një pritjeje dhe pas veprimeve të tilla, unë besoj vërtet se ne do të rigjallërohem dhe do të kontibujmë në përmirësimin dhe përparimin e botës. Megjithatë, nëse duam ta nisim këtë proces, ne duhet të pregatisim njerëz me vullnet të hekurt, të cilët do ti japin popullit një shpirt të ri; këta duhet të jenë njerëz me thellësinë e Abd al- Qadir al- Jilani, gjërësinë e Imam Gazaliut, devotshmërinë e Imam Rabbaniut, dashurinë dhe entuziazmin e Mevlana Jalal al-Din Rumi, dhe mirëkuptimin e respektin e Nursiut; si dhe të atyre të cilët do të pregatisin terrenin e ri në të cilin të jetojnë njerëzit e ditëve tona. Megjithëatë është fakt që ne kemi nevojë për kohë në dispozicion, për kushte dhe mundësi të mjaftueshme për të bërë të mundur lindjen e këtyre figurave në mënyrë që të çajmë dallgët e depresionit në të cilat janë zhytur mendimet dhe intuita jonë për vite me rallë, duke bërë të mundur që puhia e Judi të fryjë në shpirtrat e njerëzve. Sigurisht duhet të kemi parasysh që ne së pari kemi nevojë të fitojmë vetveten, të riparojmë mekanizmat e shpirtrave tanë dhe të rikthejmë në gjendjen e mëparshme botën tonë shpirtërore, ndjenjat dhe mendimet. Përndryshe nëse ne nuk jemi në gjendje të ngrejmë “ Kalorësinë e dritës”, atëherë kush do të na ndihmojë ne të arrijmë burimin e Khidrit? Për sa kohë që ne të mbetemi të mbyllur ndaj vlerave tona, sistemit tonë shpirtëror dhe të jetojmë të ç’orientuar, nuk do të jetë e mundur të ecim përpara dhe të arrijmë progres; kjo është ajo që ka ndodhur deri tani. Përsa i përket kësaj çështjeje, nuk kemi nevojë të kërkojmë për armiq të jashtëm sepse armiku i vërtetë është brenda vetes sonë; ai është duke shikuar varfërinë dhe sorollatjen tonë nga pallati i tij, këmbëkryq dhe duke nënqeshur me ironi.

Nëse do të na duhet të bëjmë një strategji për xhihad, atëherë ky lloj xhihadi duhet të mbështetet në çrrënjosjen e armiqëve të pamëshirshëm dhe të pabesë të cilët kanë pushtuar zemrat tona; bota e jonë në fakt ka qenë e bllokuar për vite me rallë nga këta armiqë të vërtetë dhe askush tjetër. Njerëzit tanë nuk kanë qenë në gjenje ta heqin këtë bllokadë fatale dhe të rikthehen në natyrën e tyre pra të jenë vetvetja. Kombi ynë ka qenë si një pikë e çuditshme vartrore për bashkësi, zakone dhe kultura të ndryshme; ai ka qenë gjithmonë një vend çrregullimi dhe çorientimi duke sjellë për pasojë mungesën e unitetit;

ai ka qenë viktimë e ideve të gabuara, i nënshtrimit konfliktual të shumë kombeve, fiseve, botëkuptimeve dhe idhujve; ai i është gjunjëzuar shumë perëndive të rreme në të njëjtën kohë, duke rinovuar betimin solem përpara çdo perëndie të rreme çdo ditë. Për këtë arsye në këtë periudhë fatkeqe, populli ynë kurrë nuk ka besuar se ndonjëra prej këtyre ideve ishte plotësisht e saktë apo e drejtë. Megjithëse ka përjetuar shumë udhëkryqe intelektuale dhe ideologjike, populli ynë nuk ka qenë kurrë në gjenje ta përqafojë plotësisht ndonjërin prej tyre.

Kushedi sa ide të mëdha janë hedhur dhe kanë mbetur të patrajtuara dhe të pazbatuara në jetë si dhe sa projekte serioze janë penguar dhe shkatërruar për shkak të shikimit të turbullt dhe të errët të njerëzve me vizion miop. Në këndvështrimin e tyre domethënia që mbartin ngjarjet, gjërat dhe marrëdhëniet e njerëzve, si dhe universi, jeta dhe shkenca përbëjnë gjëra të parëndësishme dhe të pakuptimta, duke mos u kushtuar atyre asnjë lloj rëndësie. Sipas tyre gjithçka që dimë janë njohuritë tona aktuale në lidhje me ekzistencën, ndërsa përsa i përket asaj që nuk dimë kjo do të zgjidhet nga botëkuptimi i ndokujt tjetër në të ardhmen. Gjithçka është matur, formuar dhe zgjidhur nëpërmjet këtyre ideve fikse. Ata, nëse nevojitet, me anë të paraqitjes së një bote të shtrembër si të drejtë dhe të së drejtës së të shtrembër, synojnë ta mbajnë shkencën, kërkimin dhe dijen në urdhërat e besimeve dhe dogmave të tyre dhe megjithëse ata nuk kanë qenë ndonjëherë dëshmitarë të krijimit dhe fazave të tij, ata mburren dhe kapardisen në një mënyrë kaq absurde duke i shitur hipoteza të caktuara si fakte të kryera.

Nëse nuk do të kishte ndonjë të vërtetë për të besuar në të, nëse asnjë ide nuk do të kishte vlerë për tu besuar apo pranuar, atëherë çfarë do ta dallonte ekzistencën nga kaosi? Në një botë ku pikëpamje të tilla mbizotërojnë si mund të mbrohet një bashkësi nga realitvizmi apo nga çështje të pamundura? A nuk do ta pranonin masat e zhytura në relativizëm atë çfarë është më e vërtetë dhe atë çfarë është më e pavërtetë vetëm në shkallën në atë cilën ata pranojnë të kundërtën e saj? Sigurisht, nëse një botëkuptim i tillë do të përhapet, gjithçka, që nga koncepti i së mirës / së keqes e deri tek konsiderimi i morales / imorales. Do të influencohen nga relativizmi. Sot ajo që kemi nevojë si komb është një karakter i cili aktivizohet me anë të ndërgjegjes efikasitetit në vepra si dhe

përgjegjësisë; një karakter i cili të jetë me plot ide në lidhje me klanet dhe projektet e ardhme por edhe në sjellje dhe veprime në lidhje me nevojat dhe kërkesat e së sotmes i cili të jetë i singertë dhe i lartësuar por gjithashtu i balancuar; ne kemi nevojë për një karakter të mendimit dhe shpirtit i cili të jetë i hapur ndaj të gjithë ekzistencës nepërmjet zemrës; një figurë mendja e të cilit të jetë e kultivuar dhe e përparuar dhe i cili të jetë i ndërgjegjshëm për dijet e tij; një figurë e cila të dijë gjithmonë si ta rinovojë vetveten, një njeri i cili të qëndrojë gjithmonë pas rregullit dhe ligjit dhe i cili të jetë i shpejtë në riparimin e çdo dëmtimi.

Një person me një karakter të tillë do të rendë gjithmonë nga fitorja në fitore. Kjo jo me qëllim për të shkatërruar vende dhe për të fituar pasuri prej rrënitit por përkundrazi, për të lëvizur dhe aktivizuar mendjet, ndjenjat dhe aftësitë njerëzore, për të na forcuar me shumë dashuri, dhembshuri dhe dashamirësi në mënyrë që të jemi në gjenje të përqafojmë gjithçka dhe këdo, të riparojmë dhe të rikthejmë lidhjet e shkatërruara, të bëjmë që jeta të lulëzojë në sektorët e vdekur të shoqërisë duke bërë që jeta të qarkullojë në venat e qënies dhe ekzistencës në mënyrë që ne ta ndjejmë kënaqësinë e pafundme të saj. Me të gjitha këto cilësi, një person i tillë do të jetë një njeri i Zotit dhe këta lloj njerëzish me titullin e trashëgimtarit të Tij, do të jenë gjithmonë në kontakt me krijimin. Çdo veprim dhe sjellje e tyre kontrollohet dhe vëzhgohet. Gjithçka që ata bëjnë, e bëjnë sikur të ishin nën prezencën e inspektimit të tij; ata ndjejnë atë që ndjen Ai; ata shikojnë me anë të vështrimit të Tij; ata flasin me fjalët e Shpalljes së Tij; ata janë si një njeri i vdekur në duart e Ghassalit²⁶(njeriut që lan të vdekurit) përpara Vullnetit të Tij; burimi i tyre i madh i fuqisë, është vetëdija për dobësinë, paaftësinë dhe varfërinë që kanë para Tij dhe ata gjithmonë përpiqen të bëjnë të pamundurën për të mos bërë ndonjë gabim në mënyrë që të bëjnë më të mirën e mundshme në përdorimin efikas të kësaj pasurie të pafundme.

Ata janë gjithashtu njerëz me vetëpërmbajtje dhe vetëkontroll të jashtëzakonshëm; e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara janë të ndara dhe të sistemuara në vendet e tyre në pasqyrën e shpirtit të tyre si dita me natën, drita me errësirën; e gjithë fuqia e vullnetit, zemrës, ndërgjegjes dhe perceptimit të tyre përbën një dhunti që i ndihmon në arritjen e mekanizmit të

ndërgjegjes duke qënë qëllimi më i lartë në të cilin ata synojnë dhe mbështeten është cilësia e të qenit të aftë për të ndërtuar ndërgjegjen e tyre; njohja e Atijas (dhuratave, mirësive) të Krijuesit të Gjithmëshirshëm arrihet vetëm me anë të Matijas (kafsha e ngarkesës) në një mënyrë të përgjegjëshme me anë të vullnetit, ndaj dashuria që buron nga zemrat e tyre është e madhe. Me anë të lidhjeve dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet ndërgjegjes dhe ekzistencës si dhe ndërmjet ndërgjegjes dhe së mistershmes që qëndron prapa vellos së ekzistencës, nëpërmjet sensit të tyre të të kuptuarit të së vërtetës absolute, përtej çdo mjeti dhe mënyre, përtej çdo sasie dhe cilësie dhe me anë të dijes së tyre e cila i vendos disa shkallë mbi ëngjëjt, ata e ndjejnë afërsinë me Zotin e tyre. Për sa i përket jetës së tyre individuale, sytë e tyre janë gjithmonë në horizontin e të qenit një person ekzemplar; ata janë në ndjekje të së shkëlqyerës, qafë për qafë me evlijatë dhe miq të singertë të Zotit; ata janë jashtëzakonisht të kujdesshëm, të mprehtë dhe të përpiktë veçanërisht në përmbushjen e urdhërave të Zotit. Të gjitha cilësitë e tyre si vendosmëria heroike për ta jetuar islamin e vërtetë, reagimin ndaj gjërave që Zoti nuk i pëlqen, trimëria, kurajoja dhe vendosmëria gjatë realizimit të objektivave të tyre janë përtej konceptimit apo imagjinatës tonë.

Për më tepër gjërësia e pafundme e ndjenjave të tyre kolektive, thellësia e qënies së tyre si persona të së Vërtetës dhe njëkohësisht si shokë të njeriut të zakonshëm, dashuria e tyre për Zotin dhe për krijimin për hir të Tij, dashuria e tyre asketike, zelli i tyre entuziast, interesat dhe pikësynimet e tyre janë përtej çdo përmase dhe shprehjeje.

Një person i tillë është mbi të gjitha një person i dijes dhe ndjenjës së detyrës së përtejbotshme. Ajo që ne kuptojmë me detyrën e përtejbotshme meriton një diskutim të veçantë.

Njerëzit e devotshëm : arkitektët e shpirtrave tanë

Megjithëse disa njerëz sot i përçmojnë vlerat morale, thellësinë e brendëshme të qënies njerëzore si dhe rëndësinë e të jetuarit me zemër dhe shpirt, nuk ka dyshim se rruga e njerëzimit të vërtetë kalon nëpërmjet këtyre. Nuk ka rëndësi se çfarë mund të mendojnë disa njerëz; zbatimi i suksesshëm i

këtyre dinamikave jetësore ofron zgjidhjen e vetme që mund ta shpëtojë njeriun e ditëve tona. Njerëzit sot mund të çlirohen nga streset shoqërore, politike, kulturore dhe ekonomike të cilat i bëjnë ata të jenë dyshues, duke ua kërrusur shpinën në një formë të keqpërdredhur. Ky deformim ka qenë shkaktuar për shkak të një sulmi të rreptë krizash dhe presionesh të cilat e kanë prekur pa fund njeriun e së sotshmes. Ky mision vital mund të përmbushet vetëm me anë të personave të devotshëm, të cilët kurrë nuk mendojnë për veten e tyre me përjashtim të rasteve kur ata e shohin shpëtimin e vet nëpërmjet shpëtimit të të tjerëve.

Në këndvështrimin tonë, i cili unë mendoj se shpreh edhe këndvështrimin e atyre të cilët përpiqen të jenë muslimanë të vërtetë, shpëtimi në sytë e Zotit varet prej zellit, përpjekjeve dhe vendosmërisë për të qenë një shpëtimtar. Ne vërejmë se shpëtimi dhe siguria jonë në të ardhmen e afërtë dhe të largët, qëndron në shndërrimin në vendstrehim apo faltore për shpirtrat e tjerë, në injektimin e fuqisë brenda vullnetit të të tjerëve dhe në gjallërimin e zemrave të tyre; ne gjithmonë dëshirojmë të jemi mes atyre të cilët vihen përballë dhe luftojnë me zjarrin dhe të cilët i kthejnë shpinën interesave individuale apo personale. Morali i sjelljeve dhe veprimeve tona, ka lidhje të drejtpërdrejtë me ndjenjën e përgjegjësisë e cila është idealizuar në shpirtrat tanë.

Një shpirt i tillë përgjegjësie i cili tashmë gjithmonë i kalon kufinjtë e individualitetit tonë, formon bërthamën e rregullit i cili e përqafton totalisht ekzistencën, ndaj konsiderohet si burimi më domethënës i paqes universale. Kur ky shpirt ndërthuret me zellin dhe vendosmërinë si dhe me vullnetin e orientuar drejt së mirës, atëherë ne mund të themi se kemi arritur dy objektivat themelore për të cialt kemi nevojë për shpëtimin tonë. Ata flasin gjithashtu me një zë efikas dhe me një gjuhë elokumente e cila do ti shpallë njerëzimit shpirtin dhe thelbin apo realitetin për të cilin ai ka nevojë.

Ata të cilët i kanë kthyer shpinën ekzistencës si tërësi dhe rregullit të përgjithshëm dhe të cilët kanë shpenzuar gjithë jetën e tyre brenda labirinteve të errëta të egos, nuk janë parë të kenë arritur tek shpëtimi; përkundrazi ata janë bërë shkak që edhe njerëzit e tjerë të cilët i kanë vlerësuar ata të shuhën nga pikëpamja shpirtërore. Periudhat gjatë së cilave njerëzimi ka bërë progres kanë qenë gjithmonë ato periudha kur ne kemi ecur dorë për dorë me

ekzistencën, sot ato të cilët planifikojnë të ecin drejt së ardhmes duhet të braktisin egoizmin dhe të bëjnë përpara me zemër të plotë, dorë për dorë me çdo gjë dhe çdo person. Vullneti dhe idealet do të gjejnë vlerën e tyre të vërtetë për sa kohë që ato të kenë pas mbështetjen e singertë të trupave si dhe të zellit të përbashkët, përpjekjeve dhe ndërgjegjes kolektive. Në fakt, e vetmja rrugë për tu bërë një bashkësi e shëndoshë duke qënë akoma një individ, për tu bërë një det duke qënë akoma një pikë uji, me një fjalë për të arritur pavdekësinë; e vetmja rrugë për ti bërë të tjerët të jetojnë dhe të lulëzojnë si dhe për të jetuar me ta, është të shkrihemi me ta dhe ta mirëkuptojmë njëri-tjetrin, të bëhemi miq, të bashkohemi dhe të integrohemi me ta. Nga një këndvështrim tjetër, që një njeri të bëhet një qenie e vërtetë njerëzore në kuptimin e plotë të fjalës në shkallën që pretendojmë, kjo varet nga qenia e tyre nën komandën e zemrës si dhe në dëgjimin nga ata të zërit të shpirtit, pavarësisht dëshirave sensuale dhe trupore dhe pavarësisht dëshirës për të pasur një nivel jetese të përshtatshëm (aql al-ma'ash). Pra nëse njerëzit duan ta njohin vetveten dhe ambientin që e rrethon më mirë, ata në njëfarë mase duhet të shikojnë gjithçka dhe këdo me sytë e zemrës si dhe ti vlerësojnë dhe ti çmojnë ata me anë të kriterit të zemrës. Nuk duhet harruar se një person i cili nuk ka qënë në gjendje të ruajë singëritetin e shpirtit dhe pastërtinë e zemrës duke mos qënë në gjendje të mbetet i pastër dhe i dlië si një fëmijë, pavarësisht sesa e madhe është pasuria e tij mendore, intelektuale dhe emocionale, pavarësisht sa e gjërë është dija, kultura apo përvoja e tij, nuk mund të frymëzojë apo të injektojë besim tek njerëzit, e as të shpresojë ti bindë ata kjo është arsyeja përse kaq shumë njerëz me përjashtim të atyre që pretendojnë se besojnë dhe binden tek diçka për shkak të frikës, dhunës dhe shtypjes, nuk besojnë apo i binden politikanëve të caktuar dhe njerëzve të cilët ushtrojnë pushtetin e tyre mbi logjikën, arsyen dhe zemrën. Shpirtrat e dlië dhe zemrat e pastra kanë ndjekur gjithmonë idetë e pastra dhe kanë vepruar gjithmonë me ndershmëri. Zemrat e pastra të cilat e kanë ruajtur pastërtinë e tyre natyrore, siç theksohet në disa fjalë të bekuara, konsiderohen si vendi që i përket Atij dhe ku Ai është i njohur, si një thesar i fshehur apo i groposur. Të vërtetat hyjnore mund të kuptohen dhe ndjehen përtej çdo sasi dhe cilësie sipas shkallës së shenjtërisë dhe pastërtisë së atij vendi. Në fakt ata që thonë “Unë e pashë të vërtetën” gjithmonë nënkuptojnë

këtë gjë. Duke mbartur një bërthamë të tuba al-janna²⁷ në zemrat e tyre, këta shpirtra të pastër dhe të papushueshëm, kanë arritur kopshtet e parajsës në këtë botë, një vend të cilin kushdo ndoshta apo me siguri do ta shikojë në botën tjetër; ndaj ata e kanë vëzhguar universin në një atom dhe gjithashtu konsiderohen si njerëz të cilët kanë arritur horizontin e shikimit të Zotit pas kësaj.

Një hero i zemrës është siç na ka thënë kur'ani dhe i dërguari i Allahut, një person i së vërtetës, i cili shikon, mendon dhe vepron me të gjitha shqisat e një ndërgjegjeje të tillë; ndenja dhe e ngritura në këmbë e të cilëve përbën mëshirë, fjalët dhe ligjëratat e të cilëve përbëjnë butësi dhe mirëkuptim si dhe sjelljet e të cilëve janë edukatë dhe mirëkuptim i gjallë. Ata janë njerëzit e zemrës dhe të vërtetës të cilët na shpallin dhe na mësojnë sekretet e njohjes dhe perceptimit të krijuesit nga brenda vetvetes; të cilët mund të shprehin kuptimin e vërtetë dhe qëllimin e Krijimit. Qëllimi përfundimtar i një personi të tillë të devotshëm është i gjërë dhe shumë i rëndësishëm: mbartja e çdo shpirti drejt jetës së pasosur, të ofruarit e esencës së përjetësisë çdo njeriu si dhe me anë të largimit të plotë nga dëshirat trupore, interesat personale dhe planeve për të ardhmen, ata janë në gjendje të hyjnë si në thellësitë e botës së tyre të brendëshme ashtu dhe të jenë prezentë në botën materiale; ose të jenë në brendësi të botës së tyre shpirtërore, ose në prezencë të krijuesit të tyre, duke vëzhguar dhe ruajtur kështu të gjitha këto marrëdhënie të ndryshme dhe domethënëse në të njëjtën kohë. Pavarësisht nevojave të tyre materiale dhe fizike apo varfërisë, ata janë vullnetarë dhe altruistë të mëdhenj duke qenë gjithmonë të zënë dhe të preokupuar me planifikimin e lumturisë së njerëzve rreth tyre. Ata gjithmonë punojnë për bashkësinë në të cilën jetojnë, duke zhvilluar projekte paqeje, përparimi dhe mirëqenie si një qëndistat i mrekullueshëm që e zmadhon vazhdimisht pëlhurën e tij. Përballë vuajtjeve dhe mjerimit që përjetojnë komuniteti i tyre në veçanti dhe gjithë njerëzimi në përgjithësi, me një zemër të ngjashme me atë të një profeti, ata përjetojnë ethe, dëshpërim dhe brerje ndërgjegjeje.

Ata pra luftojnë me të keqen që rrethon popullin e tyre dhe mbarë botën. Duke vepruar kështu, ata nuk kanë kohë të angazhohen në përshkrimin dhe tregimin e gjërave boshe dhe të kota sepse një verpim i tillë “të çon në rrugë

të gabuar dhe i prish mendjen” por përkundrazi ata bëhen të paduruar, tërë ankth dhe me padurim për të prodhuar dhe zbatuar projekte që u japin zgjidhje çështjeve. Ata janë heronjtë e vendimeve të ngjashme me ato Profetike, të cilët përballojnë dhe kapërcejnë problemet me një dashuri të vërtetë për ndjenjën e detyrës, me një ndjenjë të fortë përgjegjësie dhe me një vetëkontroll (ihsan²⁸) që buron nga vetëdija e tyre për Zotin. Një hero i ringjalljes fluturon me krahët e dobësisë, mungesës së ndihmës, përgjegjësisë dhe varfërisë; ai është gjithmonë i gatshëm për vepra të reja si harku i një shigjete, i mbushur me zellin ngazëllyes të mirënjohjes dhe duke ndjerë thellë dhimbjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për detyrën e madhe të rigjallërimit të harmonnisë dhe së vërtetës universale. Kjo përgjegjësi është e tillë që hyn në botëkuptimin individual dhe në vullnetin e lirë, pa dalë asnjëherë jashtë përgjegjësisë për krijimin dhe ngjarjet, natyrës dhe shoqërisë, të shkuarës dhe të ardhmes, të vdekurës dhe të gjallës, të vjetrës dhe të resë, të shkolluarve dhe të pashkolluarve, administratës dhe sigurisë... gjithçkaje dhe çdo gjëje. Dhe sigurisht, ata ndjejnë peshën e gjithë këtyre përgjegjësisë në zemrat e tyre; ata e ndjejnë vetveten duke u dridhur me furi, të dëshpëruar në shpirt, gjithmonë duke luftuar për vëmendjen e njerëzve. Mua më duket se kjo është mënyra e veprimit e cila i atribuohet të dërguarve të Zotit, të cilët i bëjnë njerëzit të luftojnë për atë çfarë është e vlefshme mbi çdo gjë të çmuar në sytë e Zotit, gjë e cila i bën ata të arrijnë nivele të reja shpirtërore dhe afërsi tek Zoti i tyre.

Dhimbja dhe vuajtjet që lindin nga ndenja e përgjegjësisë, nëse nuk janë të përkohshme, përbëjnë një lutje, një kërkesë e cila nuk hidhet poshtë dhe një burim i fuqishëm për projekte të mëtejshme alterantive, duke qenë thirrja më e madhe e ndërgjegjes që ka mbetur e pastër dhe e paprishur. Çdo njeri i shpirtit, ka potencialin të kapërcejë fuqitë e tij dhe të bashkësisë së tij në përpjestim me gjërësinë e kësaj dhimbjeje, ndaj ai mund të bëhet një pikë vatërore për fuqinë dhe forcën e brezave të shkuar dhe të ardhshëm. Më lejoni tju rikujtoj nevojën e diferencimit ndërmjet atyre të cilët jetojnë dhe atyre të cilët i bëjnë të tjerët të jetojnë. Ajo që ne jemi duke theksuar vazhdimisht është se ata të cilët e kalojnë jetën e tyre me sinqeritet, besnikëri dhe altruizëm në kurriz të vetes së tyre me qëllim që ti bëjnë të tjerët të jetojnë, janë ata të cilët përbëjnë trashëgimtarët e vërtetë të dinamikave historike dhe njerëzit të cilëve

ne mund tua besojmë shpirtrat tanë. Ata nuk e kanë si pikësynim dhe si dëshirë që njerëzit të shkojnë pas tyre. Megjithatë, ekzistenca e tyre përbën një ftesë kaq të fuqishme dhe të paevitueshme, saqë të gjithë rendin pas tyre kudo që ata të jenë, sikur këta njerëz të devotshëm të ishin një qendër rëndese.

E ardhmja do të jetë fryt i punës së këtyre njerëzve të devotshëm të cilët mund ta përfaqësojnë me dinjitet një mision të tillë kaq domethënës, duke bërë të njohura përgjegjësitë e tyre dhe duke shfaqur arritjet. Ekzistenca dhe vazhdimësia e kombit tonë dhe e kombeve të tjera që kanë lidhje me ne, do të bëhet e mundur nëpërmjet mendimeve, frymëzimit dhe arritjeve të një qytetërimi të ri si dhe me anë të dinamikave të gjëra dhe rigjallëruese të një kulture të pasur, të lartësuar në të ardhmen dhe të mbartur mbi supet e këtyre njerëzve të devotshëm. Ata përbëjnë të besuarit e të vërtetave sublime dhe trashëgimtarët e pasurive tona historike.

Ajo që nënkuptohet nëpërmjet trashëgimtarëve të historisë është të qenit trashëgimtar i gjithë bagazhit, të njohur dhe të panjohur, të madh dhe të vogël, të së kaluarës dhe përdorimi dhe rritja e mëtejshme e këtij bagazhi, në mënyrë që të prodhohet një përbërje e re; e më pas kalimi i gjithë këtyre mirësive brezave të ardhshëm, pronarëve të vërtetë. Në qoftë se një person i devotshëm nuk e përmbush detyrën historike të së sotmes dhe të së nesërme atëherë ai do të shkatërrojë të sotmen dhe do të humbasë të nesërmen tonë. Kjo përgjegjësi është e tillë që nëse trashëgimtari është përtac, i pakujdesshëm, neglizhent apo indiferent ndaj kësaj fëtyre apo nëse ai kërkon që dikush tjetër ta zëvendësojë, ose kur ai fillon të mendojë për poste më të larta në vend të detyrave aktuale për arsye të tërheqjes prej bukurive të botës së përtejme, ky person duke vepruar kështu, tradhëton kauzën dhe historinë, duke shkatërruar kështu urat lidhëse ndërmjet nesh dhe së ardhmes. Përkundrazi, për të mirën e ekzistencës dhe vazhdimësisë sonë, është i nevojshëm vitaliteti, hedhja e syve drejt së ardhmes dhe mendimi i palëkundur se e ardhmja na përket neve; një këndvështrim i tillë është tepër i rëndësishëm për funksionimin dhe efikasitetin e veprave tona me qëllim mbajtjen parasysh të kësaj detyre mbi çdo gjë tjetër, mbi ndjenjat, mendimet dhe planet tona. Alternativa ndaj kësaj mënyre verprimi është mosrespektimi i kombit tonë dhe tradhëtia ndaj tij. Ne kemi qenë mbështetës të institucioneve tona në çdo fushë të shkencës, artit,

ekonomisë, familjes, moralit dhe fesë duke i përforcuar dhe ngritur ato në nivelet më të larta të gjithë historisë, ashtu siç u takon. Prandaj ne kemi hedhur sytë përpara për të para mbërritjen e këtyre njerëzve me vullnet, vendosmëri, përpjekje dhe zell të jashtëzakonshëm.

Ne nuk kemi nevojë për përfitime, ndere apo ideologji lokale apo të huaja. Ne kemi nevojë për shkencëtarë të mendimit dhe të shpirtit të cilët do të ndjellin tek çdo njeri vetëdijen për vlerat e përgjegjësisë, sakrificës dhe vuajtjeve për të tjerët; të cilët do të mund të prodhojnë thellësi mendore dhe shpirtërore si dhe sinqeritet të pashoq në vend të premtimeve për lumturi kalimtare; kush të mundet, me një përpjekje të vetme të na bëjë të arrijmë pikën e vëzhgimit të fillimit dhe fundit të krijimit.

Tani, ne jemi duke pritur me sytë drejt pikës së mbërritjes së këtyre njerëzve, të cilët kanë kaq shumë dashuri për përgjegjësitë dhe kauzën e tyre sa që nëse do të ishte e nevojshme, ata do të jepnin në këmbim edhe biletën e hyrjes për në parajsë. Njerëz si këta, edhe nëse do të hynin brenda, do të kërkonin mënyra për tu larguar nga parajsa. I Dërguati i Allahut, Muhammedi. Ka thënë: “Nëse ata do të vendosnin diellin në dorën time të djathtë dhe hënë në dorën time të majtë, për të më bërë mua ta braktis kauzën time, unë do të refuzoja ta bëja këtë derisa Zoti të bjë që e vërteta të triumfojë apo derisa të vdes në luftë.” Ky është horizonti i të Dërguarit të Allahut. Bediuzzaman Said Nursi një dijetar rrezatues me dritën që buron nga i Dërguari i Allahut, i bërë dysh nga dhimbjet që i shkaktonte vështirësia e ndjekjes së akuzës së tij ka thënë: “Në sytë e mi, unë nuk kam as dashuri për parajsën e as frikë për ferrin dhe nëse do ta shikoja si të sigurtë besimin e popullit tim, do të isha i gatshëm që tani të digjesha në zjarrin e ferrit.” Në mënyrë të ngjashme, edhe Ebu Bekri i ngriti duart lart dhe u lut në një mënyrë që do të trondiste qiejt: “O Zoti im, bëje trupin tim aq të madh sa që unë i vetëm të mund të mbush krejt ferrin dhe të mos ketë më vend për askënd tjetër aty.”

Njerëzimi ka tmerrësisht nevojë për njerëz me thellësi dhe sinqeritet të brendshëm tani, shumë më tepër se për çdo gjë tjetër, ka nevojë për njerëz të cilët vuajnë dhe lotojnë për mekatet dhe gabimet e të tjerëve; të cilët shohin përpara për të falur dhe për të kërkuar faljen e të tjerëve përpara vetes së tyre; të cilët në vend që të hyjnë në parajsë dhe të marrin kënaqësitë e tyre

individuale atje, preferojnë të qëndrojnë në A'raf²⁹ dhe nga aty të përpiqen ti marrin të gjithë njerëzit për në parajsë sëbashku me ta; të cilët edhe pasi kanë hyrë në parajsë nuk janë në gjendje të gjejnë kohë për tu kënaqur me kënaqësitë e saj për shkak të mendjes që u rri tek të tjerët duke planifikuar vazhdimisht shpëtimin e tyre nga zjarri i ferrit.

Ndjenja e përgjegjësisë

Aspekti më domethënës i ekzistencës është veprimi dhe përpjekja. Qëndrimi në vend nënkupton dekompozim, prishje dhe emra të tjerë që kanë lidhje me vdekjen. Veprimet e bashkërenduara dhe lidhja e këtyre me ndjenjën e përgjegjësisë, u japin atyre dimensione thelbësore humane. Një veprim apo përpjekje e cila nuk dispijlohet me anë të përgjegjshmërisë, nuk mund të quhet i plotë.

Shumica e qënieve njerëzore ndjekin qëllime dhe objektiva të ndryshme. Megjithatë, për sa kohë që këto qëllime nuk marrin vlerën e duhur duke u pajisur me ndjenjën e përgjegjësisë, është e kotë të pritët ndonjë gjë me vlerë nga arritja e tyre. Egoistët, mendjet e të cilëve janë të trazuara nga lakmia për interesa dhe përfitime personale, punojnë pa pushim; politikanët bëjnë vizita kudo duke nxjerrë nga goja fjalë magjepëse; media prodhon një sasi të madhe spektaklesh në emër të informimit të publikut; disa qarqe të shoqërisë janë kthyer drejt indulgjencës përherë dhe pareshtur; disa të ashtëquajtur fetarë, të udhëhequr nga dëshira për përfitim material dhe pozita të pamerituara, bien dhe ngrihen në mëngjez me spekulime në gojë ditë e natë; disa zyrtarë shtetërore favorizojnë vetëm disa ideologji të veçanta dhe aferuesit e tyre ndërsa disa njerëz të zgjuar i shikojnë këto ngjarje të panumërta me indiferencë maksimale. Kjo ndodh në një kohë kur i fuqishmi dhe tirani ushtron forcën e tij dhe i shtypuri dhe i dobëti e pranon këtë fakt si “të zakonshëm” dhe si “përzgjedhja natyrore, mbijetesa e më të fortit”, prandaj është e nevojshme të bëhen shumë gjëra përpara se ato të bëhen më të vështira.

Është gabim nëse ata thonë se një shoqëri mund të jetojë me një të tillë pandjeshmëri,

Më tregoni mua një popull që ka mbijetuar me botë shpirtërore të vdekur?

Mehmed Aqif Ersoy

Dhe nëse do tju rastitste ti pyesnit të tillë njerëz “çfarë jeni duke bërë?” ata ose ju injorojnë ose ju qortojnë duke vazhduar në rrugën e tyre. Edhe në qoftë se nuk ju godasin apo përshtyjnë në fytyrë, përgjigjia më e mundëshme që ju japin është injorimi apo shmangia nga ndjenja e përgjegjësisë me fjalët “çdo dash mbahet nga këmbët e veta”³⁰ apo “ai që shpëton anijen është kapiteni.”³¹ Edhe kur veprimet e tyre të pamatura, të lehta dhe arrogante shkaktojnë tronditje në ndërgjegjen tonë, ata përgjigjen me fjalë të palogjikshme “rroftë gjarpri që nuk më kafshon mua.” Ne mund të ndeshemi me mjaft përgjigje të kësaj natyre të cilat bien në kundërshtim me mendimet tona të pastra dhe me ndjenjat më të pafajshme.

Megjithëatë, edhe pse këto nuk janë mendimet e zemrave të ndjeshme dhe besimtare, është e papajtueshme për ndjenjën tonë të përgjegjësisë të themi “Gabim dhe padituri” dhe të vazhdojmë sikur të mos kishte ndoshur asgjë. Kjo për arsye sepse ne, si një komb i tërë jemi të rrethuar nga armiqë dhe armiqësi. Për sa kohë që ne përjetojmë një rrethim të tillë, nuk mund të pretendojmë të jemi vetvetja përsa u përket ndjenjave, ideve besimit, artit dhe inisiativës së lirë; ne madje nuk mund as të pretendojmë të mbrojmë apo të ruajmë dinjitetin tonë islam, ndershmërinë tonë kombëtare, të shpëtojmë anijen tonë dhe të arrijmë në breg shëndoshë e mirë, duke ndërtuar botën tonë dhe të jetojmë në të ashtu siç dëshirojmë, duke u bërë trashëgimtarët e tokës dhe duke arritur tek Zoti. Është koha që ne ti hapim sytë dhe të shikojmë realitetin, të përdorim shqisat tona dhe të marrim pozicionin e protektorit dhe pronarit të arritjeve tona duke shëruar vetveten nga çdo gjë që është duke brejtur personalitetin dhe gjithë qënien tonë nga përbrenda. Në të kundërt, një ditë do të jetë e pamundur të ruajmë madje atë që sot e kemi.

Dikur armiqtë tanë ishin injoranca, padituria, varfëria, përçarja dhe fanatizmi. Tani atyre u janë shtuar edhe mashtrimi, prepotenca dhe detyrimi me forcë, ekstravaganca, dekadencia, fëlliqësia, pandjeshmëria, indiferenca dhe ndotja intelektuale. Shpresoj që ata të cilët ruajnë të pacënuar pastërtinë e

tyre fetare, dëlirësinë e mendimit dhe ndjenjat patriotike si dhe ata të cilët ndajnë pikëpamje të ngjashme me njerëzit të cilët unë citova më lart të më falin për fjalët e mia sepse unë mendoj se për një kohë mjaft të gjatë, si brezat e sotëm ashtu edhe disa mendjelehtë nga radhët e brezave më të vjetër, kanë ecur në rrugë të gabuar për shkak të naivitetit të tyre; ata kanë qënë të prekur nga ideologji të prishura, merita e vetme e të cilave qëndron në paraqitjen e tyre të komplikuar. Edhe nëse kjo që thashë vlen vetëm për disa qarqe, përjetimi i një devijimi të tillë idesh dhe personaliteti si një komb i tërë do të përbënte poshtërimin më të tmerrshëm të këtij kombi të bekuar. Në fakt, helmimi i Sulltan Mehmet Ngadhënjesit, therja e Sulltan Muratit I, vdekja nga brengat e Sulltan Jildirim Bajazidit dhe vdekja e Sulltan Javuz Selimit për shkak të një tomori nuk është asgjë përpara masakrës së shpirtit të kombit i cili doli fitimtar nga Lufta Kombëtare. Një masakër e tillë kryhet nga djajtë e epokës; ajo vjen për shkak të mendjelehtësisë së inteligjencës dhe indiferencës së masave popullore.

Ne na është ngarkuar përgjegjësia e stolisjes së botës sonë me një shpirt të ri dhe të freskët që buron nga dashuria për fenë, e cila bën që ne ti duam edhe qëniet e tjera njerëzore si dhe dashuria për lirinë. Ne jemi ngarkuar edhe më tepër me përgjegjësinë e të qenit vetvetja, të lidhur me parimet e këtyre tre lloj dashurish dhe për pregatitjen e terrenit për mbirjen e fidanëve të cilat janë rrënjët e pastra të pemës së parajsës, në mënyrë që ajo të ushqehet dhe të rritet në dheun e këtyre dashurive. Kjo sigurisht varet nga ekzistenca e heronjëve, të cilët do të marrin përgjegjësitë e duhura për mbrojtjen e fateve dhe historisë së kombit, fesë, traditave, kulturës dhe çdo gjëje tjetër të shenjtë që i përket popullit tonë; kjo do të varet në heronjtë të cilët janë absolutisht të mbushur me dashuri për shkencën dhe dijen, në mendjet e të cilëve bulëzojnë idetë në lidhje me përmirësimin dhe ndërtimin, të cilët janë jashtë mase të singertë dhe të devotshëm, patriotë dhe të përgjegjshëm dhe për rrjedhojë përherë të përgjegjshëm në punë, në barrën që u është ngarkuar dhe në detyrë. Falë këtyre heronjëve dhe përpjekjeve të tyre të singerta, sistemi ynë i mendimit dhe i botëkuptimit si dhe frytet e tyre do të dalin në pah tek populli ynë; ndjenja e devocionit ndaj të tjerëve dhe ndaj gjithë bashkësisë do të fitojë terren; ndjenja e përgjegjësisë në ndarjen e punëve, menaxhimit të kohës si dhe asistimit dhe

lidhjes me njëri tjetrin do të rigjallërohet; çdo marëdhënie autoritet – subjekt, punëdhës – punëmarrës, pronar – punëtor, çifligar bujk, artist – admirues, tregtar klient, mësues nxënës, do të marrë dimensione të ndryshme në unitetin e tërësisë; e gjitha kjo do të dalë në pah edhe njëherë tjetër duke bërë që pritshmëria jonë për epokën do të bëjë që këto të realizohen një e nga një. Ne sot jetojmë në një epokë në të cilën ëndrrat tona janë duke u bërë realitet, ndaj ne besojmë se nëse çdo gjë shkon sipas parashikimeve, secila prej këtyre përgjegjësive të kësaj epoke do të përmbushet në një ditë jo të largët.

Kjo që thamë përbën bazën e ëndrave dhe vizionit tonë; mënyra e parë dhe themelore për të realizuar ato është nëpërmjet ndjenjës dhe etikës së përgjegjësisë. Meqënëse palëvizshmëria përbën vdekje, dekompozim dhe papërgjegjësia në vepra përkëthehet në çrregullim dhe kaos, ne nuk na mbetet alternativë tjetër përveç disiplinimit të veprave tona nëpërmjet ndjenjës së përgjegjësisë. Prandaj çdo përpjekje e jona duhet të matet me njësinë matëse të përgjegjësisë. Rruga jonë është rruga e së vërtetës, kauza jonë është nxjerrja në pah dhe lartësimi i së vërtetës dhe objektivi ynë është kërkimi i kënaqësisë së Zotit në çdo shikim dhe veprim tonin. Në fakt një sjellje e tillë përbën lëmoshën që ne paguajmë për të qënë qenie të vërteta njerëzore dhe arësyen dhe justifikimin për veprat tona të vullnetshme. Ne e konsiderojmë vetveten të detyruar për të kërkuar qëllimin e jetës në qënien tonë, për të zgjuar dashurinë në shpirtrat tanë, për të kuptuar ndjenjën e përgjegjësisë në ndërgjegjen tonë, për të nxjerrë në pah rrënjët e shkencës, dijes, artit, moralit dhe mençurisë tek ata të cilët janë të gatshëm për marrjen përsipër të ndërtimit të një sistemi, parimet, themelet, drita dhe forca orientuese e të cilit buron nga besimi dhe dashuria; ne e konsiderojmë vetveten shërbëtorë të cilët nuk e pranojnë largimin nga ky mision. Përpjekjet tona të cilat ne shpresojmë të sjellin fryte në rrugën dhe drejtimin shpirtëror të gjithë njerëzve të dashur të Zotit si njerëzve të shenjtë (evliatë) të singertëve (asfiatë), njerëzve të mirë (abrarë) dhe njerëzve të afërt të Zotit (makarrabinët), do të bëjnë të mundur fillimin e një Rilindjeje të dytë.

Çdo epokë ka pasur mbrekullinë e saj përbrenda: rilindja e njerëzimit në dhekullin e gjashtë, rigjallërimi i fiseve turke dhe kombeve të tjera nëpërmjet pranimit të islamit në shekullin e dhjetë si dhe metamorfozat në provincën e

sogutit, si kristale të vogla në krahët e fluturës së mrekullueshme otomane, përbëjnë vetëm disa raste të tilla. Unë mendoj se mbrekullia e shekulli të njëzetë e njëte do të shfaqet dhe do të bëjë të mundur që populli ynë dhe popujt e tjerë të lidhur me ne do të zënë vendin e tyre qëu takon në balancën ndërkombëtare të pushtetit. Një lindje e tillë e cila do të ndryshojë rrjedhën dhe drejtimin e historisë së botës do të rrotullohet rreth boshtit të shpirtit, moralit, dashurisë dhe virtyteve. Nepërmjet betejës shpirtërore (xhihadi) të cilën ne gjithashtu mund ta quajmë edhe “lufta për dije, moral të vërtetën dhe drejtësi”, ne besojmë se brezat të cilët për kaq shumë kohë janë lënë pa mbrojtje dhe ideale , do të përjetojnë një ringjallje të re në një mënyrë të ngjashme me harenë e kapjes dhe shtrëngimit të flamurit të profetit në fushën e ringjalljes; një objektiv drejt të cilit të gjithë muslimanët duhet të bashkohen.

Nga kaosi tek rregulli

Për shekuj me radhë nëse e vërejmë nga këndvështimi ynë i moralit, virtytit, shkencës dhe dijes, shoqëria jonë ka pasur pamjen e një gërmadhe, është kërkuar mjaft për një sistem alternativ rregulli dhe mendimi ne fushat e dedkimit, artit dhe moralit. Në fakt ne kemi nevojë për mendje gjeniale, me vullnet të hekurt, të cilët janë të aftë të mbartin titullin e trashëgimtarit të Zotit në tokë dhe të cilët janë të aftë të ndikojnë në ngjarjet dhe të ndeshen me shpirtin jetim dhe mendimet e papjekura të cilat nuk i kushtojnë asnjë rëndësi ndjenjës se përgjegjësisë, ndjenjave njerëzore, dijes, moralit, ideve të vlefshme, virtyteve dhe artit në një shkallë aq të madhe sa që ne na nevojitet një ristrukturim i plotë i mendjeve dhe një vullnet i hekurt që do të bëjë të mundur përqafimin dhe interpretimin e krijimit në gjithë gjërësinë dhe tërësinë e tij si dhe do të sjellë përqafimin e njerëzimit në gjithë gjërësinë e tij të kësaj bote dhe të përtejbotshme.

Shtëllunga të kohëve të fundit ndryshimi dhe tansormimi në botë, bënë të mundur çjerrjen e maskës nga fëtyrat e shumë njerëzve duke bërë që ata të shfaqin identitetin e tyre të vërtetë; gjithashtu ato menjëherë e larguan vallon nga sytë tanë duke bërë që thelbi i vërtetë i gjithçkaje dhe kujtdo të bëhej i qartë përpara syve tanë. Tani ne mund ti vërejmë ngjarjet që ndodhin rreth

nesh më me qartësi dhe të nxjerrim konkluzione më reale dhe të shëndosha. Për pasojë ne tani kemi kuptuar dhe vërtetuar se nuk ka qënë vetëm pamja jonë e jashtme, mënyra e të veshurit, e të menduarit si dhe filozofija jonë e jetës subjekt i peripevive, keqkuptimeve, braktisjes dhe fshirjes nga kujtesa, por gjithashtu edhe kultura jonë kombëtare, ndërgjegja historike, sistemi ynë i moralit, pranimi dhe interpretimi i virtyteve, kuptimi mbi artin si dhe rrënjët e thelbit shpirtëror kanë qënë jo më pak subjekte të këtij lloj erozioni. Në fakt njerëzit që kanë pasur të tilla pikëpamje kanë vuajtur shumë më tepër. Të gjitha lidhjet tona shpirtërore u këputën dhe copëtuan, burimet tona të virtytit u shterrën dhe në vend të tyre u vendosën rrëpira dhe humnera të pakapërcyeshme që bënë të mundur ndarjen tonë nga e kaluara.

Në këtë botë tonën të bekuar, ne kemi përjetuar periudha gjatë të cilave intelektualët u detyruan të heshtin, burimet e mendimit u vulosën; ata të cilët përfaqësonin pushtetin dhe autoritetin e shtuan devijimin dhe degjenerimin; brezat e shkretë dhe të pafatë ishin gjithmonë të mbërthyer në rrjetën e “ndjenjave më të vdekura, të pashpresa dhe të errëta, brenda një kaosi rënkues si një kufomë.”

Në këtë periudhë “të kuqe,” kur kudo kishte depërtuar pluhuri dhe tymi i dendur i mungesës së shpresës, sytë derdhnin lotë dëshpërimi, zemrat pshërëtin kur hidhnin sytë drejt fëtyrave që nuk e njihnin turpin, duke u ankuar për ndjenjat e tyre me një zë vajtues që buronte nga thelësia e vetvetes: “Ç’farë tjetër duhet të presim nga këta njerëz konfuzë të cilët notojnë drejt ateizmit; nga këta njerëz të pamend të cilët lavdërojnë dhe duartrokasin këdo dhe gjithçka; nga këta viktime të ndërgjegjeve të tyre të njolllosura thellë, të cilët janë mësuar ti nënshtrohen këtij pushteti?” Megjithëatë shpeshherë gjithë këto gjëra të cilat qenë tronditur dhe shkatërruar, që ishin venitur dhe zhdukur, janë zëvendësuar. Ndaj tani, ne jemi dëshmitarë të bezdis dhe hutimit që kemi filluar të ndjejmë kohët e fundit në zemrat tona e edhe më thellë në lidhje me të ashtëquajturit realistë, të cilët nuk dinë asgjë tjetër përveç ndjekjes së kënaqësive të tyre vetjake. Është bërë e qartë si kristali se asgjë nuk është ndërtuar në vend të asaj çfarë është shkatërruar që është zhdukur dhe rrënuar; vlerat e shoqërisë kanë mbetur të pandryshuara.

Tani më lejoni tju pyes seriozisht si dhe me çfarë ne do ta kapërcejmë këtë varfëri morale e cila e ka kthyer jetën tonë në barrë dhe enigmë dhe se si do ti kapërcejmë krizat të cilat formojnë vorbulla më të forta dhe më të thella në qënien tonë sa më tepër që kalojnë ditët? Si mund ta zgjidhim, kapërcejmë dhe çlirojmë vetveten nga këto kriza individuale, familjare dhe shoqërore? Si mund të ecim me vendosmëri dhe pa frikë drejt së ardhmes? Me ca fantazi të importuara dhe ideologji boshe? Apo me botëkuptimin e kufizuar të kësaj epoke mbi të cilën ata përpiqen të ndërtojnë gjithçka? Jo! As këto mendime dhe ideologji të paligjshme dhe as kjo logjikë e errët nuk do të jenë në gjendje të na bëjnë të çlirohemi nga kjo barrë e rëndë.

Të gjitha përpjekjet e reformimit të botës sonë, kështu mbeten asgjë tjetër përveçse falsitete; ato nuk kanë sjellë kurrë realizimin e një objektivi sado të vogël dhe as ndjekjen e sukseshme të ndonjë pikësynimi të caktuar. Ata që qëndrojnë në krye, me penel në dorë, e kanë marrë këtë punë si të ishte një zanatë apo ndoshta si detyrim për të lyer plagët që janë shfaqur mbi trupin e kombit dhe shoqërisë; ata kanë qënë gjithmonë të verbër ndaj hemoragjisë së brendshme ne enët më të mëdha të gjakut që ushqejnë organet jetësore, si dhe ndaj komplikacioneve të shkaktuara për shkak të kësaj hemoragjie. Që nga fillimi i shekullit, me përjashtim të disa sukseseve në sferën private dhe të arritjeve të heronjëve të Luftës sonë Kombëtare, gjithçka ka vazhduar në këtë mënyrë. Për më tepër është e pamundur të themi se idealet e bekuara të heronjëve tanë kanë vijuar të ndiqen me të njëjtën pastërti dhe vendosmëri që kishin në fillimet e tyre. Sot nuk është e pamundur por është mjaft e vështirë të flitet për unitet në një shkallë të tillë dhe të imagjinohet një ngritje dhe rilindje e tillë që të sjellë ndryshimin e shumëpritur.

Megjithëse grupe të ndryshme e kanë ndarë dhe sdistancuar vetveten gjithmonë e më tepër nga të tjerët, ata nuk e njohin qartë ndryshimin thelbësor midis tyre për sa i përket jetës së tyre individuale, shpirtit dhe thelbit të tyre. Ata janë larguar nga njëri tjetri në një shkallë aq të madhe sa që janë shndërruar me sjelljet e tyre në kafshë të cilat sulmojnë njëra tjetrën. Ky fenomen ka arritur një nivel të tillë sa që nëse dikush thotë se diçka është e zezë, të tjerët e kundërshtojnë duke thënë se ajo është e bardhë, nëse dikush hedh një ide, të tjerët e refuzojnë dhe e kundërshtojnë atë; disa i konsiderojnë idetë alternative

të të tjerëve si tradhëti ndërsa të tjerë e shohin vendosmërinë e këtyre të fundit si fundamentalizëm dhe fanatizëm. Duke pasur parasysh gjithë këto aspekte kontradiktore, imagjini tani përmasat e kësaj lufte apo e thënë më ndryshe valleje ku nuk ekziston asnjë rregull apo kriter i përbashkët dhe asnjë lloj marrëveshjeje me të tjerët. Përpiquni tanë të zbuloni nëse mundeni nga cila anë qënfron e vërteta. Kjo është arsyeja përse më tepër se çdo gjë tjetër sot ne kemi nevojë për një mënyrë të menduari e cila të jetë e pagabueshme dhe për kritere të cilat nuk na shpien në rrugë të shtrembër me qëllim që ne të ecim drejt të vërtetës dhe virtytit. E ndërsa ndërgjegja dhe vlerat tona morale dhe etike pretendojmë të konsiderohen si një burim drite i mjaftueshëm për të zgjidhur shumë probleme, për fat të keq sot ndërgjegja është lënduar dhe këto vlera morale janë mbërthyer nga kunfuzioni; të dyja këto dinamika të rëndësishme janë çrrënjësuar dhe ashtu si çezmat antike nëpër muzeume, burimi i tyre pranveror është tharë. Siç ka thënë Mehmet Akif Ersoy:

Ajo që e rrit moralin nuk është as dija as ndërgjegjia,
Frika ndaj Zotit është burimi i vërtetë i çdo virtyti dhe mbrekullie.

Nesë ne u shtojmë të gjitha këtyre sa thamë më lart faktin që vullneti është ulur në nivelet më të vogla të mundshme, arsyeja është bërë mjaft e paturpshme dhe ndjenjat njerëzore janë egërsuar dhe bërë të liga si djajë, thellësia dhe gjërësia e makthit të cilin kemi përjetuar bëhet mjaft e dukshme.

Prandaj është mjaft thelbësore të fillojmë të rishikojmë edhe një herë të gjitha themelet e arsyes sonë, duke gjetur linjën e të menduarit logjik, duke i dhënë vullnetit tonë rëndësinë e duhur dhe duke formuar breza me vendosmëri të jashtëzakonshme. Meqenëse ne jetojmë në një univers të rrethuar nga shkaqet, nuk mund ti injorojmë ato. Neglizhenca e shkaqeve në një botë shkaqesh përbën determinizëm absolut dhe devijim. Qënia të përgjegjshëm dhe seriozë nuk nënkupton injorimin e shkaqeve por përkundrazi kërkon kujdes nga ana jonë në mbajtjen parasysh të parimit të shkaqeve (Tanasub al – illiyat), si një kërkesë të pazëvendësueshme.

Duke iu larguar kësaj çështjeje, mund të themi se nëse nuk veprojmë në këtë mënyrë, pra duke bërë përpjekje serioze të analizojmë që tani themelet e

këtyre ideologjive dhe lëvizjeve veçanërisht të dëmshme si dhe nëse nuk marrim masat e nevojshme kundër tyre, është e paevitueshme që përsëri të jetojmë mes një morali të tillë të prishur, të tilla fatkeqësive shoqërore, devijimeve dhe korrupsioni të çdo shkalle dhe përmase. Nuk është punë e mençur ti njohim pasojat e fatkeqësisë pasi ajo ka ndodhur. Meritë është parashikimi dhe parandalimi i shkaqeve dhe faktorëve që bëjnë të mundur një situatë të tillë. Gjithashtu është e vështirë të falsim për një zgjuarsi dhe largpamësi kaq preçize në lidhje me historinë tonë të kohëve të fundit; ne nuk mund të pretendojmë që i kemi dhënë vullnetit tonë drejtimin e duhur në çdo kohë. Përkundrazi gjatë kësaj periudhe muzgu, populli ynë ishte dyshues në lidhje me mendimet, vullnetin dhe vendosmërinë e vet dhe gjithmonë ka ëndërruar ta qeverisë ndonjë pushtet superior dhe i jashtëzakonshëm. Madje për shkak të ideve të ashtëquajturve “dijetarë”, koncepti i shkencëtarëve, atdheut dhe shtetit pa karakter, u ngulit në ndërgjegjen e pastër dhe të pafajshme të njerëzve tanë, duke sjellë për pasojë tronditjen e vendosmërisë dhe besnikërisë së tyre. Me kalimin e kohës, mbizotërimi dhe pushteti i këtyre njerëzve mbi mendjet dhe veprimet tona, shkaktoi një tërësi devijimesh të personalitetit, marramendje, shmangiesh të arsyes, prishje dhe çrregullimi në mendjet tona, në pranimin dhe interpretimin tonë të ideve. Kjo pastaj solli për pasojë deformime të tmerrshme tek ata të cilët dorëzoheshin pa kushte ndaj këtyre njerëzve dhe ideve, megjithëse asgjë tjetër përveç Vullnetit Hyjnor nuk meriton të besohet dhe pranohet pa u studjuar dhe thelluar në të.

Descartes ka thënë “Mendimi që nuk është i lirë nuk mund të quhet mendim.” A nuk jemi vallë aq të aftë sa të mendojmë të paktën si Descartes, në mënyrë që ta shpëtojmë vetveten nga pedantizmi i së sotmes i cili tashmë është çrrënjësor dhe vjetëruar në shumë drejtime? Mjerisht ka të ngjarë që jo...

Në vitet ne vijim brezat të cilët do të mund të shohin horizontin e ndritur të kësaj bote dhe botës tjetër, do ti rishikojnë mendimet, formulat dhe sistemet të cilat janë importuar tek ne dhe janë formuar brenda nesh; ata do ta pastrojnë shoqërinë nga gjërat dhe mendimet e huaja dhe të ndotura dhe do të na lidhin me rrënjët ona shpirtëore, në mënyrë që nëpërmjet tyre të mund të mbrojmë dhe të ruajmë thelbin, personalitetin dhe linjën tonë të veprimit në të ardhmen. Gjatë rrugës këta breza do të lidhen ngushtë me botën dhe do të bëhen të aftë

të lexojnë dhe të studiojnë të djeshmen sëbashku me të sotmen, njëren brënda tjetrës, në mënyrë që të mos e hedhim poshtë të shkuarën për shkak se ajo është e vjetër dhe të pranojmë symbyllurazi gjërat që i konsiderojmë të reja dhe të freskëta. Karakteristika me dukshme e këtij brezi të ndritshëm do të jetë njohja e gjithçkaje që ka lidhje me të shkuarën dhe të tashmen, të kuptuarit e asaj çarë është më e rëndësishme të njihet sepse ajo që konsiderohet rëndom si e njohur, nuk qëndron në faktin se gjithçka që ne dimë është e vërtetë, ndaj në një mënyrë apo në një tjetër të përpiqemi të kuptojmë të vërtetat që burojnë nga përpunimi dhe shoshitja e ideve në filtrin e mendjes, logjikës dhe arsyes si dhe nga kujdesi për rrymat e frymëzimit.

Arritja e një ndryshimi dhe përmirësimi të tillë kërkon në mënyrë të domosdoshme njohjen e të kaluarës sonë të afërt, heronjëve dhe personaliteteve historike. Duhet tu jepet patjetër përgjigje pyetjeve të tilla si: Gjatë formimit të historisë sonë kush ishin figurat më me influencë dhe cilët ishin faktorët, morivet dhe arsyet më ndikuese? Kush janë njerëzit të cilët e kanë rigjallëruar me dashuri dhe entuziazëm së fundmi popullin tonë? Kush i ka marrë përsipër dhe po i kryen punët të cilat paraqesin dhe pasqyrojnë bukuritë tona kombëtare, shoqërore dhe shpirtërore? Kur ti dimë përgjigjet e gjithë këtyre pyetjeve, unë mendoj se ne mund ta kuptojmë më mirë çfarë kemi nevojë të shohim dhe se si ti prezantojmë më qartë planet dhe projektet tona të së ardhmes. Prandaj ne mund ta arrijmë lumturinë duke ecur në gjurmët e heronjëve të cilët i mbajtën të gjalla e të shëndosha në zemrat e tyre moralin, dashurinë, kauzën dhe mendimet e tyre.

Nga kaosi tek rregulli II

Harmonia ndërmjet krijimit dhe fenomeneve natyrore është e paravendosur; rregulli midis njerëzve është vullnetar apo i bazuar në vullnetin e lirë në një shkallë të lartë e ka origjinën tek dashuria dhe frika. Rregulli përbën emërtimin tjetër të paqes, kënaqësisë dhe harmonisë shoqërore e po kështu edhe të së ardhmes premtuese. Meqenëse nuk mund të flitet për paqe dhe harmoni në kaos, atëherë nuk mund të bëhet fjalë as për të ardhmen apo efikasitetin e veprimeve në rrethana anarkike.

Në pamje të parë, rregulli ngjan të jetë produkt i një vullneti të thjeshtë dhe i mendjeve të izoluar ndaj besimit, por mendja e cila nuk është nën kontrollin e shpirtit si dhe vullneti i cili nuk është i aftë t'ia presë rrënjët tendencave djallëzore dhe të nxisë preirje për vepra të mira, konsiderohet të jetë më afër anarkisë sesa rregullit.

Çdo krijesë përveçnjërëzimit, ka ruajtur gjithmonë rregullin që kur bota ka filluar të ekzistojë. Një rregullsi magjepërse mbizotëron kudo dhe mbi çdo gjë, që nga lëvizja harmonike e elektroneve dhe atomeve e deri tek peisazhi i mbrekullueshëm i luleve, që nga balanca dhe harmonia ndërmjet gjallesave dhe jo gjallesave, deri tek yjet të cilët xixëllojnë dhe na ndriçojnë duke zgjuar shpirtin poetik dhe emocionet që vijnë nga hapësira e pamasë drejt e në zemrat tona; që nga domethënia që paraqesin lulet, gjethet dhe degët e pemëve deri tek jeta që lulëzon me vitalitet brenda dhe jashtë tyre.

Nëse ndërgjegjia e vëzhgon dhe e vlerëson librin e krijimit për një çast, ajo vëren dhe përcepton rregullin dhe harmoninë që mbizotëron kudo, bukurinë magjepëse dhe pasurinë vetëfrymëzuese të thelbit të gjithçkaje. Për këtë nuk ka nevojë për ndonjë ndjeshmëri aq të thellë; edhe një zemër me një ndjeshmëri të vogël dhe të kufizuar, mund ta ndjejë, përjetojë dhe perceptojë këtë poemë të recituar dhe të kënduar me notat dhe akordet e pafundësisë, në çdo formë, përmasë, ngjyrë, zë dhe tingull, që nga cicërima e gëzueshme dhe harmonike e zogjëve e deri tek bubullima e frikshme dhe e tmerrshme që sjellin vetëtimat ndriçuese; që nga lulet delikate shumëngjyrëshe dhe të mbrekullueshme e deri tek drita misterioze e yjeve dhe qiellit. Ndaj, ata të cilët janë një hap përpara të tjerëve, ata që dinë, i vëzhgojnë këto fenomene me anë të fizikës, kimisë, biologjisë dhe astrofizikës. Që nga thellësitë frymëzuese të detit, nga valët e tij të potershme deri tek qetësia e freskët e lirishtes parajsore të pyllit; nga pamja madhështore e kodrave deri tek majat e magjishme, të paarritshme dhe të pakapërcyeshme të maleve; nga burimi dhe rrjedhja e vazhdueshme e ujit deri në thellësitë e qiellit që shtrihet drejt pafundësisë, gjithçka flet për rregull dhe harmoni dhe i bën jehonë kuptimit të gjërë të shpirtit të krijimit.

Kështu, nëse rregulli qëndron në gjithçka dhe në çdo vend, atëherë nga na erdhi ky kaos të cilin ne e quajmë edhe çrregullim, rrëmuje dhe

paligjshmëri? Bota e njohu kaosin dhe imoralitetin që qëndron pas tij prej qënieve njerëzore; qënieve të cilat nuk ia dorëzuan mendjen e tyre Zotit, të cilat nuk ishin të aftë ti vinin fre egos së tyre dhe ti orientonin ndjenjat drejt së mirës. Njerëzit janë krijesa të ndjeshme ndaj një shkalle të gjërë ambicies dhe ata posedojnë një numër të madh dhe një shumëllojshmëri dobësish në krahasim me krijesat e tjera. Ndjenjat e shkatërrimit, anarkisë dhe vorbullave të çrregullimit, manifestohen në frekuenca të ndryshme në pothuajse çdo dobësi tonën si lakmia, ambicia, zemërimi, urrejtja, keqdashja, dhuna dhe zilia. Është e pamundur për nejrëzimin që ai ta shpëtojë vetveten nga rrjellojat negative të këtyre veseve, pa marrë më parë kontrollin e gjithë këtyre ndjenjave djallëzore; kjo mund të bëhet vetëm kur të kultivohet virtyti, fisnikëria dhe edukata. Ne nuk mund ta shpëtojmë vetveten derisa të mos forcojmë dhe konsolidojmë ndjenjat tona humane; derisa të mos i themi po një kontrate të heshtur shoqërore në ndërgjegjen tonë nepërmjet marrjes në konsideratë të ekzistencës së të tjerëve gjatë ushtrimit të ambicieve, dëshirave, gëzimit, shqetësimit, lirisë dhe të drejtave tona.

Edukimi i cili do ta ngrejë njerëzimin nga shkalla e njerëzimit potencial në nivelin e njerëzimit të vërtetë, duhet të drejtohet drejt Hyjnore dhe nga Hyjnorja, si dhe duhet të bazohet në dhuntitë dhe talentet me anë të të cilave jemi bekuar nga Zoti. Kultura jonë duhet të ushqehet me anë të trëndafilave të rritur në kopshtin tonë dhe me anë të nektarit që buron nga thelbi dhe rrënjët tona shpirtërore; kështu ai nuk do të krijojë ndonjë reagim kundërshtues nga ndërgjegja kolektive apo nga verdikti i historisë. Kontrata shoqërore duhet të realizohet sipas kushteve dhe ërkesave të kohës dhe brënda kornizës së lirive dhe të drejtave të nivelit më të lartë, në mënyrë që qarqet dhe sektorët e ndryshëm të shoqërisë, të mos e humbasin forcën, autoritetin, respektin, kredon, vetëvlerësimin apo vlerën nominale brënda lëmshit të kundërshtimit, e as të mbyllen brënda rrethit vicioz të neutralizimit të njëra tjetrës nepërmjet kontradiktave. Ajo që ne nënkuptojmë me këtë kontratë, nuk është një kontratë kolektive e hedhur në letër me gjithë ato firma njerëzish që zbukurojnë fundin e faqes, por një kontratë e cila të ketë lidhje dhe të përmbajë respektin për konceptin e lirisë dhe të drejtave dhe nga dashuria për të vërtetën, nga ana e njerëzve të cilëve u janë zgjuar vlerat njerëzore në ndërgjegjet e tyre. Kufinj

dhe korniza e kësaj kontrate përcaktohen me anë të strukturës së zemrës së individëve, gjërësisë së shpirtit të tyre si dhe të kuptuarit që feja dhe ajo çfarë besojnë ata përbën një dispozitë apo një pjesë të natyrës së tyre. Kjo është arsyeja përse kontrata e ndërgjegjes së çdo personi i korrespondon nivelit të tij të ndjenjave njerëzore. Një bashkësi e cila përbëhet prej individëve të pjekur, që kanë kapërcyer dëshirat trupore për hir të jetës së tyre shpirtërore, përbën një shembull të shkëlqyer të asaj çka thamë më sipër. Një rregull i tillë në botën njerëzore është i qëndrueshëm dhe premtues për të ardhmen sepse ai përbën një përmasë të harmonisë universale që rrethon gjithë krijimin.

Në botën tonë shteti është si kaputeni në timonin e anijes ekuipazhi i të cilës është i përbërë prej njerëzve me merita, virtyte dhe moral. Detyra e kapitenit është të bëjë më të mirën për të nxjerrë në pah cilësitë e ekuipazhit nën autoritetin e tij, të vendosë harmoninë dhe mirëkuptimin ndërmjet tyre dhe përputhjen me ligjet e universit duke bërë që anija të arrijë në destinacion pa u përplasur me dallgët e egra të ngjarjeve. Ashtu siç ëshë e pamundur të krijohet një shoqëri e shëndoshë dhe një shtet i përkryer nga një bashkësi, anëtarët e të cilës janë të privuar prej virtyteve dhe të cilët zhgërryhen në moçalet e imoralitetit, ashtu edhe shpresat që masat popullore të zhytura në rrëmujë dhe kaos, të cilat sulmohen nga të gjitha anët nga sëmundjet shpirtërore, nëse do të pretendohet që ato të silnin të ardhmen e ndritur, kjo do të përbente një ide të gabuar dhe zhgënjyese. Prandaj është një supozim, një iluzion dhe një ngushëllim i gabuar dhe i pabazë shpresa për arritjen e diçkaje domethënëse në emër dhe në fushat e administrimit dhe sigurisë nga masat e gjëra të njerëzve thjesht për shkak të fatit të tyre të verbër, pavarësisht i çfarë forme është ai. Si autoriteti ashtu dhe shteti mund të rivendosen vetëm nëpërmjet shënjestrimit të një ideali të lartë i cili do të marrë jetë dhe do të ruhet brënda shoqërisë, duke planifikuar gjithçka në përputhje me këtë ideal dhe nëse mund të flitet për përpjekje apo veprime, ato duhet të jenë të tilla që të burojnë nga “i Vetmi.”

Çdo individ dhe çdo njësi vitale duhet të planifikohen dhe të pregatiten për të mbartur mbi supe apo për të ngritur lart gjithë popullin në majat më të larta, në mënyrë që interesat e vogla, skemat dhe llogaitë brenda planeve individuale të mos mund ta pridhin harmoninë e përgjithshme dhe për

rrjedhojë të mos lindin grupe dhe qarqe të ndryshme të cilat pastaj rriten, përplasen dhe shkrihen në dëm të njëri-tjetrit si valët e detit. Dikur, kur shpirti i islamit mbizotëronte mbi tërësinë e jetës ky objektiv ishte përcaktuar dhe vendosur aq mirë saqë pjestarët dhe njësitë të cilat ndërtonin shoqërinë ishin shndërruar gjithsecila në një kolonë rregulli, ndaj ecja drejt majes u arrit brenda rrjedhjes natyrale të jetës.

Dhurata më e madhe e brezave të sotëm për botën e së nesërme, është të vepruarit dhe të rishikuarit e idesë sonë në lidhje me rregullin, rigjallërimi i besimit se harmonia Hyjnore brenda krijimit do të mbartet tek bota njerëzore nëpërmjet vullnetit tonë, duke vendosur balancën midis kombeve në këtë bosht për një mision të tillë kaq të rëndësishëm, unë besoj se do të vërejmë edhe njëherë se si vullneti ynë për të vendosur dhe siguruar vendin tonë të merituar në sytë e Zotit do të bëjë që ne të përcaktojmë objektivat për njerëzit dhe kombin tonë, të konsolidojmë gjykimin, vijueshmërinë, strategjinë dhe rregullat, duke realizuar apo sjellë në jetë dinamika të cilat tashmë ne i posedojmë.

Kauza madhore e popullit tonë

Mbarë bota tashmë është duke lëvizur drejt pranverës. Pavarësisht problemeve të së shkuarës, pothuajse gjithkush bie dakord me idenë se e ardhmja është e ndritur, në vend që të ndalemi në këtë fenomen, unë mendoj se është më e rëndësishme të marrim në konsideratë gjendjen e atyre të cilët do ta bëjnë realitet këtë të ardhme me anë të vendosmërisë, vullnetit dhe efikasitetit në punën e tyre. Të menduarit në lidhje me të ardhmen e vendit dhe të popullit të tij, përbën padyshim një detyrim për çdo individ inteligjent dhe mendjendritur. Megjithatë unë nuk mund të them me siguri nëse gjithkush është i ndërgjegjshëm dhe i gathëmpër të mbartur një përgjegjësi të tillë. Ajo që unë di është se një numër njerëzish në vendin tonë përgjatë viteve kanë jetuar ditë dhe natë duke punuar vazhdimisht dhe duke u shqetësuar për shkak të aspiratave të tyre për të ardhmen. Duke përdorur, shpenzuar dhe sakrifikuar gjithçka që ato kishin me shpresën se një ditë rruga që ata ishin duke ndërtuar do të mund të sheshohej.

Ky vend dhe komb, për të cilin miliona njerëz dikur kanë sakrifikuar jetën e tyre në mënyra të ndryshme, ndodhet në një epokë nxitëse të kalimit nga e shkuara drejt së ardhmes, i shoqëruar nga një numër i madh bijsh besnikë; kjo ka ndodhur edhe më parë, ndaj ky vend dhe njerëzit e tij tani janë të mbushur me besim dhe thellësisht të ndjeshëm dhe entuziastë në lidhje me idenë e përparimit të popullit të tyre. Kjo është kaq e vërtetë sa që kur ata kryejnë punët e zakonshme të ditës me njerën dorë dhe këmbë, përpiqen të prodhojnë plane dhe projekte për të ardhmen me dorën dhe këmbën tjetër duke vënë në zbatim ndjenjat dhe vetëdijen se ata i janë dhënë dhe përkushtuar idealeve të tyre dhe komandohen nga ato. Kështu ne mund të themi se kauza madhore të cilën ka mbrojtur dhe ruajtur ky komb fatlum dhe i lavdishëm i yni dhe kjo histori madhështore dhe e nderuar; një kauzë e cila është dormuar dhe zhvilluar për mbi një mijë vjet është duke filluar të ndezë edhe njëherë në shpirtrat e njerëzve të tij një emocion të thellë; një emocion i ngjashëm me atë të përmadimit dhe padurimit për tu rikthyer në shtëpi. Shumë nga brezat e sotëm me ndjenjën e tyre të bashkimit dhe solidaritetit, vendosmërinë dhe kujdesin për ta barë kombin e tyre kombin nnumër një të epokës, duket se janë si shfaqja e dukshme e kësaj kauze njëkohësisht edhe përfaqësuesit e këtij misioni. Përderisa ndonjë erë e kundër të fryje dhe të shkatërrojë gjithçka ka të ngjarë që e ardhmja të jetë e tyre.

Kjo kauzë u përhap nga njerëzit e parë të mbëdhenj të islamit në të katër cepat e botës, për një kohë mjaft të shkurtër dhe mori një dimension të ri me dinastitë Umajjade dhe Abbaside, një vlerë më të madhe me Selxhukët dhe në fund, u bë një çështje e një rëndësie parësore me otomanët, megjithëse ajo që subjekt i ligësive të pashoqe për një periudhë të caktuar. Ky ka filluar edhe njëherë të përjetohet si një proces që shtrihet nga fashati tek qyteti, nga familja tek shteti, nga rruga tek shkolla, nga arti tek shkenca, nga puna tek morali dhe bëhet i mundur falë atyre të cilët e kanë zgjuar kombin me thirrjet dhe entuziazmin e zemrave të tyre dhe të cilët e kanë ngjyrosur dhe ujitur hartën e vendit me lotët e tyre të vazhdueshme. Prandaj, pavarësisht gjithçkaje drita e dobët por e dukshme e agimit ka nisur të shfaqet gradualisht, duke bërë që të ndriçohet gjithçka. Në njëfarë mënyre, megjithëse ne kemi qënë subjekt i mashtrimit të agimeve të reja herë pas here, janë po këto agime të rreme të

cilat janë dëshmitari më i besueshëm që na tregon se dielli do të lindë së afërmi.

Gjatë kësaj periudhe fatkeqe, çështje si lakmia për të mira materiale, dëshira për pozitë, pasioni për jetë, dëshira për famë dhe dëshira për të qëndruar gjithmonë në këtë botë, zuri vendin e kauzave tona intelektuale dhe shpirtërore duke bërë që gjërat më të ulëta të vihen në pedestal. Megjithëatë tani shpirti dhe thelbi apo realiteti, janë orientuar drejt detyrës dhe gjërat kanë nisur të zënë vendin e tyre. Në vend të mendimeve të papjkura dhe fantazive të asaj kohe dhe të njerëzve të cilët mburreshin me thirrjet e tyre se do ta shpëtojnë vendin dhe do ta përparojnë atë në nivelet e standarteve perëndimore – një pretendim i cili në pamje të parë dukej se ishte me vend por që në fakt rezultoi asgjë më tepër sesa një falsitet – sot ekzistojnë madje në një numër mjaft të madh përfaqësues të çmuar apo kandidatë për të qënë të tillë së shpejti, të shkencës, dijes, artit, moralit dhe virtytit të cilët janë trashëgimtarët e vërtetë të të gjitha vlerave që mbart e kaluara jonë e lavdishme.

Nga ana tjetër, është e vërtetë që ekzistojnë luftra të pamëshirshme që bëhen në fushat e politikës, arenat e interesave dhe në dyert rrotolluese të përfitimit; madje disa mburren me fjalët “Le ta shpëtojmë vendin,” “Le ta ndriçojmë popullin tonë,” “Le ta përparojmë kombin tonë.” Ne gjithmonë paguajmë haraç për trillet dhe pasionet e atyre të cilët kanë gatuar përralla që e kanë keqduhëzuar popullin tonë, duke e udhëhequr kombin drejt kaosit. Megjithëatë, unë ju pyes juve seriozisht: A është e mundur të tregohet se ka pasur ndonjë periudhë gjatë së cilës gjëra të tilla nuk kanë ekzistuar dhe nuk kanë ndoshur? Gjëra të tilla kanë ekzistuar gjithmonë dhe do të vazhdojnë gjithmonë të ekzistojnë, sot, nesër dhe përherë. Historia nuk është histori vetëme njerëzve të mirë. Bashkë me historinë e njerëzve të mirë ekziston edhe historia e atyre të cilët përбетohen, brejnë, gërryejnë, bëjnë gracka, tradhetojnë dha akuzojnë njëri-tjetrin. Ju nuk duhet të lodheni shumë për ta gjetur atë. Nëse i hedhim një sy të shkuarës sonë të afërt, do ta vërejmë këtë fenomen dhe do të dridhemi për faktin se sa shumë herë shpirtrat janë vrarë në emër të demokracisë, sa shumë herë sektorët e ndryshëm të shoqërisë janë kthyer në ujë të gatshëm për të shqyer njëri-tjetrin dhe sa herë zemrat tona ishin të detyruara të pinin helmin e urrejtjes, keqdashjes dhe dhimbjes.

Duke hedhur një sy në shumë sektorë të shoqërisë nga këndvështrimi i disa çështjeve, gjërat që ne jemi duke bërë sot nuk janë shumë të ndryshme nga ato të djeshmet dhe veprat e së nesërme nuk do të kenë ndonjë ndryshim nga to të sotmet. Edhe në shoqëritë më të pastra dhe më ideale, kanë ekzistuar dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë ca shpirtra të errët të cilët vazhdimisht do të shpifin dhe përgojnë, duke sjellë përçarje, dhunë dhe shtypje dhe të cilët do të ndërrojnë vazhdimisht maskat në fëtyrat e tyre, duke qënë të aftë ta fshehin vetveten dhe identitetin e tyre të vërtetë. Nga ana tyre me përjashtim të këtyre njerëzve është më e mundur të ekzistojë një botë me njerëz pozitivë dhe me prirje pozitive.

Sot, lëvizja për edukim është realizuar nën emra dhe tituj të ndryshëm dhe përpjeket për dashuri, tolerancë dhe dialog përbëjnë përpjekje mjaft të rëndësishme për bashkimin e pjesëve të ndryshme të shoqërisë dhe bërjen e burimit të fuqisë së saj shpirtërore të lëvizë dhe të funksionojë; është e mjaftueshme që nëpërmjet duarve të brezave tensioni metafiziko shpirtëror i të cilëve është i plotë dhe të cilët realisht besojnë në këto objektiva, të rivalëvitet flamuri i anijes së kombit tonë, një anije e cila ka nisur ti largohet cekëtirës dhe të lundrojë në ujëra më të thella. Nuk ka dyshim se brezat e sotëm të cilët kanë qënë keqtrajtuar dhe keqpërdorur përse i përket anës shpirtërore dhe karakteriale dhe të cilët kanë vuajtur humbje të mëdha njëra pas tjetrës në sferën e moralit, virtyeteve, mendimit, artit e madje edhe në të gjitha vlerat e tjera njerëzore, do të arrijnë të përjetojnë një ringjallje të re falë lirisë së tyre shpirtërore dhe stabilitetit intelektual.

Shekulli i nëntëmbëdhjetë dhe ai i njëzetë u shndërruan në epoka disintegrimit dhe na kthyen mjaft pas. Për një kohë të gjatë, arsytet e vërteta të këtij fenomeni nuk kuptoheshin dhe pikëpamjet në lidhje me këtë çështje ishin krejtësisht të gabuara. Për pasojë “kryevepra” e parapmbetjes së vërtetë u prodhua dhe u shfaq në fushat e fesë, shkencës, artit dhe estetikës dhe ndonjëherë rastësisht, rryma të veçanta në formën e konfliktit të ideve u shndërruan në rryma të nihilizmit dhe ateizmit. Këto konflikte idesh lindën për shkak të fantazisë dhe konfuzionit. Kjo ishte kaq e vërtetë sa që vendin e gjenialitetit shkencor e zunë rrengjet dhe mashtrimet, vendin e ndriçimit e zuri iluzioni dhe vendin e luftës dhe vendosmërisë e zuri shpifja duke bërë që këto

vese të bëhen të pëlqyeshme. Ata të cilët e konsideronin gënjeshtren si aftësi, harxhonin të gjitha energjitë dhe përpjkejet e tyre për të hedhur poshtë ë gjitha të vërtetat historike nepërmjet fabrikimit të gënjeshtreve, keqinterpretimeve të qëllimshme, shpifjeve, përgojimeve dhe nxitjeve dashakeqëse. Vëreni manifestimin e Caktimi Hyjnor në të cilin këto dinamika historike dhe rrënjë shpirtërore të njerëzve qëndrojnë ende në këmbë dhe krahasojeni atë me gradën e ulët ku kanë rënë shpifësit dhe njerëzit e ulët.

Ky komb duke u zgjuar dhe duke ecur në gjurmët e Profetit edhe një herë tjetër, ashtu siç kërcejnë kudo flokët e borës nëpër erën pranverore, ai është duke pëshpëritur këngët e ekzistencës më të re, të rilindjes më të freskët. Ne sot dukemi më të gjallë, më aktivë dhe më të vendosur, më me shpresë, më paqësorë dhe të hareshëm në realizimin, në gjetjen dhe në kthimin në vetvete; unë dëshiroj që çdo pëpjekje e jona tani e tutje, çdo lot që derdhim të shndërrohet në ilaç për plagët tona të thella dhe dritë për të nesërmen që duket kaq e errët!

Tani në shekullin e njëzet e njëte, e ardhmja e popujve që kanë lidhje me ne mund të konsiderohet si diçka që qëndron në krahët e pëllumbit besnik të ushtrisë së dritës, i cili i valvit krahët prej drite; këta kombe tani konsiderohen si përfqësuesit e shkencës, dijes, virytit dhe moralit. Ne shpresojmë se këto breza të bekuar, shumica dërrmuese e të cilëve ia ka kushtuar vetveten mësimdhënies dhe edukimit, do të jenë udhërrëfyesit tanë me zërin e dritës dhe me idetë ndriçuese duke na bërë ne që jo vetëm të rifitojmë të gjitha vlerat historike që kemi humbur, por gjithashtu ti bëjmë njerëzit tonë të aftë të kuptojnë dhe të marrin mbi supe të gjitha përgjegjësitë e tyre që koha ju dikton.

Kauza dhe qëllimi i ekzistencës sonë, nuk ka të bëjë fare me dhunën apo forcën. Të kuptuarit e faktit se pushteti i cili i është dorëzuar dhe nënshtruar së Vërtetës e ka arsyen e vet të ekzistencës, ne me zemër të plotë e njohim dhe respektojmë nevojën për teknikë dhe teknologji, nevojën dhe domosdoshmërinë për teknologji, vlerën e shkencës dhe dijes. Në mbështetje të këtyre, ekziston një prespektivë e gjërë e mendimit tonë, e pranimi tonë të rolit ushëheqës dhe interpretimit të artit di dhe pikëpamjet e zbatimit të drejtësisë së vërtetë, e cila është një fushë tejskajshmërisht e ndjeshme dhe gjithashtu e besimit në ndjenjën e detyrës për ti shërbyer popullit tonë, për të

ushqyer dhe mbështetur të gjitha sa thamë më lart. Prandaj ne sot kemi nevojë më tepër se për çdo gjë tjetër për mendje të shëndosha, për pikëpamje të gjërë dhe për mësues shpirtërore me horizont të gjërë të cilët të mund të vendosin balancën e duhur për të gjitha këto me qëllim shërbimin bdaj kombit dhe popullit tonë. Këta njerëz do të mund të ngrejne këtë popull dhe kom në majat më të larta të mendimit, do ta drejtojnë atë drejt rrënjëve dhe esencës së tij shpirtërore dhe do tu japin mundësinë për të nisur një fillim të ri shpirtave tanë të cilët kanë nevojë dhe kanë dëshirë të përjetojnë dashurinë e Sublimit.

Në vend të partive plotike apo tarafeve të ndryshme, kombi ynë ka nevojë për didhepuj të dijes, moralit dhe virtyteve, të cilët janë të pajisur mirë me besim dhe shpresë, plot me entuziazëm dhe të cilët e kanë zhveshur vetveten nga çdo dëshirë, kërkesë dhe pikësynim të kësaj bote qoftë nga ana materiale ashtu dhe ajo jomateriale që i përket kësaj bote dhe tjetrës. Derisa të mund ti gjejmë ata dhe ta vendosim veten tonë në duart e tyre, kypersekutim dhe kjo skllavëri e ngatërruar, megjithëse në shkallë relative duket se do të vazhdojë të ekzitojë. Ne i lutemi Zotëruesit të Mëshirës të Pafundme, të dërgojë sa më parë brezat e shumëpritur në mbështetje tonë, sëbashku me ata shenja ngushëlluese të cilat ne i kemi parë të shfaqen në horizont.

Brezat ideale

Në prag të ditëve të mrekullueshme të së ardhmes, ditë agimi i të cilave është duke na pëshpëritur për festa të gëzueshme, është e qartë se ne jemi duke përballuar lriza të cilat duken të pakapërcyeshme. Ashtu si shqetësimet sociale, provlemet kombëtare dhe fatkeqësitë natyrore, krizat që kaplojnë një shoqëri nuk mund të kapërcehen apo të zgjidhen me anë të masave të zakonshme. Zgjidhjet për kriza të tilla varen në mprehtësinë, dijet dhe mençurinë e përhapur kudo. Nuk është e nevojshme – madje do të ishte thjesht humbje kohe – të përpiqemi ti zgjidhim të tilla kriza me masa të pabaza, të kufizuara dhe jo premtuese, të cilat i ngjajnë manovrave të rëndomta politike. Që nga e shkuara e deri në ditët tona njerëzit e shpirtit, esencës dhe vizionit, i kanë zgjidhur situatat dhe krizat më të përhapura dhe më të zakonshme depressive me anë të horizontit dhe zellit të tyre të pamasë, me një lehtësi të

paimagjinueshme, duke përdorur dhe aktivizuar burimet aktuale të fuqisë për të ardhmen. Disa njerëz të ligjit mendojnë se masat e tyre të ashtëquajtura gjeniale janë supernjerëzore duke i kavdëruar dhe admiruar ato aq shumë. Megjithëatë gjithçka që ato po bëjnë, ashtu si edhe njerëzit e tjerë të suksesshëm, vjen si rezultat i përdorimit të plotë dhe efikas të kapacitetit, talentit dhe mundësive që u ka garantuar atyre Zoti i Plotfuqishëm.

Njerëzit e ndryshimit janë gjithmonë, në çdo veprim dhe sjellje të tyre të zënë dhe të preukopuar me planet dhe projektet e së ardhmes; ata përdorin gjithçka që kanë, çdo rast apo mundësi që u jepet si material për të ndërtuar urën lidhëse që të çon drejt së ardhmes; ata gjithmonë e ndjejnë dhimbjen dhe shqetësimin e mbartjes të së sotmes tek e nesërmja. Zgjidhja e problemeve varet në njëfarë shkalle në kapërcimin e së tashmes dhe shndërrimin e këtij fenmeninë diçka që shtrihet përtej kohës. Prandaj kjo është me pak fjalë aftësia për të parë, parashikuar dhe vlerësuar të sotmen dhe të nesërmen në të njëjtën mënyrë. Ju mund ta quani një objektiv të tillë mendimi i cili përqafon të nesërment nga e sotmja dhe përfshin shpirtin, thelbin dhe përmbajtjen e së ardhmes si “ideal” nëse dëshironi. Një person i cili nuk ka një horizont të tillë nuk është në gjendje të kapërcejë tërësinë e problemeve e as të premtojë ndonjë gjë të vlefshme për të nesërmen. Megjithëse disa njerëz të thjeshtë kanë marrë dimensione të mëdha si këto, kompoziteti, rrethanat dhe madhështia e Faraonëve, Nimrodëve, Çezarëve dhe Napoleonëve, jeta e tyre e zhurmëshme dhe heretike e cila hutoi kaq shumë njerëz, kurrë nuk u bë dhe nuk mundet kurrë të bëhet premtuese për të ardhmen në ndonjë drejtim. Kjo për shak se për këta njerëz ishin të varfërit, të dobëtit, ata të cilët mohonin të vërtetën nën detyrimin e dhunës, ata të cilët gjithmonë duhet të nënshtroheshin dhe të vuanin lidhjet dhe marrëveshjet e të mëdhenjve për interesat dhe përfitimet vetjake të tyre; ata duhet të jetonin si skllevër, pas gëzuar kurrë liri për shkak të egoizmit dhe pavarësisë së këtyre njerëzve.

Në të kundërt, Katër Kalifët e Parë në Rrugë të Drejtë dhe më vonë Ottomanët, prezantuan kaq shumë vepra të tilla të mëdha rrjedhojat e të cilave e kapërcejnë këtë botë dhe arrijnë tek bota tjetër, vepra të cilat në thel janë të afta të garojnë me shekujt; sigurisht vetëm për ata të cilët nuk gënjehen nga eklipset e përkohëshme. Megjithëse ata e jetuan jetën, i plotësuan detyrat

krejtësisht dhe ikën nga kjo botë, do të kujtohen gjithmonë, do të flitet për ta dhe do të gjendet një vend për ta në zemrat tona si njerëz të mirë dhe të admirueshëm. Në çdo cep të vendit tonë, shpirti dhe thelbi i njerëzve të tillë si Alparslan, Melikshah, Osman Gazi, Fatihu dhe shumë të tjerë, u përhap si era e mirë e temjanit dhe shpresat e sihaqiqet e tyre fluturuan drejt shpirtit tonë nga vizioni i tyre.

Çezari e rrënoi idealin e Romës me tekat dhedëshirat e tija; Napoleoni e burgosi dhe e vrau idealin e Francës së madhe me anë të rrjetës së tij të lakmisë dhe ambicies dhe hitleri e konsumoi ëndrrën e Gjermanisë së madhe për shkak të marrëzisë së tij të pashoqe. Nga ana tjetër ideali i cili është i hapur ndaj vazhdimësisë tek njerëzit tanë, heroizmi i të cilit shpreh integritet dhe vazhdimësi, është mbajtur gjithmonë lart dhe mbi çdo kotësi apo vulgaritet, si në fitore ashtu dhe në humbje, ai është konsideruar si i dashur, i shenjtë dhe i çmuar si një flamur për të cilin është dhënë jeta. Nën një flamur të tillë Fatihu eci drejt Konstandinopojës, Sulejmani i Mbretkullueshëm përparoi drejt perëndimit dhe populli ynë gjatë Luftës së Parë botërore dhe gjatë Luftës Kombëtare, edhe njëherë tjetër e ruajti besnikërinë e tij dhe dha jetën në mënyrë që ky flamur të mund të valvitej krenar përgjithmonë. Një ideal në duart e një njeriu ideal, arrin vlerat më të larta dhe kthehet në një bukuri arritjesh dhe fitoresh. Nëse njerëzit të cilët përfaqësojnë një ideal të tillë nuk janë njerëzit e duhur për këtë detyrë, atëherë ky flamur kthehet në një sinjal në të cilin shprehen ankesa të ulëta dhe ambicie të rëndomta. Megjithatë një flamur i tillë sinjalizues është në gjendje të bashkojë fëmijët në rrugë, duke i orientuar ata drejt objektivave të caktuara si të ishin në një lojë, ai nuk është në gjendje të realizojë emocionet dhe aspiratat që shtrihen në thellësitë e shpirtit të popullit tonë. Një njeri i idealeve është para së gjithash një hero i dashurisë, i cili e do Zotin, Krijuesin e Plotfuqishëm me devocion dhe ndjen një interes të madh në lidhje me tërësinë e krijimit nën peshën e krahëve të kësaj dashurie, e cila rrethon gjithçka dhe këdo me mëshirë, i mbush me lidhje shpirtërore me vendin dhe popullin; ai kujdeset për fëmijët si gonxhet e së ardhmes, ai i këshillon të rinjtë të bëhen njerëz të idealeve, duke u dhënë atyre objektiva dhe pikësynime të larta të cilat nderojnë të vjetrën me zemër të plotë dhe me respekt, një njeri i tillë ndërton ura mbi humnera për të lidhur dhe

bashkuar sektorë të ndryshëm të shoqërisë; ai i orienton të gjitha përpjekjet e tij drejt ecjes përpara në mënyrë që çdo gjë të mund të ekzistojë në harmoni. Një person i tillë i idealeve është gjithashtu një njeri i mençur. Kur ai vëzhgon gjithçka nga bota e gjërë e arsyes, mat gjithashtu çdo gjë me njësinë matëse të zemrës vlerësuese, duke testuar vetveten nepërmjet kriterit të vetë-kriticizmit dhe vetëkontrollit, duke e gatuar dhe formuar vetveten në një udhëkryq arsueje dhe duke u përpjekjekur gjithmonë të zotërojë dhe të përfitojë rrezatimin e mendjes dhe dritën e zemrës në porcione të barabarta.

Një person i idealeve është një person i vërtetë i përgjegjësive i shoqërisë në të cilën ai jeton. Për të arritur objektivat e tij më kryesori i të cilëve është sigurisht kërkimii kënaqësisë së Krijuesit, ai sakrifikon çdo gjë me të cilën Zoti e ka bekuar, pa u menduar dy herë; ai nuk ka asnjë frikë apo lidhje me ndonjë gjë që i përket kësaj bote; zemra e tij nuk është e pushtuar nga asgjë tjetër përveç Zotit; ai nuk ka as ambicie për lumturi individuale, e as shqetësim në lidhje me mungesën e lumturisë; ai është një shpëtimtar; një jero i shpirtit; ai nuk e ka problem të digjet në zjarr për sa kohë që idealet dhe vendi i tyre të jenë të stabilizuara, të qëndrueshme dhe të forta.

Një person i idealeve dhe i gradës së lartë, ndjen respekt për vlerat me të cilat ai është i lidhur, ai posedon vetëkontrollin më të thellë në kryerjen e detyrës së tij që ka të bëjë me shprehjen e adhurimit dhe jeton si një hero i dashurisë dhe entuziazmit. Qënia dakord dhe bindja ndaj të vërtetave me ndjeshmërinë më të madhe të mundëshme bën që ai gjithmonë të shprehë preferencën e tij për idealet sublime. Një njeri i tillë është gjithmonë në luftë me thellësitë e zemrës, një luftë e cila kërkon ta bëjë zotërues të vetvetes në çdo kohë; ai është dënuar të jetë skllav i së vërtetës; ai është idiferent dhe i painteresuar në lidhje me pozitat dhe titujt dhe e sheh famën dhe kërkimin e komoditetit dhe lehtësisë si një helm fatal. Kjo është arsyeja përse të tillë njerëz fitojnë gjithmonë kur kanë një mundësi për të fituar dhe i kthejnë rrethanat e pafavorshme në favor të tyre.

Duke ecur në këtë rrugë sëbashku me shpirtrat e lavdishëm, një person i tillë është kaq i nënshtruar me sinjeritet ndaj Vullnetit të Zotit, saqë stuhitë e ambicieve të cilat e godasin atë intensivisht, konsolidojnë ndjenjën e tyre të drejtësisë, mirësisë dhe pozitivitetit; rrëketë e urrejtjes, mërisë dhe

keqdashjes, zëvendësohen nga pranvera e dashurisë dhe mëshirës në shpirtrat e tyre; ata i injorojnë dhe shkelin mbi dhuratat dhe të mirat me të cilat janë lidhur njerëzit e zakonshëm; ata janë kundërshtues të hakmarrjes. Nëse do të mendojmë për të tillë heronj të idealeve në horizontin e tyre të vërtetë, horizont i cili të trondit mendjen, atëherë ne do të jemi në gjendje të protretizojmë persona me vendosmëri pothuajse profetike; tablo të supërnjerëzve hyjnë në ndjenjat tona nga dyer të cilat janë hapur falë këtyre grupimeve dhe imagjinata jonë mbushet me shembuj historikë të heroizmit. Kështu ne jemi të magjepsur nga besnikëria dhe sinqeriteti i Uba ibni Nafiut në shkretëtiratafrikane, jemi të mahnitur nga trimëria dhe guximi i Tarik ibn Zijadit pas kapërcimit të Xhilbraltarit, zhytemi në admirim për Fatihun (Mehmetin II) dhe vendosmërinë e tij, dalldisemi nga Gazi Osman Pasha në Plevne dhe përshëndesim me respekt luanit e Galipoli mbi kokat e të cilëve fluturon si breshër bombat dhe të cilët e përballuarn sulmin e rreptë të armiqve me buzëqeshje në fytyrë.

Ne nuk kemi nevojë për asgjë tjetër përveçse për njerëz ekzeplarë me karakter dhe ideale të larta. Këta shpirtra të ndritur të idealeve të larta do të realizojnë dhe do të rithemelojnë shoqërinë e re duke sjellë si rezultat që kombi ynë të zërë vendin që i takon në vitet e ardhshme. Këta njerëz heroikë, tharmi i ekzistencës së të cilëve është besimi, dashuria, mençuria dhe mprehtësia, nuk janë përkulur dhe lëkundur nga sulmet e panumërta të cilat erdhën nga brenda por edhe nga jashtë për më shumë se dhjetë shekuj me radhë. Këto sulme ndoshta e kanë tkurrur paska kombin tonë dhe e kanë bërë pak më të vogël. Megjithatë nepërmjet fuqisë që do të fitojmë dhe vendosmërisë, ne do të ngrihemi në një nivel në të cilin do të merret parasysh edhe mendimi ynë në të ardhmen si dhe do të gjejmë kohën e përshtatshme për ta çuar deri në fund detyrën që kemi marrë përsipër me anë të një force të jashtëzakonshme shpirtërore.

Është fakt që gjatë shekullit të fundit, dashuria, mençuria, mprehtësia dhe ndjenja e përgjegjësisë janë tkurrur dhe çështje të rëndomta ditore kanë zënë vendin e idealeve të mëdha. Sigurisht, nuk mund të thuhet se ne nuk kemi bërë asgjë në emër të reformave gjatë kësaj periudhe. Megjithatë avancimi dhe gjërat që kemi çuar përpara mbeten asgjë më shumë sesa ca imitime të ulëta

dhe zhurma. Ky imitim i verbër si maskë për që bën të mundur hyrjen pa u vënë re të veseve të tilla si imoraliteti në idetë për kombin dhe si mjet që shpie në shkatërrimin e shpirtit të tij, ka sjellë për pasojë më tepër dëm sesa dobi. Kur vendi ishte i gjakosur për shkak të plagëve të shkaktuara njëra pas tjetrës, problemi i vërtetë i bashkësisë nuk ishte diagnostikuar ende, mënyra e trajtimit dhe kurimit të sëmundjeve të tij nuk ishtë ende e njohur apo e përcaktuar, ndaj mjekimet dhe trajtimet jo të rregullta bënë që masat popullore të paralizohen. Efektet e krizave të kohëve të fundit ndjehen ende sot me flakërimen, shpërthimin dhe plasjen e jashtme të mllefrit të tyre.

Prandaj ashtu si më përpara, nëse nuk do të ballafaqohemi me shkaqet e vërteta të problemeve, nëse nuk do ti përballojmë dhe trajtojmë problemet individuale, familjare dhe shoqërore me aftësi, ndjeshmëri dhe zotësi prej kirurgu, nëse nuk largohemi nga moçali i qelbur i veseve, imoralitetit dhe punëve të pisëta si dhe prej gjërave të tjera kundër të cilave kemi luftuar për tu çliruar gjatë periullave të fundit, do të bëjmë gabime njëri pas tjetrit ndërsa jemi duke kërkuar për korigjim të tyre; krizat tona do të bëhen më të egra dhe të thella, duke bërë që ne të mos mundemi kurrë të dalim nga rrethi vicioz i krizave dhe depresionit.

Nuk ka rëndësi nëse ata të cilët mbajnë frenat e vendit, vijojnë të sillen me kokëfortësinë e tyre të vjetër. Ne kemi besim të thellë dhe absolut në brezat idealë, mendimet, ndjenjat dhe veprat e të cilëve synojnë drejt së ardhmes, të cilët janë të lidhur dhe të devotshëm ndaj vendit, popullit dhe idealit të tyre, të cilët janë të fokusuar ti shërbejnë dhe të kontibudojnë për popullin e madje për gjithë njerëzimin, të cilët janë të gatshëm të lëshohen siç lëshohet shigjeta nga harku për tu shërbyer të gjithëve nepërmjet botëkuptimit dhe ndjenjës së tyre të përgjegjësisë. Ne besojmë se ata do të eliminojnë dhe kapërcejnë të gjitha gjërat negative dhe do të bjënë që zhvillimet më të reja të realizohen. Një ditë, dëshirat dhe ëndrrat e tyre të fuqishme, dashuria dhe padurimi i tyre për tu shërbyer njerëzve, do të depërtojnë në çdo sektor të shoqërisë duke u bërë një farë lulëzon kudo që hidhet. Kjo sjellje, e cila do të çrrënjosë të ashtëquajturat realitete të materializmit dhe dëshirave trupore, me siguri do të endë edhe një herë përllhurën e shpirtit të këtij kombi me anë të botëkuptimit dhe planveprimeve të njerëzve të çmuar të tij.

Determinizmi në histori

Përsosmëria dhe lumturia e brezave të së nesërme do të jetë produkt i shpirtrave të so tëm bujarë dhe njerëzve të veprimit. Do të ishte vetëzhgënjim dhe vetëngushëllim të presim një të nesërme të rregullt dhe të përkryer nga masat e njerëzve të lodhur, të shkurajuar, të degraduar dhe endacake, të cilat sot ia kanë kushtuar jetën e tyre komoditetit dhe letargjisë. E nesërmja do të zhvillohet dhe lulëzojë në mitrën e të sotmes; ajo do të ushqehet dhe marrë jetë nga fryma e sotme duke arritur kështu lulëzimin e vet. Ashtu si ekzistenca jonë e sotme e cila me të mirat dhe të këqijat e saj mbart në vetvete gjurmët e së djeshmes, edhe e nesërmja jonë do të jetë kopie e së sotmes, kopie e cila është zhvilluar përhapur dhe lindur nga individët duke u shndërruar në pjesë të shoqërisë. Jeta jonë kombëtare, me ngjyrat dhe cilësitë e vet të veçanta i ngjan një lumi që buron nga majat e larta të maleve duke i buzëqeshur së shkuarës dhe duke buruar nga jo, duke rrjedhë drejt së ardhme me notat dhe akordet e veta të bukura; duke avancuar drejt së ardhmes ky lumë merr karakteristikat e vendit nëpër të cilin ai rrjedh. Nëse ne vërejmë me kujdes lumin mbi të cilin edhe ne gjithashtu jemi duke lundruar, do të arrijmë të shquajmë paraardhësit tanë, gjurmët e tyre, nxitjen, shqetësimet, idealet dhe produktet e mendjeve dhe muskujve të tyre të cilat janë stampuar në rrymat dhe shtjellat e këtij lumi. Ndaj ne mund të themi se ata përbëjnë burimin tonë të jetës, prandaj edhe ne do të jemi një burim energjie për brezat e ardhshëm me dinamikat tona historike. Nëse mund të arrijmë të marrim pjesën që na takon në këtë trashëgimi, shpirti i kombit do të mbetet gjithmonë i ri dhe do të mbijetojë përjetësisht pavarësisht se bota në të katër anët do të plakët, nëse koha do të ndryshojë dhe nëse brezat do të zënë vendin njëri-tjetrit; ata të cilët vinë të parët, do të ikin dhe të ikurit do të zëvendësohen nga prurje të reja. Prandaj në një klimë të tillë ndrushi dhe transformimi, Ebu Bekri evuloi tek Omer ibn Abdul Aziz, Omeri u transformua në Fatih, shpirti i Aliut u bë ai i Battal Gaziut dhe Luanët e Bedrit e shfaqën vetveten në thellësitë e shpirtit dhe thelbin e Manzikerkit, Kosovës dhe Galipolit, ndaj kjo nënkupton që gjithçka është e drejtuar dhe e orientuar drejt përjetësisë. Unë mendoj se

formula magjike ripërtëritjes dhe e rinisë së përhershme duhet të jetë kjo. Sakrificat nga jeta janë individuale, do të formojnë bazat e ekzistencës dhe vazhdimësisë sonë kombëtare. Përballimi i çdo vështirësie me buzëqeshje në fëtyrë, do të na garantojë jetën e pasosur si në këtë botë ashtu dhe në botën e përtejme. Karakteret heroike të cilët kapërcejnë të gjithë heronjtë e utopive dhe të cilët do të mund të pregatisin të ardhmen për ne dhe për gjithë njerëzimin, janë ato të cilët i përdorin më së miri stadet e jetës, që nga periudha e hershme me ngjyrë trëndafili gjatë së cilët ata arrijnë të formojnë vetveten dhe karakterin e tyre në një botë të plotë dhe shumëngjyrëshe rinore, duke vijuar me periudhën gjatë së cilës pjekuria është mbi gjithçka e pastaj me fuqinë, forcën dhe vullnetin që lind nga aktivizmi, e duke përfunduar pastaj me epriudhat e qeta, dinjitoze dhe vetëpërmbajtëse të moshës së vjetër. Këta heronjë janë njerëz të cilët e ndërmarrin çdo hap të hedhur gjatë këtyre stadeve me kujdes dhe duke u menduar thellë; ata janë njerëz të cilët janë të gatshëm për të sakrifikuar çdo gjë nga jeta e tyre për të tjerët, në çdo kthesë të rrugës së jetës; ata janë njerëzit të cilët e kur janë duke vdekur, vdesim me fëtyrën e drejtuar nga shkallët e larta të hyjnore dhe të cilët janë të mbushur me dashuri për njerëzit për arsye se ata kanë zgjedhur vetë të jenë të tillë. Heronj të tillë të panjohur do të ecin dhe veprojnë gjithmonë në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre të lirë, duke vrapuar përherë në ballë të punëve por asnjëherë për arsye vlerësimi apo përfitimi; ata do të jetojnë gjithmonë nga brezi në brez si përmbledhja më e mirë e memories kombëtare dhe dëshirojnë të takohen me vdekjen në një mënyrë të tillë sa që çdokush të mund të thotë “Sa keq që vdiq.”

Është e pamundur për ne të premtojmë diçka për të ardhmen e botës dhe të mbijetojmë në të nesërmen tonë nëse nuk formojmë njerëz me të tilla karakteristika, nëse nuk u japim atyre mundësinë për të përfaqësuar këto dinamika apo nëse nuk i sistemojmë fazat e ndryshme të jetës së tyre në rrjetën e të tilla dinamikave të shpirtit dhe thelnit të jetës. Nëse ne pranojmë që periudha në të cilën ndodhemi përbën bazën për thelën e artë të epokave që do të vijnë, kjo bazë duhet të vlerësohet dhe përdoret mirë; ne duhet ta përdorim atë me mprehtësi, ndërgjegje, me efikasitet dhe me durim. Kjo ndërtesë duhet të jetë e hapur drejt së ardhmes por njëkohësisht ai duhet të ruajë shpirtin dhe thelbin e tij; faqet e saj duhet të jenë të hapura për interpretim duke bërë që ajo

të fitojë një dimension që do të jetë i aftë të përqafojë të ardhmesn, në mënyrë që e nesërmja jonë të mos zhvillohet e shkëputur prej së sotmes. Nëse një gjë e tillë neglizhohet, është e paevitueshme që rezultati i punës të jetë i varfër. Kjo për arsye se marrja në konsideratë e shpirtit të fesë si dhe parimeve të ligjeve natyrore të cilat qeverisin universin (shariat al-fitrijja), kudo që shkakët neglizohen – sigurisht brënda planifikimit të shkaqeve – është krejtësisht jo korrekte të mendohet që do të dalin në pah rrjedhojat që kanë lidhje me këto shkaqe. Determinizmi (Mu'ajjanijjati), të cilin ne jemi gjithmonë në gjendje ta vërejmë brenda fenomeneve natyrore, vlen edhe për ngjarjet historike duke i kushtëzuar ato deni në njëfarë mase. Ngjarjet dhe personat të cilët kanë bërë historinë, ishin si fara e hedhur në dheun e historisë apo si vezët e mbajtura në inkubatorët e historisë, ndaj ato mund të konsiderohen si burimi i ngrehinës në të cilën e tashmja formohet dhe modelohet. Po kështu shkakët të cilat bien si shi nga pjerrësitë e kodrave të historisë, të cilët përsëri formojnë prespektivën e rastësisë, përbëjnë faktorët të cilët përcaktojnë rrjedhojat përmasat e të cilave duhen rregulluar nepërmjet mençurisë, duhen ngjyrosur me anë të drejtësisë, duhet të shfaqen në stabilitet dhe të marrin formë me anë të integritetit.

A nuk ka ndodhur kështu deri tani? A nuk janë ditët e errëta të jetuara dikur rezultat i punëve të pista dhe veprave të ndyra të periudhave të më përparshme? A nuk ndodhi përmbytja e madhe në vendin ku mëkatarët të cilët i sollën shqetësime profetit Nuh? A nuk ishin erërat e forta që frynë Ahkaf ato të cilat kthyen përmbys si një veprim pastrues tokën që njolloshi njolloshi fisi i Adit (kur'an 46 : 21)? A nuk qe sakrifikimi i Sodomës dhe Gomorrës një taksë që toka i dha qiejve në këmbim të mizorive të kryera atje? A nuk ishin përçarja, injoranca dhe keqinterpretimi i botës nga popujtë Azisë Qëndrore, të cilët të shndërruar si ujqër që prsinin në dyert e njëri-tjetrit, arësyet për të cilat u shkatërruan prej duarve të Genghis Khan dhe Khylagu gjatë historisë antike, por duke vuajtur edhe gjatë kohëve moderne nën thundrën e pamëshirshme të komunizmit, socializmit dhe kapitalizmit? A nuk ishin ankimet rënkimet dhe vajtimet e të shtypurve, që nga lotët e pashpresa të Kartagjenës e deri tek vajtimet e pafajshme dhe tronditëse të kristianëve të hershëm, vajtime të cilat tronditën qiejt arsësyet përse i gjithë pompoziteti i Perandorisë Romake u venit duke e kthyer atë në gur? A nuk ishte ideja se disa prej njerëzve duhet të

shiheshin si “pariah” shkaku për të cilin India u shkel dhe u shtyp prej perandorive ambicioze për një periudhë kaq të gjatë kohore? Edhe në historinë e kohëve të fundit, pothuajse të gjithë ata të cilët luftuan kundër atij shteti të madh otoman dhe kundër popullit të tij të nderuar, një popull i cili konsiderohej si element balance fetare që nga shkretëtirat e afrikës e deri në ballkan e pastaj në disa vende aziatike, paguan shumëfish koston e mizorive dhe luftrave të tyre. A nuk ishte padrejtësia, tirania dhe persekucioni i Leninit, Stalinit, Hitlerit, Musolinit e të tjerëve si këta, njerëz të cilët ishin më të këqinj dhe despotë më të mëdhenj sesa tiranët më të tmerrshëm të historisë, ato që sollën për rrjedhojë që njerëzit të vuajnë aq shumë saqë jo vetëm pikëpamjet e tyre por gjithashtu edhe statujat tu hiqeshin dhe të flakeshin tutje, si qeliza kanceroze dhe ciste nga trupi i njerëzimit?

Pavarësisht gjithë tiranive dhe padrejtësive që përjetuan, muslimanët e parë i mposhtën armiqtë e tyre me armën e këtyre të fundit, me anë të armiqësisë së tyre të brendëshme, duke bërë që drejtësia të cilën ata e ngritën si sistem të bëhet shkas që flamuri i tyre të valëvitet në të gjithë botën. Bedri dhe çlirimi i Mekës përbënin mbizotërimin e drejtësisë dhe ndershmërisë; Uhudi që fitorja e pafajësisë dhe trajtimit të padrejtë. Për sa kohë që shpatat ishin në duart e zemrave të tyre, fitoret pasuan njëra-tjetrën. Gjatë kësaj epoke të bekuar, ajo që dukej si zonë humbjeje, u kthye në arenë zone fitoresh dhe çastesh triumfuese të cilat i bënë jehonë dhe i hapnin rrugë së ardhmes. Në kontrast që nga kopha kur forca dhe pushteti mbaheshin me anë të shpatave dhe që kur gjuha e zemrës u lidh, çdo dominim material dhe rregull i dalë nën petkut e suksesit, solli për pasojë dështime dhe humbje të mëdha në shpirt, duke i kthyer zonat e fitores në arena në të cilat vërehej qartë sëmbimi i ndarjes, hidhërimi i zemrave, dhimbja mendore, vuajtja dhe keaqrdhja.

Deri tani, pavarësisht me çfarë emri titulli apo forme e keqja është ushqyer dhe dhuna ka evoluar në një rreth vicioz të shtypjes, të gjithë ata të cilët kanë mbjellë rebelimin, kanë përvetësuar gjithmonë të keqen. Megjithatë ata të cilat kanë mbjellë farën e së mirës, gjithmonë kanë korrur mirësi dhe bollek. Nganjëherë pasojat e veprave të mira apo të këqija janë vonuar, por megjithatë vjen momenti kur arrin stina e tyre, ndaj edhe në të ardhmen ato me siguri do të shfaqen, lulëzojnë dhe do ti bëjnë tiranët të

rënkojnë nga dhimbja. Ndërsa përsa u përket të shtypurve, ato shndërrohen në një mjet shpëtimi dhe bekimi. Vite dhe nganjëherë edhe breza mund të kalojnë derisa shkaqet të sjellin efektet, por sapo periudha e parapregatitur me gjithë efektet e saj vjen ajo bëhet aq e kapshme saqë kompesimi për të pafajshmit, për padrejtësitë e kryera në kurriz të tyre është padyshim parajsja dhe për të pabindurit dhe tiranët vendi i tyre i vetëm është zjari i ferrit.

Është e mundur të interpretohen të gjitha këto në termat e shkaqeve dhe efekteve në thelbin e historisë; në fakt ashtu siç është e mundur të interpretohet e gjitha kjo në sensin e drejtësisë të ligjeve natyrore që qeverisin universin, ashtu mundet që kjo të pranohet edhe si shak i rëndësishëm në ciklin e historisë. Ekzistojnë ndoshta shumë shkaqe prapa ngjarjeve historike, sepse Zotëruesi i Pushtetit të Pafund i bën shkaqet si mbulesë për veprat e Tij duke bërë që bota jonë të rrethohet prej tyre. Ata janë një bekim misterioz, ashtu si cilësia e vullnetit të lirë, me anë të së cilës Ai ka bekuar njerëzimin, ndaj ato janë aksesorët tanë të nevojshëm materialë të cilët ne i përdorim për të përmbushur përgjegjësitë tona.

Në këtë aspekt, ashtu siç një përpjekje e vogël nganjëherë mund të shndërrohet në hapin e parë të ndonjë veprë mjaft të rëndësishme, ashtu edhe një opinion apo veprim i gabuar mund të sjellë për pasojë rezultate jo të këndëshme. Ne megjithëatë mund të shpresojmë për një të nesërme shumëngjyrëshe dhe të lumtur si dhe bukuri të bekuara për të cilat i gjithë njerëzimi do të interesohet ti zotërojë, duke u nisur nga puna e endësve në miniaturë, të pajisur me idenë e së mirës dhe që burojnë nga ca breza fatlumë të së sotmes.

Filozofija jonë e jetës

Dis jetojnë pa u menduar; disa të tjetë vetëm mendojnë pa mundur ti vënë idetë e tyre në zbatim. Megjithëatë ne kemi një oligim i cili është të jetuarit potësisht dhe me ide dhe duke jetuar të prodhojmë kombinime të freskëta për të zhvilluar më tepër dhe për të bërë të mundur mënyra të reja të ndërtimit të ideve. Ata të cilët jetojnë pa u menduar, shndërrohen në objekte të filozofisë së të tjerëve. Përsona të tillë gjithmonë rendin nga dega në degë, duke

ndryshuar vazhdimisht modelin dhe formën, duke u përpjekur ethshëm dhe duke ia kushtuar gjithë jetën gjërave të kota, të larguar nga çdo mendim dhe ndjenjë, me një parregullsi të madhe dhe me një metamorfozë të dukshme pamjeje dhe karakteri, pa qënë asnjëherë në gjendje të jem vetvetja. Megjithëse herë pas here ata ndajnë arritjet e shoqërisë dhe përfitojnë aty-këtu nga puhitë e rastësishme të ngjarjeve korresponduese, edhe nëse këto puhimund të kenë ndonjë efekt në mendjen, ndërgjegjen apo vullnetin e tyre, ata kurrë nuk e lehtësojnë apo çlirojnë shpirtin me dëshirën e tyre, duke mos mundur të zgjedhin lirisht meritat dhe virtytet, dhe duke mos mundur të orientohen drejt pafundësisë. Këta njerëz i ngjajnë përherë një moçali me ujë të ndenjtur, të papastër, të ndotur dhe të mbushur me erë të keqe. Larg nga të qëniet të aftë të shprehin ndonjë gjë sadopak të vlefshme, është e paevitueshme që njerëz të tillë ti ngjajnë një grumbulli virusesh kërcënuese për jetën apo një vatre mikrobesh.

Këta njerëz janë aq të cekët në mendimet e tyre dhe aq sipërfaqësorë në pikëpamje, saqë imitojnë gjithçka që shohin apo dëgjojnë, tamam si fëmijë duke e lënë veten të udhëhiqen nga masa e cila i shtyn ata majtas e djathtas pa gjetur kurrë mundësinë për tu dëgjuar apo për tu vlerësuar për ndonjë cilësi të tyre; në fakt ata nuk e kuptojnë kurrë se posedojnë vlera që u përkasin vetëm atyre. Ata e jetojnë jetën sikur të ishin skllevër të cilët nuk pranojnë kurrë të çlirohen nga ndjenjat dhe dëshirat e tyre trupore; ata e vlerësojnë çdo mundësi dhe çdo dëshirë që kanë brenda kufijve të ngushtë të dëshirave trupore; ata e kthejnë zemrën, vullnetin, ndjenjat dhe ndërgjegjen të cilat i janë dhënë si dhuratë qenieve njerëzore nga Zoti, në mjete të pavlera kënaqësish fizike, duke bërë që njerëzit ta kalojnë jetën e tyre në bohemianizëm. Pasioni i këtyre njerëzve për pozitë, tituj, gradë të lartë, interes, famë, përfitim, luks dhe komoditet, përbëjnë faktorët më të dukshëm që përcaktojnë të gjitha veprat. Dëshirat dhe aktivitetet e tyre. Me apo pa ndërgjegje, ata e gjejnë vetveten të kapur në një apo më tepër rrjeta të tilla fatale çdo ditë dhe dëmtojnë shpirtin vazhdimisht në vorbullat më të tmerrshme të vdekjes.

Njerëz të tillë të cilët nuk kanë as të shkuar e as të ardhme, thonë si Omar Kajami: “E shkuara dhe e ardhmja janë të gjitha një përrallë/ Përpiku ta gëzosh e jo ta shkatërrosh jetën tënde” duke ndjekur instiktet e tyre shtazore. Ata e

konsiderojnë botë si një livadh, një vend për të kollotur, në të cilin të jetojnë të zhveshur nga ndjenjat dhe cilësitë e tyre njerëzore. Në fakt ata vazhdimisht sillen rreth një vorbule dekadence.

Nga ana tjetër ekzistojnë ata që e jetojnë jetën plotësisht, me tërë dimensionet e saj dhe të cilët sipas nivelit të tyre e kthejnë çdo orë apo ditë të jetës në një trampolim për ide dhe mendime të freskëta; ata e kalojnë jetën të orientuar drejt së jashtëzakonshmes, surprizave dhe bukurisë së të qenit gjithmonë përtej kohës; ata e pinë të shkuarën si një esencë e bekuar pranverore, marrin frymë në të dhe i mbushin mushkëritë me aromën e saj mundërmuese, duke e studjuar si të ishte një libër ndriçues si dhe ecin drejt së ardhmes po kaq të pajisur me këto cilësi; ata e përqafojnë të shkuarën me gjithë ngrohtësinë e zemrave të tyre; e ngjyrosin atë me shpresa dhe e modelojnë atë me zellin dhe vullnetin e tyre. Përsa i përket të tashmes, ata e pranojnë atë si qëndrën e strategjive zhvilluese, si punishte të prodhimit të teknologjive të nevojshme, si urë kalimi nga teoria në praktikë, në mënyrë që të realizojnë idetë e tyre dhe për rrjedhojë të qëndrojnë gjithmonë përtej kohës dhe vendit.

Kur e vlerësojnë krijimin dhe kohën nga ky kënvështim dhe u largohen kufinjëve të ngushtë të jetës trupore dhe materiale, ata ecin përpara drejt gjërësive të botës së ideve, dhe enden nëpër rrëpira, të hapur drejt së pafundes, drejt një bote tjetër që ka përmasat e përjetësisë brënda kësaj bote të fundme dhe kalimtare. Në këtë mënyrë ata synojnë drejt pafundësisë me mendimet, emocionet dhe aspiratat e tyre; ata vlerësojnë pasurinë e të qenit njeri nëpërmjet gjërësisë hyjnore, duke gërmuarn në thellësitë e zemrave të tyre; nëpërmjet rrjetave që ata kanë vendosur në zemra, përpiqen të kapin surprizat të cilat asnjë sy nuk i ka parë ndonjëherë, asnjë vesh nuk i ka dëgjuar ndonjëherë dhe të cilat imagjinata njerëzore nuk mund ti perceptojë apo shprehë. Ata e bëjnë gjithë këtë në një mënyrë sipas së cilës njohuritë, dija shpirtërore dhe vlerat e tyre të cilat janë të pamatshme, gjithmonë u tregojnë dhe u flasin për mbretëritë e çmuara hyjnore, madje edhe ato më të lartat, duke u premtuar që secili prej tyre do të shndërrohet në një pëllumb qiellor. Ju mund ti quani këta njerëz, të cilët mendojnë dhe jetojnë në këtë mënyrë dhe të cilët e kanë kthyer jetën e tyre në një lulishte ku janë mbjellë pemë të bollshme të mendimit, njerëz të dijes apo heronj të filozofisë së orientuar nga feja. Nuk ka

rëndësi si i përkufizoni ata, është fakt që qysh nga kohët e lashta njerëzit e ndritur të cilët kanë endur historinë si një dantellë delikate dhe elegante, gjithmonë kanë dalë nga rradhët e këtyre shpirtrave të ndritur. Brahmanizmi, budizmi, konfucizmi, taoizmi dhe zoroatranizmi të cilat ngjajnë më shumë me sisteme filozofike sesa me fe, përbëjnë secila një dhuratë që i është dhënë njerëzimit nga të tillë heronj të spiritualitetit. Në murmurimën e rrëkeve të gjata të mendimeve të së shkuarës, ju mund të dëgjoni kompozimet e zëshme të këtyre ndërtesave të mendimit. Në të katër cepat e botës si në botën e lashtë ashtu dhe në atë të re këndvështrime dhe stile të ndryshme të të jetuarit, ashtu edhe pasuri kulturore dhe koleksione universale qytetërimi, janë përjetuar vazhdimisht dhe kanë qënë produkt i të korrave reflektive dhe meditative të të tillë njerëzve heroikë. Pavarësisht shumë ndryshimeve dhe devijimeve si dhe pavarësisht faktit që njerëzit janë larguar nga thelbi i tyre, ne mund të themi pa frikë se pjesa dërrmuese e njerëzve në botë, vuan dhe këkon akoma ti rikthehet këtij shpirti, thelbi dhe përmbajtjeje të vjetër, megjithëse kjo është në kontradiktë me mënyrën sesi jetojnë ata sot. Derisa njerëzit të marrin si pikë referimi përfaqësuesit e pastër dhe heroikë, thelbin e tyre të pastër, ne natyrisht do të vazhdojmë të kemi një opinion të tillë poziti për të tjerët.

Kur përpiqemi të rinovojmë vetveten dhe njëkohësisht të mbetemi ngushtë me rrënjët tona shpirtërore, ajo që bie mbi ne si detyrë sot është të pregatisim heronj të cilët të dinë të nxisin vetveten nga thellësia e shpirtit të tyre, pra njerëz të cilët të mund të riinterpretojnë dhe ti japin zë sot muzikës së të djeshmes sonë, pa u ngatërruar dhe pa u kapur mbas gjithçkaje; njerëz të cilët të mund të na bëjnë ne të ndjejmë entuziazmin në zemrat tona në një përpmasë të ndryshme çdoherë. Në fakt derisa ne ti pregatisim ata, është e qartë që do të vazhdojmë të shkatrohemi nga duart e dilentantëve të çuditshëm të cilët nuk dinë se çfarë të bëjnë dhe si të jetojnë. Gjatë kësaj periudhe, tërë njerëzimi do të përpiqet të mbushë vendin e vlerave universale dhe të përjetshme, vend të cilin ua kërkon ndërgjegjia e tyre, por që fatkeqësisht nuk do ta gjejnë brënda mendjeve të tyre apo brenda përrallave, anekdotave, legjendave dhe miteve të tyre të lashta; prandaj ata do të vazhdojnë të ecin vazhdimisht drejt pakënaqësive, nga pakënaqësitë drejt krizave dhe nga krizat drejt shkatërrimit.

Fakti që ne nuk kishim një sistem mendimi apo filozofije të jetës e cila do të ndërtonte rrënjët shpirtërore të kulturës sonë kombëtare dhe e cila do të ishte e bazuar në dinamikën islame, ka qënë shkau që ne kemi përjetuar mjerime dhe fatkeqësi të mëdha; ne nuk kemi qënë të vetëm në këtë aspekt sepse një pjesë e madhe e botës që ishte e lidhur me ne ka vuajtur në të njëjtën mënyrë. Është e nevojshme të dallojmë sistemin tonë të mendimit dhe filozofinë tonë të jetës nga ai që quhet sistemi i mençurisë i Al-Kindit, Al-Farabi (Al-Pharabius), ibn Rushd (Averroes), dhe në një kuptim ai i Ibn Sina (Avicenna). Këta ishin mendimtarë të cilët gjithashtu ishin përkthyesit e sistemit të filozofisë greke, e cila është e zhytur në mendimet dhe konceptet e Aristotelit, ndërsa rrënjët e sistemit tonë të mendimit shtrihen në Qiell, i cili është aq i vjetër sa e kaluara e përhershme (azal) dhe më i ri sesa e reja dhe i cili është i aftë të përqafojë çdo moshë. Sistemi ynë i mendimit buron dhe bazohet në Shenjtërinë (lahut), në Fuqinë dhe Madhësinë Hyjnore (xhabarut), në mbizotërimin suprem të Zotit (malakut) dhe në natyrën njerëzore (nasut); origjina e tij është e përcaktuar dhe e njohur, ajo është e shëndritshme dhe e bazuar dhe e lidhur me të vërtetat e krijimit. Nëse një interpretim i tillë përfshihet brenda kuptimit të shpirtit dhe thelbit të tij, do të jetë e mundur edhe në ditët e sotme të zhvillojmë dhe të realizojmë sistemin tonë vetjak të mendimit, i cili për rrjedhojë do të na shpjerë drejt rilindjeve serioze dhe mbarëbotërore, duke na hapur mjaft shtigje dhe rrugë të pasura për të gjithë ne.

Që nga mesi i shekullit të pesëmbëdhjetë, ka pasur mjaft përpjekje drejt zhvillimit të këtij sistemi ideal të mendimit. Megjithatë ato nuk kanë qënë kurrë në gjendje të arrijnë tek objektivat e dëshiruara. Megjithëse ky vëzhgim është i hapur drejt interpretimeve në aspekte të caktuara, në përgjithësi është i vërtetë. Që nga Hoxhazade tek Zeireku, që nga Mustafa Reshit Pasha tek arkitektët e Monarkisë Kushtetuese³², që nga këta deri tek punëtorët më të vonshëm të mendimit, shumica, qofshin të sigurtë apo jo janë përpjekur të gjejnë përgjigjet e këtyre përpjekjeve dhe aspiratave në ndërgjegjen kolektive. Megjithatë, disa ngecën në tahafutet³³ e Ibn Ruzhdiut dhe Imam Gazaliut, disa të tjerë u zhytën dhe u venitën në vorbullat e Revolucionit Francës dhe Auguste Conte, e mjaft të tjerë u morën me delirin dhe opsionin e

Durkhejmit. Këta njerëz ishin gjithmonë aktivë, po nuk e morën kurrë në konsideratë epokën në të cilët jetonin duke shkuar ose përtej fantazisë apo vlerave të kombit tonë që i kishin rrënjët njëmijëvjeçare, duke i çoroditur ato nepërmjet trajtimit të tekave dhe fantazive të tyre si të ishin zotër. Unë do të dëshiroja që ne ti kishim kapërcyer këto mërzi dhe negativizma tani. Sa do të dëshiroja që ne të mund ti kapërcenim këto kontredikta dhe të zhvillonim një sistem mendimi dhe një filozofi komëtare të ushqyer nga burimet tona të brendëshme.

Le ta shprehim këtë më saktë; për shak se këndvështrimet e ndjenjave, perceptimit dhe interpretimit të fenomeneve natyrore janë të ndryshme, atëherë nësxe nuk do të kemi një themel të fortë mendimi apo një sistem filozofik mbi të cilin të mund të ndërtojmë gjithçka, pikëpamjet tona do të jenë gjithmonë kontradiktore dhe ne do ta zhysim veten në një rrjet kundërshtie dhe konfliktesh. E nesërmja ashtu si edhe e sotmja mund të bëhen tonat vetëm me anë të këtij sistemi dhe këtyre metodave të fuqishme dhe me anë të një stili të përbashkët të cilin do ta përvetësojnë vullnetarisht të gjithë brezat. Nëse ne nuk kemi një unitet të tillë në mendime, ndjenja dhe mënyrë jetese, nuk do të mbetet asgjë tjetër përveç dëshirës së madhe për të folur në lidhje me bashkimin dhe solidaritetin kombëtar, si sot ashtu edhe nesër. Kjo për arsye se në çdo sistem, logjika kombëtare, mendimi, arsyetimi dhe frymëzimi shpirtëror (varidati) janë shumë të rëndësishme. Bashkimi i ndjenjave, logjikës, arsyes si dhe dëshirës për të jetuar sëbashku si një komb i vetëm do të realizohet në atë nivel që sistemi i mendimit që buron nga ndërgjegjia jonë kombëtare, nga mendja dhe bota jonë e emocioneve të jetë e zhvilluar. Nga an tjetër kur ndjenjat ombëtare, mendimet, interpretimet dhe stilet përplasen më njëri-tjetrin si dhe kur arsyeja dhe racionalitetit janë në kontradiktë me njëri tjetrin, veprat dhe aktivitetet nuk do të sjellin fryte, edhe në qoftë se në to do të marrin pjesë një numër i madh njerëzish. Në këto raste është më e mundëshme të përjetohet një shkatërrim i plotë. Në një shoqëri ku përjetohen të tilla konflikte apo përplasje botëkuptimesh dhe interpretimesh, çdo përpjekje do të vazhdojë të dështojë dhe të përplasat me të tjerat, ashtu si valët e detit, duke e humbur fuqinë e tyre në pellgun e palëvizshmërisë, duke bërë që gjithçka të mbetet brenda një rrethi vicioz. Ekzistojnë ca mençuri të

dukshme dhe të padukshme në përplasjen e valëve të detit; ata e shuajnë dhe e fashitin njëra-tjetrën. Megjithëatë kur flitet për shoqërinë, në një rast të tillë mund të bëhet fjalë vetëm për qëndrim në vend, kalbëzim, dizintegrim dhe veteleminim nëse përjetohen përplasje të kësaj natyre. Në një shoqëri të tillë të gjithë u ngjajnë ujërve të cilët planifikojnë të shqyejnë të tjerët dhe çdo ide i ngjan projektimit të vdekjes; edhe nëse bekime hujnore do të binin vazhdimisht si shi mbi kokat e njerëzve të kësaj shoqërie, ajo do të ngjante rrobave që brehen vazhdimisht nga tenja; edhe vlerat historike do të ishin subjekt i sulmeve dhe do të breheshin; gjërat e shenjta në këto raste vihen përballë rrezikut të shkatërrimit; njerëzit e kësaj shoqërie nuk kanë nderim për të vjetrit, e as nuk respektojnë më të rinjtë; këta të rinj nga të cilët ne presim të bëhen heronj, të shndërrohen në fuqinë dianmike që do mbartë standartet e së ardhmes së ndritur në supet e veta, në vend që të marrin rolin që u takon, përshtyjnë mbi flamurin dhe mallkojnë historinë e vendit të tyre, duke e konsideruar të ardhmen si arenën në të cilën ata do të kryejnë të gjitha veprat e tyre të ndryra dhe të pamëshirshme. Të vjetrit dhe inteligjencia të cilët me mendjelehtësi ngrejnë duart lart, veprojnë tama si avokatët e kësaj dekadence; në fjalimet, shkrimet dhe programet televizive, ata nxisin bohemianizmin në shpirt dhe rrënojnë botëkuptimin dhe ndërgjegjen e njerëzve si të kishin hedhur acid mbi to.

Gjatë një periudhe të tillë, shtyllat e shkencës dhe dijes nuk janë në gjendje të evokojnë dashurinë dhe idetë për dijen. Ata të cilët përfaqësojnë pushtetin dhe autoritetin, shndërrohen në pengje të ideologjive të veçanta, duke gllabëruar njëri-tjetrin; logjika, arësyeja dhe frymëzimi janë të dënuar të ecin në korridoret e ngushta të ideve dhe shprehjeve enigmatike. Në një shoqëri në të cilën përhapet një pezmatim dhe kontradiksion i tillë, kotësia, ambiciet dhe zbrazëtia zëvendësojnë gjithçka dhe jeta bëhet një torturë e vërtetë.

Megjithëatë, sistemi ynë i mendimit apo filozofia jonë e jetës, janë të lidhura jo vetëm me botën e ekzistencës por gjithashtu edhe me mbretërinë e paraekzistencës dhe gjithçka që shtrihet përtej kësaj ekzistence. Ai gjithashtu takohet me të gjitha fenomenet natyrore dhe gjërat që dështohen pas tyre si tërësi; ai është mjaftueshëm i gjërë për të përkufizuar mënyrën e gjithë jetës

sonë në vahdimësi. Me anë të një sistemi të tillë, shoqëria, edhe në qelizat e saj më të vogla, individët, është në gjendje të realizojë drejtësinë universale të shumëpritur në tokë dhe tu përgjigjet të gjitha shpresave të njerëzimit nëpërmjet stimulimit të individëve për të vepruar sipas moralit të pastër; në këtë mënyrë, shoqëria ushqehet me shpirt, moral, virtyt dhe me synim, duke arritur kështu stadin e rinovimit nga brenda përbrenda vetvetes. Kështu kuptimi ynë për qytetërimin dhe apsuritë kulturore shndërrohet në një të mirë të dëshiruar, të shumëpritur dhe të endërruar mbi gjithçka tjetër në botë; për rrjedhojë ne jemi të aftë të shtrijmë duart tona për të ndihmuar pjesën tjetër të botës, duke ua paraqitur atyre lehtësisht idealet tona në lidhje me njerëzimin, filozofinë tonë të moralit, kuptimin tonë të virtytit dhe idetë tona dhe interpretimin tonë në lidhje me drejtësinë. Madje për shkak të arritjes të një niveli dhe pozite kaq të lartë, si burimet e pushtetit të një shteti, ashtu edhe dinamikat administrative, si dhe parimet shoqërore dhe ekonomike. Do të lulëzojnë duke bërë që nga shpirti i njerëzve tanë dhe njëkohësisht edhe i shoqërisë, të arrihet të gjehet shpëtim prej çdo lloj “varësie.” Varësia e heshtur të cilën ne e kemi mbartur mbi supe si një zinxhir rreth qafës për shkak të dobësisë dhe borxheve tona ka sjellë për pasojë paralizimin dhe qëndrimin në vend të sistemit tonë politik, ekonomik, gjyqësor si dhe administrativ. Në të shkuarën, brezat tonë të artë të cilët dikur kishin ndërtuar Anadollin, një prej vendeve më të përparuar dhe të qytetëruar të botës ndërtuan dhe vendosën administratën e tyre, sistemet politike dhe gjyqësore të zhveshura nga përfitimet materiale, nëpërmjet forcës që buronte nga shpirti i tyre. Ata nuk lejuan që ndonjë, mendim, sistem apo botëkuptim të hynte në institucionet e popullit, të cilat i ruanin si shtëpitë e tyre, si nderi i familjes dhe emri i mirë, pa e kontrolluar më parë dhe pa e kaluar në sitën e kriterëve dhe përmasave të tyre. Madje ata këto vlera nuk i mbajtën vetëm për vete por edhe pasi kishin luftuar me pothuajse gjithë botën dhe kishin përjetuar një disfatë të përkohëshme, pasi ishin tronditur dhe plagosur, ata me shpresë, besim, zell dhe dëshirë të jashtëzakonëshme, u përpoqën të ruajnë origjinin e tyre, duke u mbledhur rreth ndërgjegjes së historisë dhe duke u lidhur ngushtë me dinamikat e ekzistencës së tyre, duke i eksportuar edhe jashtë këto vlera. Ata, siç thuhet në një hadith, “I mbajtën këto vlera të shtrënguara mes dhëmëve dhe

qiellzës së tyre.” Kokat e tyre nuk u ulën por u mbajtën lart; botëkuptimi, pranimi dhe interpretimi i kësaj bote dhe botës së përtejme, mbeten të shëndodha dhe të paprekura dhe përparimi i tyre drejt një rilindjeje të freskët vazhdoi pa u ndalur pa asnjë çast.

Sot kur agimet pasojnë njëri-tjetrin, nga këndvështrimi i horizontit tonë të dijes, nëse ne do të jemi të aftë të vlerësojmë dhe të gjykojmë në mënyrë të shëndetshme dhe të përfitojmë edhe njëherë nga bota në të cilën jetojmë, nëse do të jemi të aftë ti interpretojmë mirë gjërat dhe ngjarjet, nëse do të jemi të aftë të përcaktojmë materialet bazë të strukturës së brendëshme të popullit tonë si dhe nëse do të jemi të aftë të lidhemi me idealet tona të cilat do të ekzistojnë përjetësisht, atëherë do të jemi gjithmonë si paraardhësit tanë të lavdishëm, madje ndoshta do të mund të përparojmë më tepër se ata. Në fakt përse nuk u dashka që këta breza të çmuar të mos jenë në ballë dhe përpapra brezave të kaluar e madje të të gjithë brezave? Ata do të marrin të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmes dhe do ti vendosin ata në perspektivë të gjitha në të njëjtën kohë, duke i vlerësuar dhe duke marrë më të mirën e tyre; ata do të marrin traditat, kulturat dhe dinamikat historike të shoqërisë në të cilat jetojnë nën mbojtjen e tyre; ata do të interpretojnë siç duhet ciklin e rivlerësimit të historisë në drejtim të ripërtëritjes së tyre vetjake.

Është e rëndësishme të theksohet edhe njëherë se përgjegjësia e parë që bie mbi ne është ndjesia e efekteve të dhimbjes, vuajtjes, vështirësisë, besimit dhe kulturës të ndjehet në ndërgjegjet e brezave, duke i rrënjosur ato në përpjestim të drejtë me peshën e tyre. Kjo do të bëhet e mundur nepërmjet zhvillimit tek njerëzit të ndërgjegjes historike. Nëse ne arrijmë ta bëjmë këtë, pas disa brezash askush që do të jetojë në tokën tonë nuk do të hedhë sytë dhe nuk do të kërkojë për të gjetur ndonjë burim të jashtëm për të vënë në lëvizje institucionet e ndryshme por do të majftohet me dinamikat tona shpirtërore.

Nesër ne do të sjellim të gjitha elementet e jetës sonë nga e kaluara. Nëse do të jemi në gjendje ti ndriçojmë ato me dritën e fesë sonë dhe me rrezet e shkencës dhe dijes në udhëkryqin e kulturës sonë atëherë do të kemi arritur të pregatisim zamin tonë që na ngjit me përjetësinë.

Brezat e shpresës, të cilët për sa i përket të sotmes përbëjnë përfaqësuesit e shkecës, dijes, moralit dhe artit, janë gjithashtu arkitektët e shpirtit të njerëzve të cilët do të na pasojnë. Ata do të mbushin nevojat e zemrës me frymëzimin e pastër nga zemrat e tyre, frymëzim i cili buron dhe ushqehet në nivele të larta, duke bërë të mundur ardhjen e formacioneve të reja në çdo sektor të shoqërisë. Mbrapshtia dhe humbja, ndotja, obsesionet si dhe deliri i brezave që jetuan me të shkuarën tonë të afërt, erdhën në njëfarë mase për shkak se ata nuk ishin takuar me një brez të tillë shprese.

Brenda shekujve të fundit të historisë sonë, ne kemi përjetuar dështim pas dështimi edhe në vendet ku ne duhet të kishim sukses dhe kemi humbur më së shumti në zonat ku duhet të kishim fituar dhe të kishim dalë triumfues. Në të periudhë, ne trajtonim njëri-tjetrin si ujqërit, duke lënë pas një trashëgimi zilie, urrejtjeje, lakmie dhe ambiciesh politike për brezat që erdhën më vonë; ata të cilët ishin në politikë dhe mbështetësit e tyre, e konsideronin çdo mjet apo veprim si të ligjshëm dhe të lejuar në rast se ai do të sillte përfitime për vete apo për formacionin e tij politik; këta njerëz shpikën dhe u bënë pjesë e intrigave komplekse duke ulur reputacionin e tyre saqë kur një grup dominant binte dhe në pushtet hipte një parti tjetër, ata ndryshonin çdo gjë, çdo qëndrim, duke e motivuar këtë me shpëtimin e kombit. As ata që ishin në pushtet e as ata që ishin në opozitë, nuk e kuptuan kurrë se objektivat e tyre shpirtërore ishte e mundur të arriheshin vetëm nëpërmjet një performace veprimesh revolucionare, të udhëhequra nga idetë, dijet, besimi, norali dhe virtyti. Kjo është arsyeja përse ne e vërejtëm “ndryshimin” dhe “transforimimin” e shumëpritur vetëm në trajtën formale, të jashtme, boshe dhe të pakuptimtë dhe në atë çfarë mund të kishte qënë një reformim dhe restaurim gjigand historik, ata u morën vetëm me lustrën, ngjyrat, pikturimin dhe kozmetikën e rëndomtë të këtij procesi. Për më tepër disa, të larguar nga vlerat tona të vërteta kombëtare, na shitën idealin e patriotizmit të Djallit, në këmbim të gjërave të parëndësishme, pikërisht si Fausti naiv; në përputhje me kërkesat dhe kushtet e kohës si dhe disa interesa dhe përfitime kalimtare, ata ia kushtuan vetveten marrësisë së ndërtimit të një lloj kombi në një ditë dhe një tjetri në një ditë tjetër duke mos qënë të tillë në fakt por vetëm duke i shfaqur

kështu. Ata ose u frymëziarn nga turanizmi, ose murmuritën në lidhje me popillin fshatar apo flisnin rreht aristokracisë si një klasë me pretendime; ata përpiqeshin të deklaronin se do të zbatonin demokracinë, e nga ana tjetër i shkelnin syrin komunizmit, duke mos e shpëtuar vetveten kurrë nga bredhja e vazhdueshme nga njëra ideologji në tjetrën. Veçanërisht me oreksin e përzier të inteligjencës sonë, një oreks që nuk mund të ketë shkallë krahasimi, këta njerëz, njëherë bëheshin tifozë fanatikë të Francës, pastaj pëlqenin dhe admironin Anglinë, më vonë u lindte pasioni për Gjermaninë e më vonë ndienin dashuri e zell për Amerikën apo për ndonjë vend tjetër të ngjashëm, duke bërë që këto vende të udhëhiqnin mënyrën tonë të interpretimit të jetës dhe të shiheshin si portet nga të cilët ne duhet të lundronim drejt së ardhmes.

Në kontrast me këtë fakt, sensi i fesë dhe kombit i cili përbën idealin e përnashkët të kombit tonë, duhet të bazohet mbi një themel. Themeli duhet të jetë mbi të gjitha llojet e fantazive, ai duhet të nxisë të çërtetën e shpirtrave individualë dhe duhet të përbëjë një besim të fuqishëm, ai duhet të ndërtohet nga idetë e bazuara, në moralin e shëndoshë dhe në virtytet të cilat njihen dhe posedohen nga të gjithë shpirtrat. Ai duhet të jetë më i fuqishëm sesa themeli më i fuqishëm i ndërtuar deri tani. Kjo është një lëvizje morale, e cila çto ditë të udhëheqë në të njëjtin drejtim e cila ecën në rrugën e pasurisë shpirtërore dhe kuptimit të realitetit; e cila është e hapur ndaj çdo lloj ndryshimi dhe përpjekjeje të re; ajo duhet të orientohet drejt kërkimit të kënaqësisë së Zotit dhe të jetë krejtësisht e zhveshur ndaj marrjes në konsideratë të interesave dhe përfitimeve; me anë të të cilave ne do ti premtojmë shpëtimin e shumëpritur brezave të ardhshëm. Përndryshe, ndërsa bota jonë intelektuale ecën drejt qorsokakeve, ndërsa zemrat tona kanë një besim i cili akoma nuk e ka arritur gradën e sigurisë (jakin) dhe ndërsa njerëzit janë në konfuzion dhe çrregullim absolut, ndërsa mendjet tona shohin kaq shumë metoda dhe koncepte të ndryshme të cilat përmbajnë një shumëllojshmëri këndvështrimesh në lidhje me qytetërimin, duket e pamundur për ne të pretendojmë për pronësinë e shpirtit dhe thelbit që në fakt përbëjnë pasuritë e vërteta të kombit tonë, në mënyrë që ta marrim atë nën mbrojtje, duke ia kaluar shëndosh e mirë brezave të tjerë si korrierë besikë.

Shumë persona e kanë përjetuar dhe e njohin mjaft mirë të shkuarën tonë të afërt, periudhat kritike gjatë të cilave ne humbëm vlerat që na përkisnin. Ne mendojmë se prodhimi i një stili dhe filozofije të re jete për veten tonë nëpërmjet kombinimit të kaq shumë botëkuptimeve dhe interpretimeve të ndryshme kaq të kundërta nga njëra tjetra dhe i kaq shumë ideve të cilat bien në kontradiktë me njëra tjetrën, do të sjellë rezultat. Për fat të keq ne kemi humbur kaq shumë jetë njerëzish dhe jemi ende duke ngushëlluar vetveten me zhgënjimin dhe me ëndrrat boshe se gjoja jemi duke prodhuar diçka. Meqënëse nuk kemi në gjendje ta bëjmë këtë deri tani, do të jetë e pamundur për ne të ecim tani e tutje në të njëjtën rrugë. Kjo sepse pa përqafuar rrënjët e spiritualitetit dhe kuptimit të jetës sonë, nuk do të jetë e mundur të arrijmë një sintezë të re në ide dhe një stil të freskët në prezantimin e vetvetes. Gjatë kësaj periudhe, larg arritjes së sintezave dhe stileve të reja, ne kemi përjetuar një përshtjellim të vazhdueshëm për shkak të çarjeve në botëkuptimin dhe ndjenjat tona si dhe kemi ndjerë efektet e kontradiktave të thella në shpirtin tonë. Sigurisht të gjitha shanset që patëm nga koha në kohë si dhe forca dhe fuqitë potenciale që kishim, humbën u shuan dhe u zeruan plotësisht. Megjithatë mund të ngjajë në pamje të parë se ne kemi pasur disa arritje gjatë shekujve të fundit, e vërteta është se nuk kemi qënë në gjendje të paraqitemi bindës në vepra të admirueshme për sa i përket besimit tonë, mënyrës sonë të menduarit, moralit, kulturës, artit, ekonomisë apo mënyrës sonë të administrimit. Edhe pse ka pasur disa arritje në këtë periudhë, ato u provuan se nuk janë gjë thjetër përveçse “fantazi” apo gjëra “sipërfaqësore” të cilat nisën të ngushtonin dëshirat e rinisë. Këto arritje nuk shkuan më tej sesa një çift duzinash, dëshirash dhe arritjesh të parëndësishme kur i krahasojmë me nevojat tona të vërteta si interpretimi i epokës, një vlerësim dhe çmim i dijes dhe shkencës, një kuptim i ri i shpirtit të mirëkuptimit dhe aleancës (vifak dhe itifak) si dhe zgjidhja dhe kapërcimi i kërkesave dhe nevojave të cilat na kanë përkulur për një kohë të gjatë. Shpëtimi ynë prej të tilla pikëpamjeve të ngushta dhe ideve të dobëta të cilat skllavërojnë ndjenjat dhe na burgosin shpirtin, mund të realizohet vetëm nëpërmjet heronjëve të kuptimit, vizionit, mprehtësisë si dhe vetëdijes për Zotin, të cilët janë të ndëgjegjshëm për realizimin e aspiratave në të cilën jetojmë, të cilët janë dashurues të së

vërtetës, të cilaët janë të frymëzuar nga etja për dije, mbi të cilët rëndon barrë e rëndë e vështirësive dhe shqetësimeve reale të se sotmes dhe të cilët paraprijnë të nesërmen, veprat e të cilëve janë pasqyrim i botës së tyre të brendëshme, premtimet e të cilëve përbëjnë frymën e shpirtit të tyre, të nerëzve të cilët janë të aftë të shikojnë përtej horizontit, të cilët ndjejnë dhimbjen e situatës aktuale të padëshirueshme dhe shuarjes së të ardhmes së njerëzve, të cilët vuajnë në mënyrë që të ngrejnë brezat në nivele më të larta duke derdhur lot për ta si profeti Job, të cilët ndajnë dhimbjet e sotme dhe të ardhme dhe vuajnë sëbashku me brezat e sotëm si dhe atyre të cilët e vlerësojnë lumturinë dhe kënaqësinë e tyre si punë dhe dhuratë të dhënë nga Zoti duke u bërë edhe më falenderues dhe duke u ngritur shumë shkallë më lart me anë të kësaj mirënjohjeje. Këtë heronj të vetëdijes për Zotin do ta marrin forcën dhe frymëaimin nga jeta jonë dhe nga shekujt e historisë shumëgjyreshë. Ata do të fryjnë brenda nesh shpirtin e të qënurit një komb i vërtetë dhe më i pastër se të pastrit; kështu ata do të entuziazmojnë të rinjtë tanë me anë të nesimit, shpresës dhe idealeve të veprimit dhe do të prodhojnë kanale të reja të rrjedhjes së ujit në çezmat e idealeve tona kombëtare të cilat kanë qenë të ndenjura dhe joaktive, të penguara nga diga fatale e një shuarjeje të gjatë dhe të tmerrshme.

Dhe pastaj ne si një komb i cili do të vrapojë drejt vendit të adhurimit të cilin ne e kemi humbur nga zemrat nepërmjet të tilla kanaleve dhe rrugëve, do të derdhë lot riabshkimi; duke u rikthyer në shtëpitë tona të cilat janë po aq të ngrohta sa qoshet e parajsës; ne do të ndeshemi me pasqyrimet e parajsës të cilat i kemi humbur kophë më përpara; duke zbuluar shkollën tonë të mendimit, shtyllat e të cilit janë kërkimi për të vërtetën dhe dashuria për dijen, ne do të takohemi dhe do të riprezantohemi me krijimin nepërmjet dyerve të kësaj shkolle të cilat janë të hapura ndaj universit; me anë të dashurisë për të gjitha qëniet njerëzore, ne do të mësojmë sesi të ndajmë me ta çdo gjë; duke jetuar përmes shqetësimit për fatin e të tjerëve, ne do të përqafojmë çdokënd në kodrat prej diamanti të zemrave tona; duke vëzhguar dhe studjuar krijimin, ne do të entuziazmohemi nepërmjet ndjenjës së artit dhe në marrëdhëniet tona me njerëzit ne do të mendojmë me një vizion të brendëshëm më të thellë duke derdhur rrëke lotësh dhe duke u dridhur si purteka, duke shprehur kështu vetveten.

Brezat e shpresës II

Për ne, përjetimi i ringjalljes së re mbarëkomëtare varet nga ca dyzina heronjsh të cilët do ti japin jetë trupit tonë dhe do të përbëjnë gjakun që rrjedh në venat tona. Ca dyzina heronjsh të cilët do të kenë arritur dritën e së vërtetës përtej horizontit të dijes, të cilët do të kenë kontrolluar dhe dispilnuar nevojat dhe dëshirat e trupit të tyre, duke i kufizuar ato deri tek nevojat më elementare. Këta heronj do të ndjejnë gjithmonë në ndërgjegje të tyre thirrjen që Zoti u drejton në një harmoni transhendente. Ata do ta komunikojnë gjithmonë mesazhin e Tij, të mbushur me entuziazëm duke folur me fjalë dhe tinguj të shumëllojshme; ata do të marrin frymë nëpërmjet frymës së Tij.

Meqënëse këta heronj ia kanë kushtuar vetveten me një skllavëri vullnetare të vëretës që nga fillimi, ata kurrë nuk do të jenë sherbëtorë apo skevër të dëshirave punëve dhe pazarlleqeve të shoqërisë. Ata janë të ndërgjegjshëm për shërbimin që kryejnë në rrugën e Zotit me përuftësi dhe vazhdimisht veprojnë me kujdes dhe me bindje për të arritur nivelet e përjetësisë në çdo akt të tyre. Ata e orientojnë jetën e tyre nën sjiun e frymëzimit që u vjen nga Zoti. Duke rikthyer dhe rforcuar portat e dhuntive të tjera hyjnore me çdo frëmëzim, ata do ta ndjejnë ndryshimin e tyre me të tjerët sepse posedojnë bekimin e kthimit të secilit prej tyre në mijëra njerëz të barazvlefshëm duke shijuar çdo glënkë të jetës, shijen, kënaqësinë dhe gëzimin e pavdekësisë.

Aventura e jetës së këtyre heronjëve do të rinovohet brenda kornizës së besimit, dijes, ngrohtësisë, dashurirë dhe kënaqësive shpirtërore; horizonti i tyre i të menduarit, do të shkëlqejë mbi hapësirën që ndan të vdekshmen nga e përjetshmja. Kapitali i tyre është dija dhe besimi, bazamenti i tyre është Zotëruesi dhe i Plotfuqishmi dhe shtegu i tyre është rruga e të gjithë sherbëtorëve të ndershëm të së Vërtetës të cilët kanë jetuar më përpara. Ata ecin duke u mbështetur në fuqinë e pamposhtur të fesë dhe përjetojnë ndihmën e Zotit në udhëheqjen që Profeti i bëri njerëzve drejt pavdekësisë, ndaj një periudhë e tillë mohimi, mosbesimi dhe ateizmi do të shuhet dhe zhdukët në skutat e largëta të panatyrshmes.

Ashtu siç njerëzimi nuk ka jetuar asnjëherë pas besim dhe dije në ndonjë periudhë të historisë së tij, ashtu edhe qytetërimet nuk kanë qënë kurrë pa vende adhurimi për Zotin. Megjithëse me anë të errësimit të horizontit me duart e veta, njerëzimi herë pas here ka rënë në kthetrat e mosbesimit dhe injorancës, ai është ngritur me një vendosmëri më kuptimplote, të qëndrueshme, të shpejtë dhe dinjitoze pas çdo rënieje, duke ndjerë shijen e Krijuesit më thellë në ndërgjegjen e vet. Kjo është arsyeja përse qëndrimi dhe jeta në një boshllëk qytetërimi, në lidhje me vendet e adhurimit ndaj Zotit si dhe në lidhje me besimin dhe dijen ndaj vetë njerëzimit, ka përbërë gjithmonë një gjendje të përkohshme e cila do të vazhdojë të jetë e tillë edhe tani e tutje; deri sa të vijë dita e gjykimit dhe shkatërrimi i botës, ideja për vendet e adhurimit dhe Zotin nuk do të çrrënjohet nga zemrat e njerëzimit; qëniet njerëzore nuk do të mund të largohen krejtësisht nga Krijuesi i tyre. Ndërgjegjet janë fundamentalisht të hapura ndaj Zotit, prandaj errësira e përkohëshme e horizontit të tyre e cila përjetohet herë pas here, do ti ngjajë një eklipsi. Drita do të pasojë errësirën dhe errësira do të pasojë dritën; dhe kur të vijë momenti, koha dhe gjithçka tjetër që lidhet me të do të lëshohet në një rrugë dhe orbitë të paracaktuar për të nga urdhëri i parëzistueshëm i Zotit duke bërë që të bëhet realitet përjetësia.

Gjithçka rreth botës së brezave të sotëm është duke kërkuar thelbin e vet, jetën me ndërgjegje dhe parajsën që e ka humbur dikur. Kjo tendencë edhe në këtë shkallë që është, do të jetë e mjaftueshme që njerëzit të gjejnë heroin e tyre dhe të arrijnë rrugën e së Vërtetës. Sapo ndërgjegjet e tyre hyjnë në rrugën e natyrës dhe dispozitës së vërtetë arrijnë të përceptojnë në çdo gjë dhe gjithçka Zotin, gjë që vjen si rezultat i shqisave të tyre të ndendëshme.

Për më tepër, ateizmi i cili i zhvesh gjërat nga shpirti dhe esenca që ata përmbajnë duke i përdorur për të realizuar dëshirat, ambiciet dhe fantazitë e veta, ka nisur të mposhtet për shkak të paqëndrueshmërisë së tij e madje edhe të dizintegrohet. Gjatë kësaj kohe shpirtat të cilët janë duke kërkuar të vërtetën e tyre kanë lëvizur drejt fazës së zbulimit të thelbit të tyre. Sigurisht që në këtë mënyrë njerëzit do të humbasin interesin për gjërat e zakonshme. Ata do ti përjetojnë paaftësitë, dobësitë dhe lodhjen e tyre sio pikë referimi në zemra, duke përceptuar pikën e mbështetjes dhe bazimit (nokta al-istinad) si dhe

pokën e ndihmës dhe përkrahjes (nokta al-istimdad) në thellësitë e ndërgjegjes së tyre. Kështu natyra e tyre do të shfaqet e jashtëzakonëshme, vullneti i tyre do të çlirohet nga ngushtësia e vet ndaj ata do të kthehen tek vullneti dhe urdhërat e Zoti, të Pafundmit, të Përjetshmit.

Në këtë proces, besimi dhe vendosmëria të cilët përbëjnë dinamikën më të mëdha shpirtërore të suksesit do të bëjnë që çdokush të arrijë fuqinë e shpirtit të vet, fuqi e cila i përket sekreteve hyjnore. Kjo fuqi do ti mbushë këta njerëz me entuziazëm, shpresë dhe zell, do të eliminojë çrregullimet dhe paqëndrueshmërinë, do ti ndihmojë ata të kapërcejnë urat të cilat i shpiejnë ata drejt vetvetes duke i bërë kështu të arrijnë tek Zoti.

Rruga më e shurtër, më e shpejtë, më e sigurtë dhe më e suksesshme për qëniet njerëzore që ata të arrijnë tek e vërteta, është rruga e besimit, e cila është e pajisur me dije shkencore dhe shpirtërore. Shpirti gjithmonë ka arritur sukseset e tij më marramendëse dhe fitoret e tij më të mëdha me anë të kësaj rruge. Në një vend ku besimi nuk ushqehet me dije, injoranca zëvendëson të vërtetën dhe ligjin duke bërë që të përjetohet në mënyrë të paevitueshme dhuna dhe forca. Në kushte të tilla, njerëzit u drejtohen armëve, paraja bën ligjin, vetëm njerëzve hileqarë u dëgjohet zëri dhe hipokrizia shndërrohet në cilësinë më të dëshirueshme dhe të ëndërruar. Është e pamundur të arrihet shpirti apo thelbi i Krijimit apo të vëzhgohet çfarë shtrihet pas tij në një atmosferë të tillë.

Nga ana tjetër e vërteta jonë është e lidhur ngushtë me shpirtin e pafundësisë. Për ta ndjerë këtë marrëdhënie dhe për të përceptuar atë çfarë ajo premt, ne si një komb i tërë duhet të sakrifikojmë shumë, nuk është e mundur të flasim rreth një marrëdhënie apo lidhjeje të tillë përderisa të mos sakrifikojmë nga kënaqësitë, lumturia, rehatia, pozita, shkalla dhe titujt individualë e madje edhe nga ndjenjat dhe ambiciet tona për të bërë të mundur përparimin shpirtëror. Në qoftë se kjo lidhje dhe marrëdhënie arrihet, bota e së nesërme, do të jetë një botë e ndritshme në të cilën Zoti konsiderohet si Qenie më e Lartë tek i Cili ne besojmë me vullnet të plotë dhe me respektin e duhur. Në një botë të tillë interesi në lidhje me pushtetin dhe përfitimet personale do të konsiderohen si turp fatkeqësi.

Ne ndjejmë se kemi qënë në rrugën e një bote të tillë të ndritur për vite me radhë. Ne bashkohemi në kërkimin e shenjave dhe simptomave të agimit

të shumëpritur jo nepërmjet studimit të nimrave magjike dhe datave misterioze në lidhje me ngjarjet e ardhëshme por duke vlerësuar gjithçka që shpirti ynë arrin të përqafojë. Duke vepruar kështu, nën udhëheqjen dhe idhëzimin e realitetit hyjnor, ne do të përpiqemi të lidhim vetveten me Vullnetin Hyjnor nepërmjet vullnetit tonë të lirë; ne do të bëhemi si ata njerëz heroikë të cilët sjpenzuan gjithçka që kishin në këto rrugë; ne do të vëmë në përdorim, do të shemzojmë dhe sakrifikojmë pjesë nga jeta dhe pasuria jonë; ne do të vijojmë të ecim në këtë rrugë deri sa të takojmë Vullnetin hHyjnor dhe atë çfarë Ai paraqet dhe premt.

Secili person i cili ka një ndjenjë serioze përgjegjësie individuale, do të thotë: Mua më duhet ta bëj këtë punë. Nëse unë nuk do ta bëj atë tani sido që të mundem, atëherë ndoshta askush nuk do ta bëjë.” Në këtë mënyrë njerëzit do të rendin të parët për të kryer një vepër të caktuar duke mbajtur lart flamurin. Ata do të veprojnë kështu pa ndjenjën e garës, pa xhelozin apo armiqësinë, pa penguar dhe shqetësuar të tjerët por përkundrazi duke garantuar mudnësinë për të tjerët rreth tyre në mënyrë që ata të përparojnë. Gjatë periudhës së errët që kemi përjetuar, disa prej gjërave që ne i bëmë me apo pa vetëdije, kanë sëmëmur zemrat tona dhe kanë shkatërruar shpirtin tanë; shumica dërrmuese e popullit tonë nuk qe në gjendje të shkëputej apo të dilte nga kjo situatë, ndaj ata nuk qenë të aftë të zgjojnë dritën e së vërtetës më esencën e tyre. Ata nuk arritën të fitojnë dinamikën shpirtërore të cilat shprehin gjallësinë dhe të cilat i ngjajnë ujit, ajrit dhe fuqisë vegjetative të domosdoshme për rilindjen dhe ringjalljen tonë. Të paktën në ditët tona në vend që të kërkojmë për diçka tjetër përveç vetes si një lule kacavjerrëse për tu ngjitur në të dhe për tu mbajtur në mënyrë që të mbetemi në këmbë dhe të mbijetojmë, duke nxjerrë në pah gjithë fuqinë tonë potenciale me të gjitha lidhjet dhe marrëdhëniet me të përtejmen dhe Mbretërinë Qiellore, duke u mbështetur në ndihmën e Zotit, ne vazhdojmë të ecim frejt tij. Për të arritur një pikësynim të tillë të cilën ne mund ta vërejmë, dëgjojmë, kapim dhe marrim me vete të gjithë duke e vlerësuar nepërmjet një gjykimi të hapur ndaj frymëzimit, kjo varet në rishikimin dhe rinovimin e kësaj furie dhe lidhjeje potenciale. Shkurt, ju nuk duhet ta kërkonin kurrë shpirtin dhe thelbin që mbart ekzistencën juaj jashtë vetvetes. Përkuleni kokën dhe dëgjoni ndërgjegjen tuaj dhe duke përdorur

esencën, dhe tërësinë tuaj si një gotë magjike, ju do të filloni të udhëtoni në drejtim të ekzistencës duke u nisur nga ky thelb.

Ribashkimi më të vërtetën

Shekulli i njëzetë qe një shekull me probleme të pareshtuara dhe që vazhdojnë të jenë të tilla. Një prej këtyre problemeve është kaq i thellë sa që na bën që ti harrojmë të gjithë të tjerët; ai është kronik dhe rezistent ndaj ndërhyrjeve dhe mjekimeve dhe është aq urgjent sa që nuk mund të neglizhohet. Ky problem serioz është neglizhimi i vlerave tona nga populli ynë, veçanërisht nga rinia. Nëse ai nuk do të zgjidhet plotësisht prej duarve të njerëzve të zotë, pa humbur më asnjë çast, ne do ta gjejmë vetveten të zhytur në shumë fatkeqësi dhe sëmundje të tjera të mëdha dhe do të përjetojmë dështim të plotë, pavarësisht rrethanave kur këto ngjarje do të shfaqen, të favorshme apo të pafavorshme. Ato do të shfaqen në mënyrën më të papritur dhe do të errësojnë fatin tonë.

Tumori i neglizhencës, injorancës, indiferencës, paaftësisë dhe fantazisë së atyre që kërkojnë të futin gjërat e huaja në tërë komunitetin, i shfaqur në formën gjendrave dje, dhe që ka përhapur metastazat e tij brënda një kohe mjaft të shkurtër, duke u përhapur nëprë gjith trupin tinë, ka sjellë për pasojë gjunjëzimin tonë. Kjo ka ndodhur në një shkallë kaq të madhe sa që një “rënie” e qartë është përjetuar në çdo aspekt të shoqërisë, duke bërë që ngjyra e njerëzve tanë të fshihet. Mjerisht, shumë herë ne jemi tronditur nga sëmundje të tilla. Sa shumë herë kemi vuftur fatin e keq të dështimit dhe jemi mudur! Sa shumë herë jemi rrënuar duke parë me sytë tanë fatin tonë të zi dhe vdekjen që vinte sëbashku me të! Sa shumë herë jemi përpjekur të shprehim hidhërimin tonë për këto ngjarje! Sa shumë herë e kemi ndjerë bezdinë e të qenit të paftë për të gjetue fjalët e duhura kundër këtyre ndodhive, duke mos ditur nëse janë fjalë të pështatshme apo të gabuara dhe të gjejmë një përgjigje të saktë në lidhje me këtë çështje! Sa shumë herë e kemi shtypur dha kapërdirë dëshpërimin tonë duke kërkuar strehë tek Zoti ! Disa prej nesh janë tronditur dhe dridhur nga rrymat e ndenjave të tilla vrastare, ndërsa të tjerë kanë vijuar vetem duke i qortuar ata të cilët bnin në këto gabime.

Megjithëatë në vend që ti gjykojmë dhe mallkojmë të tillë njerëz ashtu dhe të tjerët për rrugën që kanë marrë, ne duhet ti kishim përqaftuar ata duke i rrethuar me premtimin e një jete të re dhe të freskët; duke nxitur enduziazmin e tyre nepërmjet respektit; duke gjetur shakqet e arsyeshme dhe justifikime për obsesinoe dhe delirin e tyre, ne duhet të ishim përpjekur njëkohësisht të largonim atmosferën e urrejtjes, dhunës dhe terrorit; duke u dhënë atyre disa të drejta, ne duhet të kishim pregatitur terrenin për të diskutuar me ta rreth çështjeve të përbashkëta dhe reciproke mes nesh. Është fakt që shoqëria jonë është një shoqëri e cila strehon mendime, koncepte dhe filozofi të ndryshme. Prandaj kur ecnim në rrugën tonë, ne viheshim në gjurmët e francezëve duke u ndikuar nga ata, pastaj mbërtheheshim nga sjellejt dhe interpretimet e gjermanëve. Pas ca kohësh u zhytëm dhe u mahnitëm me mënyrën angleze të të menduarit dhe së fundmi është intoksikuar nga filozofia e lirë amerikane. Prandaj ne kemi vendosur përherë barriera në rrugën tonë. Është e vërtetë që të gjitha këto koncepte, interpretime dhe filozofi, kanë ndikuar negativisht në kulturën tonë kombëtare. Gjithashtu është e vërtetë që një ndryshim dhe kolorit i tillë mund të vlerësohet si pasuri. Për mua ajo që është më e rëndësishme është fakti që kombi ynë duhet të ruajë vlerat e tij vetjake dhe duhet të sillet nepër ornitën e vet. Megjithëatë, duke qenë të apaftë të vlerësojmë kaq shumë kultura të ndryshme, çdonjëra prej tyre konsiderohet si sinteza më e fundit e atyre që e mbështesin atë, ne jemi nga tërruar dhe penguar sikur të ecnim në një rrugë të minuar. Ashtu si minatorët pa përvojë të cilët kur gërmojnë për mineral ose gërmojnë tokën dhe shkëmbinjtë duke u lodhur pa arritur të nxjerrin gjë në dritë, ose nuk interesohen për mineralin sepse mendojnë se miniera në të cilën kanë hyrë ka vetëm gurë. Ne kemi parë deri tani shumë burime drite por në vend që të vlerësojmë dhe të përdorim me efikasitet secilin prej tyre për ndiçimin tonë, ne kemi prodhuar vetëm zjarr e flakë nga ato, duke lejuar që zjarri të na djegë në vend që të na ndiçojë.

Është e çuditshme që disa prej nesh pavarësisht dijeve të tyre të pakta, e konsiderojnë veten si njerëz të ndritur; të gjithë atë që mendojnë qoftë edhe fare pak, e konsiderojnë veten si filozofë. Ata të cilët përfaqësojnë pushtetin e trajtojnë arsyen dhe logjikën si të çmueshme por vazhdojnë në rrugën e tyre të të qenit ekzekutues të forcës brutale. Ata në politikë bëjnë militantizëm,

sakrifikojnë gjithçka dhe çdo pikësynim e kanë të orientuar drejt tij sepse sipas tyre nuk mund të ekzistojnë pa të. Veprimtaria jonë social kulturore, politike dhe ekonomike, nuk ka qenë kurrë në gjendje të dalë nga rrethi vicioz i kundërshtimit dhe konfliktit, i zënë mat në rrjetën e xhelozosë, armiqtësisë, konkurrencës dhe intolerancës. Ata të cilët nuk kanë as përkurinë e adoleshentëve, i kanë përdorur këto metoda si mjete për të gaoditur kokat e njëri tjetrit; të rinjtë, në vent që të riparojnë kredon tonë të tronditur dhe krenarinë e cënuar, e kanë përdorur dinamizmin e shpirtit të tyre kundër vendit dhe popullit të vet, duke shkaktuar plasaritje dhe çarje në shpirtin e tij.

Unë mënrzitem për këtë të vërtetë. Pësre të mos e duam njëri-tjetrin kur kemi mundësi ta bajmë një gjë të tillë? Përse nuk vendosim marëdhënie dhe miqësi të qëndrueshme? Përse nuk mund ta ndajmë ankthin, shqetësimin, mërzinë dhe përse të mos kënaqemi me suksesin dhe lumturinë të gjithë sëbashku? Kam frikë se përpjekjet dhe lufta në rrugën e përfitimit të zemrave është më e vështirë për ne sesa lufta dhe përpjekja në fushën e betejës. A është zemra e njerëzimit e mbyllur ndaj dashurisë, tolerancës, pranimi të të tjerëve; a është ajo e turpshme ndaj përqafimit dhe ndarjes së vlerave; a ka ajo tendencë ndaj urrejtjes, keqdashjes, mërisë, intolerancës, kopracisë dhe egoizmit? Unë nuk mund të bësoj se kjo është e vërtetë! Betohe në Zotin i cili krijoi zemrat se çfarë është e pasur dhe e gjërë nuk mund të jetë e mbyllur ndaj virtyeteve por përkundrazi me gjërësi të pamasë.

Pushtuesit më të mëdhenj në botë e nisën punën me pushtimin e zemrave. Satacioni i parë i tyre ishin zemrat e njerëzve dhe duke i përdorur ato si bazë dhe port, ata lundruan drejt pjesëve të tjera të botës. Nëse ata nuk do të kishin hyrë se pari në zemrat e popullit të Anadollit, ata nuk do të kishin fituar në Manzikert luftën ndërmjet shtetit Selxhuk dhe Bizantinëve në vitin 1071, një luftë e cila i hapi portat e Anadollit për muslimanët. Muret e Kostandinopojës nuk do të ishin dorëzuar sulmit, nëse nuk do të kishin ndjerë premtimet e zemrave të ushtarëve të cilat rrihnin me forcë për shkak të sinjeritetit. Rrjeti i dashurisë dhe mëshirës i cili lindi sëpari si ndjenjë dhe interes dhe më vonë mori çdo zemër dhe çdo njeri nën kontrollin e vet, i mirëpriti dhe i toleroi ata të cilët rendën drejt tij me zgjedhjen dhe vullnetin e tyre të lirë, duke i bërë ata të dëgjuar në legjendat e dashurisë dhe ndjenjave.

Kështu tani nëse nuk ka qënë pjesë e historisë sonë, atëherë nga depërtoi tek populli ynë kjo urrejtje, keqdashje, armiqësi dhe intolerancë? Kur ne ndjenim admirimin e thellë për Francën, Gjermaninë, Anglinë dhe së fundmi për Amerikën dhe Japoninë, përse e urrenim dhe e nënçmonim njëri –tjetrin dhe jetonim si ujqërit duke shqyer njëri- tjetrit? Përse ua bënim jetën ferr të tjerëve? A mos kemi ndonjë lloj çrregullimi personalitetit? Dhe ne përgjigjemi “Po, dhe mund të kërkojmë strehë në shpirtat e huaj” duke flakur kështu tutje njëmijë vjet vlera në koshin e mbeturinave, për hir të fantazisë së sëmurë.

Kur ne kemi qënë duke ngritur sistemin e kaosit për veten tonë, shumë breza pa asnjë bazë, mbështetje, synim, objektiv, ideal apo sigusht dije shpirtërore, janë rritur si fëmijë të tekave, ambicieve, trilleve dhe ëndrrave fantastike me sy hapur. Të tillë breza të cilët e kanë humbur çdo konsideratë metafizike, janë të pavetëdijsëm për identitetin e tyre kombëtar dhe vazhdojnë të jetojnë të zhgënjyer në besim saqë ata e kanë gjetur përgjigjen e pyetjes “Kush jam unë,” në filozofitë e dala mode të importuara të cilat ua kanë rrëmbyer të shtatë kontinenteve. Ata kanë luftuar në rrejtën e tërheqjes nga bota materiale, ata kanë jetuar me gjuhë të lidhur dhe pa zemër, duke e ngatërruar herë pas here fenë me përrallat epike dhe legjendat historike; ata e kanë sakrifikuar moralin me futjen e idesë së lejueshmërisë së çdo gjëje, e kanë ndotur konceptin për artin me vesin e lakmisë, e kanë kthyer poezinë dhe muzikën në paturpësi dhe së fundmi e kanë parë vetveten drejt e në mes të një zone vrasjesh në të cilët kontradikta dhe konflikte të panumërta dhe të pamëshirshme kanë sjellë për pasojë luftëra të egra mes tyre. Në fakt, pasojat nuk mund të ishin gjë tjetër përveç këtyre.

Dhe pastaj këta breza sulmuan çdo gjë me zemërim dhe inat; ata denigruan dhe fyen të kaluarën tonë; ata e humbën besimin dhe besnikërinë sëbashku me fenë e tyre dhe ecën drejt humbjes dhe mungesës së ndjenjave ashtu si edhe të mungesës së dashurisë njerëzore. Për më tepër gjatë kësaj periudhe, ata iu dorëzuan duarve të ndërgjegjeve të huaja; rritja shpirtërore dhe edukimi i tyre iu la në dorë të huajve; ata u rritën si fëmijë në infiermeritë e vendeve të tjera duke u bërë më të afërt për ta sesa për ne; ata u bënë viktimat e ideologjive të ndryshme duke u ndeshur për shkak të distancës dhe ftohtësisë ndërmjet tyre, edhe pse në fakt ata ishin mjaft të afërt për ta ndjerë

nxehhtësinë e trupit të njëri tjetrit. Janë këta njerëz, besimi i të cilëve u vu në diskutim për shkak të mijëra dyshimeve dhe pasigurive, besnikëria e të cilëve u trondit nga themelet, shpresa e të cilëve u rrënjos në konfuzion, zemra e të cilëve ishte si shtrati i një lumi të tharë, ndjenjat njerëzore të të cilëve iu nënshtruan urrejtjes, keqëdashjes dhe ariqësisë, zemrat e të cilëve u bënë orbita për kaq shumë hije dyshimi dhe frike. Këta njerëz ishin gjithmonë të çliruar nga ndjenjat e detyrës dhe përgjegjësisë duke bërë që horizonti i tyre të zhytet në errësirë, pa pasur asnjë shpresë për tu ndryshuar. Këta njerëz edhe kur dukeshin në ngritje, në fakt ishin në rënie; ata u shndërruan në njerëz fallco, artificialë dhe të përkohshëm për shkak se thelbi i tyre ishte shkullur dhe e gjithë ajo që kishte mbetur brenda tyre ishte vetëm lëvorja.

Në fajt është mjaft e vështirë ti jepet jetë një kufome të tillë lëvizëse, për arësyr se ajo është larguar krejtësisht nga kjo botë dhe veron kundër të gjitha vlerave të saj. Nga ana tjetër, pavarësisht gjithë kësaj na bie në përsipër përgjegjësia për ta mbështetur dhe ringritur atë. Ne besojmë se kur Vullneti hyjnor do të mbushë trupin tonë me fuqi, kjo kufomë do të ngrihet sikur të kishte dëgjuar borinë e Israfilit³⁴ dhe do talavdërojë edhe njëherë fatin e vet të mirë, përparimin dhe lumturinë. Në fakt nuk do të jetë e lehtë të mbushet zbrazëtia dhe të riparohet dëmi i shkaktuar në trupin e shoqërisë për shkak të neglizhencës së kohëve të fundit. Megjithatë, trashëgimtarët e mendimit në botë të cilët e kanë transformuar kaq shumë herë jo vetëm fatin e tyre të keq, kundërshtinë dhe tragjedinë në sukses, por edhe ata të cilët ishin të shtypur, të keqtrajtuar dhe të përsekutuar do ta kapërcejnë me siguri një fat të tillë të tmerrshëm dhe do të bëjnë të mundur ekzistencën e një parajse paqësore dhe të përparuar për të tjerët ndërsa vazhdojnë të bëjnë jetën e tyre të thjeshtë dhe modeste. Ata natyrisht do të mbushin boshlleqet e shoqërisë me anë të përhapjes së tolerancës dhe mirëkuptimit të tyre; kjo është përgjegjësi vetëm e tyre. Ata do të injorojnë gabimet e të tjerëve duke i parë ato nëpërmjet lenteve të gabimeve të veta të cilat ndodhta përbëjnë edhe shkallën e gabimeve të të tjerëve. Pa iu drejtuar forcës, keqtrajtimit, apo pa i bërë të tjerët të vuajnë për shkak të gabimeve të tyre, të tjerë trashëgimtarë do të paraqesin një numër alternativash të cilat do ta ngrejë njeriu mbi këto gabime, alternativa reabilitimi dhe përmirësimi.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se nuk është e mundur të ndryshohet gjithçka brenda natës; ne nuk presim të ndodhë ndonjë mbrekulli. Në një shoqëri vlerat e së cilës kanë qënë për një kohë të gjatë të përbuzura dhe e cila ka qënë mësuar me një gjendje të tillë, sigurisht do të duhet më shumë sesa thjesht një përpjekje e vogël për të zëvendësuar ateizmin me besim, arbitraritetin me disiplinë, kaosin me rregull, imoralitetin me moral, lakminë me dashurinë për Zotin si dhe interesat dhe përfitimet personale me altruizmin. Ne jemi të sigurtë se çrrënjësia e ateizmit, i cili kohë më parë e vendosi vetveten në fronin e fesë, e kësaj sjelljeje kaq të lehtë e cila ka topitur vlerat morale, e kotësisë dhe pafrytshmërisë e cila ka përfituar nga mungesa e disiplinës, nuk është dhe nuk do të jetë kurrë e lehtë. Nuk është e lehtë të zëvendësohen të gjitha këto dhe të vendoset në vend të tyre ajo çfarë Zoti dëshiron dhe çfarë këshillon Profeti. Kjo sepse të gjitha kriteret të cilat bëjnë të mundur shndërrimin e një mase njerëzish në një shoqëri dhe të cilat e shndërrojnë një shoqëri në shoqëri të vërtetë, janë çrrënjësuar për shkak të ideologjive devijuese, mendimeve nihiliste dhe delireve të çmendura në mbarë botën. Në të njëjtën kohë një ndjenjë përgjegjësie u çrrënjës nga zemrat tona dhe rinia energjike ja në kthetrat e bohemianizmit; çdo ditë një fantazi e re i tërhiqte masat pas vetes dhe shpirta të caktuar të lirë dhe të pavarur si dhe natyra të helmuara, e shprehin devijimin, mohimin dhe ankesën për çdo vlerë tonën duke e lënë vetveten të drejtohëshin nga rrymat destinacioni dhe fati i të cilave është gjithmonë i pasigurtë. Tani na ka rënë ne përsipër kjo barrë; ajo ka rënë mbi këdo që e do vendin dhe popullin e tij për të bërë të mundur eliminimin e gjithë këtyre çrregullimeve dhe rizgjimën e aktivizmit tonë pasiv në përputhje me horizontet e filozofisë sonë. Duke u udhëhequr nga pjesa më e çmuar e shpirtit kombëtar dhe duke përdorur vullnetin tonë sa më shumë që të mundemi; me një vendosmëri të forcuar prej kaq shumë votesh shtypjeje, gabimesh dhe keqtraktimi, ashtu si apostujt e Jezusit dhe muslimanët e parë, ne duhet të themi “Le të mblidhemi, dhe të përpiqemi të shkojmë kudo me idenë se “Ku jeton një njeri, duhet të ekzistojë besimi, konsiderata për të tjerët dhe dija” duke bërë kështu që jeta e jonë të marrë peshë dhe thellësi për shkak të lëvizjes nga njëri emigrim tek tjetri. Që tani e tutje ne duhet të përpiqemi të endim pëlhurën e jetës sonë në vegjën e mendimit dhe verpimit të heronjëve

të së vërtetës, të cilët kanë fituar kënaqësinë e Zotit. Ne besojmë se pothuajse çdokush në tokë do ta vlerësojë dhe admirojë dorën e shtrirë drejt tyre prej zemrave të një kalibri të tillë. Në se kjo ndodh, poseduesit e këtij vullneti të pjekur, të shëndodhë dhe dinjitoz do të jenë mbartësit e fesë, vendit, gjuhës dhe idaleve tona; ata do të udhëtojnë në të gjithë botën, do të takohensi Khidri kudo që të shkojnë dhe aho që tdo tu paraqesin njerëzit do të pranohet dhe gëlltitet si një eliksir i jetës. Kudo që ata të shkojnë, do të rrethohen nga njerëz besnikë dhe miqësorë siç ishte rasti i Moisiut dhe Khidrit; ata do të ndërtojnë barriera mbrojtëse dhe mure të pakapërcyeshme për ata të cilët presin Dhilkarnejnin³⁵ dhe do të hapin rrugën që të shpie drejt ringjalljes me ndihmën e këtyre miqve të cilët kanë kaluar jetën në izolim për vite me rradhë. Kushedi, ndoshta ata do të jenë të parët që do të gëzojnë realizimin e rilindjes më të madhe dhe më gjithpërfshirëse të cilën ne e presim prej kaq shumë shekujsh.

Shënime

¹Shih Bukhari, Janaiz, 79.

²A'raf 7: 28; Hud 11 : 49.

³Shih Ra'd 13 : 11, Anfal 8 ; 53.

⁴Ils al-kalimetullah: Njohja e vlerave më të larta të fjalës së Zotit dhe të vërtetave islamike me anë të përhapjes së emrit dhe fjalës së Tij duke ua mësuar atë të tjerëve.

⁵Hurufitë: Sekt i së shkuarës, i cili nxirrte konkluzione nga shkronjat, duke përdorur onomancinë.

⁶Qurtubi, al-Jami'u li-ahkam-il Kur'an, 4/251

⁷Disa Sahabe të rinj të cilët nuk patën shensin të merrnin pjesë në luftën e Bedrit, dëshironin të lufton në fushëbetejë. Të verbuar nga dëshira e tyre, ata nuk qenë në gjendje tëvlerësonin siç duhet gjykimin e mençur të Profetit, duke ndenjur për të mbrojtur qytetin, Medinën. Ky konsiderohet Zalla, lapsus.

⁸Qurtubi, al-Jami'u Li-ahkam-il Kur'an, 4/251.

⁹al-Jami'u Li-ahkam-il Kur'an

¹⁰Abu Daëud, Adab, 114; Timidhi , Zuhd,39;Adab,57;Ibn-i Maja,Adab,37.

¹¹Qurtubi, al-Jami' u Li-ahkam-il Kur'an, 16/36.

¹²Tirmidhi, Fitan, 7.

¹³Ibn Maja, Fitan, 8.

¹⁴Musnad, 6/396.

¹⁵Shih shënimin 7.

¹⁶Ky këshill quhet ahl al hal ëal 'aqd që do të thotë “ata të cilët u japin zgjidhje çështjeve.”

¹⁷Muhaxhirët janë muslimanët e parë të cilët emigruan nga Meka në Medinë, ndërsa ensarët ishin vendasit në Medinë të cilët i ndihmuan këta emigrantë dhe muslimanë të parë.

¹⁸Miraxhi: Ngritja e Profetit Muhammed në qiell ose Udhëtimi i tij i natës drejt Qiellit.

¹⁹Keuther: Ujë Parajse, bollek, mirësi.

²⁰Sakina: Paqe, qetësi. Ëngjëjt dhe qëniet shpirtërore quhen kështu për shkak të një gjendjeje të tillë që posedojnë.

²¹Babiali Raid (1913): Sulmi i armatosur i kryer nga partia Ittihad ve Terakki në zyrat qëndrore të qeverisë së perandorisë osmane me qëllim rrëzimin e administratës.

²²Khidri, paqja qoftë mbi të ishte një përsone i bekuar emri i të cili është përmendur në komentet e Kur'anit dhe në hadithe (Bukhari, Tefsir, 249). Khidër (apo Khadir) ka kuptimin e gjelbërimit apo të një vendi me bollek bimësh të gjelbërta. Sipas një hadithi, Khidri u quajt kështu për arsye se ai u ul në një tokë të shkretë e cila u bë e gjelbër dhe plot bimësi më pas (pasi ai u ul mbi të) (Bukhari, Envija 29). Raportohet gjithashtu se që kur Khidri piu ujë nga një burim në parajsë, çdo vend ku hidhte hapin, bëhej i gjelbër (Makdisi III, 78).

²³Një nga profetët emri i të cilit përmendet në Kur'an (37:123 – 130), Elijah (ose Eliasi), paqja qoftë mbi të, jetoi në shekullin e nëntë përpara Krishtit dhe erdhi për të rigjallëruar besimin dhe ligjet e Moisiut në rradhët e popullit të Izraelit. Raportohet se ai u ngrit në një nivel të ndryshëm jete dhe u takua me Khidrin në çdo sezon pelegrinazhi (Shih Nursi, Letrat, Letra e Parë).

²⁴Judi: Mali ku varka e Profetit Nuh qëndroi sipas Kur'anit, surja Hud 11:44: “ E iu pat thënë: ‘Oj tokë, përbije ujin tënd, dhe o qiell, ndërpreje (shiun), uji u tërhoq, urdhëri u zbatua dhe ajo (anija) u ndal në (kodrën) Xhudij, e u tha: ‘I shkatërruar qoftë populli mizor!’”. Mali Judi ndodhte në juglindje të Turqisë. Shumë afër me kufirin turko-iraken. Me numrin e madh të shpellave, me të përpjetat e buta dhe sigurisht me majën madhështore, peisazhi i tij duket i përshtatshëm për tu akomoduar në të pas fluturimit. Raportohet gjithashtu që Judi mund të jetë emri i një mali që shtrihet mes Mosulit, Xhizras dhe Daskut.

²⁵ Ghassal : Përsoni i cili kryen ritualin e larjes së të vdekurit në islam.

²⁶ Tuba al-Xhannah: Emër i një peme në parajsë me lule dhe fruta të shijshëm të çdo lloji të imagjinueshëm dhe të paimagjinueshëm.

²⁷Ihsan: a. Nder, dashamirësi, bukuri. b. Kufizim, pastërti nga mëkatet apo gjërat jo të pështatshme; c. Të vepruarit dhe lutja sikur të ishim duke parë Zotin, dhe qenia të vetëdijshëm se ai na sheh ne megjithëse ne nuk e shohim atë.

²⁸A'raf: Vënd i sheshtë, fushë e cila ndodhet ndërmjet apo ndan parajsën dhe ferrin.

²⁹Një proverb turk, secili mban përgjegjësi për vetveten dhe për atë që bën; ajo që bëj unë nuk është puna jotem ti nuk do të pyetësh apo të japësh llogari për atë që bëj unë prandaj merru me punët e tua.

³⁰Ai që do të vijë njihet si një përson i aftë; unë bëj diçka tani, jam i aftë, kam potencialin apo kontrollin e plotë, prandaj unë do të përpiqem të bëj më të mirën për rastet që më vijnë dhe të korr çfarë mbjell; nëse je i aftë bëje edhe ti të njëjtën gjë në të kundërt më lër të qetë.

³¹Lufta Kombëtare: Lufta turke për të shpëtuar Turqinë nga pushtimi i të huajve pas Luftës së Parë Botërore (1919-1922).

³²Kushtetuta e re dhe sistemi parlamentar në historinë otomane i cili u shpall sëpari në 1876 por që nuk funksionoi si duhet për shkak të lufërave të pafundme, deri në një shpallje të dytë në 1908.

³³Tafhfut at Tahafut (inkoherenca e inkoherencës) nga Ibn Ruzhdiu dhe Tahafut al Falasifa (inkoherenca e filozofëve) nga Imam Gazaliu, janë dy veprat më të famshme në historinë e filozofisë.

³⁴ Kryengjelli i cili do ti fryjë Surit, borisë në Ditën Ringjalljes.

³⁵Dhulkarneini: “Ai i dy brirëve.” Emri i tij përmendet në siren e tetëmbëdhjetë të Kur’anit. Burime të ndryshme e paraqesin atë si të Dërguar apo Profet ndërsa Aliu, Kalifi i Katërt, ka thënë se ai qe një shërbëtor besnik i Zotit e jo Profet e as mbret.

Kopertina e pasme

Gyleni i bën jehonë mësuesit të madh Rumiut, duke na treguar se nuk duhet injoruar doktrina e shkaqeve e as nuk duhet ndenjur kot pa bërë asgjë duke pritur për ndihmën nga Zoti, por përkundrazi duhet të vazhdojmë të përpiqemi në mënyrë që ta transformojmë këtë botë të prishur në një botë paqeje dhe drejtësie, në përputhje me vullnetin e Zotit. Ai as nuk e mohon realitetin duke i kthyer shpinën modernizmit e as nuk bie në hidhërim, moskupëtim dhe zemërim por përkundrazi, ai i nxit muslimanët të edukojnë dhe të kontrollojnë veteveten dhe të përdorin burimet e tyre të brendëshme për të rifituar dhe rikthyer kulturën dhe identitetin e tyre si dhe kujdesin e tyre në ndjekjen e fese. Ky përbën ekstenzialisht një mesazh paqeje dhe shprese një mesazh i cili shprehet më së miri në librin Statuja e Shpitrave tanë.

“Vëllazëria e njerëzve të përkushtuar të cilët i takova në Turqi është një komunitet muslimanësh të cilët u shfaqen në Anadoll nën tutelën e Rumiut, poetit të madh dhe mësuesit shpirtëror të shekullit të trembëdhjetë. Intelektuali bashkëkohor dhe udhëheqësi shpirtëror i kësaj bashkësie, ai i cili frymëzoi një pjesë të madhe të punës edukative dhe shpirtërore të studentëve të tij turq, është M. Fethullah Gylen. Këta dy njerëz të shenjtë që vijnë nga epoka të ndryshme, kanë një ngjashmëri të madhe në faktin se ata i shikojnë muslimanët dhe jomuslimanët si grupe potencialisht të aftë për të negociuar në këtë botë të trazuar në të cilën gjendemi tani.”

Dr. Lynn E. Mitchell

Drejtor i Studimeve Fetare të Universitetit të

Houston

“... njerëzit që takuam nëpër shkolla si dhe shponsorët e gjithë punëve të mira dhe të rëndësishme të frymëzuara nga mësimet e Fethullah Gylenit, janë shembuj të përpjekjeve serioze dhe shërbimit të cilin nuk kisha mundur ta shikoja dhe dëgjoja më parë në gjithë jetën time. Unë nuk mund ta imagjinoj një paraqitje më origjinale të islamit sesa ajo që pashë.”

Dr. Jill Carroll.

Qendra Boniuk për Studimin dhe Përparimin në Fushën e Tolerancës
Fetare

Rice University Texas

“Disa vite më parë unë jam njohur me shkrimet e Xhelaliddin Rumiut nga një koleg i im i cili është njëri me një botë shpirtërore të thellë. Por tani unë kam gjetur një “Rumi” të ri dhe bashkëkohor, jeta dhe mësimet e të cilit janë duke lënë gjurmë jo vetëm në botën e islamit të sotëm por edhe në lëvizje të mëdha fetare që përjetohen në mbarë botën.”

Rev. Donald S. Nesti, CSSp,

STD

Profesor i Teologjisë, Universiteti i St. Thomas,
Houston, Texas

Disa shkolla të mendimit islamik e përqëndruan mendimin e tyre tek individët, por dështuan në pajisjen e tyre me instrumentet e nevojshme për të ruajtur barazpeshën me epokën dhe për të përqafuar çdo moshë. Shkolla të tjera u morën me ide dhe mendime të cilat nuk i merrnin në konsideratë mendjen dhe zemrën njëkohësisht. Lëvizja e Gylenit ka kryer një vlerësim kuptimplotë të njerëzimit dhe me anë të orientimit të individëve drejt angazhimit në vepra që janë në përputhje me kohët moderne, ajo i adresohet çdo aspekti të jetës.”

Dr. Abd al-Halim Uëays

Profesor i Historisë së Fëve, Zakaik University,

Egypt